



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT




100 Vjet Pavarësi

# RAPORT

## PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2011

---



LIGJ  
Nr.10335, datë 2.12.2010  
PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2011  
Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI:

Buxheti i Shtetit për vitin 2010 është:  
Të ardhurat  
Shpenzimet  
Deficiti

360955 milionë lekë  
410721 milionë lekë  
49766 milionë lekë

Neni 2

Tiranë, 2012



**Znj. Jozefina TOPALLI (ÇOBA)**  
**Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**  
**TIRANË**

*Në përputhje me kërkesat e nenit 164, të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, nenit 18, të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, si dhe të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ju paraqesim raportin “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2011”.*

*Në këtë raport, të dhënat dhe problematika e pasqyruar dhe trajtuar, mendimet e shprehura për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar, si dhe përfundimet e veprimtarisë audituese mbikëqyrëse për vlerësimin e veprimtarisë së kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimin e brendshëm, janë produkt i nxjerrë nga rezultatet përfundimtare të auditimeve të ushtruara nga KLSH për llogari të zbatimit të Buxhetit të Shtetit të vitit 2011 dhe shfrytëzimit të materialeve dhe buletineve statistikore të përgatitura nga ministritë dhe institucionet qendrore lidhur me zbatimin e Buxhetit të këtij viti.*

**Bujar LESKAJ**

**Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit**

*Tiranë, më 28.09.2012*

## PËRMBAJTJA:

		Faqe
Përmbledhje		3
Hyrje		21
<b>PJESA E PARË</b>	<b>PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2011</b>	<b>25</b>
Kapitulli I	Treguesit e planit të buxhetit të shtetit të vitit 2011	25
Kapitulli II	Treguesit kryesorë fiskalë të buxhetit të konsoliduar	26
Kapitulli III	<i>Realizimi i të ardhurave të buxhetit të shtetit</i>	29
III.1	Të ardhurat nga ndihmat	30
III.2	Të ardhurat tatimore	31
III.2.a	Realizimi të ardhurave tatimore nga tatimet e doganat	31
III.3	Të ardhurat jotatimore	50
III.3.a	Rregullshmëria e përcaktimit dhe e kalimit të fitimit të BSH	50
III.3.b	Të ardhurat nga institucionet buxhetore	51
Kapitulli IV	<i>Administrimi i shpenzimeve të buxhetit të shtetit</i>	56
IV.1	Shpenzimet korrente	59
IV.2	Shpenzimet për fondin rezervë të KM dhe të kontigjencës	62
IV.3	Shpenzimet për investime kapitale	66
IV.3.a	Shpenzimet për investime të brendshme	67
IV.3.b	Shpenzimet me burime të huaja financimi	69
Kapitulli V	<i>Deficiti i përgjithshëm buxhetor dhe financimi i tij</i>	75
V.1	Mbi saktësinë e mbajtjes së llogarisë “Depozitë e Qeverisë”	76
V.2	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për arkëtimet e pagesat e kryera	79
V.3	Rakordimi i bankave të nivelit të dytë me BSH dhe degët e thesarit	81
VI.	Borxhi i brendshëm dhe i jashtëm shtetëror	82
VI.1	Borxhi i brendshëm dhe shërbimi i tij	84
VI.1.a	Përcaktimi i nevojave për huamarrje, llogaritja e nevojave për sasinë e bonove të thesarit dhe obligacionet që emetohen	86
VI.1.b	Mbi rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit	90
VI.1.c	Mbi rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të obligacioneve	92
VI.1.d	Mbi ecurinë e tregut të bonove të thesarit dhe obligacioneve	93
VI.1.e	Mbi borxhin e garantuar në tregun e brendshëm	98
VI.2	Borxhi i jashtëm shtetëror dhe shërbimi i tij	101
VI.2.a	Mbi rregullshërinë e evidentimit të marrveshjeve të nënhuave	102
VI.2.b	Shpenzimet për shërbimin e borxhit të jashtëm	107
VI.2.c	Mbi zbatimin e planit të buxhetit të shtetit	109
Kapitulli VII	<i>Për përgatitjen dhe saktësinë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit.</i>	119
Kapitulli VIII	<i>Zbatimi i rekomandimeve të lëna në Ministrinë e Financave për zbatimin e buxhetit të vitit të kaluar.</i>	120
Kapitulli IX	<i>Administrimi i buxhetit të pushtetit vendor</i>	122
IX.1	Në fushën e të ardhurave	123
IX.2	Në fushën e të shpenzimeve	126
Kapitulli X	<i>Administrimi i buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore</i>	129
X.1	Buxheti i sigurimeve shoqërore	132
X.2	<i>Buxheti i sigurimeve shëndetësore</i>	150
X.3	Rekomandimet e bëra nga KLSH në ISSH dhe ISKSH si dhe zbatimi i tyre	157

<b>PJESA E DYTË</b>	<b>MENDIME PËR RAPORTIN E KM PËR SHPENZIMET E VITIT TË KALUAR FINANCIAR, PARA SE TË MIRATOHET NGA KUVENDI</b>	179
<b>PJESA E TRETË</b>	<b>MBI MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN, SI DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM</b>	186
Kapitulli I	Mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të mbrendshëm dhe menaxhimit financiar.	188
Kapitulli II	Mbikëqyrja e veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm	196
Kapitulli III	Marrdhëniet e bashkpunimit ndërmjet KLSH me Ministrinë e Financave (NJQH/AB dhe DIFP)	212
Kapitulli IV	Zbatimi i masave të rekomanduara nga KLSH për NJQH/AB	215
<b>ANEKSE</b>		
Aneksi nr.1	Lista e subjekteve të audituara për zbatimin e buxhetit të vitit 2011	221
Aneksi nr. 2	Investimet me financim të brendshëm	223
Aneksi nr. 3	Investimet me financim të huaj	224
Aneksi nr.4	Të dhëna përmbledhëse sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar efektet negative në të ardhura, dëmet ekonomike në shpenzime dhe detyrimet debitore.	225
Aneksi nr.5	Lista e subjekteve të audituara për vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm	226
Aneksi nr.6	Fjalori i shkurtimeve	229

## PËRMBLEDHJE

### I. *Kuadri rregullator ligjor*

Në zbatim të ligjit nr. 8417, datë 21/10/1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, neni 164, pika 1, gjerat a-b; ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, neni 18, pika 1, gjerat a-b; dhe të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 62 e 63; Kontrolli i Lartë i Shtetit paraqet në Kuvendin e Shqipërisë Raportin “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011”.

### II. *Fusha audituese*

Theksojmë se si arrijtet, ashtu dhe parregullsitë dhe dëmet ekonomike që përbëjnë ose jo vepër penale, rekomandimet e dërguara për përmirësimin e gjendjes, vlerësimet për menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditimin e brendshëm, si dhe niveli i zbatimit të masave të rekomanduara, të pasqyruara dhe trajtuara në këtë Raport, *janë produkt i shqyrtimit dhe nxjerrjes së konkluzioneve nga raportet përfundimtare të auditimeve të kryera e të evaduar për llogari të buxhetit faktik të vitit 2011.*

Auditimi për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011, ka përfshirë fushën e ekonomisë, të industrisë, bujqësisë, shëndetësisë, arsimit, rendit publik, transportit dhe telekomunikacionit, mbrojtjes së ambientit, dhënies me qira të objekteve shtetërore, administrimit të pronës dhe një sërë aktiviteteve të tjera ekonomike e sociale.

Objekt auditimi kanë qenë institucionet qendrore dhe vendore, disa sipërmarrje publike ku shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, si dhe një numër subjektesh (institucionesh) të pavarur.

### III. *Objektivi i Raportit*

Objektivi kryesor është dhënia e opinionit për raportin që Ministri i Financave dhe Këshilli i Ministrave paraqet në Kuvend “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011”, i formuluar si rezultante e të gjithë auditimeve të kryera për llogari të buxhetit të vitit 2011, mbi rregullaritetin dhe ligjshmërinë e transaksioneve, saktësinë e raportimeve në lidhje me zbatimin e buxhetit, raportimin e borxhit publik, realizimin e të ardhurave dhe administrimin e shpenzimeve, përdorimin e fondit rezervë të KM, funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

#### IV. *Opinionit i përgjithshëm mbi zbatimin e Buxhetit të Shtetit 2011*

Referuar rezultateve përfundimtare të auditimeve të evaduara dhe raportuara, me objekt zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2011, përfshirë mendimet për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit financiar 2011, para se të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, *opinionit i përgjithshëm i KLSH*, është se

- përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2011;
- zbatimi, ndjekja dhe rishikimi tij;
- të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre;
- kontrolli, kontabiliteti, raportimi dhe auditimi i këtij buxheti;

Janë kryer në respektim të kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, ndryshuar me ligjin nr. 10450, datë 14/7/2011; ligjit nr. 10496, datë 22/12/2011 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit”, nr. 4, datë 14/12/2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011” të ndryshuar; dhe ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

*KLSH vlerëson pozitivisht punën e bërë nga Qeveria dhe veçanërisht nga ana e Ministrisë së Financave në drejtim të konsolidimit të mëtejshëm të reformave të ndërmarra për menaxhimin efektiv të financave publike, të ruajtjes së qëndrueshmërisë së treguesve makroekonomikë dhe fiskalë. Gjithashtu, dhe në ministritë, institucionet e tjera qendrore dhe vendore, si dhe entet publike të audituara, janë bërë përpjekje serioze për përmbushjen e objektivave dhe realizimin e detyrave të marra përsipër për zbatimin buxhetit të vitit 2011, si dhe për kryerjen e reformave të ndërmarra në kuadër të “Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit*

#### V. *Treguesit, gjetjet dhe rekomandimet kryesore*

Më poshtë paraqesim konstatimet, gjetjet dhe rekomandimet më kryesore të verifikuara dhe të dërguara subjekteve të audituara për llogari të zbatimit të buxhetit të vitit 2011, dhe konkretisht:

Treguesit e konsoliduar fiskalë të buxhetit të shtetit të vitit 2011 janë realizuar përsa vijon:

\* *Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit* janë realizuar në vlerën 330,475 milionë lekë dhe përfaqësojnë 25.14 të PBB-së të vitit 2011, nga 26.22% të PBB-së që rezultoi në vitin 2010. Në krahasim me të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës, ato rezultojnë me rritje në shumën 5,754 milionë lekë.

\* *Shpenzimet e përgjithshme buxhetore* janë realizuar në vlerën 376,652 milionë lekë dhe përfaqësojnë 28.63% të PBB-së të vitit 2011. Në krahasim me shpenzimet e realizuara në vitin 2010, ato paraqiten me rritje në shumën 13,600 milionë lekë. Ndërkohë që, *shpenzimet për investime kapitale* janë realizuar në vlerën 70,679 milionë lekë duke zënë 5.38% të PBB-së të vitit 2011, nga 67,492 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2010 ose në nivelin 5.45% të PBB-së të rezultuar në vitin 2010.

\* *Deficiti i përgjithshëm i buxhetit* në fund të vitit 2011 rezultoi në vlerën 45,877 milionë lekë nga 46,812 milionë lekë të programuara ose në masën 98%, kundrejt përcaktimit vjetor. Kundrejt PBB-së të vitit 2011, niveli i deficitit këtë vit arriti në 3.49%, nga 3.07% të rezultuar në vitin 2010, me një rritje prej 0.42 pikë përqindje.

\* *Borxhi publik në total*, në fund të vitit 2011 rezultoi në vlerën 772,581.5 milionë lekë ose në masën 58.76% kundrejt PBB-së të këtij viti, nga 715,518.5 milionë lekë që rezultoi në vitin 2010 dhe që përfaqësonte 57.79% të PBB-së të vitit 2010. Nga ky borxh, *borxhi publik i qeverisjes qendrore* rezultoi 772,364 milionë lekë dhe *borxhi i qeverisjes vendore* 217.8 milionë lekë.

\* *Stoku i borxhit të brendshëm* në fund të vitit 2011 rezultoi me rritje kundrejt vitit 2011 në shumën 31,210 milionë lekë, nga 407,372 milionë lekë në vitin 2010 në 438,582 milionë lekë në vitin 2011, ose në masën 7.66% më shumë. Në raport me PBB-në e vitit 2011, ai rezultoi në masën 33.36%, nga 32.90% të PBB-së që zinte një vit më parë, me një rritje prej 0.46%.

Ndërsa, *stoku i borxhit të jashtëm shtetëror* në fund të vitit 2011 arriti në 333,782 milionë lekë ose në masën 25.39% të PBB-së të këtij viti, kundrejt 307,999 milionë lekë rezultuar në fund të vitit 2010, ose në masën 24.88% të PBB-së të vitit 2010, me një rritje në vitin 2011 kundrejt vitit 2010 në shumën 25,783 milionë lekë ose në masën 8.38% më tepër.

\* *Borxhi i qeverisjes vendore* në fund të vitit 2011 rezultoi 217.8 milionë lekë ose 0.016% të PBB-së, nga 147.5 milionë lekë ose 0.012% të PBB-së që rezultoi në vitin 2010.

### ***V.1 Mbi menaxhimin e borxhit publik***

Nga analiza e treguesit të borxhit publik kundrejt PBB-së, në harkun kohor të tre viteve të fundit 2009-2011, rezulton se ky tregues varion në nivelet 57.78%-59.30% të PBB-së, pra shumë afër kufirit ligjor prej 60% (zona e rrezikut).

Me synim marrjen e masave parandaluese për ndryshimin e dinamikës së borxhit, me tendencë uljen e nivelit të tij, referuar praktikave të disa vendeve të Eurozonës, KLSH i ka rekomanduar MF që :

a) Brenda dy viteve në vijim, të ndërmerret nisma për hartimin e një plani veprimi për të **propozuar amendime kushtetuese**, ku të përcaktohet që: **“Borxhi total publik nuk duhet të tejkalojë kufirin limit prej 60% të PBB-së”**.

Gjithashtu, me qëllim mostejkalimin e këtij niveli, të studiohet mundësia e parashikimit të vendosjes së një pragu të nivelit të borxhit publik kundrejt PBB-së, pas të cilit (nëse ky prag kalohet) Qeveria duhet të marrë masa për balancimin e buxheteve.

Në këtë Raport, ne si KLSH vlerësojmë përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e treguar nga ana e MF me dakordësinë e shprehur për rekomandimet e dhëna nga institucioni ynë. Kështu, *me shkresën nr. 4637/17, datë 14/9/2012 “Mbi rekomandimet e raportit përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet”, të nënshkruar nga Ministri i Financave në lidhje me rekomandimin e mësipërm cilësohet: - shprehemi dakord me ndërmarrjen e kësaj inisiative ligjore”.*

b) Nga auditimi në MF kemi konstatuar se në ligjet për buxhetin e vitit 2011, nuk janë vendosur kufijtë në lidhje me totalin e borxhit shtetëror dhe totalin e shumës së garancive, sikurse përcakton neni 58 “Kufijtë e borxhit publik” i ligjit nr. 9936 datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”.

Nga MF argumentohet se: “Në lidhje me përcaktimin e kufijve të totalit të stokut të borxhit, përsëri jemi të mendimit se në kushtet e ndryshimit të kursit të këmbimit, rezultatet e stokut të borxhit janë të ndryshme dhe mund të sjellin *pasoja negative* për tregun e jashtëm dhe të brendshëm, si dhe në *perceptimin e kreditorëve për Shqipërinë*”.

Përsa sipër, *vlerësojmë si objektive komentet e bëra nga MF, por meqënëse përcaktimi i kufijve të borxhit është detyrim ligjor, KLSH ka rekomanduar që:*

Në ligjin “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013”, të përcaktohet kufiri për totalin e borxhit shtetëror dhe borxhit të garantuar, ndërkohë MF të ngrejë një grup pune për rishikimin e nenit 58 “Kufijtë e borxhit publik”, të ligjit nr. 9936 datë 26/06/2008.

Reagimi është pozitiv. Në shkresën *nr. 4637/17, datë 14/9/2012 të Ministrisë të Financave theksohet: - “jemi dakord me ndërmarrjen e kësaj inisiative ligjore dhe rishikimin e kuadrit ekzistues”.*

## ***V.2 Mbi garancitë shtetërore***

a) Në drejtim të borxhit të garantuar, kemi konstatuar se mungojnë memorandumet e mirëkuptimit për marrëveshjet e garancive të lidhura nga MF.

Me synim domosdoshmërinë e vendosjes së procedurave për realizimin e marrëdhënieve në funksion të zbatimit të nenit 38 “Dhënia e garancisë shtetërore të huasë” dhe nenit 43 “Kthimi i garancisë shtetërore të huasë”, të ligjit nr. 9665, datë 18/12/2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në RSH”, KLSH ka rekomanduar që:

MF (Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit) të përgatisë dhe t’i propozojë Këshillit të Ministrave përmirësimin e ligjit nr. 9665, datë 18/12/2006, ku në një nen të veçantë të përcaktohen kushtet dhe kriteret e specifikuar të marrëdhënieve të



mirëkuptimit midis MF dhe përfituesit të garancisë, duke i kthyer këto në detyrime ligjore dhe duke eliminuar në këtë mënyrë nënshkrimin e marrëveshjeve të veçanta, për të lehtësuar procesin e realizimit të marrëveshjeve të garancive, referuar zbatimit të këtyre detyrimeve ligjore.

Në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: “Ministria e Financave në procesin e rishikimit të ligjit të borxhit do të vlerësojë përmirësimet dhe në aspektin e garancive”.

b) Duke u nisur nga shuma e konsiderueshme e papaguar nga huamarrësit dhe përfituesit e garancive, detyrime këto që *deri në fund të vitit 2011 arrijnë në shumën 1.69 miliard lekë*, referuar dhe problematikës së shfaqur nga ujësjellësit, të rezultuara në vijimësi këto vitet e fundit, të konkluduara në raportet e përvitshme të paraqitura nga KLSH; gjithashtu, nga mungesa e zgjidhjes së kësaj problematike, pavarësisht takimeve të shumta nga struktura përkatëse e MF me institucionet përgjegjëse, *kemi rekomanduar që:*

□ Mbështetur në ligjin nr. 10294, datë 1/7/2010 “Për Inspektimin Financiar Publik”, Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik të *nisë kryerjen e inspektimeve financiare në ndërmarrjet e ujësjellsave përfituese të nënshpallura dhe garancive*, me synim zgjidhjen e problematikave në lidhje me:

\* Dokumentacionin, inventarizimin dhe kontabilizimin e përfitimeve nga projektet.

\* Menaxhimin e fondeve publike në drejtim të përmirësimit të rezultateve financiare, të cilat deri tani kanë rezultuar në paaftësi paguese të njësisë në shuma të konsiderueshme.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit Nr. 191/5 dt. 08.05.2012 ndërmjet KLSH dhe MF, nëse MF e gjykon të arsyeshme dhe të nevojshme, mund të kontribuojë dhe KLSH në këtë drejtim.

Në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: “shprehemi dakord”.

### ***V. 3 Mbi menaxhimin e investimeve publike***

Me synim rritjen e efektivitetit të menaxhimit të fondeve për shpenzime publike, *KLSH ka rekomanduar që:*

a) Në Udhëzimin plotësues që Ministri i Financave nxjerr çdo vit për zbatimin e buxhetit vjetor, Kapitulli I “Procedura specifike shtesë për zbatimin e buxhetit të shtetit “Detajimi i fondeve buxhetore”, *të shtohet si detyrim përfshirja në financimin e vitit “në radhë të parë”, jo vetëm si detyrim ligjor dhe ekonomik, por edhe si dëshmi e bashkëpunimit të sigurtë dhe të drejtpërdrejtë Qeveri-Biznes:*

□ E të gjitha investimeve të kontraktuara, për punime të cilat rezultojnë të realizuara dhe nuk janë financuar për vitin ushtrimor, si dhe atyre të cilave u mbaron afati kontraktual i punimeve në vitin që po programohet, për diferencën e punimeve të mbetura.

□ Për projektet e investimeve “objekte të reja”, të synohet në financimin e projekteve në vlerën e plotë të projektit, kur vlera e tyre është e realizueshme brenda vitit buxhetor.

b) Nga shqyrtimi i vendimeve të miratuara nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve “Për shpërndarjen e fondeve të zhvillimit të rajoneve” është konstatuar që vendimet përmbajnë vetëm vlerën e alokuar në nivel projekti, dhe nuk japin një pamje të qartë të fondeve, sa është vlera e plotë, sa janë alokuar progresivisht deri në vitin buxhetor korrent, si dhe sa mbetet për t’u alokuar në vitet e ardhshme”.

Për këtë, *KLSH ka rekomanduar që:*

□ Në aneksin nr. 3 të ligjit “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013”, të vendoset detyrimi që: “Vendimi i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve për detajimin e granteve konkurruese në nivel projekti duhet të përmbajë:

a) Vlerën e plotë të projektit për objektet e reja apo vlerën e kontratës së lidhur për objektet në proces.

b) Vlerën e fondeve të alokuara dhe të realizuara deri në vitin korrent buxhetor.

c) Alokimin e fondit në vitin korrent.

d) Vlerën e mbetur për buxhetim në periudhën pasardhëse”.

Në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: *“Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve i ngritur pranë Zyrës së Kryeministrit, në detyrat funksionale të tij të sanksionuara edhe sipas germës g, të pikës IX, të aneksit 3 të ligjit për buxhetin e çdo viti, në dokumentacionin e marrë nga sekretariatet teknike të ministrive të linjës përfituese nga këto fonde, ka të evidentuar dhe analizuar informacionin që propozohet për t’u shtuar në Aneksin 3 nga ana e KLSH-së. Nisur nga ky fakt, e gjykojmë të drejtë rekomandimin tuaj që ky informacion të bëhet pjesë e Aneksit 3 të ligjit të buxhetit 2013”.*

Sa më sipër, në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: *“rekomandimi ka gjetur pasqyrim në pikën 65 të udhëzimit nr. 2, datë 6/2/2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, por do të gjejë pasqyrim në udhëzimin plotësues të zbatimit të buxhetit për vitin 2013”.*

#### ***V.4 Mbi fondet e kontigjencave***

Kemi konstatuar se fondi i subvencionit i MF është alokuar nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit, që në 6/mujorin e parë të vitit 2011. Mbështetur në përcaktimet në Ligjin Organik të Buxhetit dhe në ligjin vjetor të buxhetit, *KLSH ka rekomanduar :*

□ Planifikimin në ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2013 dhe në vazhdim, nga MF të fondeve kontigjencë për ruajtjen e deficitit buxhetor, me të drejtë të përdorimit nga Kuvendi i Shqipërisë. E drejta e rialokimit të këtij fondi të përcaktohet nga Kuvendi, për përdorim nga KM vetëm në fund të periudhës vjetore buxhetore, atëherë kur realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve janë progresivisht, konform treguesve buxhetorë të miratuar të vitit.

Në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: “Përcaktimi i propozuar nga ana e ekspertëve të KLSH është i drejtë dhe mund të bëhet pjesë e ligjit të buxhetit të vitit 2013”.

### ***V.5 Mbi monitorimin e Buxhetit të Shtetit***

Duke marrë shkas nga konstatimi që në raportin “Mbi monitorimin e realizimit të shpenzimeve të vitit 2011”, i cili është pjesë e raportit që MF ka dërguar në KM “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2011”, treguesit e realizimit të shpenzimeve të ministrisë së linjës nuk përmbajnë shpenzimet faktike të financuara nga të ardhurat jashtë limitit apo edhe nga financimi i huaj, si dhe që për rrjedhojë këto raporte nuk rakordojnë me raportet e konsoliduara të MF për shpenzimet faktike, *KLSH ka rekomanduar që:*

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit t’i kërkohet ministrive të linjës që në raportet e monitorimit në një rubrikë të veçantë të trajtohen shpenzimet faktike të kryera për të ardhurat jashtë limitit apo edhe mospërputhjet e financimit të huaj.

Në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012, ndër të tjera cilësohet se: “kjo kërkesë do të jetë pjesë e udhëzimit të monitorimit, i cili është në proces”.

### ***V.6 Mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore***

Gjatë auditimeve në disa ministri, institucione të tjera qendrore dhe vendore, kemi konstatuar pagesa të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për kthimin e nëpunësve civilë në vendin e punës me impakte negative financiare të konsiderueshme. Në disa raste specifike, kemi vërejtur pagesa njëkohësisht të dy punonjësve në një vend pune, si p.sh. pagesën e vendimeve gjyqësore në administratën tatimore për vitin 2011 me rreth 35 milionë lekë.

Theksojmë që si KLSH do të kryejmë vitin që vjen auditim të performancës për një vlerësim tërësor të marrjes së vendimeve gjyqësore për njësitë publike, duke u përqëndruar në analizën e shkaqeve që çuan në këto vendime. Jemi të vetëdijshëm dhe nuk duam kurrësi të cënojmë pavarësinë dhe padiskutueshmërinë e vendimeve të gjyqësorit, por përballë shumë vendimeve arbitrare që kanë sjellë dëm të konsiderueshëm financiar në Buxhetin e Shtetit, në bashkëpunim me organet e Drejtësisë dhe me struktura të tjera specializuara, do të përpiqemi të identifikojmë përgjegjësitë institucionale duke dhënë rekomandimet përkatëse dhe duke informuar Kuvendin e Shqipërisë, Presidentin, Kryeministrin, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatën e Lartë.

Kemi rekomanduar që institucionet respektive të marrin masa për zbatimin e vendimeve gjyqësore, njëkohësisht të analizojnë gjendjen dhe të përcaktojnë përgjegjësinë ndaj personave shkaktarë përgjegjës, duke kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

## VI. Mbi administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet tatimore

Në vlerësim të performancës së administratës tatimore, theksojmë punën dhe përpjekjet për realizimin e të ardhurave për vitin 2011, me impakt dinamikën në rritje të të ardhurave nga njëra periudhë në tjetrën.

Megjithatë, konstatojmë që në vlerë nominale të ardhurat *nuk janë realizuar kundrejt parashikimit*. Konkretisht, *realizimi i të ardhurave është 94 përqind kundrejt parashikimit, me impakt defiqitar prej 9,085 milionë lekë.*

Ndër faktorët që kanë ndikuar negativisht në nivelin e të ardhurave tatimore kundrejt parashikimit për vitin 2011, rendisim:

- mosrritja e të ardhurave tatimore në proporcion me rritjen e numrit të subjekteve;
  - niveli i ulët i pagesës së TVSH-së;
  - rritja e subjekteve kreditore për TVSH-në dhe Tatimin mbi Fitimin;
  - rritja e subjekteve me aktivitet me humbje;
  - ulja e nivelit të arkëtimeve nga njëra periudhë në tjetrën, për TVSH-në, lojrat e fatit, taksën e qarkullimit dhe taksën e karburantit;
  - rritja e numrit të subjekteve debitore nga njëra periudhë në tjetrën;
  - mosevidentimi dhe moskontrolli i subjekteve me risk të lartë, referuar treguesve negativë që ata kanë;
  - mungesa e luftës kundër informalitetit dhe konkurrencës së pandershme në evidentimin dhe regjistrimin e subjekteve të parregjistruara;
  - moskryerja e kontrolleve nga struktura të DPT-së në Drejtoritë Rajonale Tatimore mbi ekzistencën e numrit të subjekteve mosdeklarues;
  - mosvlerësimi dhe mosndjekja nga strukturat përkatëse të DPT-së të deklarimit të numrit të kontribuesve nga subjekte të ndryshëm, ku realisht ekzistojnë mundësi dhe rezerva për rritjen e numrit të tyre dhe uljen e evazionit;
  - mosbashkëpunimi në nivelin e duhur i DPT me institucionet e auditimit të jashtëm.
- *Borxhi tatimor, për vitin 2011 rezultoi 64,734 milionë lekë dhe përfaqësoi 38.2% të planit të të ardhurave të këtij viti. Me synim uljen e nivelit të borxhit, kemi rekomanduar që nga administrata tatimore të merren të gjitha hapat ligjore për pakësimin e gjendjes së borxhit nëpërmjet zbatimit në kohë dhe me rigorozitet të procedurave ligjore të vjeljes së tij, me qëllim që subjekteve debitore të mos ju*

**parashkruhet borxhi, madje cilësia dhe shpejtësia në mbledhjen e borxhit duhet të jetë një faktor kyç në realizimin e të ardhurave të programuara të DPT.**

- Përsa i përket efektivitetit të masave shtrënguese konstatohet se ato janë aplikuar ne 42 përqind te subjekteve dhe ne vlere nga 58,565 milione leke borxhi, jane marre masa per vleren 41,717 milione leke. Ne lidhje me nivelin e arketimeve nga aplikimi i masave shtrënguese, rezultoi qe vetem 9.4 perqind e numrit të subjekteve kane derdhur detyrimet ne favor te Buxhetit te Shtetit, ose 4.8% të vlerës për arkëtim.
- Kemi konstatuar një *rritje të nivelit kreditor per kategorite e te Ardhurave tatimore nga Tatimi mbi Fitimin dhe TVSH, te cilat rezultojnë ne nivele me te larta se pagesat e kryera per to*. Kemi rekomanduar që strukturat përgjegjëse të bëjnë analiza të veçanta ku të evidentohen prirjet dhe në bashkëpunim me strukturat e kontrollit tatimor të ushtrohen kontrole sipas vlerësimit që do të bëhet.
- Për *kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore*, u konstatua se *të ardhurat nga kontributet janë pothuajse të barabarta si nga sektori publik dhe nga sektori privat, megjithëse numri i kontribuesve në sektorin privat është dukshëm më i madh krahasuar me sektorin shtetëror*. Për vitin 2011 është rritur numri i subjekteve që nuk deklarojnë kontribues për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Më gjerë problematikat e mësipërme trajtohen në Kapitullin 3.2. dhe 3.2a “Realizimi i të ardhurave nga tatimet dhe doganat”.

## VII. Mbi administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet doganore

KLSH vlerëson se për vitin 2011 administrata doganore ka ndërmarrë përpjekje serioze për reformim dhe modernizim, duke përmirësuar Kodin Doganor dhe thelluar dixhitalizimin e rregjistrimit të të dhënave doganore. Ajo ka realizuar dhe tejkaluar të ardhurat e programuara për vitin 2011. Të ardhurat tatimore nga sistemi doganor për vitin 2011 janë realizuar *në masën 101,2%, me një tejkalim në vlerë prej 1,486 milionë lekë*.

Borxhi doganor është ulur. Për vitin 2011 ai rezultoi në 2,959 mijë lekë, nga 12,298 milionë lekë në fund të vitit 2010. Pas shumë vitesh, ky borxh paraqitet me ulje, madje ulje të madhe, si në vlerë dhe në numër subjektësh. Kundrejt të ardhurave doganore të realizuara në vitin 2011, vlera e borxhit doganor zë rreth 2.3% nga 10.3% që zinte një vit më pare.

Krahas performancës së mirë, kemi konstatuar parregullsi dhe shkelje në disa degë doganore. Si pasojë e moszbatimit korrekt të dispozitave të legjislacionit doganor (Kodi Doganor dhe dispozitat zbatuese të tij) nga ana e administratës doganore, është akumuluar *një efekt negativ financiar në të ardhurat e buxhetit të vitit 2011 në formën e të ardhurës së munguar në shumën 50,323 mijë lekë*,

Ndër masat që kemi rekomanduar veçojmë rritjen e rolin mbikëqyrës të DPD mbi degët doganore, nëpërmjet kontroleve të ndryshme të strukturave të saj të specializuara, sidomos për funksionimin e regjimeve ekonomike, duke shfrytëzuar të gjithë bazën ligjore fiskale për maksimizimin e të ardhurave doganore.

**KLSH ka rekomanduar gjithashtu që DPD nëpërmjet strukturave të saj të specializuara të marrë masa për rekuperimin e borxhit në vlerën 2,959 milionë lekë.**

Me synim rritjen e efektivitetit të Auditimit të Brendshëm, veprimtaria e kësaj structure duhet të fokusohet në vlerësimin e funksionimit mbi bazë sistemesh, veçanërisht të sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e riskut dhe performancës së monitorimit, në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit për DPD-në.

Problematikat e mësipërme, llojet e masave të rekomanduara, përmbajtja e tyre dhe përgjigjet e subjekteve të audituara paraqiten në mënyrë të detajuar në Kapitullin III.2. dhe III.2a “Realizimi i të ardhurave nga tatimet dhe doganat”.

## VIII. Mbi zbatimin e buxhetit të pushtetit vendor.

Për vitin 2011, të ardhurat e grumbulluara nga vetë pushteti vendor janë realizuar në masën *77.1%*, me një *impakt deficitar në vlerë prej 3,508 milionë lekë*. Kundrejt të ardhurave të realizuara në vitin 2010, përkatësisht në shumën 11,898 milionë lekë, ato paraqiten me ulje për 106 milionë lekë.

Sipas llojit të të ardhurave vendore, rezulton se:

- Taksa lokale paraqitet me mosrealizim të theksuar, vetëm në masën 66.6% kundrejt planit, me një mosrealizim në vlerë prej 3,650 milionë lekë.
- Taksa mbi pasurinë në masën 105%, me një tejkalim në vlerë prej 92 milionë lekë.
- Të ardhurat nga tatimi mbi biznesin e vogël në masën 102%, me një tejkalim në vlerë prej 50 milionë lekë.

Nga analizimi i punës dhe nivelit të realizimit të të ardhurave të bashkive dhe të komunave nxjerrim konkluzionin se ato gjenden para një mosrealizimi të thellë, pasi pothuajse *në të gjitha bashkitë dhe komunat niveli i të ardhurave luhetet nga 50-80%*.

○ Arsyet e mosrealizimit janë të shumta, por ndër to veçojmë:

a) Mosndjekjen dhe moszbatimin me rigorozitet të përcaktimeve në kuadrin ligjor që rregullon grumbullimin e të ardhurave vendore, përfshirë udhëzimet e përbashkëta, ndërmjet MF me MB dhe DPT-në, me pasojë mosrealizimin e detyrave të planifikuara.

b) Mangësitë në bashkëpunimin dhe rakordimin me organet tatimore dhe agjentet tatimor, konkretisht ndërmjet zyrave të taksave në njësitë vendore, me Drejtoritë Rajonale Tatimore në qarqe dhe qytete, zyrat e gjendjes civile, të regjistrimit të

pasurive të paluajtshme, zyrave të kadastrës dhe të urbanistikës, *gjë që ka ndikuar si në planifikimin jo real ashtu dhe në realizimin në nivele të ulëta të taksave dhe tarifave vendore.*

c) Moskryerjen periodikisht të kontrollit fiskal dhe mosmarrjen e masave ndëshkimore ndaj subjekteve të parregullta, konform dispozitave ligjore në fuqi.

KLSH në bashkitë e audituara ka konstatuar subjekte të parregullt të cilët ushtrojnë aktivitet pa leje dhe nuk paguajnë detyrimet për taksat vendore. Ndërkohë, nga zyrat e taksave vendore në Bashki nuk zbatohen procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve vendore.

d) Mangësitë në dokumentimin e taksave dhe tarifave vendore.

e) Shkeljet e ndryshme ekonomiko-financiare me pasojë mosarkëtimin e të ardhurave nga burime të parashikuara me dispozita ligjore *në vlerën 155,8 milionë lekë*, konkretisht:

- *Në fushën administrimit të aseteve për shitjen dhe dhënien me qira të tyre.*

- *Në fushën e urbanistikës*, si rezultat i mospagesës së detyrimeve nga subjektet për marrjen e lejes së ndërtimit; mosarkëtimin të detyrimeve nga financimi i studimeve urbanistike dhe i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi.

- *Në fushën e legalizimeve të ndërtimeve pa leje*, ku nga auditimi në Drejtorinë Qendrore të AUIZNI-t dhe Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI Tiranë, Durrës dhe Vlorë, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3/4/2006 janë miratuar legalizime dhe arkëtuar më pak të ardhura. Gjithashtu, mosrealizimi i të ardhurave ka ardhur dhe si pasojë e mospërputhjes në zbatim ndërmjet ligjit nr. 9482, datë 3/4/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar; dhe vendimit të KM nr. 1180, datë 5/8/2008 “Për përcaktimin e vlerës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimit të të ardhurave të procesit të legalizimit”.

Krahas propozimeve për ndryshime për përmirësimin e legjislacionit në fuqi, KLSH i ka rekomanduar njësitë të ALUIZNI-t një sërë masash të karakterit organizativ e disiplinor, si dhe shpërblim të dëmit të shkaktuar *në vlerën 127,7 milionë lekë.*

o *Shpenzimet faktike të pushtetit vendor për vitin 2011 rezultuan në masën 95.9% kundrejt planit, me një mosshpenzim në vlerë prej 1,195 milionë lekë.* Krahasuar me nivelin e shpenzimeve të realizuara në vitin 2010 (30,764 milionë lekë), ato rezultojnë në masën 8% më të ulta, e barabartë me 2,645 milionë lekë fond shpenzimesh në pak.

Auditimet e ushtruara nga KLSH në këtë fushë janë përqendruar në zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, lidhur me administrimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, në përfundim të të cilave krahas punës së bërë, janë konstatuar edhe mjaft parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, me *dëm ekonomik në shumën 24,7 milionë lekë*

o Krahas sa më sipër, gjatë auditimeve në njësitë e pushtetit vendor janë konstatuar probleme dhe në drejtim të zbatimit të vendimit të KM nr. 396, datë

21/6/2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”, kur aktualisht rreth 70% e pyjeve dhe kullotave i janë transferuar njësive të pushtetit vendor (komunave) në pronësi.

Kemi konstatuar se kuadri ligjor mbi pyjet dhe kullotat rezulton përgjithësisht i kompletuar, por megjithë përmirësimet dhe plotësimet, përsëri ngelet ende për të bërë. Shkalla më e lartë e dëmeve në pronat komunale në krahasim me ato shtetërore e vërteton këtë fakt.

Në DSHP-të e audituara ka rezultuar se dëmtimi i pyjeve dhe kullotave, sidomos nga zjarret mbeten problemi kryesor dhe më shqetësuesi. Problematika në shuarjen e zjarreve është mjaft e gjerë. Pamjaftueshmëria e mjeteve teknike e lëvizëse që disponon Policia Pyjore dhe Shërbimi Zjarrfikës, si dhe gjendja teknike e tyre, në shumë raste nuk lejojnë përdorimin e tyre në terrenet e vështira pyjore.

Problematikat e mësipërme, llojet e masave të rekomanduara, përmbajtja e tyre dhe përgjigjet e subjekteve të audituara paraqiten në mënyrë të detajuar në Kapitullin XIX: “Administrimi i buxhetit të pushtetit vendor”.

## IX. Mbi zbatimin e Buxhetit të Sigurimeve Shoqërore

□ *Plani i të ardhurave për fondin e sigurimeve shoqërore, nga 50,010 milionë lekë të programuara, është realizuar në shumën 48,396 milionë lekë, në masën 96.8%, me një mosrealizim në vlerë prej 1,614 milionë lekë.*

□ Nga ISSH janë ndjekur dhe respektuar çdo muaj kufijtë e programuar të fondeve për transfertat në buxhetet familjare sipas programit të përcaktuar me ligjin për buxhetin e shtetit të vitit 2011 dhe me vendime të veçanta të KM. Shpenzimet janë mbajtur nën kontroll për të gjitha skemat.

□ Gjatë vitit analizues, janë përmirësuar rregullat dhe procedurat e administrimit të shpenzimeve, sidomos të drejtimit të minimizimit të informalitetit në pensionet dhe trajtimet e veçanta financiare dhe të zbatimit të masave më efektive për bllokimin e shpenzimeve të tepërta, tërheqjen e rregullt të financimeve shtetërore dhe shmangien e tejkalimeve.

Janë përmirësuar procedurat e shërbimeve ndaj përfituesve, sidomos afatet e caktimit të pensioneve të reja dhe janë ulur ditët e qëndrimit të një pensioni në proces të verifikimit të dokumentacionit për caktimin e tij.

Gjatë auditimit në ISSH, vend i veçantë i është kushtuar vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe vlerësimit të efektivitetit të tij, për realizimin e objektivave dhe performancës të tij.

Ndonëse objektivat, në përgjithësi janë realizuar në aspektet e parashikuara, njëkohësisht me to paraqesim dhe disa nga gjetjet më kryesore si vijon:



a) *Në fushën e përfitimeve afatgjata*: nga auditimi i ushtruar në dosjet e pensioneve që paguhen nga fondet e DRSSH-ve Tiranë, Durrës, Elbasan, Lezhë dhe Kukës, janë konstatuar shkelje të ligjit nr. 7703, datë 11/5/1993 “Për sigurimet shoqërore” dhe të kërkesave të Rregullores nr.1, datë 21/1/2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, në 35 raste, me një *efekt financiar negativ për arkën e shtetit në shumën prej 8,8 milionë lekë*. Më konkretisht, nga ballafaqimi dhe kryqëzimi i informacioneve dhe të dhënave në Regjistrin Elektronik të Pensioneve të ISSH dhe Regjistrin Kombëtar të Shtetasve, janë vërtetuar pasaktësi në hedhjen e të dhënave të përfituesve; janë përfituar njëkohësisht nga të njëjtët persona dy pensione; gabime në përlllogaritjen e vjetërsisë së punës për efekt pensioni, (pasaktësi në hedhjen e viteve apo kategorive të punës së kryer); përfitime në mënyrë të parregullt me anë të mashtrimit dhe përdorimit të dokumentacionit fiktiv; si dhe mungesë të të dhënave të përfituesve në Regjistrin Kombëtar të Shtetasve.

b) Të meta dhe mangësi në realizimin e objektivave të parashikuara në programin vjetor të të ardhurave nga kontributet e fermerit, si pasojë e mangësive në kuadrin rregullativ dhe moszbatimin me efektivitet të masave shtrënguese në luftën kundër informalitetit dhe derdhjes së detyrimeve për kontributet e detyrueshme nga të vetëpunësuarit në bujqësi, duke i ndjekur çështjet deri në Zyrën e Përmbarimit.

Përsa më sipër, KLSH i ka rekomanduar ISSH-së një sërë masash, duke filluar nga shqyrtimi i kuadrit rregullues legjislativ, ndërmarrja e veprimeve efektive dhe deri në ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore për vënien në arkëtim të vlerave të dëmeve që i janë shkaktuar arkës së shtetit për të gjithë përfitimet e paligjshme.

Është e domosdoshme që ISSH të përcaktojë një Strategji të Përgjithshme për reformimin e sistemit aktual të sigurimeve shoqërore, nëpërmjet marrjes së mendimit të aktorëve të interesuar, si atyre privatë dhe publikë.

Problematikat e mësipërme, llojet e masave të rekomanduara, përmbajtja e tyre dhe përgjigjet e ISSH-së paraqiten në mënyrë të detajuar në Kapitullin X, pikat 1 dhe 3 “Rekomandimet e dërguara nga KLSH dhe zbatimi i tyre”.

## X. Mbi zbatimin e Buxhetit të Sigurimeve Shëndetësore

Kemi konstatuar se nga stafi i ISKSH niveli i punës së menaxhimit dhe administrimit të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, ka ardhur në rritje. Vlen të pasqyrohen arritjet e veprimtarisë kontrolluese dhe audituese të Drejtorisë së Kontrollit Farmaceutik dhe Parësor dhe Drejtorisë së Kontrollit Spitalor, si dhe Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, në drejtim të rritjes së forcës së zbatimit të ligjit, përfshirë zbatimin e detyrave për arkëtimin e vlerave të rekomanduara për shpërblim dëmi.

Duhet përmendur puna menaxhuese në drejtim të vendosjes dhe heqjes së barnave nga lista, duke ruajtur balancat e kushtëzuara nga disponibiliteti i buxhetit të akorduar për barnat. Futja e metodave bashkëkohore në sistemin farmaceutik është arritje e vlerësueshme dhe ka sjellë rezultate pozitive në mënyrën e

dokumentimit të barnave që rimbursohen dhe minimizimin e abuzimeve nga kontraktuesit.

Krahas arritjeve dhe vlerësimit të punës së bërë, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

a) Gjatë zbatimit të kontratave me farmacitë dhe agjensitë në DRSKSH Tiranë është konstatuar se në 27 kontrata me vlerë rimbursimi të kryer në shumën *44,5 milionë lekë*, kjo shumë është përdorur pa u zbatuar kriteret e caktuara në kontratat dypalëshe dhe në legjislacionin përkatës në fuqi. Këto farmaci kanë kryer aktivitet tregtimi ilaçesh rimbursimi pa dokumentacion të rregullt ligjor në marrëdhënie me DRSKSH Tiranë, pa plotësuar kriteret e vendosura në kontratë dhe udhëzimin përkatës të Këshillit Administrativ, pa kontrata shtesë, madje me veprime jo ligjore në nënshkrimin e kontratës, si dhe pa dokumente licensimi.

b) Mungesë bashkëpunimi ndërmjet drejtorive të kontrollit dhe të përcaktimit qartë të detyrave të tyre.

Problematikat e mësipërme, llojet e masave të rekomanduara, përmbajtja e tyre dhe përgjigjet e ISKSH-së, paraqiten në mënyrë të detajuar në Kapitullin X, pikat 2 dhe 3 “Rekomandimet e dërguara nga KLSH dhe zbatimi i tyre”.

## **XI. Vlerësimi i situatës së menaxhimit financiar e kontrollit dhe auditimit të brendshëm.**

Konstatimet, gjetjet dhe rekomandimet për vlerësimin e situatës së menaxhimit financiar e kontrollit si dhe rezultatet e mbikqyrjes që KLSH ka kryer mbi organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik janë trajtuar në pjesën e tretë të Raportit “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe auditimin e brendshëm”.

## **XII. Disa mendime për Raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit financiar 2011**

Referuar të dhënave të raportuara të realizimit të treguesve të vitit 2011 në nivel makroekonomik dhe nga analizimi i tyre, konkludojmë se ekonomia shqiptare ndonëse me ritme më të ngadalta mundi t’i përballojë efekteve të krizës ekonomike që ka përfshirë vendet e Eurozonës, madje arriti të sigurojë një rritje pozitive të zhvillimit ekonomik të vëndit dhe të ruaj ekuilibrat kryesorë makroekonomikë, nëpërmjet respektimit të kufirit të borxhit publik nën 60% të PBB-së dhe ruajtjes të niveleve të ulta për deficitin buxhetor vjetor.

Pasqyrojmë se normat e rritjes ekonomike të vitit 2011, rezultojnë përafërsisht në nivelin e realizimit të një viti më parë. Për sigurimin e një niveli të tillë, krahas masave për zhvillimin dhe transformimin ekonomik, si dhe politikat

makroekonomike të ndjekura, duhen vlerësuar përpjekjet dhe politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë për kontrollin e inflacionit dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Niveli i treguesve fiskalë të realizuar gjatë vitit 2011, u bë i mundur me miratimin e rishikimit të buxhetit gjatë këtij viti, duke kombinuar ruajtjen e ritmit të realizimit të të ardhurave buxhetore të programuara me pakësimin e shpenzimeve. Në shifra konkrete, sipas të dhënave të siguruara gjatë kontrolleve të ushtruar në MF dhe BSH, treguesit kryesorë makroekonomikë dhe ata fiskalë të buxhetit të shtetit të vitit 2011, paraqiten:

- Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) si një nga treguesit kryesorë (me çmimet korrente) ka arritur në kuotën e 1,314,700 milionë lekë.

Politika monetare e ndjekur nga BSH ka bërë të mundur përmbushjen e objektivit kryesor të saj, mbajtjen nën kontroll të inflacionit, brenda kufirit për një inflacion vjetor 2-4%. Në vitin 2011, niveli mesatar vjetor i inflacionit ka rezultuar 3.5%, pothuajse i përafërt me atë të një viti më parë, duke ndihmuar favorshëm mjedisin ekonomik të vendit tonë.

Për vitin 2011, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit janë realizuar *në masën 96.3%*, me një *mosshpenzim në vlerë prej 14,507 milionë lekë* ndaj planifikimit, kurse kundrejt realizimit të një viti më parë, paraqiten *me rritje në masën rreth 3.75% dhe në vlerë 13,600 milionë lekë më shumë*.

Në strukturë, *shpenzimet korrente dhe kapitale*, janë realizuar në masën 97.1% dhe 93.2% dhe ato zenë përkatësisht: 81.2% dhe 18.8% të totalit të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit të shtetit të këtij viti.

Konstatohet se, *shpenzimet korrente janë realizuar në një përqindje më të madhe se sa niveli i realizimit të shpenzimeve kapitale. Rezulton se fondet e shpenzuara në zërin "Shpenzime korrente" në vitin 2011 krahasuar me një vit më parë, paraqiten me ritëm rritjeje më të ulët se sa fondet e përdorura për shpenzimet kapitale në vitin 2011 kundrejt vitit 2010.*

Analizuar sipas zërave të shpenzimeve korrente rezulton se:

**1.** *Shpenzimet për personelin* zënë rreth 22.06% të totalit të shpenzimeve korrente dhe kundrejt PBB-së të vitit 2011, shpenzimet e personelit zënë 5.13%, nga 5.31% të PBB-së të rezultuar në vitin 2010.

Shpenzimet për paga të realizuara në vitin 2011, kundrejt atyre të realizuara një vit më parë, rezultojnë me rritje *në masën 2.54%*, nga 56,951 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2010, në 58,398 milionë lekë në vitin 2011, me një *rritje në vlerë prej 1,447 milionë lekë*.

**2.** *Shpenzimet operative mirëmbajtje*, zenë rreth 10.4% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 11.4% që përfaqësonin në vitin 2010.

**3. Shpenzimet për interesat** zënë rreth 13.45% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 13.82% që zinin një vit më parë.

**4. Shpenzimet për subvencione**, zënë rreth 1.07% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 1.2% që zinin një vit më parë. Kundrejt kuotës së planifikuar, ato janë realizuar në masën 100.3%, me një tejkalim në vlerë prej 9 milionë lekë. Shpenzimet për subvencione të realizuara në vitin 2011, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, rezultojnë me ulje në masën rreth 6.6% ose në shumën 234 milionë lekë më tepër.

Referuar raporteve të konsoliduara rezulton se fondet e subvencioneve kanë ndryshuar nga buxheti fillestar në sasi të konsiderueshme nga 1,830.6 milionë lekë lekë në fillim viti në 3,372 milionë lekë, pra me një rritje prej 1,541 milionë lekë ose 84%. Kjo rritje konstatohet kryesisht në Ministrinë e Financave ku nuk ka pasur të pasqyruar subvencion në planin e fillimit të vitit. Nga auditim rezultoi se, me vendime të KM, MF-ve i është çelur fond subvencion (artikull 603 ) për “Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetraive tek njësitë e qeverisjes vendore” në shumën 1,524,395,812 lekë (sipas situacionit të shpenzimeve) të konfirmuar nga thesari.

**5. Shpenzimet për fonde speciale (sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe fondi i kompensimit në vlerë të pronarëve)**, zënë rreth 37.28% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 35.30% që zinin në vitin 2010.


**6. Shpenzimet për buxhetin vendor** zënë rreth 9.2% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 10.2% që zinin në vitin 2010, pra me një ulje prej 1%. Në vitin 2011, këto shpenzime zënë 2.14% të PBB-së të këtij viti, nga 2.48% të PBB-së që zinin në vitin 2010, pra konstatohet një ulje prej 0.34%. Shpenzimet për buxhetin vendor të realizuara në vitin 2011, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, rezultojnë me ulje në masën rreth 8.6% dhe në vlerë 2,645 milionë lekë më pak.

**7. Shpenzime të tjera sociale (pagesa e papunësisë, ndihma ekonomike dhe fondi i kompensimit për ish të përndjekurit politikë)** zënë rreth 6.13% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011. Në vitin 2011, këto shpenzime zënë 1.43% të PBB-së të këtij viti, nga 1.51% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Në strukturë, shpenzimet për pagesën e papunësisë, ndihmën ekonomike dhe fondin e kompensimit për ish të përndjekurit politikë, janë realizuar respektivisht 93.2%, 98% dhe 83.3%, dhe në vlerë 64 milionë lekë, 336 milionë lekë dhe 400 milionë lekë, më pak se sa kuotat e planifikuara.

Shpenzimet për kompensimin e ish të përndjekurve politikë rezultojnë me rritje të ndjeshme nga 1,000 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2010, në vitin 2011 janë shpenzuar 1,500 milionë lekë, me një rritje në masën 50% dhe në vlerë 500 milionë lekë më tepër. Pavarësisht tendencës në rritje të buxhetimit të kësaj kategorie shpenzimesh, theksojmë që nevojat dhe detyrimet ligjore e morale për këtë shtresë sociale kërkojnë planifikimin e shifrave shumë më të larta se këto.

Në mënyrë grafike, ecuria e shpenzimeve korrente buxhetore sipas klasifikimit në zërat kryesore, për periudhën 2007-2011, paraqitet:



- *Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm dhe të jashtëm)*, zenë rreth 18.8% të totalit të përgjithshëm të shpenzimeve të realizuara në vitin 2011, nga 18.6% që zinin në vitin 2010.

*Në vitin 2011, krahasuar me vitin 2010, ka një ulje të peshës specifike të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm me 11%.*

Kundrejt PBB-së të vitit 2011, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj zënë përkatësisht 3.13% dhe 2.13%, nga 3.77% dhe 1.68% të PBB-së të rezultuar në vitin 2010.

Krahas mendimeve dhe rekomandimeve të parashtruara më sipër, me synim miradministrimin dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike për shpenzime, gjatë vitit të ardhshëm buxhetor sugjerojmë:

- Konsolidimin dhe mirëfunksionimin e strukturave të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përgjithësi, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të miratuar për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe në përputhje me kërkesat e parashtruara nga BE për vendin tonë në kuadër të Kontrollit të Brendshëm Financiar të Sektorit Publik (KBFSP)

Në këtë kontekst, për miradministrimin e shpenzimeve publike, krahas kuadrit ligjor rregullator i cili tashmë është konfiguruar dhe plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen e stabilizim asociimit të vendit tonë në BE, kërkohet thellimi dhe përmirësimi cilësor i veprimtarisë së kontrollit brendshëm, auditimit të brendshëm, madje dhe auditimit të jashtëm.

- Referuar strukturës së shpenzimeve dhe gjetjeve të KLSH të pasqyruara në këtë raport, ka vend për të riparë kuotimin dhe përdorimin e fondeve të shpenzimeve

brenda zërave të shpenzimeve korrente. Madje, ka vend për rishikim dhe brendapërbrenda zërave kryesorë të shpenzimeve, si të disa nënzërave të llogarisë 602, siç u veprua me shpenzimet për mirëmbajtjen dhe përdorimin e autoveturave me daljen e ligjit nr. 10160, datë 15/10/2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”.

- Në lidhje me shpenzimet për interesa, ato priren drejt rritjes, sidomos në kushtet e bërjes efektive të kredive apo huave të marra, ndaj kërkohet përcaktimi i masave më të efekshme në pagesën e tyre, sidomos në reduktimin e deficitit buxhetor dhe zgjatjen e afateve të maturimit.
- Përdorimin më me efektivitet të fondeve për investime publike, nëpërmjet rritjes së përgjegjshmërisë të nëpunësve të administratës publike, të nivelit teknik dhe profesional të tyre, si dhe të kërkesës të institucioneve të ngritur me ligj për monitorimin dhe respektimin e dispozitave ligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik të fondeve publike për investime.

\*Krahas rritjes së borxhit publik dhe masave që duhen marrë në këtë drejtim, sikurse e trajtuam me sipër, shqetësim për ekonominë tonë përbëjnë borxhet që Buxheti i Shtetit ka kundrejt sipërmarrësve private. Në kushtet aktuale sugjerojmë shqyrtimin me realizem të gjendjes së borxheve, përcaktimi i masave për t'i dhënë mundësi dhe për të lehtësuar sa të jetë e mundur kompanitë private nga kosto e kredive që ato mund të kenë marrë për përmirësimin e situatës së tyre financiare, nëpërmjet ndërhyrjes për ristrukturimin e kredive dhe ndërkohë mbledhjen e borxheve të këqija. Gjithashtu duhet kërkuar nga sistemi bankar të inkurajojë dhënien e kredive.

- Në programin buxhetor të vitit 2013, krahas dhënies përparësi me fonde buxhetore sektorëve prioritarë të ekonomisë, si shëndetësisë, arsimit, investimet në infrastrukturë dhe shërbimet sociale; kujdes duhet t'i kushtohet mbështetjes së sektorëve që punojnë për eksport si bujqësia, industria minerale, prodhimi agroindustrial, industria që punon me material porositësi etj.

Po t'i referohemi strukturës së PBB-së sipas sektorëve për periudhën 2006-2011, të raportuar nga MF-ve, sektorët e bujqësisë dhe industrisë me përjashtim të vitit 2009, në 5 vitet e tjerë kanë kontribuar mesatarisht çdo vit bujqësia 17.46% të PBB-së dhe industria 9.68% të PBB-së.

- Për hartimin e buxhetit të vitit 2013 rekomandojmë që nga ana e strukturave përgjegjëse të kryhet një analizë dhe vlerësim real i ndikimeve të krizës në Eurozone, si dhe i situatës në vend, me impakt reflektimin në këtë buxhet të parashikimeve realiste të treguesve në nivele agregate me synim shmangjen e praktikave të rishikimit të buxhetit gjatë ekzekutimit të tij

## HYRJE

Për llogari të përgatitjes të këtij raporti, KLSH ka kryer auditim në 87 subjekte, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur këtij raporti.

Për përgatitjen e Raportit, krahas programit të auditimeve të 6/mujorit të dytë të vitit 2011, në muajin shkurt të vitit 2012 KLSH ka përgatitur dhe miratuar disa akte të nevojshme, përfshirë një program të veçantë auditimi për periudhën deri në korrik 2012, ku janë përcaktuar:

- mënyra e organizimit të auditimeve dhe drejtimet e kryerjes së tyre;
- struktura dhe objektivat e auditimit në Ministrinë e Financave;
- drejtimet kryesore të auditimit në Bankën e Shqipërisë;
- drejtimet dhe objektivat e auditimeve në subjektet objekt auditimi, nga të katër departamentet e auditimit, vetëm për zbatimin e buxhetit të vitit 2011;
- afatet e kryerjes së auditimeve, të përgatitjes dhe të dorëzimit të materialeve respektive nga departamentet e auditimit;
- struktura e hartimit të raportit dhe procedura e miratimit të tij;
- dërgimi i raportit në Kuvend, brenda afatit të parashikuar me ligjin nr. 9936, datë 26/6/2008 etj.

Ndër subjektet objekt auditimi, rendisim:

- *Ministrinë e Financave*, si institucioni përgjegjës i ngarkuar drejtpërdrejtë me hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

Objektivi kryesor i auditimit në këtë ministri është dhënia e opinionit për Raportin që Ministri i Financave dhe Këshilli i Ministrave paraqet në Kuvend “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011”, duke audituar rregullaritetin dhe ligjshmërinë e transaksioneve si dhe saktësinë e raportimeve që kanë të bëjnë me zbatimin e buxhetit, të borxhit publik dhe menaxhimit të tij, me përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave, funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar e kontrollit dhe organizimin e funksionimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Cilësojmë se në drejtim të respektimit të kufijve të rritjes së borxhit shtetëror publik, respektivisht të atij të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe rregullshmërisë së shërbimit të borxhit, nga ana e grupit të auditimit të KLSH janë bërë një sërë analizash. Gjithashtu, vëmendje e posaçme i është kushtuar auditimit dhe ligjshmërisë së transaksioneve të kryera nëpërmjet llogarisë “Depozitë e Qeverisë”, si dhe dhënies së opinionit në lidhje me saktësinë e Projektligjit “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2011”.

- *Bankën e Shqipërisë*, të ngarkuar me zhvillimin e tregut të bonove të thesarit e të obligacioneve, etj.
- *Ministritë dhe organet e pushtetit vendor, si prefektura, bashki, këshilla qarqesh dhe komuna*, të cilët përgjigjen për administrimin dhe përdorimin ligjor të fondeve publike.
- *Institucionet qendrore buxhetore*, ku veçojmë *Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor*, të ngarkuar me administrimin e buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe të atij shëndetësor, si dhe efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve buxhetore.

- *Organet e sistemit fiskal dhe subjekte të tjera, në nivel qendror dhe lokal, të ngarkuar me programimin, vjeljen dhe arkëtimin e burimeve të të ardhurave buxhetore.*
- *Agjenci dhe projekte që operojnë me fonde buxhetore , etj.*

Përsa më sipër, vëmendje e veçantë i është kushtuar studimit, programimit dhe ushtrimit të auditimeve në ato institucione qendrore apo ente publike, të cilët gjatë vitit objekt auditimi kanë përdorur dhe administruar fonde buxhetore sipas programeve të miratuara me ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, ndryshuar me ligjin nr. 10450, datë 14/7/2011 dhe ligjin nr. 10496, datë 22/12/2011.

*Ndër drejtimet kryesore të veprimtarisë audituese të ushtruar nga KLSH në MF,* në ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe në entet publike, për zbatimin e buxhetit të vitit analizues, paraqesim:

- Zbatimin e dispozitave ligjore në fushën ekonomike, financiare, fiskale e të kontabilitetit, me synim për të identifikuar gjendjen reale, të metat apo parregullsitë e mundshme në menaxhimin dhe përdorimin e fondeve publike, si dhe për të rekomanduar masat e nevojshme që duhen marrë, për mënjanimin dhe mospërsëritjen e të metave e të parregullsive të konstatuara.
  - Realizimin faktik të buxhetit të vitit 2011 (të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme buxhetore, deficitin e përgjithshëm buxhetor dhe burimet e financimit të tij), saktësinë e regjistrimit të tyre, përfshirë ndryshimet e bëra gjatë këtij viti, sipas klasifikimit:
    - a) Buxheti i shtetit;
    - b) Buxheti i pavarur i pushtetit vendor;
    - c) Buxheti i sigurimeve shoqërore;
    - d) Buxheti i sigurimeve shëndetësore;
    - e) Pasqyra e realizimit të treguesve fiskal të buxhetit;
    - f) Pasqyra e realizimit të buxhetit sipas programeve të ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore.
  - Respektimin e dispozitave dhe të procedurave ligjore në kryerjen e veprimeve financiare, në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- Në këtë drejtim, theksojmë auditimin për zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike me burim të brendshëm financimi dhe shpenzimet kapitale me burim të huaj financimi.
- Përdorimin sipas qëllimit dhe me efektivitet të fondeve të huave të marra, përfitimit të të mirave dhe shërbimeve me kosto efektive dhe cilësinë e duhur.
  - Rregullshmërinë dhe korrektësinë e mbajtjes së dokumentacionit financiar dhe atij kontabël.
  - Ligjshmërisë e transaksioneve të kryera nëpërmjet llogarisë “Depozitë e Qeverisë”.
  - Rregullshmërinë në kryerjen e rakordimeve financiare.
  - Respektimin e kufijve vjetor për rritjen e stokut të borxhit të brendshëm, borxhin e jashtëm të shtetit dhe garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese, të përcaktuar me ligjin vjetor të buxhetit. Kryerja e një sërë analizave në drejtim të respektimit të kufijve të rritjes së borxhit shtetëror publik, respektivisht atij të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe rregullshmëria e shërbimit të borxhit.



- Saktësinë e raportimit të borxhit publik dhe menaxhimit të tij.
- Ligjshmërinë e përdorimit të fondit rezervë të KM dhe të fondit të kontigjencës.
- Zbatimin e kërkesave të përcaktuara ligjore mbi paraqitjen e llogarive vjetore për raportimet buxhetore.

Në përcaktimin e drejtimeve të mësipërme, KLSH është mbështetur në rregullimet ligjore të përcaktuara në:

a) Ligjin nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

b) Ligjin nr. 10355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, ndryshuar me ligjin nr. 10450, datë 14/7/2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”.

c) Ligjin nr. 10496, datë 22.12.2011 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 14.12.2011, i Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar”.

d) Udhëzimin e MF nr. 4, datë 27/1/2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”;

e) Në dispozita të ndryshme ligjore të miratuara për vitin buxhetor 2011.

- Drejtim tjetër i rëndësishëm i auditimit ka qenë zbatimi dhe funksionimi i sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit financiar, si dhe funksionimi i auditimit të brendshëm, më konkretisht zbatimi i kërkesave të:

a) Neneve 62 e 63, të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” për përgatitjen e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit dhe raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të shtetit.

b) Planit të veprimit të miratuar me VKM nr. 640, datë 11/6/2009 “Për miratimin e letërpolitikave për kontrollin e brendshëm financiar publik dhe të planit të veprimit 2009-2014”.

c) Ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

d) Ligjit nr. 9720, datë 23/4/2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

e) Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15/12/2011 “Për paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

Rezultatet përfundimtare të auditimeve të kryer dhe masat e rekomanduara për përmirësimin e gjendjes, për secilin subjekt të kontrolluar, u janë dërguar pa përjashtim të gjithë subjekteve të kontrolluar, në mjaft raste dhe institucioneve më të larta drejtuese të tyre. Madje, për disa subjekte gjykuar sipas rëndësisë apo peshës që zënë në kontekstin e përdorimit të fondeve buxhetore, raportet dhe masat e rekomanduara u janë dërguar institucioneve më të larta drejtuese shtetërore.

Me rezultatet e auditimeve dhe masat e rekomanduara është njohur edhe publiku i gjerë, nëpërmjet aplikimit të formave të ndryshme të komunikimit e të informimit.

□ ëëëëPër përgatitjen e këtij raporti, krahas materialeve të auditimit të KLSH-së, janë shfrytëzuar materialet lidhur me zbatimin e buxhetit të vitit 2011 të përgatitur dhe shpërndarë për përdorim nga Kryeministria, MF, BSH, ministritë dhe institucione të ndryshme qëndrore. Madje, cilësojmë se, të dhënat e pasqyruara në këtë raport, janë siguruar në ministritë dhe institucionet shtetërore të audituara për llogari të zbatimit të buxhetit të vitit 2011 sipas listës nr. 1 bashkëlidhur këtij

*raporti, gjithashtu, nga buletinet informativë statistikore të MF, INSTAT, BSH, DPD etj.*

Gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë audituese për zbatimin e buxhetit të vitit 2011 deri në përgatitjen e këtij Raporti, nga ana e punonjësve të KLSH-së është patur parasysh dhe janë respektuar me rigorozitet standardet e auditimit, rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të KLSH-së, kodi etik, dokumentacioni i standardizuar i auditimit, metodikat dhe manualet e auditimit, si dhe akte të tjera të nxjerra për zbatim nga Kryetari i KLSH.

**PJESA E PARË:**

**RAPORT: “PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2011”**

**I. TREGUESIT E PLANIT TË BUXHETIT TË VITIT 2011**

Buxheti i shtetit për vitin 2011, është bazuar në aktet ligjore të mëposhtme:

1. Ligji nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”.
2. Ligji nr. 10450, datë 14/07/2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”.
3. Ligji nr. 10496, datë 22/12/2011 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 14/12/2011, i Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011” të ndryshuar”, dekretuar me Dekretin e Presidentit nr. 7221, datë 10/1/2012.

Bazuar në rregullimet e mësipërme ligjore, buxheti i shtetit për vitin 2011, paraqitet:

➤ **BUXHETI**

a) Të ardhurat .....	344,047 milionë lekë
b) Shpenzimet .....	390,859 milionë lekë
c) Defiçiti .....	46,812 milionë lekë

Buxheti përbëhet nga:

- A. Buxheti i shtetit.
- B. Buxheti i pushtetit vendor.
- C. Buxheti i fondeve speciale, i përbërë nga:
  - C.1 Buxheti i sigurimeve shoqërore.
  - C.2 Buxheti i sigurimeve shëndetësore.
  - C.3 Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Konkretisht, përbërja sipas buxheteve (nivelet) për vitin 2011, paraqitet:

**A. Buxheti i shtetit**

1. Të ardhurat .....	270,727 milionë lekë
2. Shpenzimet .....	317,539 milionë lekë
3. Defiçiti (3=2-1) .....	- 46,812 milionë lekë

**B. Buxheti i pushtetit vendor**

1. Të ardhurat .....	29,314 milionë lekë
Nga të cilat:	
1.a Granti i pakushtëzuar nga buxheti qendror .....	14,014 milionë lekë
2. Shpenzimet .....	29,314 milionë lekë

**C. Buxheti i fondeve speciale**

**C.1 Buxheti i sigurimeve shoqërore**

**C.1.a Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror**

1. Të ardhurat gjithsej .....	79,628 milionë lekë
1.a Nga kontributet .....	49,730 milionë lekë
1.b Transferimet nga buxheti i shtetit .....	27,898 milionë lekë
2. Shpenzimet .....	79,628 milionë lekë

**C.1.b Skema e sigurimit suplementar**

1. Të ardhurat gjithsej .....	5,472 milionë lekë
1.a Nga kontributet .....	280 milionë lekë
1.b Transferimet nga buxheti i shtetit .....	5,192 milionë lekë
2. Shpenzimet .....	5,472 milionë lekë

**C.2 Buxheti i sigurimeve shëndetësore**

1. Të ardhurat gjithsej .....	27,767 milionë lekë
1.a Nga kontributet dhe të tjera .....	6,610 milionë lekë
1.b Transferimet nga buxheti i shtetit .....	20,857 milionë lekë
1.c Ndryshimi i gjendjes së ISKSH .....	300 milionë lekë
2. Shpenzimet .....	27,767 milionë lekë

**C.3 Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve**

1. Të ardhura gjithsej .....	1,700 milionë lekë
1.a Të ardhura të tjera .....	1,400 milionë lekë
1.b Transferimet nga buxheti i shtetit .....	300 milionë lekë
2. Shpenzimet .....	1,700 milionë lekë

*Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 46,812 milionë lekë, nga i cili 300 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit dhe 300 milionë lekë nga rezultati financiar i ISKSH-së.*

Në rast të mosrealizimit të ardhurave të buxhetit dhe të ardhurave nga privatizimi, huamarrja e brendshme për financimin e deficitit prej 46,212 milionë lekë nuk ndryshon.

*Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2011, është 84,690 milionë lekë, i detajuar si më poshtë:*

1. Për huamarrjen vjetore neto, deri në 29,312 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja, deri në 45,800 milionë lekë.
3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, është 6,926 milionë lekë.
4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të huaja të papaguara, është 2,652 milionë lekë

**II. TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR**

Treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar të planifikuar të vitit 2011, përfshirë të gjitha ndryshimet ligjore të bëra gjatë zbatimit të buxhetit të këtij viti, paraqiten:

Në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	Plani fillestar sipas ligjit nr. 10355, datë 2/12/2010	Plani i ndryshuar sipas ligjit nr. 10450, datë 14/7/2011	Plani përfundimtar me ndryshime sipas Ministrisë së Financave	Në % ndaj PBB
<b>I.</b>	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE (1+2+3)</b>	<b>362,223</b>	<b>344,047</b>	<b>344,047</b>	<b>26.17</b>
1.	Të ardhura nga ndihmat	8,422	8,422	8,422	0.64
2.	Të ardhura tatimore	332,778	315,397	315,397	23.99
2.a	Të ardhurat nga tatimet dhe doganat	256,138	242,077	242,077	18.41
2.b	Të ardhura nga pushteti vendor	17,300	15,300	15,300	1.16
2.c	Të ardhura nga fondet speciale	59,340	58,020	58,020	4.41
3.	Të ardhura jotatimore	21,023	20,228	20,228	1.54
<b>II.</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE(1+2+3+4+5)</b>	<b>409,035</b>	<b>390,859</b>	<b>390,859</b>	<b>29.73</b>
1.	Shpenzimet korrente	321,386	311,538	314,814	23.95
2.	Fondi rezervë dhe kontigjenca Nga i cili:	5,147	5,575	187	0.01
2.a	- Fondi rezervë i KM	1,500	1,928	164	-
2.b	- Kontigjenca për ruajtjen e deficitit	3,647	3,647	23	-
3.	Shpenzimet kapitale Nga:	82,502	73,746	75,858	5.77
3.a	- Financimi i brendshëm	44,935	41,023	43,382	3.30
3.b	- Financimi i huaj	37,567	32,523	30,876	2.35
3.c	- Shpronësime	0.0	200	1,600	0.12
<b>III.</b>	<b>DEFICITI I PËRGJITHSHËM (2-1)</b>	<b>- 46,812</b>	<b>- 46,812</b>	<b>- 46,812</b>	<b>3.56</b>
	<i>Financimi i deficitit (1+2)</i>	46,812	46,812	46,812	3.56
1.	Financimi i brendshëm	28,518	30,062	30,062	2.29
1.a	- Të ardhura nga privatizimi	300	300	300	0.02
1.b	- Huamarrje e brendshme	28,218	29,462	29,462	2.25
1.c	- Të tjera	0.0	0.0	0.0	
1.d	- Ndryshimi i gjendjes së ISKSH	0.0	300	300	0.02
2.	Financimi i huaj	18,294	16,750	16,750	1.27
2.a	- Hua afatgjatë të marrë për projekte	29,145	24,101	24,101	1.83
2.b	- Mbështetje buxhetore	0.0	2,500	2,500	0.19
2.c	- Ndryshimi i gjendjes së arkës	0.0	0.0	0.0	0.00
2.d	- Ripagesat	- 10,851	- 9,851	- 9,851	- 0.75

Ndërsa, realizimi i treguesve buxhetor të vitit 2011, përkatësisht të ardhurat, shpenzimet dhe deficitit të përgjithshëm, kundrejt treguesve të planit përfundimtar me ndryshime, paraqitet:

Në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	Plani vitit 2011 me ndryshime	Fakti i vitit 2011	Diferenca (Fakt-Plan)	Realizimi në %	Në % fakt ndaj PBB	Fakti i vitit 2010
<b>I.</b>	<b>TOTALI TË ARDHURAVE (1+2+3)</b>	<b>344,047</b>	<b>330,475</b>	<b>- 13,572</b>	<b>96.1</b>	<b>25.14</b>	<b>324,721</b>
1.	Të ardhurat nga ndihmat	8,422	3,811	- 4,611	45.3	0.29	4,605
2.	Të ardhurat tatimore	315,397	303,933	- 11,464	96.4	23.12	288,564
2.a	Të ardhurat nga tatimet dhe doganat	242,077	235,509	- 6,568	97.3	17.91	223,019
2.b	Të ardhura nga pushteti vendor	15,300	11,792	- 3,508	77.1	0.90	11,898
2.c	Të ardhura nga fondet speciale	58,020	56,632	- 1,388	97.6	4.31	53,647
3.	Të ardhurat jotatimore	20,228	22,731	- 2,503	112.4	1.73	31,552
<b>II.</b>	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE (1+2+3+4)</b>	<b>390,859</b>	<b>376,352</b>	<b>- 14,507</b>	<b>96.3</b>	<b>28.63</b>	<b>362,752</b>

Nr.	EMËRTIMI	Plani vitit 2011 me ndryshime	Fakti i vitit 2011	Diferenca (Fakt-Plan)	Realizimi në %	Në % fakt ndaj PBB	Fakti i vitit 2010
1.	Shpenzimet korrente	314,814	305,673	- 9,141	97.1	23.25	300,878
2.	Fondi rezervë dhe kontigjenca	187	0.0	- 187	0.0	0.00	0.0
3.	Shpenzimet kapitale	75,858	70,679	- 5,179	93.2	5.38	67,492
	Nga i cili:						
3.a	- Financimi i brendshëm	43,382	41,097	- 2,285	94.7	3.13	46,642
3.b	- Financimi i huaj	30,876	27,982	- 2,894	90.6	2.13	20,850
3.c	- Shpronësime	1,600	1,600	0.0	100.0	0.12	0.0
3.	Huadhënie neto						- 5,618
III.	<b>DEFICITI I PËRGJITHSHËM (2-1)</b>	<b>- 46,812</b>	<b>- 45,877</b>	<b>- 935</b>	<b>98.0</b>	<b>3.49</b>	<b>38,031</b>
	<i>Financimi i deficitit (1+2)</i>	46,812	45,877	- 935	98.0	3.49	38,031
1.	Financimi i brendshëm	30,062	26,119	- 3,943	86.9	1.99	27,819
1.a	- Të ardhura nga privatizimi	300	438	+ 138	146.0	0.03	411
1.b	- Huamarrja	29,463	28,175	- 1,288	95.6	2.15	25,948
1.c	- Të tjera	0.0	- 2,494	- 2,494	-	- 0.19	1,460
1.d	- Ndryshimi i gjendjes së ISKSH	300	0.0	- 300	-	-	-
2.	Financimi i huaj	16,750	19,758	+ 3,008	118.0	1.50	10,212
2.a	- Hua afatgjatë të marrë për projekte	24,101	25,229	+ 1,128	104.7	1.92	0.0
2.b	- Mbështetje buxhetore	2,500	0.0	- 2,500	-	-	0.0
2.c	- Ndryshimi i gjendjes së arkës	0.0	2,142	+ 2,142	-	+ 0.16	0.0
2.d	- Ripagesat	- 9,851	- 7,613	- 2,238	77.3	- 0.58	0.0

Përsa më sipër:

□ **Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit** janë realizuar në masën 96.1%, ose në terma sasiorë 330,475 milionë lekë, nga 344,047 milionë lekë të planifikuara, me një *impakt deficitar në të ardhurat e buxhetit të shtetit në shumën 13,572 milionë lekë*. Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2011, ato zenë 25.14% të tij, nga 26.17% të PBB-së të planifikuar, duke reflektuar një mosrealizim në 1.03% të PBB-së. Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat në vitin analizues 2011 janë rritur me 1.77% dhe në vlerë absolute 5,754 milionë lekë më tepër.


□ **Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit** u realizuan në masën 96.3%, ose janë shpenzuan 376,352 milionë lekë nga 390,859 milionë lekë të planifikuara, duke reflektuar *mosshpenzim të fondeve në shumën 14,507 milionë lekë*. Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2011 ato zenë 28.63% të tij, nga 29.73% të PBB-së të programuara.

Krahasuar me vitin 2010, shpenzimet e kryera gjatë vitit 2011 rezultojnë me rritje për rreth 13,600 milionë lekë më shumë.

□ **Deficiti i përgjithshëm e buxhetit të shtetit** për vitin 2011 rezultoi në shumën 45,877 milionë lekë, nga 46,812 milionë lekë kuota e planifikuar, ose 935 milionë lekë më pak. Kundrejt PBB-së të vitit 2011, ky tregues arriti në 3.49% nga 3.07% që rezultoi në vitin 2010 dhe nga 7.07% në vitin 2009.

Deficiti i përgjithshëm buxhetor u financua me 26,119 milionë lekë nga burime të brendshme dhe 19,758 milionë lekë nga burime të huaja.

Në mënyrë grafike, treguesit fiskalë të planifikuar të buxhetit të konsoliduar të vitit 2011, kundrejt niveleve të realizuara, përkatësisht të ardhurat, shpenzimet dhe deficiti buxhetor, paraqiten si më poshtë:



### III. REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

Referuar treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar të vitit 2011, është parashikuar që shuma e të ardhurave të përgjithshme prej 344,047 milionë lekë të sigurohet nga këto burime të të ardhurave:

- a) Ndihamat në vlerën 8,422 milionë lekë;
- b) Tatimet dhe doganat 242,077 milionë lekë;
- c) Pushteti vendor 15,300 milionë lekë;
- d) Kontributet e sigurimeve shoqërore 50,010 milionë lekë;
- e) Kontributet e sigurimeve shëndetësore 6,610 milionë lekë;
- f) Kompensimi në vlerë të pronarëve 1,400 milionë lekë; dhe
- g) Të ardhurat jotatimore 20,228 milionë lekë.

Plani me ndryshime dhe niveli i realizimit të të ardhurave të buxhetit të vitit 2011, në total dhe të shprehura sipas zërave, paraqiten në tabelën e mëposhtme:


*Në milionë/lekë*

Nr.	<i>E M Ë R T I M I</i>	<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>	<i>Diferenca (F-P)</i>	<i>Përqindja realizimit</i>	<i>Në % ndaj/PBB</i>
A.	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>344,047</b>	<b>330,475</b>	<b>- 13,572</b>	<b>96.1</b>	<b>25.14</b>
I.	Të ardhura nga ndihmat	8,422	3,811	- 4,611	45.3	0.29
II.	Të ardhura tatimore	315,397	303,933	- 11,464	96.4	23.12
II.1	<i>Nga Tatimet dhe Doganat</i>	<i>242,077</i>	<i>235,509</i>	<i>- 6,568</i>	<i>97.3</i>	<i>17.91</i>
1.	Tatimi mbi vlerën e shtuar	120,056	119,189	- 867	99.3	9.06
2.	Tatimi mbi fitimin	21,127	19,712	- 1,415	93.3	1.50
3.	Akcizat	41,270	40,403	- 867	97.9	3.07
4.	Tatimi mbi të ardhurat personale	29,493	27,967	- 1,526	94.8	2.13
5.	Taksa nacionale dhe të tjera	22,320	21,388	- 932	95.8	1.63
6.	Taksa doganore	7,812	6,850	- 962	87.7	0.52
II.2	<i>Nga Pushteti Vendor</i>	<i>15,300</i>	<i>11,792</i>	<i>- 3,508</i>	<i>77.1</i>	<i>0.90</i>
1.	Taksa lokale	10,930	7,280	- 3,650	66.6	0.55
2.	Taksë mbi pasurinë (ndërtesat)	1,850	1,942	+ 92	105.0	0.15
3.	Tatimi mbi biznesin e vogël	2,520	2,570	+ 50	102.0	0.20
II.3	<i>Të ardhurat nga fondet speciale</i>	<i>58,020</i>	<i>56,632</i>	<i>- 1,388</i>	<i>97.6</i>	<i>4.31</i>
1.	Sigurimi shoqëror	50,010	48,844	- 1,166	97.7	3.71
2.	Sigurimi shëndetësor	6,610	6,152	- 458	93.1	0.47
3.	Fondi i kompensimit pronarëve	1,400	1,636	+ 236	116.9	0.13
III.	<i>Të ardhurat jotatimore</i>	<i>20,228</i>	<i>22,731</i>	<i>- 2,503</i>	<i>112.4</i>	<i>1.73</i>

Nr.	<i>E M Ë R T I M I</i>	Plan	Fakt	Diferenca (F-P)	Përqindja realizimit	Në % ndaj/PBB
1.	Transferimi i fitimit nga BSH	5,200	5,710	+ 510	109.8	0.43
2.	Nga institucionet buxhetore	10,323	10,336	+ 13	100.1	0.79
3.	Dividendi, gjoba e sekuestrime	500	1,060	+ 560	212.0	0.08
3.	Tarifat e shërbimeve	3,000	3,510	+ 510	117.0	0.27
4.	Të tjera	1,205	2,115	+ 910	175.5	0.16

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme, rezulton se të ardhurat në vitin 2011 janë realizuar në masën 96.1%, ose nga 344,047 milionë lekë të programuara, janë realizuar 330,475 milionë lekë, *me një impakt negativ në vlerë prej 13,572 milionë lekë.*

Në mënyrë grafike, struktura e realizimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit sipas zërave kryesorë për periudhën 2007-2011 paraqiten si më poshtë:



□ Analizuar sipas zërave, *realizimi i kuotave të planifikuara të të ardhurave, paraqitet:*


### III.1 Të ardhurat nga ndihmat

Për vitin 2011, të ardhurat nga ndihmat nga 8,422 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar 3,811 milionë lekë *ose në masën 45.3%, me një mosrealizim në vlerë prej 4,611 milionë lekë.* Kundrejt totalit të të ardhurave të realizuara këtë vit, ato zënë rreth 1.15% të tij, nga 1.42% të rezultuar në vitin 2010 dhe 1.48% në vitin 2009, pra nga viti në vit të ardhurat nga ky zë kanë tendencë uljeje. Ndërsa kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2011 ato zenë 0.29%, nga 0.37% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Në krahasim me një vit më parë, këto të ardhura paraqiten me ulje, përkatësisht 794 milionë lekë më pak (4,605 milionë lekë – 3,811 milionë lekë).

Në mënyrë grafike, niveli i realizimit të të ardhurave nga ndihmat për periudhën 2007-2011 paraqitet si vijon:






### III.2 Të ardhurat tatimore

*Këto të ardhura janë realizuar në masën 96.4% ndaj nivelit të planifikuar, me një mosrealizim në vlerë prej 11,464 milionë lekë. Ky impakt deficitar është shkaktuar si pasojë e mosrealizimit të kuotave të planifikuara në:*

- a) Të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të cilat janë realizuar në masën 97.3%, me një mosrealizim në vlerë prej 6,568 milionë lekë;
- b) Të ardhurat nga pushteti vendor në masën 77.1%, me një mosrealizim në vlerë prej 3,508 milionë lekë; dhe
- c) Të ardhurat nga fondet speciale ku përfshihen kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe fondi i kompensimit të pronarëve në masën 97.6%, me një mosrealizim në vlerë prej 1,388 milionë lekë.

Të ardhurat tatimore zenë 91.97% të totalit të të ardhurave gjithsej të realizuara në vitin 2011, nga 88.86% të rezultuar në vitin 2010. Krahasuar me realizimin faktik të një viti më parë, të ardhurat tatimore të realizuara në vitin 2011 paraqiten me rritje, përkatësisht, nga 288,564 milionë lekë të realizuar në vitin 2010, në 303,933 milionë lekë në vitin 2011, ose në masën 5.3% më shumë dhe në vlerë 15,369 milionë lekë më tepër. Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2011 ato zenë 23.12%, nga 23.3% të PBB-së që zinin në vitin 2010, pra me një ulje prej 0.18%.

Në mënyrë grafike, ecuria e realizimit të të ardhurave tatimore për periudhën 2007-2011 paraqitet si vijon:



#### III.2.a Realizimi i të ardhurave tatimore nga tatimet dhe doganat

Zëri kryesor i të ardhurave tatimore, janë *të ardhurat nga tatimet dhe doganat*, të cilat në vitin 2011, nga 242,077 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në vlerën 235,509 milionë lekë, ose në masën 97.3%, *me një impakt negativ në totalin e*

*të ardhurave prej 6,568 milionë lekë.* Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2011 ato zenë 17.91%, nga 18.01% të PBB-së që zinin në vitin 2010, pra me një ulje prej 0.10%.

Krahasuar me të ardhurat e realizuara në vitin 2010 në shumën 223,019 milionë lekë, ato rezultojnë me rritje me 5.6% dhe në vlerë 12,490 milionë lekë më tepër.

Të ardhurat e realizuara në vitin 2011 zenë rreth 71.26% të totalit të të ardhurave të realizuara këtë vit, nga 69.86% që zinin në vitin 2010, pra me një rritje prej 1.4 pikë përqindje. Ndërsa, kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2011, këto të ardhura zenë 17.91% të tij.

Në strukturë, të ardhurat e realizuara nga tatimet dhe doganat, paraqiten:

- Tatimi mbi vlerën e shtuar në shumën 119,189 ose në masën 50.5% të totalit;
- Tatimi mbi fitimin 19,712 milionë lekë ose në masën 8.4%;
- Akcizat 40,403 milionë lekë ose në masën 17.2%;
- Tatimi mbi të ardhurat personale 27,967 milionë lekë ose në masën 11.9%;
- Taksa nacionale dhe të tjera 21,388 milionë lekë ose në masën 9.1%;
- Taksa doganore 6,850 milionë lekë ose në masën 2.9% të shumës totale.

Pa dashur të nënvlerësojmë aspak punën, përpjekjet dhe përmirësimet e bëra gjatë vitit buxhetor 2011 nga organet tatimore dhe doganore në drejtim të administrimit të tatimeve dhe taksave, krahas arritjeve, do të fokusohemi dhe në ato drejtime dhe problematika të konstatuara nga ana e KLSH gjatë auditimeve të kryera, të cilat kërkojnë një vëmendje më të madhe për trajtimin e tyre, njëkohësisht përgjegjshmëri më të lartë nga administrata tatimore dhe doganore.

### **1. DPT dhe njësitë e saj vartëse.**


Plani i të ardhurave tatimore neto (pa vlerën e rimbursuar) për vitin 2011, *është realizuar në masën 93.9% e nivelit të parashikuar*, nga 115,552 milionë lekë të planifikuara, në 108,499 milionë lekë, *me një mosrealizim në shumën 7,053 milionë lekë (sipas të dhënave të DPT).*

Sipas klasifikimit, të ardhurat tatimore janë realizuar nga:

- a) Sektori shtetëror në vlerën prej 14,282 milionë lekë, ose 13% e të ardhurave, kjo për 2375 subjekte.
- b) Sektori privat në vlerën prej 94,217 milionë lekë, ose 87% e të ardhurave, kjo për 68587 subjekte.

Duke analizuar periudhat e viteve 2010 dhe 2011, konstatohet se të ardhurat e realizuara në vitin 2011 paraqiten në rritje, përkatësisht nga 105,509 milionë lekë të realizuara në vitin 2010, në 108,499 milionë lekë të realizuara në vitin 2011, *ose në masën 2.8% më tepër dhe në vlerë 2,990 milionë lekë më shumë.*

Në totalin e të ardhurave të realizuara për vitin 2011, përqindja e çdo zëri tatimor, paraqitet në grafikën e mëposhtme:



Nga të dhënat grafike, konstatohet se të ardhurat nga tatimet indirekte zenë 39% të totalit të të ardhurave tatimore (t.v.sh. dhe akciza), kurse tatimet direkte 61% të të ardhurave.

Në vijim, paraqesim disa nga faktorët e konstatuar në auditimet e KLSH, të cilat kanë ndikuar negativisht në nivelin e të ardhurave tatimore për vitin 2011, dhe konkretisht:

- Mosrritja e të ardhurave tatimore në propocion me rritjen e numrit të subjekteve.
- Rritja e subjekteve kreditore për t.v.sh.-në dhe tatim mbi fitimin.
- Rritja e subjekteve me aktivitet me humbje.
- Ulja e ritmit të arkëtimeve nga njëra periudhë në tjetrën, për t.v.sh.-në, lojrat e fatit, taksën e qarkullimit dhe taksën e karburantit.
- Rritja e numrit të subjekteve debitore nga njëra periudhë në tjetrën.
- Mosevidentimi dhe moskontrolli i subjekteve me risk të lartë, referuar treguesve negativ që ato kanë.
- Mungesa e luftës kundër informalitetit dhe konkurrencës së pandershme, në evidentimin dhe regjistrimin e subjekteve të paregjistruara.
- Moskryerja e kontrolleve nga struktura të DPT në DRT, mbi ekzistencën e numrit të subjekteve mosdeklarues.
- Mosvlerësimi dhe mosndjekja nga strukturat përkatëse të DPT-së, mbi deklarimin e numrit të kontribuesve nga subjekte të ndryshëm, ku realisht ekzistojnë mundësi dhe rezerva për rritjen e numrit të tyre dhe uljen e evazionit.
- mosbashkëpunimi në nivelin e duhur i DPT me institucionet e auditimit të jashtëm.

## **2. DPD dhe njësitë e saj vartëse.**

Të ardhurat tatimore nga sistemi doganor për vitin 2011 janë realizuar në vlerën 128,010 milionë lekë nga 126,525 mijë lekë të planifikuar, *ose në masën 101,2%, me një tejkalim në vlerë prej 1,486 milionë lekë (sipas të dhënave të DPD).*


Krahas punës dhe përpjekjeve serioze të bëra nga administrata doganore për realizimin e të ardhurave të programuara, përmendim rastet e parregullsive dhe shkeljeve të konstatuar gjatë auditimit në disa degë doganore. Si pasojë e moszbatimit korrekt të dispozitave të legjislacionit doganor, Kodit Doganor dhe dispozitave zbatuese të tij, audituesit e KLSH kanë konstatuar *një efekt negativ financiar në të ardhurat e buxhetit të vitit 2011, në shumën 50,323 mijë lekë,*

përkatësisht në Degët Doganore Tiranë në vlerën 21,960 mijë lekë, Fier 19,794 mijë lekë, Berat 2,972 mijë lekë dhe Rinas 922 mijë lekë.

**Shënim:** Lidhur me **realizimin e të ardhurave tatimore nga organet tatimore për llogari të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore**, ato trajtohen në Kapitullin X “Administrimi i buxheteve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

▪ Referuar treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar të raportuar nga MF, nga zërat përbërës të të ardhurave nga tatimet dhe doganat, **asnjëri prej tyre nuk paraqitet i realizuar kundrejt kuotave të planifikuara.**

Tendenca e realizimit të të ardhurave nga organet tatimore dhe doganore për periudhën 5-vjeçare 2007-2011, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



**a) Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH.)**

Për vitin 2011, të ardhurat tatimore nga TVSH-ja të realizuar nga organet tatimore dhe doganore janë realizuar në masën 99.3%, nga 120,056 milionë lekë të planifikuara janë grumbulluar 119,189 milionë lekë, me një mosrealizim prej 867 milionë lekë.

Në krahasim me të ardhurat e realizuara në vitin 2010, ato rezultojnë me rritje në masën 4.5% dhe në vlerë 5,191 milionë lekë më tepër. Kundrejt PBB-së të realizuar në vitin 2011, këto të ardhura zenë 9.07%.

**a.1 Të ardhurat neto nga TVSH-ja, nga organet në vartësi të DPT,** janë realizuar në masën 87%, ose nga 30,170 milionë lekë të programuara, janë arkëtuar 26,280 milionë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 3,890 milionë lekë.

o Nga 14 DRT, rezultojnë me realizim 3 prej tyre, konkretisht: DRT Shkodër 116%, Elbasan 106% dhe Fier 101%, me një tejkalim në vlerë kundrejt planit prej 95 milionë lekë. Kurse, nga 11 DRT-të që paraqiten me mosrealizim, në 7 prej tyre niveli i mosrealizimit varion nga 11% - 37%. Ndër to, veçojmë Njësinë e Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë, e cila rezulton me një mosrealizim prej 3,490 milionë lekë, vlerë kjo e barabartë me rreth 87% të totalit të mosrealizimit të t.v.sh.-së.

o Të ardhurat neto nga TVSH-ja të realizuara në vitin analizues 2011, rezultojnë 2,962 milionë lekë më të ulta se ato të realizuara në vitin 2010, ose në masën 10% më pak. Nga 14 DRT, vetëm 6 prej tyre kanë realizuar më shumë të ardhura në vitin 2011, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, ndonëse numri i tatimpaguesve të TVSH

o -së në vitin 2010 ka pësuar rritje kundrejt atyre të regjistruar në vitin 2011.

Megjithëse, numri i tatimpaguesve për vitin 2011 kundrejt vitit 2010 është rritur me 2847 tatimpagues, ose në masën 15.4% (nga 16436 në vitin 2010, në 19283 në vitin 2011), po kështu, shitja e tatueshme në total ka pësuar rritje në vlerën 135,4

milione lekë ose në masën 14% (nga 1,004,348 milionë lekë në vitin 2010, në 1,139,771 milionë lekë në vitin 2011); *t.v.sh. ja e arkëtuar ka pësuar rënie me një vlerë prej 9.5 milionë lekë, ose në masën rreth 27% (nga rreth 36 milionë lekë në vitin 2010, në 26.3 milionë lekë në vitin 2011).*

o Ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga t.v.sh.-ja kanë pasur faktorë të tillë si; *rritja e numrit të subjekteve tatimpagues kreditorë, atyre që nuk deklarojnë dhe ata që deklarojnë me zero.*

Duke shkuar më tej në analizë, rezulton se, *ndërsa realizimi i t.v.sh.-së neto nga data 1/1/2011 deri më 31/12/2011 ka rënë nga 29,242 milionë lekë në 26,280 milionë lekë, ose në nivelin rreth 90%, kredia është rritur për të njëjtën periudhë me 13% (41,471/36,657), pra, kemi ritëm më të lartë të rritjes së kredisë se sa arkëtimi i t.v.sh.-së neto, brenda të njëjtës periudhë ushtrimore.*

Po kështu, dhe *numri i subjekteve ka pësuar rritje nga njëra periudhë në tjetrën, kështu, në fillim të vitit 2011 ky numër deklarohet 12455 subjekte, kurse në fund të këtij viti 18742 subjekte, pra është shtuar me 6017 subjekte, ose në masën mbi 50%.*

Sipas DRT-ve paraqitet kjo situatë: - DRT Berat shtuar për 487 subjekte ose në masën 16% më shumë se një vit më parë; Fier 492 subjekte ose 43% më shumë; Durrës 652 subjekte ose 36% më shumë; Dibër 233 subjekte ose 39% më shumë; Elbasan 117 subjekte ose 18% më shumë; Gjirokastrë 68 subjekte ose 21% më shumë; Korçë 87 subjekte ose 12% më shumë; Lezhë 89 subjekte ose 22% më shumë; Sarandë 67 subjekte ose 25% më shumë; Shkodër 398 subjekte ose 56% më shumë; Vlorë 894 subjekte ose 112% më shumë; Tiranë 3256 subjekte ose 73% më shumë dhe DRT Kukës 67 subjekte më shumë se një vit më parë.

Ndërsa, gjendja e subjekteve tatimpagues me mosdeklarim dhe deklarim me zero në t.v.sh., paraqitet në pasqyrën mëposhtme:

Dega Rajonale Tatimore	Deklaruar gjithsej tatimpagues numër	Viti 2010		Dega Rajonale Tatimore	Deklaruar gjithsej tatimpagues numër	Viti 2011	
		Deklaruar paaktivitet gjithë vitit	Mos deklarim gjithë vitin			Deklaruar paaktivitet gjithë vitit	Mos deklarim gjithë vitin
Berat	477	34	1	Berat	592	20	8
NJTPM	823	3	8	NJTPM	823	13	11
Durrës	2,161	426	181	Durrës	2,714	453	414
Diber	252	36	11	Diber	319	44	31
Elbasan	901	113	97	Elbasan	1,193	122	143
Fier	1,279	168	62	Fier	1,635	199	129
Gjirokastrë	411	29	27	Gjirokastrë	456	23	73
Korçë	910	131	39	Korçë	1,067	117	77
Kukës	46	4	36	Kukës	64	6	62
Lezhë	510	50	7	Lezhë	606	53	27
Sarandë	405	54	0	Sarandë	513	80	0
Shkodër	870	122	14	Shkodër	884	64	44
Tiranë	6,394	1,590	1,118	Tiranë	7,166	1,551	1,815
Vlorë	997	157	92	Vlorë	1,251	166	161
<b>TOTALI:</b>	<b>16,436</b>	<b>2,917</b>	<b>1,693</b>	<b>TOTALI</b>	<b>19,283</b>	<b>2,911</b>	<b>2,995</b>

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se, numri i subjekteve mos deklarues në vitin 2011 zë 15.5% të numrit gjithsej të subjekteve tatimpagues të regjistruar në t.v.sh., dhe në krahasim me vitin 2010, numri i subjekteve me mos

deklarim është rritur për 1302 subjekte, po kështu numri i subjekteve të regjistruar në t.v.sh. ka pësuar rritje prej 2847 subjekte.

*Cilësojmë se, rritja e numrit të subjekteve mos deklarues dhe deklarim me zero, kanë influencuar negativisht në nivelin e arkëtimit të t.v.sh.-së.*

Përkeqësimi i treguesve në vitin 2011 kundrejt vitit 2010, tregon se masat organizative dhe teknike të përcaktuara nga DPT dhe DRT-të në arkëtimin e t.v.sh.-së nuk kanë qenë efektive. Për t'u përmendur mangësitë në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punëve ndërmjet strukturave respektive të administratës tatimore, në lidhje me kryerjen e kontroleve dhe verifikimeve në subjektet që kanë kryer pagesa të ulta t.v.sh.-je, nuk deklarojnë apo paraqiten me deklarim zero.

o Gjatë vitit 2011 janë bërë 705 kërkesa për rimbursim me vlerën prej 18,251 milionë lekë dhe janë miratuar 471 kërkesa ose 66,8% e totalit të tyre, në vlerën 13,723 milionë lekë ose 75,1% e vlerës së kërkuar.

Rimbursimi faktik në total, rezulton në vlerën 6,758 milionë lekë ose në masën mbi 49,2% të vlerës së miratuar. Brenda vlerës së rimbursuar, me xhirim (kthim drejtpërsëdrejti subjektit) janë 6,374 milionë lekë, ndërsa me kompensim (për shtyrje detyrimesh të tjera tatimore ligjërish për t'u paguar) janë dhënë 384 milionë lekë.

Si përfundim, vetëm 5.7% e rimbursimeve të dhëna kanë shkuar drejtpërsëdrejti në favor të shlyerjes së detyrimeve të ndryshme tatimore, me dobi në rritjen e të ardhurave tatimore në buxhetit të shtetit, pjesa tjetër prej 94,4% kanë shkuar tek subjektet.

**a.2 Të ardhurat nga t.v.sh.-ja në sektorin doganor,** janë realizuar në masën 103.3%, ose nga 89,886 milionë lekë të programuara, janë realizuar 92,909 milionë lekë, me një tejkalim në vlerë prej 3,023 milionë lekë. Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2010 në vlerë prej 84,798 milionë lekë, rezulton një rritje në masën 9.6% dhe në vlerën 8,111 milionë lekë.

Të ardhurat nga t.v.sh.-ja në sektorin doganor përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave, të cilat në realizimin faktik të vitit 2011, zënë 72.3% (92,909 milionë lekë/128,489 milionë lekë), ndërkohë që në vitin 2010 kjo përqindje ka rezultuar në masën 70%, me një rritje prej 2.3 pikë përqindje.

Në këtë rritje, krahas punës së bërë nga strukturat doganore, ka influencuar rritja e sasisë së mallrave të importit, ndryshimi i strukturës së tyre, si dhe luhatja e çmimeve të mallrave në bursë.

#### **b) Tatimi mbi fitimin**

Për vitin 2011, tatimi mbi fitimin është realizuar në masën 93.3%, ose nga 21,127 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar 19,712 milionë lekë, me një impakt negativ prej 1,415 milionë lekë.

Kundrejt PBB-së të realizuar në vitin 2011, ato zenë 1.50% të tij.

Nga 14 DRT-të, kanë realizuar këtë lloj tatimi vetëm 3 prej tyre, me një impakt pozitiv në vlerë prej 399 milionë lekë dhe nuk e kanë realizuar 11 DRT, me një impakt negativ në vlerë prej 1,814 milionë lekë.

Bazuar në të dhënat e DPT-së, paraqiten me realizim DRT-të Berat, Kukës dhe Tiranë, kurse nga DRT-të me mosrealizim përmendim NJTPM Tiranë 245 milionë lekë, DRT Vlorë 217 milionë lekë, Durrës 117 milionë lekë, Fier 106 milionë lekë, Korçë 99 milionë lekë, Lezhë 74 milionë lekë dhe Gjirokastër 52 milionë lekë. Nga krahasimi i arkëtimeve të vitit 2010 me ato të vitit 2011, konstatohet se kemi një

*rritje në vlerë prej 2,106 milionë lekë ose në nivelin rreth 12% më shumë, nga të cilat me rritje paraqiten 6 DRT me vlerë totale 756 milionë lekë dhe me ulje 8 DRT me vlerë totale 9,214 milionë lekë.*

*Efekt negativ në realizimin e tatimit mbi fitimin, ka pasur mosevidentimi dhe moskontrolli i subjekteve me risk të lartë, sipas treguesve negativ, si më poshtë:*

- *Rritja e gjendjes kreditore për të njëjtën periudhë për 2142 subjekte ose mbi 23% (në fund të vitit 2010 numri i subjekteve kreditor ishte 9203 subjekte, kurse në fund të vitit 2011 ky numër deklarohet 11345 subjekte), dhe në vlerë 613 milionë lekë më tepër, ose 8.6 pikë përqindje më shumë.*
- *Rritja e nivelit të subjekteve debitorë, ku për të njëjtën periudhë ajo paraqitet në vlerën 847 milionë lekë.*
- *Rritja e nivelit të subjekteve me humbje duke arritur në 3200 subjekte me një vlerë prej 42,990 milionë lekë.*

### c) Akciza

Për vitin 2011, të ardhurat tatimore nga akciza janë realizuar *në masën 97.9%*, nga 41,270 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar 40,403 milionë lekë, *me një mosrealizim në vlerë prej 867 milionë lekë.*

Krahasuar me të ardhurat e realizuara në vitin 2010, ato rezultojnë me rritje në masën 4.2% dhe në vlerë 1,615 milionë lekë më tepër (40,403 milionë lekë kundrejt 38,788 milionë lekë).

Kundrejt PBB-së të realizuar në vitin 2011, ato zenë 3.07% të tij.

**c.1** Të ardhurat nga akcizat të realizuara nga organet tatimore në vitin 2011, rezultojnë në masën 98%, ose në vlerë 252 milionë lekë më pak se sa parashikimi.

Sipas të dhënave të administratës tatimore qendrore, paraqiten me mosrealizim 6 DRT në vlerën 460 milionë lekë, ku mosrealizimi më i theksuar rezulton në *NJTPM Tiranë në vlerën 362 milionë lekë, vlerë kjo e barabartë me mbi 78% të totalit të mosrealizimit.* Me realizim paraqiten 8 DRT, ku me nivelin më të lartë paraqitet *DRT Tiranë me një tejkalim në shumën 135 milionë lekë, ose rreth 65% të totalit të vlerës së tejkaluar.*

Në vitin 2011, në krahasim me arkëtimet e vitit 2010, janë realizuar të ardhura me shumë në vlerën 1,859 milionë lekë, ose 13% më i lartë. Sipas DRT-ve, nivelet e realizimit kanë disproporcion të theksuar, ku disa paraqiten me nivel realizimi mjaft të lartë si DRT Fier në masën 461%, Tiranë 172%, Lezhë 148% dhe Sarandë 143%, kurse disa të tjera me mosrealizime të theksuara si DRT-të Korçë 32% dhe Kukës 51%, *realitet ky që tregon se planifikimi sipas DRT-ve nuk është bërë mbi baza reale të numrit të subjekteve dhe kapaciteteve prodhuese e tregtues të mallrave të akcizës.*

Gjithashtu, konstatohet se në 4 DRT, megjithëse numri i subjekteve në vitin 2011 paraqitet në rritje kundrejt vitit 2010, arkëtimet paraqiten me ulje në shumën 534.6 milionë lekë, dhe konkretisht:



Në mijë/lekë

Nr.	EMERTIMI	PERIUDHA 12-MUJORE					
		Realizimi faktik		Diferenca	Numri subjekteve tatimpagues		Diferenca
		2010	2011	2011-2010	2010	2011	2011-2010
<b>I.</b>	<b>AKCIZA</b>	<b>728,881</b>	<b>194,265</b>	<b>- 534,616</b>	<b>76</b>	<b>103</b>	<b>+ 27</b>
	Nga të cilat:						
1.	DRT Durrës	132,594	116,288	- 16,306	36	44	+ 8
2.	DRT Fier	535,821	61,728	- 474,093	14	26	+ 12
3.	DRT Shkodër	45,767	4,096	- 41,671	14	14	0.0
4.	DRT Vlorë	14,699	12,153	- 2,546	12	19	+ 7

**c.2** Të ardhurat nga akciza të realizuara nga organet doganore në vitin 2011, rezultojnë në masën 97.6%, nga 25,200 milionë lekë të programuara janë realizuar 24,585 milionë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 615 milionë lekë.

Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2010 në vlerën 24,829 milionë lekë, ato rezultojnë një ulje në vlerë prej 244 milionë lekë, ose në masën 0,98% më pak.

Referuar të dhënave të siguruara gjatë auditimit të kryer në DPD, konstatohet se janë zhdoganuar 457250 ton karburante, 3250 ton cigare dhe 6546 ton kafe. Në krahasim me vitin 2010, janë zhdoganuar 27142 ton karburante më pak ose në masën 5.6% (484392-457250); 1250 ton cigare më pak ose në masën 27.8% (4500-3250); 211 ton kafe më shumë ose në masën mbi 3.3% (6335-6546) dhe 2498 ton birrë ose 7.36% më pak.

Gjatë auditimeve të kryera, audituesit e KLSH-së kanë siguruar informacion për raste të tregtimit të mallrave të akcizës pa pullën fiskale. Për mënjanimin e këtij shqetësimi, e rëndësishme është gjetja e mekanizmave efikas dhe ligjor për të siguruar vënien nën kontroll të lëndëve të para që shërbejnë për prodhimin e mallrave të akcizës që në momentin e importimit, ku rëndësi të veçantë merr informacioni. Me ndryshimin e organizimit të ndjekjes dhe mbledhjes së akcizës, duke u transferuar totalisht në sektorin doganor, e shoqëruar kjo dhe me rritjen e profesionalizmit dhe ndjenjës së përgjegjësisë së administratës doganore, krijohen premisa për minimizimin apo parandalimin e evazionit fiskal nga mallrat e akcizës dhe rritjen e të ardhurave nga këto mallra në të ardhmen.

#### **d) Të ardhurat personale**

Për vitin 2011, plani i të ardhurave për *tatimin mbi të ardhurat* është realizuar në masën 94.8%, me një mosrealizim në vlerë prej 1,526 milionë lekë (nga 29,493 milionë lekë plani janë realizuar 27,967 milionë lekë).

Krahasuar me të ardhurat e realizuara në vitin 2010, ato rezultojnë me rritje në masën 3.3% dhe në vlerë 909 milionë lekë më tepër (27,967 milionë lekë minus 27,058 milionë lekë).

Kundrejt PBB-së të realizuar në vitin 2011, ato zenë 2.13% të tij.

Sipas subjekteve, me realizim të planit paraqitet vetëm *NJTPM Tiranë*, kurse të gjithë DRT-të e tjera me mosrealizime, ndër të cilat paraqesim DRT Durrës me një mosrealizim në vlerë 540 milionë lekë ose në masën 26% më pak dhe atë Fier me 301 milionë lekë të ardhura të paarkëtuara ose në masën 25% më pak.

Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara në vitet 2010 dhe 2011, konstatohet se 10 DRT kanë arkëtuar të ardhura nën nivelin faktik të vitit 2010, me një *diferencë prej 471 milionë lekë*, ndërkohë që numri i subjekteve ka pësuar rritje; kurse me rritje të nivelit të të ardhurave paraqiten 4 DRT, ku me vlerë më të lartë *tejkalimi*



*paraqitet NJTPM Tiranë në shumën 1,086 milionë lekë, shumë e cila ka ndikuar ndjeshëm në nivelin e realizimit të të ardhurave nga ky lloj tatimi.*

Për vitin në vazhdim dhe më tej, nga administrata tatimore kërkohet të kryhet një punë më e organizuar dhe serioze, sidomos në realizimin real të të ardhurave nga tatimi mbi pagesat e sektorit privat, tatimi mbi qiranë dhe mbi shitjet e pasurive të paluajtshme. *Për këtë duhet të bëhet i mundur, konstatimi dhe përcaktimi i masave efektive për mënjanimin e informalitetit në numrin e punonjësve të angazhuar në punë realisht dhe në nivelin real të pagave të punonjësve me ato të deklaruara nga vetë subjektet, sidomos në aktivitetet e prodhimit dhe të ndërtimit.*

Në kontekstin e mësipërm, paraqesim rastet e konstatuar nga audituesit e KLSH në *MPCSSH*, ku si pasojë e mosmbajtjes së tatimit mbi të ardhurat, në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në ligjin nr. 8438, datë 28/12/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, dhe udhëzimin e MF nr. 3, datë 11/2/2002, është shkaktuar një *dëm ekonomik në shumën 293 mijë lekë*; po kështu, në *Projektin “Spitali Universitar Nënë Tereza”* nga mosmbajtja e tatimit në burim mbi të ardhurat e përfutuara vlera e dëmit ekonomik është *9,155 mijë lekë; gjithsej 9,448 mijë lekë.*

#### **e) *Taksat nacionale dhe të tjera***

Për vitin 2011, të ardhurat nga *taksat nacionale* janë realizuar *në masën 95.8%*, nga 22,320 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar 21,388 milionë lekë, *me një mosrealizim në vlerë prej 932 milionë lekë.*

Krahasuar me të ardhurat e realizuara në vitin 2010, ato rezultojnë me rritje në masën 16.9% dhe në vlerë 3,093 milionë lekë më tepër (21,388 milionë lekë minus 18,295 milionë lekë).

Kundrejt PBB-së të realizuar në vitin 2011, ato zenë 1.63% të tij.

Nga të dhënat e raportuara nga DPT, konstatohet se vetëm 3 DRT janë me tejkalim të ardhurash, përkatësisht NJTPM Tiranë 2,539 milionë lekë, Tiranë 440 milionë lekë dhe DRT Elbasan 71 milionë lekë, kurse 11 të tjerat paraqiten me mosrealizim, ku *vetëm DRT Durrës ka raportuar 1,183 milionë lekë më pak se sa plani ose në masën 57% më pak.*

Sipas DRT-ve, në vitin 2011 paraqiten me të ardhura më të shumta se sa në vitin 2010, vetëm NJTPM Tiranë dhe DRT Elbasan.

#### **f) *Taksa doganore***

Për vitin 2011, të ardhurat nga *taksat doganore* janë realizuar *në masën 87.7%*, nga 7,812 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar 6,850 milionë lekë, *me një mosrealizim në vlerë prej 962 milionë lekë.*

Krahasuar me të ardhurat e realizuara në vitin 2010, ato rezultojnë me ulje në masën 9.5% dhe në vlerë 424 milionë lekë më pak (6850 milionë lekë minus 7,274 milionë lekë).

Kundrejt PBB-së të realizuar në vitin 2011, ato zenë 0.52% të tij.

Theksojmë se, niveli i realizimit të të ardhurave nga ky zë, do të ishte më lartë, në se do të ishte mundësuar minimizimi i ndikimit negativ të disa faktorëve në realizimin e tyre, si: rënia e nivelit mesatar të taksës doganore, nivel i cili për vitin 2011 ka rezultuar në masën 1.52% nga 1,80% që rezultoi në vitin 2010; ndryshimi i strukturës së importeve, rritja e vëllimit të importeve të pa taksueshme; luhatjet e kursit të këmbimit etj.

Megjithëse këta faktorë, kanë influencuar negativisht në realizimin e të ardhurave në këtë zë, ato nuk mund të argumentojnë plotësisht mosrealizimin, pasi këto

ndikime të faktorëve të sipërcituar janë prezente pothuajse për çdo vit, për rrjedhojë në momentin e hartimit të projekt programit të të ardhurave doganore, kërkohet që këta faktorë dhe të tjerë të mbahen parasysh nga organi kompetent që merret me programimin e të ardhurave.

**g) Detyrimet debitoare në sektorin e tatimtaksave**

Gjendja e detyrimeve debitoare në fund të vitit 2011 përbën një nga shqetësimet serioze për ekonominë. Bazuar në të dhënat e nxjerra dhe të raportuara nga DPT, gjendja në vlerë e detyrimeve debitoare në fund të vitit 2011 rezulton 64,510 milionë lekë, nga 58,415 milionë lekë që kanë qenë më 1/1/2011; pra me një rritje në vlerë prej 6,095 milionë lekë ose në masën 10.4% më tepër, megjithëse impakti në uljen e detyrimeve nga ligji i faljeve ka qenë në shumën **10,690 milionë lekë**.

Detyrimet debitoare në vlerë më 31/12/2011, zënë 59.5% të vlerës totale të të ardhurave neto të realizuara nga organet e tatimtaksave në vitin 2011; ndërsa kundrejt PBB-së të vitit 2011, vlera e detyrimeve debitoare zë rreth 4.9% të saj, nga 4.73% të PBB-së që zinte në vitin 2010 dhe 4.31% në vitin 2009.

Gjendja e detyrimeve tatimore në fillim dhe në fund të vitit 2011, sipas DRT-ve, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Drejtoritë Rajonale Tatimore	Gjendja më 1/1/2011		Gjendja më 31/12/2011		Diferenca	
		Numri i subjekteve	Vlera në mijë/lekë	Numri subjekteve	Vlera në mijë/lekë	Numri subjekteve	Vlera në mijë/lekë
1.	Berat	2179	508,443	2342	1,293,431	163	784,988
2.	Dibër	2935	1,004,245	3023	1,035,348	88	31,103
3.	Durrës	11196	5,906,722	12376	7,998,414	1180	2,091,692
4.	Elbasan	4982	3,136,098	4328	2,370,158	- 654	- 765,940
5.	Fier	4729	2,529,856	4999	2,575,546	270	45,690
6.	Gjirokastrë	2217	816,491	1804	382,993	- 413	- 433,499
7.	Korçë	4439	1,647,128	4360	1,371,061	- 79	- 276,066
8.	Kukës	1767	499,598	1608	681,866	- 159	182,268
9.	Lezhë	2456	921,343	2520	2,268,570	64	1,347,227
10.	Sarandë	2412	432,373	2125	545,436	- 287	113,063
11.	Shkodër	4626	2,496,902	4266	2,520,918	- 360	24,016
12.	Tiranë	30620	22,347,733	31300	20,989,539	680	-1,358,194
13.	NJTPM Tiranë	1015	13,785,903	898	19,309,695	- 117	5,523,792
14.	Vlorë	3603	2,382,166	3816	1,166,981	213	- 1,215,185
<b>TOTALI:</b>		<b>79176</b>	<b>58,415,001</b>	<b>79765</b>	<b>64,509,956</b>	<b>589</b>	<b>6,094,955</b>

Të dhëna më të detajuara për situatën e detyrimeve debitoare dhe lëvizjen e tyre gjatë vitit 2011 (gjendja, shtesat e pakësimet), paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë/lekë

Nr.	Drejtoritë Rajonale Tatimore	Gjendja më 1/1/2011	Shtuar gjatë vitit 2011	Pakësuar gjatë vitit 2011	Gjendje më 31/12/2011	Diferenca
1.	Berat	508,443	1,024,608	239,620	1,293,431	+ 784,988
2.	Dibër	1,004,245	273,059	241,956	1,035,348	+ 31,103
3.	Durrës	5,906,722	3,385,230	1,293,538	7,998,414	+ 2,091,692
4.	Elbasan	3,136,098	991,188	1,757,128	2,370,158	- 765,940
5.	Fier	2,529,942	1,093,186	1,047,582	2,575,546	+ 45,603
6.	Gjirokastrë	816,491	182,939	616,437	382,993	- 433,498

Nr.	Drejtoritë Rajonale Tatimore	Gjendja më 1/1/2011	Shtuar gjatë vitit 2011	Pakësuar gjatë vitit 2011	Gjendje më 31/12/2011	Diferenca
7.	Korçë	1,647,128	762,419	1,038,485	1,371,061	- 276,066
8.	Kukës	499,598	197,442	15,174	681,866	+ 182,268
9.	Lezhë	921,343	2,027,912	680,685	2,268,570	+ 1,347,227
10.	Sarandë	432,373	361,275	248,213	545,436	+ 113,063
11.	Shkodër	2,496,902	1,083,949	1,059,933	2,520,918	+ 24,016
12.	Vlorë	2,382,166	625,998	1,841,183	1,166,981	- 1,215,185
13.	Tiranë	22,347,733	5,455,677	6,813,871	20,989,539	- 1,358,194
14.	NJTPM Tiranë	13,785,903	13,330,871	7,807,079	19,309,695	+ 5,523,792
<b>TOTALI:</b>		<b>58,415,001</b>	<b>30,795,753</b>	<b>24,700,798</b>	<b>64,509,956</b>	<b>6,094,955</b>

Sipas bilancit të gjëndjes dhe lëvizjes së detyrimeve debitore për vitin 2011, rezulton se gjatë këtij viti janë pakësuar detyrimet e trashëguara gjendje më 1/1/2011 në vlerën 24,700 milionë lekë, ndërkohë që si pasojë e mosarkëtimeve të detyrimeve të periudhës ushtrimore, nga subjektet tatimpaguese janë krijuar debitorë të rinj me një vlerë prej 30,795 milionë lekë, për rrjedhojë janë krijuar 6,095 milionë lekë detyrime debitore të reja shtesë.

Nga krahasimi i gjëndjes debitore në fund të vitit 2011 me gjëndjen në fillim sipas DRT-ve, rezulton se, nga 14 DRT gjithsej, në 5 prej tyre gjendja në fund është ulur, ndërsa në 7 të tjera është rritur.

Në numër subjektësh, nga 79176 subjekte në fillim të vitit 2011, në fund rezultojnë 79765 subjekte, me një rritje prej 589 subjekte, ose 100.7 përqind. Pra, megjithëse numri i subjekteve është rritur 0.7 përqind, detyrimet e papaguara janë rritur 10.4%, ose mesatarisht 10,348 mijë lekë/subjekt (6,095 milionë lekë/589 subjekte), ndërkohë që nga krahasimi i detyrimeve debitore gjithsej me numrin e subjekteve në fund të vitit rezulton që mesatarja e detyrimeve të jetë 809 mijë lekë/subjekt (64,510 milionë lekë/79765 subjekte).

Ndër DRT-të që zenë peshë të konsiderueshme kundrejt totalit të detyrimeve debitore, paraqesim ato me detyrime mbi 2,000 milionë lekë:

- *DRT Tiranë*, ku vlera e detyrimeve debitore gjëndje në fund të vitit 2011 rezultoi 20,989 milionë lekë ose në masën 32.5% të vlerës totale të detyrimeve, me një pakësim prej 1,358 milionë lekë kundrejt gjëndjes në fillim të vitit 2011.

- *Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë* me një vlerë prej 19,309 milionë lekë ose në masën rreth 30% të totalit të detyrimeve debitore, me një rritje prej 5,523 milionë lekë kundrejt gjëndjes në fillim të vitit 2011.

- *DRT Durrës* me 7,798 milionë lekë ose në masën 12.4% të totalit të detyrimeve, me një rritje prej 2,091 milionë lekë kundrejt gjëndjes në fillim të vitit 2011.

- *DRT Fier* me 2,575 milionë lekë ose në masën 4% të totalit të detyrimeve, me një rritje prej 45 milionë lekë kundrejt gjëndjes në fillim të vitit 2011.

- *DRT Shkodër* me 2,520 milionë lekë ose në masën 3.9% të totalit të detyrimeve, me një rritje prej 24 milionë lekë kundrejt gjëndjes në fillim të vitit 2011.

- *DRT Elbasan* me 2,370 milionë lekë ose 3.7% të totalit të detyrimeve, me një pakësim prej 765 milionë lekë kundrejt gjëndjes në fillim të vitit 2011.


- *DRT Lezhë* me 2,268 milionë lekë ose në masën 3.5% të totalit të detyrimeve, me një rritje prej 1,347 milionë lekë kundrejt gjendjes në fillim të vitit 2011. Struktura e detyrimeve debitore dhe pesha specifike e secilit prej tyre kundrejt totalit të detyrimeve, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMËRTIMI	Në milionë/lekë	
		Vlera	Në % ndaj totalit
1.	Detyrimet e papaguara për tatimin mbi fitimin	21,648	34.0
2.	Detyrimet e papaguara për t.v.sh.-në	18,047	28.0
3.	Detyrimet e papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore	8,375	13.0
4.	Detyrimet e papaguara për akcizën	5,832	9.0
5.	Detyrimet për tatimin mbi të ardhurat personale	3,644	5.6
6.	Detyrimet për taksat nacionale	1,619	2.5
7.	Detyrimet për biznesin e vogël	841	1.3
8.	Detyrimet për letrat me vlerë	344	0.5
9.	Detyrimet për kamatëvonesat	423	0.6
10.	Detyrimet për gjokat e papaguara	2,945	4.5
11.	Të tjera detyrime të tatimit mbi të ardhurat (në burim)	792	1.2
<b>TOTALI:</b>		<b>64,510</b>	<b>100.0</b>

Referuar këtyre të dhënave, konstatohet se peshën më të madhe e zënë debitorët për tatimin mbi fitimin në shumën 21,648 milionë lekë ose në masën 34% të totalit të detyrimeve, debitorët për t.v.sh.-në 18,047 milionë lekë ose në masën 28% dhe debitorët për kontributet e sigurimeve shoqërore 8,375 milionë lekë ose në masën 13% Të tre këto lloj detyrimesh zënë rreth 75% të vlerës totale të tyre.

Nga pikëpamja kohore e krijimit të detyrimeve debitore, rezulton se rreth 77% të tyre ose në shumën 49,681 milionë lekë e zënë debitorët e trashëguar nga viti 2009 dhe përpara; rreth 13.8% ose në shumën 8,885 milionë lekë debitorët e krijuar gjatë vitit 2010 dhe rreth 9.2% ose në shumën 5,945 milionë lekë debitorët e krijuar gjatë vitit 2011.

Në mënyrë grafike, krijimi i detyrimeve debitore, duke filluar nga viti 2005 dhe përpara (13,766 milionë lekë ose në masën 21.3%); viti 2006 (3,879 milionë lekë ose në masën 6%); viti 2007 (3,812 milionë lekë ose në masën 5.9%); viti 2008 (8,436 milionë lekë ose në masën 13.1%); viti 2009 (19,788 milionë lekë ose në masën 30.7%); viti 2010 (8,885 milionë lekë ose në masën 13.8%) dhe viti 2011 (5,495 milionë lekë ose në masën 9.2%); paraqitet:



- Në lidhje me masat e marra për vjeljen e detyrimeve debitore, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, Kreu XI, neni 88 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”; neni 89 “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar”; neni 90 “Urdhëri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit”; neni 91 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar”; neni 93 “Sekuestrimi i pasurisë”; neni 97 “Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë”; neni 98 “ E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë”; dhe neni 99 “Përgjegjësia e ortakut, aksionerit dhe administratorit”; grupi i auditimit të KLSH ka konstatuar se gjatë vitit 2011 janë aplikuar masa shtrënguese, të cilat kanë dhënë efektet e tyre si më poshtë:

LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Në mijë/lekë			
	Të vendosura		Të arkëtuara	
	Nr. raste	Shuma	Nr. raste	Shuma
Urdhër bllokime të llogarive bankare	14,949	22,671,090	4,557	1,538,214
Njoftim të tatimpaguesve për vendosjen e masave të sigurisë	4,074	2,085,439	325	103,777
Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e masave të sigurisë	2,857	1,344,397	312	53,266
Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	5,160	6,675,163	1,969	468,367
Njoftim për vendosjen e barrës siguroese	4,681	4,280,994	97	246,276
Urdhër sekuestrimi të pasurisë	815	1,190,205	152	47,140
Njoftim transferimi detyrimit tatimor palës së tretë	2	2,587	1	6,000
Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Administratorit	3	110,971	1	25,800
Njoftim për vendosje urdhër bllokimi në Doganë	540	3,355,872	98	318,117
<b>TOTALI:</b>	<b>33,081</b>	<b>41,716,717</b>	<b>7,513</b>	<b>2,806,958</b>

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se:

- *Masat shtrënguese të marra gjatë vitit 2011, si në numër subjektesh ashtu dhe në vlerë, janë më të pakta se gjendja e borxhit më 1 janar 2011.* Kështu, nga 79176 subjekte debitore në fillim të vitit, janë marrë masa shtrënguese në total vetëm për 33081 subjekte ose për 42 përqind të subjekteve, dhe në vlerë nga 58,415 milionë lekë gjendja e detyrimeve debitore me 1/1/2011 për 41,717 milionë lekë.
- Në totalin e masave shtrënguese peshën kryesore si në numër subjektesh dhe në vlerë, e ze masa urdhër bllokim i llogarive bankare, më e lehta për t’u zbatuar.
- Efektiviteti i masave shtrënguese ka qenë shumë i ulët, kështu nga 79176 subjekte debitore në fillim të vitit 2011, kanë arkëtuar gjatë këtij viti vetëm 7513 subjekte, ose 9.4 përqind e numrit të subjekteve; kurse nga 58,415 milionë lekë detyrime, janë arkëtuar vetëm 2,807 milionë lekë ose 4.8% e shumës.
- Nga krahasimi i masave shtrënguese të marra gjatë vitit 2011 me ato të marra gjatë vitit 2010, rezulton se:
  - Gjatë vitit 2011, janë marrë masa shtrënguese për 33081 subjekte, nga 111379 subjekte të marra gjatë vitit 2010.
  - Sipas llojit të masave, urdhër bllokim i llogarive bankare nga 27612 subjekte në vitin 2010, në vitin 2011 janë marrë 14949; njoftim për vendosje masë sigurie nga 6273 subjekte në vitin 2010 në 4074 në vitin 2011; njoftim i përgjithshëm për

vendosje masë sigurie nga 5510 në vitin 2010 në 2857 në vitin 2011; dhe njoftim për vendosje barrë hipotekare nga 13800 në vitin 2010 në 5160 në vitin 2011.

□ Nga krahasimi i arkëtimeve të debitorëve si rezultat i masave shtrënguese, gjatë gjatë vitit 2011 kanë paguar 7513 subjekte nga 12458 subjekte në vitin 2010, pra 4945 subjekte më pak; ndërsa në vlerë gjatë vitit 2011 janë arkëtuar 2,807 milionë lekë, nga 3,419 milionë lekë arkëtuar në vitin 2010, pra 612 milionë lekë më pak.

□ Numri i subjekteve debitore që kanë paguar detyrime gjatë vitit 2011 zë vetëm 9.5% të numrit të subjekteve debitore në fillim të vitit. Sipas DRT-ve, kanë paguar detyrime debitore në numër më pak subjekte në: DRT Dibër vetëm 47 subjekte nga 2935 subjekte debitore ose në masën 1.6%; Tiranë 574 subjekte nga 30620 subjekte debitore ose 1.9%; Sarandë 55 subjekte nga 2412 subjekte ose 2.3%; Gjirokastër 67 subjekte nga 2217 subjekte ose 3%; Korçë 144 subjekte nga 4439 subjekte ose 3.2% etj. Ndërsa, në vlerë, gjatë vitit 2011 janë arkëtuar vetëm 4.8% e vlerës gjithsej të detyrimeve debitore, ku ndër subjektet veçojmë, DRT Dibër nga 1,004,245 mijë lekë detyrime janë arkëtuar 20,746 mijë lekë ose në masën 2%: Durrës nga 5,906,722 mijë lekë janë arkëtuar 147,192 mijë lekë ose 2.5%: Sarandë nga 432,373 mijë lekë, 10,274 mijë lekë ose 2.4%: Elbasan nga 3,136,098 mijë lekë, 96,863 mijë lekë ose 3.1%: Korçë nga 1,647,128 mijë lekë, 50,697 mijë lekë ose 3.1%; dhe Tiranë nga 22,347,733 mijë lekë, janë arkëtuar 757,776 mijë lekë ose në masën 3.4%.

▪ Përsa i përket masave të marra për zbatimin e ligjit të faljes nr. 10418, datë 21/4/2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, subjektet me borxhe tatimore gjendje në fund të vitit 2010 kanë përfutur dhe u është falur vlera 10,690 milionë lekë, vlerë e cila ka ndikuar direkt në uljen e gjëndjes debitore. Megjithkëtë, përsëri gjendja debitore më 31/12/2011 rezulton me rritje në vlerën 6,095 milionë lekë.

Të dhëna më të detajuara për zbatimin e ligjit të faljes sipas DRT-ve, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë/lekë

Nr.	Emërtimi i DRT-ve	Totali për t'u falur në vlerë	Falur nga Komisioni							
			Falur sipas detyrimeve						Falur në total	
			Numër	Detyrim	Numër	Gjobë	Numër	K/Vonesë	Numër	Vlerë
1.	Berat	302,215	1,219	56,484	592	29,884	286	7,204	2,097	93,572
2.	Dibër	984,112	2,367	151,675	2,408	60,540	446	3,322	5,221	215,537
3.	Durrës	3,560,612	7,457	283,141	8,928	297,959	1,246	8,445	17,631	589,545
4.	Elbasan	1,576,850	5,042	466,846	2,983	733,697	753	11,677	8,778	1,212,220
5.	Fier	1,640,098	3,961	700,721	3,470	278,487	294	111,399	7,725	1,090,607
6.	Gjirokastër	524,990	1,101	279,432	3,095	176,577	308	52,011	4,504	508,020
7.	Korçë	1,394,802	5,041	374,397	6,171	163,421	4,142	71,151	15,354	608,969
8.	Kukës	1,322,517	914	205,674	689	66,173	15	5,757	1,618	277,604
9.	Lezhë	590,271	1,753	179,364	4,914	163,248	3,314	28,280	9,981	370,892
10.	Sarandë	325,323	1,991	105,412	123	8,070	113	9,929	2,227	123,411
11.	Shkodër	1,901,755	3,038	362,590	2,585	419,851	650	63,397	6,273	845,838
12.	Tirana	20,267,553	955	594,543	11,674	771,771	5,481	424,418	18,110	1,790,732
13.	NJTPM	6,945,334	69	471,735	302	1,340,808	158	486,847	529	2,299,390
14.	Vlorë	1,648,910	1,085	256,057	5,216	309,554	2,579	97,917	8,880	663,528
<b>TOTALI:</b>		<b>42,985,342</b>	<b>35,993</b>	<b>4,488,071</b>	<b>53,150</b>	<b>4,820,040</b>	<b>19,785</b>	<b>1,381,754</b>	<b>108,928</b>	<b>10,689,865</b>

Nga analiza e këtyre treguesve rezulton se, nga 42,985,342 mijë lekë të llogaritura për t'u falur në zbatim të ligjit të sipërcituar, janë përfunduar procedurat dhe *deri*



*me datën 31.12.2011 është falur vlera 10,689,865 mijë lekë ose në masën 24.9% vlerë e cila u përket 108928 rasteve.*

Sipas llojit të detyrimeve të falura, që peshën kryesore e zë falja e gjobave për shumën 4,820,040 mijë lekë.

Sipas DRT-ve, paraqiten me një nivel shumë të ulët DRT Tiranë, ku niveli i faljes rezulton në masën 8.8%, ndërkohë që kjo DRT ka dhe vlerën më të madhe për t'u falur, po kështu DRT Durrës dhe Dibër përkatësisht 16.5% dhe 21.9%.

□ Sipas nenit 19, germa "a", të ligjit, detyrimet e falura pa pagesë për personat fizike të regjistruar si subjekt i taksës vendore të biznesit të vogël të periudhës deri me datën 31 dhjetor 2010, rezultojnë në vlerë 1,466,179 mijë lekë për 29,715 raste, ose në masën 13.7% të totalit të faljeve. Veçojmë DRT Sarandë e cila nuk ka paraqitur asnjë rast të falur në zbatim të këtij neni.

□ Sipas nenit 19, germa "b", të ligjit, detyrimet e falura pa pagesë për individët për periudhën tatimore deri në datë 31 dhjetor 2010 janë 244,077 mijë lekë për 6,432 raste, ose 2.3% e totalit të faljeve.

□ Sipas nenit 19, germa "c", të ligjit, detyrimet e falura pa pagesë të tatim paguesve, persona juridikë apo fizikë, të regjistruar si subjekt i t.v.sh.-së, që janë të evidentuar në regjistrat e administratave tatimore deri në datën 31/12/2008, janë në shumën 5,096,056 mije lekë për 11,566 raste, ose 47.7% e totalit të faljeve.

*Në total deri me datën 31/12/2011 detyrimet tatimore që falen pa pagesë kapin vlerën 6,806,312 mijë lekë për 47,713 raste, ose 63.7% të totalit të vlerës së falur.*

□ Sipas nenit 20, pika 1, të ligjit, detyrimet e falura për tatimpagues, persona juridikë apo fizikë, të regjistruar si subjekt i t.v.sh.-së, që janë të evidentuar në regjistrat e administratave tatimore në periudhën 1/1/2009 deri më 31/12/2009, që paguajnë 30% të principalit të tatimit, janë në shumën 1,367,008 mijë lekë për 5,201 raste. Sipas Drejtorive Rajonale rezulton që DRT-të Dibër, Durrës, Korçë, Kukës e Sarandë të mos kenë asnjë rast falje.

□ Sipas nenit 20, pika 2, të ligjit, detyrimet e falura për tatimpagues, persona juridikë apo fizikë, të regjistruar si subjekt i t.v.sh.-së, që janë të evidentuar në regjistrat e administratave tatimore në periudhën 1/1/2010 deri më 31/12/2010, që paguajnë 50% të principalit të tatimit, janë në shumën 1,367,008 mijë lekë për 5,201 raste. Sipas Drejtorive Rajonale rezulton që DRT-të Dibër, Durrës, Korçë, Kukës e Sarandë të mos kenë asnjë rast falje.

□ Sipas nenit 21, të ligjit, detyrimet e falura janë në shumën 17,938 mijë lekë për 170 raste; sipas nenit 22 të ligjit në shumën 764 mijë lekë për 3 raste; sipas nenit 23 dhe 24 të ligjit, detyrimet e falura për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën deri 31/12/2010 janë në shumën 1,153,328 mijë lekë për 45,973 raste; dhe sipas nenit 32 të ligjit, detyrimet e falura janë për shumën 86,785 mijë lekë për 2,639 raste.

*Pra, nga këto të dhëna, konstatohet se zbatimi i ligjit për legalizimin dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor, paraqitet në nivele mjaft të ulta.*

Ndër shkaqet më kryesore të krijimit të gjendjes tepër të madhe të detyrimeve debitore dhe nivelit të ulët të mbledhjes së borxhit, si dhe punës së pamjaftueshme për faljen e detyrimeve tatimore në zbatim të ligjit të faljeve, paraqesim:

**1. Niveli i ulët i zbatimit të masave shtrënguese.**

Ndonëse, nga ana e strukturave përgjegjëse në DPT dhe DRT-të janë marrë dhe po merren disa hapa ligjore për vjeljen e detyrimeve debitore, *ato nuk kanë dhënë efektivitetin e duhur, si nga pikëpamja e hartimit të manualeve apo urdhërave për zbatim, ashtu dhe gjatë ndërmarrjes të hapave konkretë ligjore për vjeljen e borxhit*, konform kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 për procedurat tatimore, sidomos në drejtim të *zbatimit të masave shtrënguese të mbledhjes me forcë të detyrimeve debitore.*

Këtu, ka ndikuar dhe mosshtrirja e masave shtrënguese në të gjithë fazat e procedurave, pasi inspektorët e mbledhjes janë mjaftuar vetëm me vendosjen e një mase dhe me tej procedurat janë bërë pjesërisht ose janë ndërprerë.

Për ndryshimin e kësaj sistuate, drejtuesit e DPT, duhet të kërkojnë dhe përgjegjësojnë të gjithë strukturat në terren, për moszbatimin me rigorozitet të kërkesave të procedurave ligjore lidhur me evidentimin dhe mbledhjen e borxhit, në veçanti të procedurave për vlerësimin dhe përcaktimin e subjekteve debitore me risk; subjekte që gjykohen se detyrimet e tyre do të kalojnë në borxhin e keq provizor apo do të parashkruhen; saktësimin e bankave ku operojnë subjektet; gjendjen në likuiditete të llogarive etj. Gjithashtu, kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet detajimit të arkëtimeve në objektiva konkrete dhe kohorë për çdo inspektor, duke organizuar raportimin periodik mbi detyrat e kryera.

**2. *Mosdërgimi brënda afatit ligjor të të dhënave të borxhit tatimor*** të administruar e të kontabilizuar nga drejtoritë e përpunimit dhe menaxhimit të të ardhurave dhe mosrakordimi i tyre me të dhënat e borxhit që administrojnë drejtoritë e mbledhjes së të ardhurave në qendër dhe në bazë.

Gjithashtu, për t'u riparuar, *dërgimi me vonesë nga DPMA i detyrimeve tatimore që lindin në vijimësi dhe që përbën risk për borxhin dhe zvogëlon shansin për arkëtimin e tij.*

**3. *Ndryshimet e herëpashershme të strukturave organizative e të punonjësve të ngarkuar me administrimin dhe rikuperimin e borxhit tatimor*** në qendër dhe në bazë, *pa asnjë argumentim ligjor.*

**4. *Mangësitë në bashkëpunimin me institucionet e tjera shtetërore*** si: DPD dhe degët doganore, ZRPP-të, institucionet bankare etj.

Këtu, duhen përfshirë dhe vonesat apo mungesat e kthimit të përgjigjeve nga Bankat, ZRPP-të, madje dhe nga organet doganore.

**5. *Mosarritja e treguesve të parashikuar nga ligji i faljes nr. 10418, datë 21/4/2011*** "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor", ndër të cilat paraqesim, mangësitë organizative, mosfunksionimin rregullisht të Komisioneve të Faljes dhe efektivitetin e pakët të punës së tyre.


**g) Borxhi doganor**

Ky borxh në fund të vitit 2011, *pas shumë viteve paraqitet me ulje, si në vlerë dhe në numër subjektësh.* Sipas të dhënave të DPD-së, gjendja në vlerë, *nga 12,298 milionë lekë në 1/1/2011, ka zbritur në 2,959 milionë lekë më 31/12/2011, pra një ulje mjaft e madhe, përkatësisht në vlerën 9,339 milionë lekë, ose në masën 76%.*

Kundrejt të ardhurave doganore të realizuara në vitin 2011, vlera e borxhit doganor zë rreth 2.3% nga 10.3% që zinte një vit më parë, *pra me një pakësim të dukshëm prej 8 pikë përqindje.*



Në mënyrë grafike, ecuria e borxhit doganor për periudhën 2007-2011 paraqitet:



Gjendja e borxhit doganor në vitin 2011, shtesat dhe pakësimet, si dhe krahasuar me vitin 2010, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Në milionë/lekë*

Vitet	Gjendja në fillim		Shtuar gjatë vitit		Pakësuar gjatë vitit		Gjendja në fund	
	Numri	Vlerë	Numri	Vlerë	Numri	Vlerë	Numri	Vlerë
2010	2304	10,405	2012	4,606	1800	2,713	2516	12,298
2011	2516	12,298	2289	3,972	3630	13,310	1,175	2,959
Ndryshimi:		1,893	277	-634	1830	10,597	-1341	-9,339

Nga auditimet e ushtruar nga KLSH në DPD dhe në disa degë dganore dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit në DPD, ka rezultuar se:

*Rënia e nivelit të borxhit doganor në masën 76%, është rrjedhojë kryesisht e ndikimit të zbatimit të ligjit nr.10418, datë 21/04/2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjesë të borxhit tatimor dhe doganor".*

Në fund të vitit 2011, analizuar sipas degëve doganore, veçojmë 6 prej tyre, ku pakësimi i borxhit doganor rezultoi në vlerën 9,911 milionë lekë, konkretisht: Dega e Doganës Vlorë me një ulje në vlerë prej 2,220 milionë lekë (borxhi i krijuar 170 milionë lekë – borxhi i pakësuar 2,390 milionë lekë) ose në masën rreth 23.8% e totalit të uljes së borxhit; Durrës me një ulje në vlerë 2,030 milionë lekë (borxhi i shtuar 1,161 milionë lekë – borxhi i pakësuar 3,191 milionë lekë) ose në masën 21.7% të uljes totale të borxhit; Kakavijë në vlerën 965 milionë lekë (borxhi i shtuar 106 milionë lekë – borxhi i pakësuar 1,071 milionë lekë) ose në masën 10.3%; Tiranë në vlerën 956 milionë lekë (borxhi i shtuar 1,901 milionë lekë – borxhi i pakësuar 2,857 milionë lekë) ose 10.2%; dhe Pogradec me një ulje të borxhit në vlerën 722 milionë lekë (borxhi i shtuar 41 milionë lekë – borxhi i pakësuar 763 milionë lekë) ose 8.3% të totalit të uljes të vlerës së borxhit.

Analizuar në këndvështrimin e shtesave dhe pakësimeve të numrit të subjekteve dhe vlerës së borxhit përgjatë vitit 2011, rezulton se borxhi doganor është shtuar për 2289 debitorë me 2784 raste dhe në vlerë 3,972 milionë lekë, ndërkohë që është pakësuar për 3630 debitorë me 4534 raste dhe në vlerë 13,310 milionë mijë lekë; pra me një diferencë në numër 1341 debitorë më pak dhe në vlerë 9,338 milionë lekë pakësuar më shumë se sa vlera e borxhit doganor të shtuar.

*Raporti ndërmjet borxhit të pakësuar me atë të shtuar, rezulton në masën 2.35 herë tepër (9,338/3,971 milionë lekë).*

Në pamje të parë duket sikur është punuar mirë, por nga një analizë më e thelluar e faktorëve që kanë ndikuar në gjendjen e borxhit doganor, duke e xhveshur nga influenca e zbatimit të ligjit nr.10418, datë 21/04/2011, kemi evidentuar se:

Numri i debitorëve në DPD për vitin 2011 (pa përfshirë pakësimet sipas ligjit), është shtuar me 277 debitorë krahasuar me gjendjen në fillim të vitit dhe në vlerë 1,901 milionë lekë.

Në strukturë, gjendja e borxhit doganor datë 31/12/2011, përbëhet nga detyrimet doganore të papaguara në vlerën 1,706 milionë lekë ose në masën 57.6%; gjobat e pa arkëtuara për shkeljet e konstatuara 1,082 milionë lekë ose 36,6%; dhe kamatëvonesat e llogaritura për pagesa të vonuara 171 milionë lekë ose në masën 5,8%. Në krahasim me një vit më parë, *gjobat dhe kamatëvonesat e aplikuara nga autoriteti doganor zënë rreth 42.4% të totalit të borxhit doganor, nga 68.2% që zinin një vit më parë.*

Struktura e gjendjes së borxhit doganor për vitet 2010 dhe 2011, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Periudha	Numri	Detyrimet	Gjobat	Kamatë Vonesat	Totali
1.	31.12.2010	2516	3,908	6,298	2,092	12,298
2.	31.12.2011	1175	1,706	1,082	171	2,959
3.	Diferenca	-1,341	-2,202	-5,216	-1,921	-9,338
4.	Në përqindje 2011 ndaj 2010	46.7	43,66	17,18	8,19	24,06
	Viti 2010	Struktura	31.8	51.20	17.00	100
	Viti 2011		57.64	36.56	5.80	100

Duke e analizuar gjendjen e borxhit doganor sipas periudhës së kontabilizimit të vendimeve administrative, konstatojmë se 5.1% e borxhit i takon periudhës deri më 31/12/1999, vlerë e cila është miratuar nga komisionet e monitorimit për t'u falur në tremujorin e parë të vitit 2012. Nga debitorët e trashëguar nga 31/12/1999 deri më 31/12/2006, mbeten pa u likuiduar rreth 284 milionë lekë për të cilët nga DPD kërkohet të ndiqen procedurat përkatëse ligjore. Është me rëndësi të cilësojmë se, gjendja e borxhit që trashëgohet deri më 31/12/2011, i takon vitit 2008 në vlerën 554.2 milionë lekë ose në masën 18.7%, vitit 2009 me 457 milionë lekë ose në masën 15.5%, vitit 2010 me 788.4 milionë lekë ose në masën 26.7% dhe vitit 2011 me një borxh doganor në vlerë 652.8 milionë lekë ose në masën 22.1%.

Në auditimet e kryera dhe nga të dhënat e DPD, rezulton se, deri më 31/12/2011 nga totali i borxhit prej 2,959 milionë lekë, 32.4% të tij e barazvlefshme me 960 milionë lekë e zë borxhi i krijuar nga mospagesa e detyrimeve doganore për t.v.sh.-në e shtyrë. Ndryshe nga vitet e mëparshme, për vitin 2011, borxhi i krijuar nga moslikuidimi i t.v.sh.-së së shtyrë rezulton në verën 572.6 milionë lekë ose në masën 59.6% të borxhit gjithsej të lindur nga mospagesa e t.v.sh.-së së shtyrë. Më keq, në lidhje me gjendjen e borxhit doganor të lindur nga mospagesa e t.v.sh.-së së shtyrë deri në datën 31/12/2011, paraqiten Degët Doganore Tiranë me një vlerë prej 457 milionë lekë ose në masën 47.6% të totalit të borxhit për t.v.sh.-në e shtyrë dhe 45.6% të totalit të borxhit gjithsej të vetë degës; Berat për vlerën 177.6 milionë lekë

ose pothuajse 100% të borxhit total të saj; Durrës për vlerën 138.5 milionë lekë ose 20.8% të totalit të borxhit të saj; dhe Fier me vlerën 98.2 milionë lekë ose në masën 80.8% të totalit të borxhit të saj.

▪ *Ndër shkaqet kryesore që kanë ndikuar në lindjen dhe shtimin e borxhit doganor, paraqesim:*

1. Moszbatimin nga ana e administratës doganore të kërkesave të legjislacionit doganor dhe të dispozitave zbatuese të tij, gjatë zbatimit të procedurave të zhdoganimit të mallrave të importit e të eksportit, mbikëqyrjes së rregjimeve ekonomike, si dhe gjatë zbatimit të procedurave të lehtësirave doganore (skemat e shtyrjes së pagesave me një efekt të shprehur në vlerë prej 960 milionë lekë).

2. Punën e pamjaftueshme të punonjësve të zyrave të borxhit doganor për kryerjen e detyrës në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe lëvizjet e shpeshta të tyre nga vendet e punës.

3. Mossigurimin e rezultateve të duhura nga bashkëpunimi me strukturat e tjera të shtetit, sidomos me DPT, Drejtorinë e Përgjithshme të Sherbimit të Transportit Rrugor, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm të titujve, përfshirë veprimet e sekuestrimit apo të kalimit të pronësisë, të cilat duhet të zbatohen nga Zyrat Përmbartimore në rrethe.

4. Mangësitë në zbatimin me rigorozitet të masave të përcaktuara për arkëtimin e detyrimeve debitore, në veçanti të borxhit të mbështetur edhe nga Autoritetet Gjyqësore me urdhra ekzekutiv për zbatim të menjëhershëm nga Zyrat e Përmbartimit Gjyqësorë në rrethe.

5. Mosndjekjen e të gjitha rrugëve të mundshme ligjore, që kur lind një borxh doganor, përgatitja, nxjerrja dhe kontabilizimi i vendimit, njoftimi i debitorit, nxjerrja e urdhërave të ekzekutimit etj., që përbëjnë ndër detyrat prioritare të organeve doganore për të patur rezultatin e kërkuar dhe të duhur, në lidhje me arkëtimin dhe rikuperimin e borxhit doganor etj.

Mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore.

○ Gjatë zbatimit të buxhetit në DPT, problem i përvitshëm ka qenë *mungesa e fondeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore*. Nga viti 2006 dhe deri në fund të vitit 2011, janë kryer pagesa për 34 punonjës me vendime gjyqësore të formës prerë, me objekt rikthim në punë dhe kthimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë, duke kryer pagesa dy herë për të njëjtin vend pune, një herë sipas strukturës organike dhe tjetra me vendim gjyqësor. Në total, detyrimi sipas vendimeve të gjykatave të formës prerë për likuidimin e shumave në favor të punonjësve tatimorë të trajtuar me *kod pune* dhe me *statusin e nëpunësit civil*, rezulton në vlerën 173,050,325 lekë, nga e cila deri në fund të vitit 2011 janë likuiduar 42,658,367 lekë, dhe mbeten në proces likuidimi 130,391,958 lekë.

Krahas sa më sipër, nga DPT janë kryer pagesa ndaj subjekteve tatimpagues, në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë me një vlerë prej 103,113,971 lekë, nga e cila kamatëvonesa në favor të një subjekti privat kap vlerën 59,950,014 lekë. Në vitet 2010 dhe 2011, në DPD janë punësuar gjithsej 140 punonjës, nga të cilët asnjë nga punonjësit e listuar në listën e punonjësve kreditorë për ekzekutim vendimi gjykate të formës së prerë me objekt: “Pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së mardhënieve financiare deri në kthimin në punë”. Mosmarrja në

punë e 15 punonjësve të listës (kreditorë për ekzekutim vendimi gjykatë) në vitin 2011 ka sjellë një efekt financiar *në shumën 5,273,430 lekë*.

### **III.3 Të ardhurat jotatimore**

Për vitin 2011, të ardhurat jotatimore nga 20,228 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 22,731 milionë lekë ose në masën 112,4%, *me një tejkalim në vlerë prej 2,503 milionë lekë*. Impakti më i madh pozitiv në këtë kategori të ardhurash ka ardhur nga zëri “Të tjera”, i cili është realizuar në masën 175.5%, me një tejkalim në vlerë prej 910 milionë lekë.

Krahasuar me të ardhurat jotatimore të realizuara në vitin 2010, ato rezultojnë me ulje të konsiderueshme, përkatësisht nga 31,552 milionë lekë të realizuar në vitin 2010, në 22,731 milionë lekë në vitin 2011, *ose në masën 28% më pak dhe në vlerë 8,821 milionë lekë më pak*. Këto të ardhura, nga 9.71% të totalit të të ardhurave gjithsej të realizuara që zinin në vitin 2010, në vitin analizues 2011 zenë 6.9%, *pra me një ulje të ndjeshme prej 2.81 pikë përqindje*.

Kundrejt PBB-së të realizuar në vitin 2011, këto të ardhura zenë 1.73% të tij, nga 2.54% të PBB-së që zinin në vitin 2010 (realizuar 31,552 milionë lekë).

Nga shqyrtimi i strukturës së realizimit të të ardhurave jotatimore për vitin 2011 rezulton se, të 5 zërat përbërës të tij paraqiten me realizim dhe tejkalim të kuotave të planifikuara. Kështu:

- Të ardhurat nga “*Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë*” janë realizuar në masën 109.8%, me një tejkalim në vlerë prej 510 milionë lekë.
- Të ardhurat nga “*Institucionet buxhetore*” në masën 100.1%, me një tejkalim në vlerë prej 13 milionë lekë.
- Të ardhurat nga “*Dividenti*” në masën 212% ose 560 milionë lekë më shumë kundrejt planifikimit.
- Të ardhurat nga “*Tarifat e shërbimeve*” në masën 117% dhe në vlerë 510 milionë lekë më shumë.
- Dhe të ardhurat nga zëri “*Të tjera*” në masën 175.5% ose 910 milionë lekë më shumë.

#### **III.3.a Rregullshmëria e përcaktimit dhe kalimit të fitimit neto të BSH në buxhetin e shtetit.**

Për auditimin e përcaktimit dhe të kalimit të fitimit neto të Bankës së Shqipërisë në buxhetin e shtetit, KLSH është mbështetur në:

a) Pikën 2, neni 10, të ligjit nr. 8269, datë 23/12/1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohet: “*Fitimi neto për vitin financiar që mbetet pasi bëhen zbritjet, sipas neneve 8, 9 dhe të pikës 1 të këtij neni, kalon në të ardhurat e buxhetit të shtetit brenda 4 muajsh, pra deri më datën 30 prill të vitit pasardhës*”.

b) Pikën 4.2, neni 4, të marrëveshjes të lidhur midis BSH dhe MF dhe hyrë në zbatim më datë 27.03.2003, ku përcaktohet: “*Transferimi i fitimit të Bankës Shqipërisë bëhet me kërkesë të Ministrisë së Financave dhe jo më shpejt se data 7 e çdo muaji në formë paradhënie. Transferimi do të fillojë në muajin shkurt dhe do të përfundojë në muajin janar të vitit pasardhës. Masa e fitimit të derdhur, nuk do të tejkalojë vlerën 90% të fitimit të realizuar*”.

Gjatë auditimit për vitin raportues 2011, KLSH ka konstatuar se të 2 institucionet kanë vepruar si më poshtë vijon:

1. Me vendimin e Këshillit Mbikqyrës të BSH nr. 20, datë 09.03.2011 “Për miratimin e bilancit financiar (pasqyrën e pozicionit financiar) dhe të shpërndarjes së fitimit të BSH për vitin 2010”, në pikën 5 të tij, është miratuar kalimi i të ardhurave në buxhetin e shtetit të shumës prej *2,610 milionë lekë*, si pjesë e pa shpërndarë e fitimit neto të BSH për vitin 2010. Ky kalim duhet të bëhet brenda datës 30/4/2011.

Nga verifikimi ka rezultuar se, me datë 3/1/2011 ka kaluar për llogari të buxhetit të shtetit pranë MF, shuma prej *1,500 milionë lekë*, dhe me datë 28/3/2011 shuma prej *1,110 milionë lekë*, duke prekur llogaritë “Fitim i pashpërndarë i BSH” dhe “Depozitë e Qeverisë”.

2 Në zbatim të pikës 4.2 të marrëveshjes të sipërcituar dhe në përgjigje të këtyre shkresave, BSH-së ka transferuar në MF gjatë gjithë vitit 2011, për llogari të “Depozitës së Qeverisë” *shumën prej 3,100 milionë lekë, shumë e cila zë 70% të fitimit të derdhur për llogari të vitit 2011*, duke prekur llogarinë “Paradhënie e fitimit të planifikuar”.

3. Me vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 12, datë 29/2/2012 “Për miratimin e pasqyrës së pozicionit financiar të BSH-së dhe të shpërndarjes së fitimit të BSH për vitin 2011”, në pikën 5 të tij, vendimi ka miratuar kalimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit në shumën *prej 1,373 milionë lekë*, si pjesë e pa shpërndarë e fitimit neto të BSH-së për vitin 2011. BSH-së ka transferuar në MF për llogari të “Depozitës së Qeverisë” shumën prej *170 milionë lekë*, duke prekur llogarinë “Fitimi neto i vitit 2011”, gjithashtu, mbas daljes së konkluzioneve të auditimit të jashtëm për certifikimin e llogarive, ka derdhur brënda 4/mujorit të parë 2012, shumën prej *1,203 milionë lekë*, duke prekur llogarinë “Fitimi neto i vitit 2011”.

Nga auditimi rezultoi se, derdhjet e fitimit të BSH-së në llogarinë “Depozitë e Qeverisë”, janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituar, ***pra çdo muaj është transferuar paradhënia e fitimit.***

Gjithashtu, nga verifikimi i derdhjeve për vitin 2011, rezultoi se shuma e përcaktuar e fitimit të BSH-së në bilancin e këtij viti, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 12, datë 29/2/2012, për t’ia kaluar buxhetit të shtetit, ishte përcaktuar në vlerë ***4,473 milionë lekë***, vlerë e cila rezultoi e njëjtë dhe nga derdhjet e kryera në favor të buxhetit të shtetit.

### **III.3.b *Të ardhurat nga institucionet buxhetore***

Për vitin 2011, të ardhurat nga institucionet buxhetore nga 10,323 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në shumën 10,336 milionë lekë ose në masën rreth 100.1%, *me një tejkalim në vlerë prej 13 milionë lekë*. Në krahasim me të ardhurat e realizuara një vit më parë, ato paraqiten me ulje të konsiderueshme, *rreth 26% më ulët dhe në vlerë 3,658 milionë lekë më pak* (10,323 milionë lekë në vitin 2011 minus 13,994 milionë lekë realizuar në vitin 2010).

Ndërsa, kundrejt PBB-së të realizuar në vitin 2011, këto të ardhura zenë 0.78% të tij, nga 1.13% të PBB-së që zinin në vitin 2010..

Nga auditimet e ushtruara në 12 ministri dhe institucione të tjera qendrore për zbatimin e buxhetit të vitit 2011, në drejtimet e auditimit është parashikuar pikë e

veçantë auditimi në lidhje me nivelin e realizimit dhe zbatimin e legjislacionit për parashikimin dhe përdorimin e të ardhurave që krijojnë këto institucione buxhetore. Në këto auditime ka rezultuar se, në përgjithësi, janë zbatuar kërkesat e vendimit të KM nr. 432, datë 28/6/2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore” me ndryshime, ndërkohë që në disa prej tyre janë konstatuar mosrealizime kundrejt programimit, të cilat kanë ndikuar në kryerjen e shpenzimeve të parashikuara për t’u mbuluar nga këto të ardhura.

Në të 12 institucionet e audituar rezultoi se, të ardhurat dytësore për periudhën e kontrolluar të vitit 2011 janë realizuar në vlerën **969.2** milionë lekë nga **2,619.3** milionë lekë të realizuara në vitin 2010, ose në masën 37%.

Në mënyrë analitike realizimi i të ardhurave sipas institucioneve paraqitet në tabelën më poshtë:

					<i>Në mijë/lekë</i>
<i>Nr.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Realizimi i vitit 2010</i>	<i>Realizimi i vitit 2011</i>	<i>Periudha e Audituar</i>	<i>Në % 2011/2010</i>
1.	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	866,746	157,634	3/m i-re	=
2.	Qendra Kombëtare e Regjistrimit	17,927	9,260	6/m i-re	=
3.	MPPT	43,820	18,217	6/m i-re	=
4.	METE	1,253,352	368,660	6/m i-re	=
5.	Agjencia Telegrafike Shqipëtare	6.110	2,717	8/mujori	=
6.	Qendra e Publikimeve Zyrtare	36,446	16,467	9/mujori	=
7.	Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër	162,744	140,194	9/mujori	=
8.	Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	9,178	8,429	viti 2011	92 %
9.	Shërbimi Informativ Shtetëror	11,418	8,107	viti 2011	71 %
10.	MMPAU	127,124	160,692	viti 2011	126 %
11.	MTKRS	77,669	76,187	viti 2011	98 %
12.	Drejtoria Rajonale Arsimore Shkodër	6,431	2,636	viti 2011	
<b>SHUMA:</b>		<b>2,619,365</b>	<b>969,200</b>	=	=

Të analizuar sipas institucioneve rezultojnë:

**1. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit .**

Ky institucion në 3/mujorin e parë 2011, ka realizuar të ardhura dytësore në shumën *157,634 mijë lekë*, nga të cilat: 108,015 mijë lekë ose në masën 68% nga kundravajtjet administrative; 25,562 mijë lekë ose në masën 16% nga veprimtaritë kryesore; 21,375 mijë lekë ose 14% nga veprimtari dytësore dhe 2,682 mijë lekë ose 2% nga veprimtari ekonomike. Peshën kryesore e zënë të ardhurat e realizuara nga kundravajtjet administrative të konstatuara nga policia e qarkullimit rrugor, e cila në shkallë vendi për 3/mujorin e audituar ka aplikuar 142 mijë gjoba me një vlerë prej 118,589 mijë lekë; nga të cilat janë arkëtuar 76979 raste me vlerë 88,341 mijë lekë ose 54% e numrit dhe 74% e vlerës.

Për sa më sipër, mosarkëtimi i shumës prej *30,348 mijë lekë* përbën një rezervë të konsiderueshme për të ardhurat e buxhetit të shtetit.

Gjithashtu, nga 22312 mjete të bllokuara për kundravajtjet administrative apo arësye të ndryshme të përcaktuara në kodin rrugor, janë sekuestruar dhe kaluar në rezervën e shtetit vetëm 195 automjete ose 0.9% e tyre.

Vlen të theksohet se, *mbajtja e mjeteve të bllokuara pranë Drejtorive Rajonale të Policisë për një kohë të gjatë, krijon një kosto të konsiderueshme financiare për strukturat e policisë, pasi lidhen me ruajtjen në gjendjen teknike të bllokimit deri*

*në momentin që i kthehet kundërvajtësit ose kalojnë për sekuestrim dhe me vendosjen e rojeve për ruajtjen e tyre në qendrat e ruajtjes.*

Përdorimi i të ardhurave dytësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

## **2. Në Qendrën Kombëtare të Regjistrimeve .**

Për 6/mujorin e parë 2011, janë realizuar të ardhura dytësore në shumën *9,260 mijë lekë*, nga të cilat; 7,835 mijë lekë ose në masën 85% nga aplikimet për marrjen e NIPT-it dhe ekstraktit për të dhënat e biznesit, kurse pjesa tjetër prej 1,425 mijë lekë ose rreth 15% të ardhura nga gjobat për vonesat e raportimeve të ndryshimeve që mund të ndodhin në shoqëritë tregtare, në ndryshimin e bilanceve etj.

Të gjitha të ardhurat e realizuara janë derdhur në buxhetin e shtetit.

## **3. Në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit .**

Kjo ministri për vitin 2011, ka parashikuar në planin e të ardhurave shumën *17,405 mijë lekë*. Në fakt vetëm për periudhën e audituar 6/mujorin e parë të vitit 2011 janë realizuar *18,217 mijë lekë ose në masën 105% të planit vjetor*, çka tregon për një planifikim të pa studiuar, jo real dhe me rezerva.

Në vlerën e realizuar peshën kryesore e zenë të ardhurat e arkëtuara nga koncesionet, të cilat zenë rreth 60% të totalit të të ardhurave. Vetëm nga dhënia me koncesion e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve arkëtohen mesatarisht rreth 1.4-1.8 milionë lekë në muaj ose afro 17-22 milionë lekë në vit.

Cilësojmë se, këto të ardhura nuk janë parashikuar si zë i veçantë në hartimin e programeve afatmesme për vitet 2010 dhe 2011, si dhe nuk janë pasqyruar si zë më vete në aneksin 7.a, veprime të cilat kanë të bëjnë me balancimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit, konformë neneve 5 dhe 9 “ii”, të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

## **4. Në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.**

Për 6/mujorin e parë të vitit 2011, METE ka realizuar të ardhura dytësore në shumën *368,660 mijë lekë*, nga të cilat; 174,334 mijë lekë ose në masën 47% të tyre nga shitja e shërbimeve; 91,285 mijë lekë ose 25% nga taksat koncensionare të HEC-ve; 24,072 mijë lekë ose 6.5% nga lejet; 22,799 mijë lekë ose 6% nga dhënia me qira e ambienteve etj.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, *të ardhurat dytësore janë me ulje*. Impaktim më të madh negativ e kanë pasur të ardhurat e realizuara nga dividenti, të cilat për 6/mujorin e parë 2011 janë realizuar vetëm 6,739 mijë lekë nga 733,534 mijë lekë që janë realizuar në vitin 2010.

Përdorimi i të ardhurave dytësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

## **5. Në Qendrën e Publikimeve Zyrtare .**

Për 9/mujorin 2011, QPZ ka realizuar të ardhura dytësore në shumën *16,467 mijë lekë* nga shitja e fletoreve zyrtare dhe e botimeve të ndryshme.

Nga auditimi u konstatua se në këtë institucion zbatohet urdhri i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë nr. 8089/1, datë 22.11.2006 dhe MF nr. 9534/5, datë 26.12.2006 “Për caktimin e çmimeve të botimeve e shpërndarjes së konfirmimeve dhe kopjeve të akteve të qendrës së publikimeve zyrtare”, urdhër i cili bie në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8502, datë 30.06.1999 “Për krijimin e qendrës së publikimeve zyrtare”, ndryshuar me ligjin nr. 9091, datë 26.06.2003, pasi QPZ shpërndan falas dhe me mjetet e veta 106 kopje të çdo botimi (përfshirë edhe fletoret zyrtare), për 4 institucione të larta shtetërore, si dhe për anëtarë të

Këshillit të Qendrës dhe për punonjësit e saj, të cilat *të vlerësuara me çmimin e një botimi vjetor krijojnë një mungesë në të ardhurat e këtij institucioni në shumën 5,565 mijë lekë*. Po kështu, sipas këtij udhëzimi, çmimi i shitjes së botimeve, përfshirë dhe fletoren zyrtare, është 2 lekë për një fletë, ndërkohë që *kostoja e blerjes së një flete në subjektin privat të kontraktuar, është 3.25 lekë për një fletë, ose 1.25 lekë më shumë*. Gjithashtu, *kostoja e prodhimit të një flete të prodhuar nga QPZ është 3.1 lekë për një fletë, ose 1.1 lekë më shumë, ndërsa çmimi i shitjes për një fletë botimi vazhdon të jetë 2 lekë për një fletë, që nga viti 2006*.

Nga përlogaritjet e bëra rezulton se, *diferenca ndërmjet kostos së prodhimit dhe çmimit të shitjes në total është 16,993 mijë lekë, shumë e cila krijon mungesë të ardhurash për buxhetin e këtij institucioni*.

Përdorimi i të ardhurave dytësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

#### **6. Në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër .**

Ky institucion për 9/mujorin 2011, ka realizuar të ardhura dytësore në shumën *140,194 mijë lekë ose në masën 86% të realizimit të vitit 2010*. Këto të ardhura janë krijuar nga tarifat për dhënien e vërtetimeve të ndryshme, nga tarifat e shkollimit, regjistrimit, si dhe tarifat e analizave mikrobiologjike. Miratimi i këtyre tarifave është bërë me vendimet e Senatit të Uiversitetit nr. 134, datë 6/07/2009 dhe nr. 22, datë 20/06/2011. Por, pas miratimit të tyre nga Këshilli i Administrimit, në zbatim të VKM nr. 432, datë 28/6/2006 dhe udhëzimit të përbashkët të MASH dhe MF “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të arsimit”, tarifat duhej të miratoheshin nga MASH dhe nga MF.

Përdorimi i të ardhurave dytësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

**7. Në Agjencinë Telegrafike Shqiptare,** gjatë vitit 2011, janë realizuar të ardhura dytësore në shumën *2,717 mijë lekë ose në nivelin 45% të realizimit të vitit 2010*. Këto të ardhura janë krijuar nga shitja e lajmeve për klientë vendas dhe të huaj. Përdorimi i të ardhurave dytësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

**8. Në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë,** gjatë vitit 2011, janë realizuar të ardhura dytësore në shumën *8,429 mijë lekë ose në nivelin 92% të realizimit të vitit 2010*. Këto të ardhura janë krijuar kryesisht nga dhënia e objekteve me qira, të cilat zenë rreth 82% të totalit të të ardhurave dhe nga shitja e biletave të teatrit të fëmijëve të cilat zënë rreth 13%.

Nga auditimi u konstatua se çmimi i biletave për shfaqjet e teatrit të fëmijëve në vlerën 100 lekë për shfaqje është caktuar para 10 vitesh nga MTKRS sipas propozimit të Qendrës, por nuk është miratuar nga MF, gjë që bie në kundërshtim me pikën i/a.1 të udhëzimit të përbashkët të MTKRS dhe MF nr. 3, datë 25/10/2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të MTKRS”, pasi këto tarifa caktohen me vendim të KM. Përdorimi i të ardhurave dytësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

**9. Në Shërbimin Informativ Shtetëror,** gjatë vitit 2011, janë realizuar të ardhura dytësore në shumën *8,107 mijë lekë ose në nivelin 71% të realizimit të vitit 2010*. Këto të ardhura janë krijuar kryesisht nga ofrimi i shërbimeve ndaj të tretëve dhe nga të ardhurat e realizuara nga shtëpitë e pushimit që ka në administrim ky institucion.



Përdorimi i të ardhurave dytësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

10. Në MMPAU, gjatë vitit 2011, janë realizuar të ardhura dytësore në shumën *160,692 mijë lekë ose 126% e realizimit të vitit 2010*. Këto të ardhura janë krijuar kryesisht nga shitja e lëndës drusore, nga arkëtimi i tarifave të shërbimeve që kryhen, nga dhënia në përdorim e fondit pyjor etj. Pamvarësisht se të ardhurat janë rritur krahasuar me një vit më parë, nga auditimi i kryer u konstatua se në 6 Agjencitë e Baseneve Shkodër, Lezhë, Tiranë, Elbasan, Fier dhe Vlorë, 49 ndërmarrje e shoqëri anonime të ujësjellës kanalizimeve, nuk kanë llogaritur dhe paguar tarifën e përdorimit të ujit që kanë konsumuar, *duke shkaktuar një mungesë të ardhurash në shumën 28,560 mijë lekë*.

Përdorimi i të ardhurave dytësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

11. Në MTKRS, gjatë vitit 2011, janë realizuar të ardhura dytësore në shumën *76,187 mijë lekë ose në masën 98% të realizimit të vitit 2010*. Këto të ardhura janë krijuar nga shitja e biletave të institucioneve skenike, muzeve, galerive, dhënia e licencave, shitja e objekteve të riprodhuara, dhënia në përdorim e objekteve me kohë të kufizuar për ngjarje jubilarë, dhënia me qira e ambienteve të lira, si dhe nga marrëveshjet e qirasë të lidhura me personat e stimuluar në fushën e turizmit.

o Krahas sa më sipër, në këtë Raport, vlen të pasqyrohet *rasti i shkeljeve me dëm ekonomik të konstatuar nga KLSH, në fushën e të ardhurave*, konkretisht:

Në METE në fushën e koncesioneve në vlerën 606,927 mijë lekë, nga e cila; shuma 595,146 mijë lekë është shkaktuar si pasojë e mosaktësimit dhe mosllogaritjes të penaliteteve për 24 shoqëri koncesionare, si dhe mosndjekjes të procedurave ligjore për të kërkuar arkëtimin e kësaj shume, për shkeljen e kushteve të kontratave koncesionare të lidhura; dhe shuma 11,780 mijë lekë, si pasojë e mosllogaritjes dhe mosarkëtimit nga 13 shoqëri koncesionare të “Free koncesionare” për prodhimin e energjisë elektrike të shitur në masën 2-5%.

### III.3.c Të ardhurat nga dividendi

Për vitin 2011, të ardhurat nga dividendi nga 500 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në shumën 1,060 milionë lekë ose në masën 212%, *me një tejkalim në vlerë prej 560 milionë lekë*. Në krahasim me të ardhurat e realizuara një vit më parë, ato paraqiten me rritje, *rreth 44% më shumë dhe në vlerë 325 milionë lekë më tepër* (1,060 milionë lekë në vitin 2011 minus 735 milionë lekë realizuar në vitin 2010).

Në auditimin e ushtruar *në METE për dividendin*, u konstatua se,

- Në vartësi të MBUMK janë 6 shoqëri anonime të cilat administrojnë tregjet e fruta-perimeve me shumicë. Në këto shoqëri anonime, METE ka emëruar 36 anëtarë të këshillave mbikëqyrës ose nga 6 anëtarë për çdo shoqëri, duke i trajtuar si shoqëri strategjike dhe jo si shoqëri të vogla e të mesme me nga 3 anëtarë të këshillave mbikëqyrës, në kundërshtim me pikën 1, të VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar.

- Në sektorin e administrimit të shoqërive publike nuk kishte CV të anëtarëve të shoqërive publike, për rrjedhojë nuk mund të nxirret konkluzion se çfarë detyre funksionale kryejnë, çfarë kualifikimi profesional kanë kryer, si dhe të dhëna të tjera, me qëllim për të shmangur konfliktin e interesit që mund të kenë, veprim në

kundërshtim me udhëzimin e METE nr. 29, datë 13.01.2006 “Për emërimin dhe ndryshimin e përbërjes së këshillave mbikëqyrëse të shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar.

- Sektori i administrimit të shoqërive publike nuk disponon informacione të rregullta për veprimtarinë e këshillave mbikëqyrëse të shoqërive anonime, në kundërshtim me pikën 8, të VKM nr. 642, datë 11.10.2005, i ndryshuar.

- Në disa këshilla mbikëqyrëse janë emëruar si anëtarë, drejtorë të shoqërive tregtare dhe konkretisht, Drejtori i sh.a. “Trajtimi i studentëve nr. 2, në Këshillin Mbikëqyrës të sh.a. “Tregtimi i librit artistik dhe shkencor”; në 3 raste përfaqësues të MBUMK janë caktuar anëtarë në 3 këshilla mbikëqyrës, veprime këto që bien në kundërshtim me pikat 3 dhe 5 të VKM-së të sipërcituar etj.

#### IV. ADMINISTRIMI I SHPENZIMEVE BUXHETORE TË VITIT 2011

Për vitin 2011, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, janë realizuar në masën 96.3%, nga 390,859 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në vlerën 376,352 milionë lekë, duke reflektuar mosshpenzim të fondeve kundrejt nivelit të planifikuar në shumën 14,507 milionë lekë. Në krahasim me fondet e shpenzuara një vit më parë, ato paraqiten me rritje prej 3.75% dhe në vlerë 13,600 milionë lekë (376,352 milionë lekë-362,752 milionë lekë).


Kundrejt PBB-së të vitit 2011, ato përfaqësojnë 28.63% të tij, nga 29.28% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Në mënyrë të detajuar, realizimi i zërave kryesorë të shpenzimeve të buxhetit të shtetit për vitin analizues 2011, kundrejt kuotave të rishikuara dhe ndryshuara, paraqiten si më poshtë:

Nr.	EMËRTIMI	Plani me ndryshime	Fakti 2011	Diferenca a 3=2-1	Në milionë/lekë	
					Ne perqindje	Fakt në % ndaj PBB
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>390,859</b>	<b>376,352</b>	<b>- 14,507</b>	<b>96.3</b>	<b>28.63</b>
I.	Shpenzime korrente	314,814	305,673	- 9,141	97.1	23.25
1.	Personeli	68,572	67,446	- 1,126	98.4	5.13
1.a	Paga	59,085	58,398	- 687	98.8	4.44
1.b	Kontributi për sigurime shoqërore	9,258	9,048	- 210	97.7	0.69
1.c	Politikat e reja për pagat	229	-	- 229	0.0	-
2.	Interesat	46,838	41,121	- 5,717	87.8	3.13
2.a	Të brendshme	38,700	34,253	- 4,447	88.5	2.61
2.b	Të huaja	8,138	6,868	- 1,270	84.4	0.52
3.	Shpenzime operative mirëmbajtje	30,452	32,995	+ 2,543	108.4	2.51
4.	Subvencionet	3,292	3,301	+ 9	100.3	0.25
5.	Shpenzime për fondet speciale	116,901	113,946	- 2,955	97.5	8.67
5.a	Sigurime shoqërore	87,434	85,317	- 2,117	97.6	6.49
5.b	Sigurime shëndetësore	27,767	26,974	- 793	97.1	2.05
5.c	Kompensimi në vlerë të pronarëve	1,700	1,655	- 45	97.4	0.13
6.	Shpenzime per buxhetin vendor	29,314	28,119	- 1,195	95.9	2.14
7.	Shpenzime te tjera	19,445	18,745	- 700	96.4	1.43
7.a	Pagesa e papunësisë	940	876	- 64	93.2	0.07
7.b	Ndihma ekonomike	16,705	16,369	- 336	98.0	1.25
7.c	Kompesim për të përndjekurit politikë	1,800	1,500	- 300	83.3	0.11
II.	Fondi reserve i KM dhe kontigjenca	187	-	- 187	0.0	-

Nr.	EMËRTIMI	Plani me ndryshime	Fakti 2011	Diferenca 3=2-1	Ne përqindje	Fakt në % ndaj PBB
1.	Fondi rezervë i KM	164	-	- 164	0.0	-
2.	Fondi kontigjencës	23	-	- 23	0.0	-
III.	Shpenzime kapitale	75,858	70,679	- 5,179	93.2	5.38
1.	Financimi i brendshëm	43,382	41,097	- 2,285	94.7	3.13
2.	Financimi i huaj	30,876	27,982	- 2,894	90.6	2.13
3.	Shpronësime	1,600	1,600	0	100.0	0.12

Në mënyrë grafike, ecuria e shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, për periudhën 2007-2011, paraqitet si më poshtë:



Në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2011, KLSH ka audituar veprimtarinë ekonomiko financiare në 34 ministri, institucione të administratës publike dhe ente të ndryshme buxhetore përfshirë njësitë vartëse, 6 projekte me financim të huaj dhe 41 njësi të qeverisjes vendore, ku një vend të veçantë ze auditimi i administrimit dhe përdorimit të shpenzimeve.

Përgjithësisht, auditimet e kryera janë përqendruar në këto drejtime kryesore:

- o Në zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011 të ndarë në kapituj e artikuj, përfshirë ndryshimet dhe transferimet gjatë vitit buxhetor.
- o Në administrimin dhe mbrojtjen e pronës publike dhe shtetërore.
- o Në zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e pagave dhe të shpërblimeve, si dhe të derdhjes së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- o Në kryerjen e shpenzimeve operative të mirëmbajtjes.
- o Në dhënien e ndihmës ekonomike dhe pagesën e papunësisë.
- o Në zbatimin e procedurave të prokurimit publik për mallra, punë dhe shërbime.
- o Në realizimin e shpenzimeve për investimeve kapitale, me burim financimi të brendshëm dhe të huaj.
- o Në administrimin dhe monitorimin e granteve konkurruese për institucionet qendrore në nivel projekti etj.

Referuar rezultateve të veprimtarisë audituese të realizuar, raportojmë se, krahas përpjekjeve dhe arritjeve pozitive të konstatuara në administrimin e shpenzimeve, janë konstatuar dhe evidentuar parregullsi dhe shkelje ligjore të ndryshme, madje

dhe me dëm efektiv financiar në përdorimin e shpenzimeve buxhetore në vitin raportues buxhetor, në vlerën 174,199 mijë lekë, nga të cilat:

- a) Në ministritë, institucionet e administratës së lartë publike dhe entet e ndryshme buxhetore në shumën 23,327 mijë lekë.
- b) Në projektet me financim të huaj 56,026 mijë lekë.
- c) Në njësitë e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 70,097 mijë lekë
- d) Në njësitë e pushtetit vendor 24,749 mijë lekë.

Shkeljet e dispozitave ligjore me pasojë dëm ekonomik në fushën e shpenzimeve gjatë vitit 2001, sipas subjekteve ku janë konstatuar paraqitet:

a) Ministritë, institucionet e administratës së lartë publike dhe entet e ndryshme buxhetore në shumën 23,327 mijë lekë, si më poshtë:

1.	Drejtoria e Përgjithshme Shfrytëzimit Transportit Rrugor.....	7,294 mijë lekë
2.	MTKRS.....	3,309 mijë lekë
3.	MPÇSSHB.....	1,356 mijë lekë
4.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.....	1,079 mijë lekë
5.	Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër.....	652 mijë lekë
6.	Aparati i Kryeministritë.....	618 mijë lekë
7.	Univesiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.....	541 mijë lekë
8.	Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë.....	505 mijë lekë
9.	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizime.....	147 mijë lekë
10.	METE.....	120 mijë lekë
11.	DPT.....	1,991 mijë lekë
12.	DPD.....	5,715 mijë lekë

b) Në projektet me financim të huaj në shumën 56,026 mijë lekë, si më poshtë:

1. Projekti “Rehabilitimi i rrugës Shkodër-Hani i Hotit” .....30,106 mijë lekë
2. Projekti “Spitali Universitar Nënë Tereza Tiranë” .....9,666 mijë lekë
3. Projekti “Ndërtimi i Banesave Sociale” .....8,561 mijë lekë
4. Projekti “Ndërtimi i linjës 400 kv Tiranë-Podgoricë” .....7,693 mijë lekë

c) Në ISSH dhe në ISKSH dhe njësitë e tyre vartëse në shumën 70,097 mijë lekë, si më poshtë:

1. ISSH Tiranë ..... 8,924 mijë lekë
2. Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqërore Tiranë ..... 60,103 mijë lekë
3. ISKSH Tiranë ..... 1,070 mijë lekë

d) Në njësitë e pushtetit vendor në shumën 24,749 mijë lekë, si më poshtë:

1. Bashkinë Bajram Curri ..... 2,340 mijë lekë
2. Bashkinë Lezhë ..... 1,652 mijë lekë
3. Bashkinë Peshkopi ..... 1,517 mijë lekë
4. Bashkinë Rrëshen ..... 1,237 mijë lekë
5. Bashkinë Elbasan ..... 780 mijë lekë
6. Bashkinë Tepelenë ..... 786 mijë lekë
7. Bashkinë Rubik ..... 524 mijë lekë
8. Bashkinë Laç ..... 482 mijë lekë
9. Bashkinë Prrenjas ..... 426 mijë lekë
10. Bashkinë Shkodër ..... 388 mijë lekë
11. Bashkinë Peqin ..... 298 mijë lekë
12. Bashkinë Delvinë ..... 225 mijë lekë
13. Bashkinë Poliçan ..... 82 mijë lekë
14. Komunën Qukës, Librazhd ..... 8,803 mijë lekë

15. Komunën Golem, Kavajë .....	1,942 mijë lekë
16. Komunën Petrelë, Tiranë .....	562 mijë lekë
17. Komunën Bradashesh, Elbasan .....	482 mijë lekë
18. Komunën Lenie, Gramsh .....	460 mijë lekë
19. Komunën Milot, Qarku Lezhë .....	407 mijë lekë
20. Komunën Gjepalaj, Durrës .....	395 mijë lekë
21. Komunën Farkë, Tiranë .....	248 mijë lekë
22. Komunën Dajç, Shkodër .....	206 mijë lekë
23. Komunën Kryevindh, Kavajë .....	15 mijë lekë
24. Drejtorinë Rajonale ALUIZNI Tiranë .....	480 mijë lekë
25. Drejtorinë Rajonale ALUIZNI Vlorë .....	12 mijë lekë

#### IV.1 *Shpenzimet korrente.*

Për vitin 2011, këto shpenzime nga 314,814 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 305,673 milionë lekë ose *në masën 97.1%, me një mosshpenzim kundrejt planifikimit në vlerë prej 9,141 milionë lekë më pak.*

Në krahasim me fondet e shpenzuara një vit më parë, ato paraqiten me rritje prej 1.6% dhe në vlerë 4,795 milionë lekë (305,673 milionë lekë-300,878 milionë lekë).

Kundrejt PBB-së të vitit 2011, ato *përfaqësojnë 23.25% të tij*, nga 24.30% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Duhet pasqyruar fakti se, pesha në përqindje që zenë shpenzimet korrente të realizuara gjatë vitit 2011 kundrejt totalit të shpenzimeve të përgjithshme të realizuara gjatë këtij viti, përkatësisht në masën 81.2%, *ka pësuar rënie kundrejt të njëjtit raport të rezultuar në vitin 2010 respektivisht 82.9%, pra me një ulje prej 1.7 pikë përqindje.*

Nga analiza e strukturës së shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, rezulton se:

- *Shpenzimet për personelin (paga dhe kontributi për sigurime shoqërore) janë realizuar në masën 98.4%, me një mosrealizim ndaj kuotave të planifikuara prej 1,126 milionë lekë. Këto shpenzime zënë rreth 22.06% të totalit të shpenzimeve korrente, nga 21.85% që zinin një vit më parë, pra rezultojnë me rritje në përqindje dhe në vlerë absolute 1,684 milionë lekë më tepër (67,446 milionë lekë realizuar në vitin 2011 nga 65,762 milionë lekë në vitin 2010).*

- *Shpenzimet për shërbimin e borxhit (interesat) janë realizuar në masën 87.8%, me një mosrealizim ndaj kuotave të planifikuara prej 5,717 milionë lekë, dhe në krahasim me vlerën e realizuar në vitin 2010, ato paraqiten me ulje në shumën 483 milionë lekë ose në masën rreth 1.2% (nga 41,604 milionë lekë të realizuar në vitin 2010, në vitin 2011 janë realizuar 41,121 milionë lekë). Ky zë i shpenzimeve do të trajtohet në kapitujt në vijim).*

- *Shpenzimet operative mirëmbajtje, nga 30,452 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në shumën 32,995 milionë lekë ose në masën 108.4%, me një tejkalim në vlerë prej 2,543 milionë lekë. Ndonëse, këto shpenzime në vitin analizues rezultojnë me tejkalim, në krahasim me realizimin e një viti më parë, ato rezultojnë me ulje në vlerë për 1,323 milionë lekë ose në masën rreth 3.86% (nga 34,318 milionë lekë të realizuar në vitin 2010, në vitin 2011 janë realizuar 32,995 milionë lekë).*

- *Shpenzimet për subvencione*, nga 3,292 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar 3,301 milionë lekë ose në masën 100.3%, me një tejkalim në vlerë prej 9 milionë lekë.
- *Shpenzimet për fondet speciale (sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të pronarësve)*, nga 116,901 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar 113,946 milionë lekë ose në masën 97.5%, me një mosrealizim në vlerë prej 2,955 milionë lekë. Në krahasim me realizimin e një viti më parë, ato rezultojnë me rritje, përkatësisht në vlerë 7,739 milionë lekë ose në masën 7.3% më tepër (në vitin 2011 janë realizuar 113,946 milionë lekë, nga 106,207 milionë lekë të realizuar në vitin 2010).
- *Shpenzimet për buxhetin vendor*, nga 29,314 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në vlerën 28,114 milionë lekë ose në masën 95.9%, me një mosshpenzim në vlerë prej 1,195 milionë lekë. Në krahasim me realizimin e një viti më parë, ato rezultojnë me ulje në vlerë përkatësisht 2,650 milionë lekë, ndërsa në përqindje 8.6 pikë përqindje më pak (në vitin 2011 janë realizuar 28,114 milionë lekë, nga 30,764 milionë lekë të realizuar në vitin 2010).
- Pagesa e papunësisë dhe ndihma ekonomike janë realizuar respektivisht në masën 93.2% dhe 98%, me një mosrealizim në vlerë 64 milionë lekë dhe 336 milionë lekë. Po kështu me mosrealizim rezulton dhe kompensimi për të përndjekurit politikë përkatësisht në masën 83.3% dhe në vlerë 300 milionë lekë mosrealizim (nga 1,800 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 1,500 milionë lekë).

Në auditimin e ushtruar në Shërbimin Social Shtetëror, u konstatua se, për vitin 2011 janë inspektuar dhe ri-inspektuar 327 njësi të qeverisjes vendore. Nga këto inspektime janë konstatuar rreth 4,041 raste me një efekt financiar 12,498 mijë lekë, ku familjet në skemën e ndihmës ekonomike e përfitonin në mënyrë abuzive dhe jashtë kriterëve këtë pagesë, gjithashtu janë konstatuar dhe 441 raste pagesa të padrejta të personave me aftësi të kufizuara, me një efekt financiar prej 9,256 mijë lekë. Për të gjitha këto raste është lënë detyrë largimi i menjëhershëm i këtyre familjeve nga skema e ndihmës ekonomike, si dhe kthimi i shumave të përfituara padrejtësisht.

Problem serioz mbetet rritja e numrit të familjeve që trajtohen jashtë kriterëve të skemës së ndihmës ekonomike, nga ana e Këshillave të komunave apo bashkive si raste të veçanta, në kundërshtim me ligjin nr. 9355 datë 10/3/2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”. Kështu, për vitin 2011 nga 4,041 familje të evidentuara si raste abuzive në skemën e ndihmës ekonomike, 1,492 prej tyre janë trajtuar nga ana e Këshillave vendorë jashtë kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor. Nga këto raste rreth 830 familje në Qarkun e Elbasanit, 204 familje në Qarkun e Dibrës, 180 të Kukësit, 149 të Shkodrës, 79 të Gjirokastrës dhe 50 familje në Qarkun e Tiranës.

□ *Në fushën e shpenzimeve korrente (përfshirë ISSH, ISKSH dhe njësitë e pushtetit vendor pasi trajtohen në Kapitujt për buxhetet e pavarur)*, ka rezultuar se:

**IV.1.a Shpenzimet e personelit**, në fushën e pagave dhe shpërblimeve, vlera e shkeljeve me dëm ekonomik ka rezultuar 15,037.5 mijë lekë, nga e cila: në *DPSHTRR*, Tiranë në vlerën 6,908 milionë lekë, si pasojë e pagesave të dyfishta për të njëjtin vend pune për 15 punonjës të larguar padrejtësisht nga puna në vitin

2011, në kundërshtim me kërkesat e kodit të punës; në *Komisionin Qendror të Zgjedhjeve* 792 mijë lekë, si pasojë e përfitimit të shpërblimeve nga 24 punonjës, në kundërshtim me pikën 1, germa “b” të vendimit të KM nr. 591, datë 23/7/2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore” dhe pikën 1, germa “b” të vendimit të KM nr. 472, datë 2/7/2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore të vitit 20011”; në *DPT* 1,991 mijë lekë pagesa në kundërshtim me vendimin e KM nr. 605, datë 8/7/2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1093, datë 2/7/2008 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të sistemit tatimor” të ndryshuar; dhe në *DPD* 5,346.5 mijë lekë, si pasojë e pagesave të 143 punonjësve në kundërshtim me kërkesat e vendimeve të KM nr. 686, datë 2/1/2005 dhe nr. 997, datë 10/12/2010.


**IV.1.b *Shpenzimet operative***, shkeljet me pasojë dëm ekonomik vlerësohen në 10,283 mijë lekë, nga të cilat: në *MPCSSHB* në shumën 1,321 mijë lekë, përfaqësojnë shpenzime të përlllogaritura gabim për organizim aktivitetesh festive, për promovim të vlerave të traditës, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe shkelje të klauzolave në kontratat e lidhura; në *Aparatin e Kryeministrisë* në shumën 618 mijë lekë, shumë e përfituar padrejtësisht nga një ent furnitor nëpërmjet futurimit aforfe të produktit të furnizuar, ndërkohë që janë të instaluar aparatet matëse; në *QKKF Tiranë* në shumën 27 mijë lekë, dhënë padrejtësisht një subjekti privat në kundërshtim me udhëzimin nr. 3165, datë 12/5/2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifin e shërbimit të përkthimit të jashtëm dhe tarifin e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, si dhe përfituar padrejtësisht shpenzime telefonike celulare në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23/7/2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, privat”; në *Projektin “Ndërtimi i banesave sociale”* në vlerën rreth 624 mijë lekë, e cila përfaqëson tejkalim të shpenzimeve telefonike; dhe në *Projektin “Ndërtimi i linjës 400 kv Tiranë-Podgoricë”* në shumën 7,693 mijë lekë që përfaqëson dëmtim automjeti.

**IV.1.c *Shpenzimet për subvencione***, për vitin 2011, janë realizuar në masën 100.3% ndaj planit, nga 3,292 milionë lekë të planifikuara, janë shpenzuar 3,301 milionë lekë, me një mbishpenzim prej 9 milionë lekë.

Në krahasim me një vit më parë, ato paraqiten me ulje në shumën 234 milionë lekë ose në masën rreth 6.6% (nga 3,535 milionë lekë të realizuar në vitin 2010, në vitin 2011 janë realizuar 3,301 milionë lekë).

Kundrejt PBB-së të vitit 2011, shpenzimet për subvencione zenë 0.25% të saj, nga 0.28% që zinin në vitin 2010.

Më poshtë paraqesim tendencën e realizimeve të shpenzimeve të subvencionimit për periudhën 5/vjeçare 2007-2011.



## IV.2 Shpenzimet për fondin rezervë të KM dhe fondin e kontigjencës.

### IV.2.a Mbi përdorimin e fondit rezervë të KM

Për përdorimin e këtij fondi, auditimi u krye në drejtim të zbatimit të rregullimeve të mëposhtme ligjore në:

a) Ligjin nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, neni 3, pika 15, ku përcaktohet se: “Fondi rezervë i KM krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit” dhe Kreu II, neni 5: “Fondi rezervë i KM, përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet vetëm me vendim të KM. Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës, miratohen nga Kuvendi në ligjin buxhetor vjetor deri në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara”.

b) Ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, neni 13, ku fondi rezervë i KM është përcaktuar në vlerë **1,500,000 mijë lekë** dhe përdoret për raste të parashikuara të institucioneve buxhetore.

c) Ligjin nr. 10450, datë 14/7/2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”, neni 9 të tij, fondi rezervë i KM është përcaktuar në masën **1,928,000 mijë lekë**.

d) Udhëzimin nr. 4, datë 27/1/2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”, Kapitulli 3 “Procedurat e zbatimit të buxhetit”, ndarja 3.8 “Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave”, pika 65 ku përcaktohet se: “Sipas nenit 5 të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008, fondi rezervë përdoret: “Vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Në zbatim të këtij neni, kërkesa e ministrive të linjës për përdorimin e fondit rezervë kalon në këto faza:

- Ministrinë e linjës paraqesin në MF *një projekt*, me të cilin argumentojnë: nevojat për shtesë fondesh, pamundësinë për t’u përballuar nëpërmjet rialokimit të fondeve brenda sistemit, realizimin e buxhetit për periudhën raportuese, emergjencën e problemit dhe pamundësinë e parashikimit në procesin buxhetor.

- Ministria e Financave, pas analizës së këtij projekti, *jep vërejtjet dhe sugjerimet*, të cilat duhet të sqarohen dhe të plotësohen *detyrimisht* kur të përgatitet projekt-vendimi përfundimtar.



- Me mendimin e ministrive të interesuara, dhe atë të MF projekt-vendimi paraqitet për shqyrtim në KM.

Për vitin 2011, janë marrë 44 vendime të KM në vlerë 1,763,487 mijë lekë dhe janë ekzekutuar 44 vendime të KM në vlerë 1,763,527 mijë lekë, ose në masën 100%. Ndryshimi në vlerë prej 40 mijë lekë ka rezultuar në vendimin nr. 119, datë 17/2/2011 “Për dhënie ndihmë financiare fondacionit “refugees internacional”, në kujtim të veprës së diplomatit të shquar amerikan Ricard Ollbrok (në vlerë 20,000 USD)”, si efekt i llogaritjes së kundravleftës në lekë për ditët midis marrjes së vendimit dhe ekzekutimit të tij.

Të analizuara sipas institucioneve dhe ministrive përfituese, përdorimi i fondit rezervë të KM, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i institucioneve përfituese		Nr. i vendimeve		Vlera në mijë lekë		
			Aprovuar	Realizuar	Aprovuar	Realizuar	Në % ndaj totalit
1.	Ministria e Brendshme	16	10	10	925,717	925,717	52.5
2.	Ministria e Financave	10	10	10	395,896	395,896	22.4
3.	Këshilli i Ministrave	03	3	3	110,000	110,000	6.2
4.	Ministria e Shëndetësisë	13	11	11	21,050	21,050	1.2
5.	MTKRS	12	2	2	61,745	61,745	3.5
6.	DSHQ	87	3	3	10,799	10,745	0.6
7.	Ministria e Punëve të Jashtme	15	1	1	2,060	2,100	0.1
8.	KQZ	40	2	2	130,000	130,000	7.4
9.	ISTAT	50	1	1	78,100	78,100	4.4
10.	FZHSH	56	1	1	28,120	28,120	1.7
<b>TOTALI:</b>			<b>44</b>	<b>44</b>	<b>1,763,487</b>	<b>1,763,527</b>	<b>100</b>

Nga tabela e mësipërme, konstatohet se pjesën më të madhe të fondit e ka përdorur MB në shumën 925,717 mijë lekë ose në masën 52.5% të tij dhe MF në shumën 395,717 mijë lekë ose 22.4% të tij.

Përdorimi i këtij fondi është bërë për të gjithë zërat e buxhetit si për pagat, shpenzimet korrent dhe për investime, siç paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Zërat e shpenzimeve	Shuma në mijë/lekë	Në % ndaj totalit
<b>I</b>	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>206,216</b>	<b>11.7</b>
600	Shpenzime për pagat	205,966	11.7
601	Shpenzime për sigurime shoqërore	250	-
<b>II</b>	<b>Shpenzime të tjera korente</b>	<b>845,655</b>	<b>47.9</b>
602	Shpenzime operative dhe mirembajtje	607,296	34.4
603	Suensionet	4,799	0.3
604	Transferta të brendeshme	164,295	9.3
605	Transferta të jashtme	66,970	3.8
606	Transferta te individët	2,295	0.1
<b>III</b>	<b>Investime</b>	<b>711,656</b>	<b>40.4</b>
230	Projekttime	-	-
231	Shpenzime për investime	711,656	40.4
<b>SHUMA:</b>		<b>1,763,527</b>	<b>100</b>

Nga auditimi i praktikave të përdorimit të fondit rezervë të KM, rezultoi se:

1. Për vitin 2011, ka qenë më evident se vitet e tjera të audituara, *rishikimi nga MF i projektvendimeve për përdorimin e këtij fondi, rishikim që ka bërë të mundur saktësimin e llogaritjeve, brenda mundësive reale të përballueshme nga fondi rezervë i KM.*

MF ka dhënë mendim për rishikim të projektvendimeve për efektet financiare të hartimit të preventivave dhe përlllogaritjes së fondit të kërkuar, apo mungesë të bazë bazës ligjore, si më poshtë:

- Në 3 dosje vendimesh, të aprovuar për MB, në vlerë 684,295 mijë lekë, konkretisht: VKM nr. 66, datë 7/2/2011 “Për një shtesë fondi për blerje pajisjesh, mjete dhe materiale speciale në plotësimin e nevojave të policisë” (vlerë 660,000 mijë lekë); VKM nr. 489, datë 20/7/2011 “Për pjesëmarrjen e RSH me punonjës të Policisë së Shtetit në misionin e forcave të ndihmës për sigurinë ndërkombëtare në Afganistan” (vlerë 16,000 mijë lekë); dhe VKM nr. 581, datë 10/8/2011 “Për dhënie ndihmë financiare një kategori personash të strehuar në RSH” (vlerë 2,295 mijë lekë).

- Në 2 dosje vendimesh, të aprovuar për MSH, vlerë 3,000 mijë lekë (për mbulim shpenzimesh për kurim), konkretisht: VKM nr. 832, datë 30/11/2011 (vlerë 1,250 mijë lekë për S.Dobi); dhe VKM nr. 857, datë 14/12/2011 (vlerë 1,750 mijë lekë për M.Pepa).

- Në 2 dosje vendimesh në vlerë 60,529 mijë lekë, konkretisht: KM nr. 186, datë 9/3/2011 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, për vendimin e Gjykatës Evropiane për çështjen Puto kundër Shqipërisë” (vlerë 10,529 mijë lekë); dhe VKM nr. 629, datë 7/9/2011 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për DPT-në (vlerë 50,000 mijë lekë).

- Në 1 dosje vendimi, të aprovuar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, vlerë 28,120 mijë lekë, konkretisht: VKM nr. 658, datë 28/9/2011 “Për shtesë të VKM nr. 208, datë 24/3/2010, për dhënie ndihmë financiare Qeverisë së Kosovës për projekte të propozuara për komunën e Graçanicës”.

- Në 1 dosje vendimi, të aprovuar për INSTAT, vlerë 78,100 mijë lekë, konkretisht: VKM nr. 588, datë 18/8/2011 “Për shtesë fondi për organizimin dhe zbatimin e projektit të censusit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave, si dhe lejimin e shtyrjes së afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit”.

2. Në 6 raste në shumën 168,799 mijë lekë, fondi rezervë është përdorur si “shtesë buxheti” për institucione përfituese, fonde këto të cilat, *duhet të parashikoheshin në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore të planifikimit të buxhetit dhe të miratoheshin me ligjin vjetor të buxhetit*, ku përmendim:

- Në 1 dosje vendimi të MF në vlerë 50,000 mijë lekë, konkretisht: VKM nr. 629, datë 7/9/2011 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011” miratuar për DPT-në, përdorur për shpenzime korrente - vendime gjyqësore të pa ekzekutuara për punonjës të larguar nga puna, të cilët kanë fituar proceset gjyqësore”.

Me shkresën nr. 15722, datë 8/8/2011, DPT i është drejtuar MF (DPTH dhe DPB), ku ndër të tjera citon “... për shkak të shkurtimit të buxhetit me 36,575 mijë lekë shpenzime operative, jemi në vështirësi për pagesat e vendimeve gjyqësore të pa ekzekutuara për punonjës të larguar nga puna, vlerë e cila është 139,000 mijë lekë, shumë e cila përbën rreth 77% të shpenzimeve të 6/mujorit të parë të këtij viti”.

Ky vendim, megjithëse është inicuar nga MF, nuk përbën emergjencë apo pamundësi gjatë procesit të planifikimit buxhetor.

#### IV.2.b Përdorimi i fondit të kontigjencës.

Ky fond u auditua duke u mbështetur në:

1. Ligjin nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, neni 3, pika 16, ku përcaktohet se: “Fondi i kontigjencës është fond i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme për të ardhurat dhe shpenzimet gjatë zbatimit të buxhetit” dhe Kreu II, neni 5, ku përcaktohet se: “Fondi i kontigjencës përdoret sipas përcaktimit në ligjin e buxhetit vjetor, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese. Fondi rezervë i KM dhe fondi i kontigjencës, miratohen nga Kuvendi në *ligjin buxhetor vjetor* deri në në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara.

2. Ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, neni 10, ku përcaktohet se: “Fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit është planifikuar *3,647 milionë lekë* dhe fondi i kontigjencës për politika pagash e pensionesh është planifikuar *3,533 milionë lekë*, pra gjithsej ky fond është planifikuar *7,180 milionë lekë* dhe neni 13, ku përcaktohet se ky fond përdoret me Vendim të KM.

3. Ligjin nr. 10450, datë 14/7/2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, ku përcaktohet se: “Fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit është planifikuar *3,647 milionë lekë* dhe fondi i kontigjencës për politika pagash e pensionesh është planifikuar *2,734 milionë lekë*, pra gjithsej ky fond për këtë vit është planifikuar *6,381 milionë lekë*.

4. Në udhëzimin nr. 4, datë 27/1/2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”, Kapitulli “Të tjera”, pika 100, në të cilin përcaktohet se: “Bazuar në nenin nr.19/7.a.iii të ligjit nr.8652, datë 31/7/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe nenit 6, të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” .....*Fondi i kontigjencës krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve egzistuese.*

Mbështetur në bazën ligjore të mësipërme, fondi i kontigjencës, rezulton i përdorur me 18 vendime të KM, me vlerë 5,258,396 mijë lekë dhe me 13 shkresat e MF (Drejtoria e Menaxhimit dhe Monitorimit të Buxhetit), drejtuar institucioneve kërkuese të këtij fondi, për mbulimin e rritjes së pagave dhe të pagesës sociale, në vlerë 771,200 mijë lekë. Gjithsej ky fond është përdorur në vlerë ***6,029,597 mijë lekë ose 94.5% e shumës së planifikuar.***

				<i>Në mijë/lekë</i>
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Kontribute për shtim pagash dhe për rritjen e pensioneve</i>	<i>Për ruajtjen e deficitit</i>	<i>Shuma mijë lekë 3=2+1</i>
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
I.	Buxheti fillestar	3,533,000	3,647,000	7,180,000
II.	Buxheti i rishikuar	2,734,000	3,647,000	6,381,000
III.	Përdorimi	3,105,190	2,924,406	6,029,596
IV.	Diferenca (2-1)	+ 371,190	- 722,594	- 351,404

Në mënyrë të përmbledhur, përdorimi i fondit të kontigjencës sipas artikujve, është realizuar si më poshtë:

1. Artikulli 600 “rritje page” .....	603,955 mijë lekë;
2. Artikulli 601 “sigurime shoqërore” .....	167,245 mijë lekë;
3. Artikulli 603 “subvencione biznesit të vogël” .....	1,524,396 mijë lekë;
4. Artikulli 604 “transferta të brendshme” .....	3,734,000 mijë lekë;
4.a <i>Shpronësime</i> .....	1,400,000 mijë lekë;
4.b <i>Rritje pensionesh</i> .....	2,334,000 mijë lekë.
<b>TOTALI:</b> .....	<b><u>6,029,596 mijë lekë.</u></b>

Plani përfundimtar i kontigjencës i papërdorur rezulton 351.4 milionë lekë (6,381 milionë lekë-6,029.6 milionë lekë).

Për përdorimin e këtij fondi, *audituesit e KLSH kanë audituar dosjet e 18 vendimeve të KM, në vlerë 5,258,396 mijë lekë*, nga të cilat:

**a) Pesëmbëdhjetë VKM në vlerë 1,524,396 mijë lekë**, janë miratuar për kompesimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetra tek njësitë e qeverisjes vendore. Në zbatim të këtyre VKM-ve dhe të urdhrave nr. 4, datë 12/1/2011 dhe nr. 4/1, datë 15/4/2011 “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit të njësitë të qeverisjes vendore të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetra”; kurse DPB dhe Drejtoria e Marrëdhënieve Fiskale Ndërqeveritare, me 15 shkresa, u është drejtuar për ekzekutim vendimi degëve të thesarit në rrethe dhe DPTH.

**b) Dy (2) VKM në vlerë 2,434,000 mijë lekë**, janë marrë për rritjen e pensioneve, dhe pikërisht: VKM nr. 471, datë 2/7/2011 “Për rritjen e pensioneve”, në vlerë 1,634,000 mijë lekë dhe VKM nr. 909, datë 28/12/2011 “Për një shtesë fondi për MPÇSSHB, për ISSH-në, në vlerë 800,000 mijë lekë.

**c) Një (1) VKM në vlerë 1,300,000 mijë lekë**, pikërisht me nr. 911, datë 30/12/2011, është përdorur në vlerë 1,400,000 mijë lekë, transfertë për shpronësimet dhe i janë zbritur ISSH-së vlera prej 100,000 mijë lekë.

Gjithashtu, janë audituar shkresat e MF (DMMB) drejtuar 13 institucioneve kërkuese të këtij fondi, për mbulimin e rritjes së pagave dhe të pagesës sociale në zbatim të ligjeve dhe udhëzimit të sipërcituar, në vlerën *771,200 mijë lekë*. Kjo shumë alokuar këtyre institucioneve, ka kaluar në vlerën *603,955 mijë lekë*, ndarë për mbulimin e rritjes së pagës (llogaria ekonomike 600) dhe për mbulimin e rritjes së sigurimit shoqëror (llogaria ekonomike 601), në vlerë *167,245 mijë lekë*.

*Nga auditimi i shifrave të planifikuar për fondin rezervë të KM dhe fondin e kontigjencës, si dhe përdorimin e tyre, rezultoi se, ato janë planifikuar dhe realizuar brenda kërkesave të ligjit, **duke zënë rreth 2% të fondeve buxhetore të planifikuara dhe të realizuara.***

#### **IV.3 Shpenzimet kapitale për vitin 2011**

Për vitin 2011, shpenzimet kapitale të buxhetit u realizuan në *masën 93.2% të kuotave të parashikuara*, me një *mosshpenzim të fondeve buxhetore prej 5,179 milionë lek.* Në krahasim me realizimin e këtyre shpenzimeve në vitin 2010, ato rezultojnë *me rritje në masën 4.7% dhe në vlerë 3,187 milionë lekë më shumë.*

Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2011, *shpenzimet kapitale faktike zenë 5.38% të tij, nga 5.52% që rezultuan një vit më parë.*

Me poshtë paraqesim nivelin e planifikuar dhe atë faktik të shpenzimeve kapitale:


Në milionë/lekë

Nr.	EMERTIMI	Buxheti fillestar 2011	Buxheti i rishikuar 2011	Plani me ndryshime 2011	Fakti 2011	Diferenca fakt-plan	Në %	Në % PBB	Fakt 2010
I.	<b>Shpenzime kapitale</b>	<b>82,502</b>	<b>73,746</b>	<b>75,858</b>	<b>70,679</b>	<b>- 5,179</b>	<b>93.2</b>	<b>5.38</b>	<b>67,492</b>
1.	Financimi brendshëm	44,935	41,023	43,382	41,097	- 2,285	94.7	3.13	46,642
2.	Financimi huaj	37,567	32,523	30,876	27,982	- 2,894	90.6	2.13	20,850
3.	Shpronësime		200	1,600	1,600	0	100.0	0.12	

Në këto të dhëna të raportuara, konstatohet një shkurtim i dukshëm i shpenzimeve kapitale nga parashikimet e fillim vitit me rishikimet e buxheteve gjatë vitit (plani me ndryshimet).

Nga analiza e realizimit të investimeve në nivel institucional rezulton një nivel relativisht i lartë i realizimit të investimeve të brendshme. Ky tregues në total për vitin 2011 rezulton në nivelin 94.7% të kuotave të planifikuara, duke reflektuar mosshpenzim në shumën 2,285 milionë lekë të kuotave të planifikuara. Financimi i huaj rezulton i realizuar në masën 90.6%, me një mosrealizim ndaj kuotave të planifikuara në shumën 2,894 milionë lekë.

Në grafikun e mëposhtëm paraqesim ecurinë e investimeve kapitale në disa vite, përsa vijon:



Realizimi i investimeve të brendshme dhe të huaja, sipas ministrive dhe institucioneve qendrore, bazuar në pasqyrat e të dhënave të konfirmuara nga MF, paraqiten në aneksin nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur këtij raporti.

#### IV.3.a Shpenzimet për investime me financim të brendshëm.

Për vitin 2011, shpenzimet për investime me financim të brendshëm, nga 43,382 milionë lekë të planifikuar, janë realizuar në shumën 41,097 milionë lekë ose në masën 94.7%, me një mosrealizim të fondeve të planifikuara në shumën 2,285 milionë lekë.

Në krahasim me fondet e shpenzuara një vit më parë, ato paraqiten me ulje në masën rreth 12% dhe në vlerë 5,545 milionë lekë më pak (nga 46,642 milionë lekë shpenzuar në vitin 2010, në 41,097 milionë lekë në vitin 2011).

Kundrejt PBB-së të vitit 2011, ato përfaqësojnë 3.13% të tij nga 3.64% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Për vitin analizues, KLSH në nivel qendror ka audituar zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore në prokurimin e fondeve publike me burim të brendshëm financimi në 31 ministri, institucione dhe njësi të vartësisë së tyre.

*Nga auditimi, ka rezultuar se në përgjithësi institucionet e audituara kanë zbatuar kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë fushë, megjithatë duhen relatuar disa nga parregullsitë apo shkeljet e këtyre dispozitave, me qëllim mospërsëritjen e tyre në vitet e ardhshme.*

Subjektet e audituar nga KLSH kanë zhvilluar gjithsej 182 procedura prokurimi, me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 36,466,839 mijë lekë. Nga tenderët e zhvilluar, janë kontrolluar 104 procedura prokurimi me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 35,496,882 mijë lekë ose 57% e numrit dhe 97% e vlerës. Për tenderët e kontrolluar kanë tërhequr dokumentet 400 operatorë ekonomik, janë shpallur fitues 106 operatorë ekonomik dhe janë lidhur 106 kontrata në vlerë 24,808,145 mijë lekë. Si rezultat i konkurrencës së realizuar është ulur vlera e kontratave të lidhura në shumën 10,688,737 mijë lekë ose rreth 30%.

Nga tenderat e audituar, rreth 44% të tyre e zënë tenderët e hapur, rreth 21% tenderët me negociim pa shpallje paraprake të kontratës, 18% tenderët me procedurë kërkesë për propozim dhe 17% procedura të tjera prokurimi.

Nga të 104 tenderat e audituar, në 52 prej tyre janë konstatuar 91 shkelje të procedurave të prokurimit, me pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 2,910 mijë lekë** (përfshihet në vlerën totale të dëmit ekonomik të trajtuar).

Nga 91 shkeljet e konstatuara, 63 prej tyre ose në masën 69% janë kryer në fazën e përgatitjes së tenderëve, 14 shkelje ose 15% e tyre në fazën e zhvillimit të tenderit dhe 14 shkelje të tjera ose 16% e tyre janë konstatuar në fazën e lidhjes, zbatimit të kontratave dhe arkivimit të dokumentave.

Të analizuara këto mangësi dhe shkelje, sipas fazave të zhvillimit të procedurës së prokurimit ku ato janë konstatuar, rezulton:

1. Në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit, 63 rastet e shkeljeve të procedurave të prokurimit, kanë të bëjnë me:

- a) në 29 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në metodën e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike nga entet prokuruese;
- b) në 5 raste është shkelur procedura e prokurimit në respektimin e kufirit monetar dhe në mënyrën e informimit dhe të komunikimit me ofertuesit;
- c) në 29 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe në paraqitjen dhe pranimin e ofertave.

Cilësojmë se, rastet e mësipërme, janë konstatuar nga audituesit e KLSH-së dhe janë rrjedhojë e mungesës në dosjet përkatëse të audituara të dokumenteve që justifikojnë përllogaritjen e vlerës së kontratës dhe në bërjen e përllogaritjeve të vlerës së kontratës, të cilat nuk pasqyrojnë realitetin e tregut; në disa raste të tjera dokumentet e tenderit paraqiten me mangësi në përcaktimin e specifikimeve teknike, duke u bërë shkak që tenderët të shtyhen apo të anulohen, po kështu mangësi dhe në përcaktimin e procedurës. Këto veprime, bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Mangësitë e sipërcituara, janë konstatuar në: Autoritetin Rrugor Shqiptar në 9 raste, MASH 6 raste, Bankën e Shqipërisë 6 raste, Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër 6 raste, MMPAU 4 raste, MTKRS 4 raste, KQZ 4 raste, ISKSH Tiranë 4

raste, Aparatin e Kryeministrisë 3 raste, METE 3 raste, Ministrinë e Drejtësisë 2 raste, Qendrën Kombëtare të Regjistrimeve 2 raste, DPD 1 rast, DPSHTRR Tiranë 1 rast, DRA Shkodër në 1 rast etj.

**2. Në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit, 14 rastet e shkeljeve të procedurave të prokurimit, i përkasin:**

a) në 8 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në hapjen, vlerësimin dhe kualifikimin e ofertuesve;

b) në 3 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në s'kualifikimin e padrejtë të ofertave;

c) në 3 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në fazën e njoftimit të fituesit.

Këto shkelje të procedurave janë konstatuar përkatësisht në: MASH në 3 raste, në Bankën e Shqipërisë 3 raste, MMPAU 2 raste, ISKSH 2 raste, Administratën e Presidencës 2 raste, Aparatin e Kryeministrisë 1 rast dhe METE 1 rast.

**3. Në fazën e lidhjes, zbatimit të kontratave dhe arkivimit të dokumenteve të tenderit, 14 rastet e shkeljeve të procedurave të prokurimit, i përkasin:**

a) në 10 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në hartimin dhe lidhjen e kontratave;

b) në 3 raste në inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të prokurimeve;

c) në 1 rast janë shkelur procedurat e prokurimit në zbatimin e kontratave.

Këto shkelje janë konstatuar përkatësisht në: Bankën e Shqipërisë në 3 raste, ISSH 3 raste, QKR 2 raste, ISKSH 2 raste, METE 1 rast, MASH 1 rast, Ministrinë e Drejtësisë 1 rast dhe në DPD 1 rast.

Sipas subjekteve ku është konstatuar vlera e dëmit ekonomik të sipërcituar rezulton:

1. ISKSH .....	në shumën 965 mijë lekë
2. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër .....	541 mijë lekë
3. DPSHTRR Tiranë .....	386 mijë lekë
4. KQZ .....	287 mijë lekë
5. DPUK Tiranë .....	147 mijë lekë
6. METE .....	120 mijë lekë
7. MTKRS .....	61 mijë lekë
8. MPCSSHB .....	35 mijë lekë
9. DPD .....	368 mijë lekë
	<i>Gjithsej: 2,910 mijë lekë</i>

Për të gjitha rastet e dëmeve ekonomike të konstatuara, *KLSH ka përcaktuar personat shkaktarë dhe përgjegjësitë, si dhe ka rekomanduar masat përkatëse administrative e disiplinore, duke kërkuar dhe zhdëmtimin në masën 100% të dëmit ekonomik të shkaktuar.*

#### **IV.3.b Shpenzimet me burim të huaj financimi**

Për vitin 2011, shpenzimet me burim të huaj financimi, nga 30,876 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në shumën 27,982 milionë lekë ose në masën 90.6%, me një mosrealizim të fondeve të planifikuara në shumën 2,894 milionë lekë.

Në krahasim me fondet e shpenzuara një vit më parë, ato paraqiten me rritje në masën rreth 34.2% dhe në vlerë 7,132 milionë lekë më pak (nga 20,850 milionë lekë shpenzuar në vitin 2010, në 27,982 milionë lekë në vitin 2011).

Kundrejt PBB-së të vitit 2011, ato përfaqësojnë 2.13% të tij nga 1.68% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Për llogari të zbatimit të buxhetit të vitit 2011, KLSH ka ushtruar dhe evaduar auditimet në 6 Projekte me financime të huaja, me një vlerë totale të tyre të disbursuar në vitin analizues rreth 31.3 milionë Euro dhe 2.3 milionë USD. Krahas përpjekjeve dhe përmirësimit të punës të njërive të projekteve për zbatimin e tyre në përputhje me marrëveshjet e financimit janë konstatuar dhe evidentuar disa parregullsi dhe shkelje të legjislacionit, me pasojë **dëm ekonomik në 4 projekte në vlerën gjithsej 56,026 mijë lekë**, nga të cilat: *në fushën e prokurimit 38,553 mijë lekë, të tatim taksave 9,156 mijë lekë dhe shpenzime të ndryshme 8,317 mijë lekë në.* Për parregullsitë dhe mangësitë e evidentuara janë rekomanduar mbi 50 masa organizative dhe administrative, si dhe nuk kanë munguar masat disiplinore për personat përgjegjës si drejtues të niveleve të larta e punonjës të zbatimit të projekteve, deri edhe kallëzim penal për ndonjërin prej tyre.

Përbën interes për të gjithë paraqitja e problematikës dhe mangësive organizative e administrative të konstatuara, me synimin e vetëm, riparimin dhe mospërsëritjen e tyre në të ardhmen, përsa vijon:

1. Gjatë zbatimit të pothuajse të gjithë projekteve konstatohen ritme të ulëta të disbursimit, në krahasim me përcaktimet në marrëveshjet respektive. Ritmet e ulëta të disbursimit, jo vetëm që reflektojnë ecurinë e ngadaltë të projektit dhe shtyrjen e afatit të realizimit të objektivave të tij, por mund të kenë pasoja financiare negative për shkak të përqindjeve të interesit që paguhet për vlerën e hausë së padisbursuar.

2. Krahas vonesave në fillimin e zbatimit të projekteve për shkaqe kryesisht subjektive, konstatohet cilësi e dobët e shërbimeve të projektimit në fazën e negocimit, hartimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve, gjë e cila shoqërohet me ndryshime të mëdha të projekteve gjatë zbatimit, për pasojë me rritje të kostos jo vetëm për rihartimin e projektit, por dhe të strukturës së zërave të shpenzimeve të projektit, ndryshim të objektivave, si dhe shtyrje të afatit të përfundimit të projektit.

3. Në projektet që zbatohen në infrastrukturën rrugore, vazhdon të mbetet problematike çështja e shpronësimeve, duke sjellë jo vetëm rritje të kostos, por vonesa dhe pasoja në arritjen e objektivave dhe përfitimeve publike nga këto projekte.

4. Vazhdon të ketë abuzime lidhur me pagesën e tatimit në burim, kryesisht nga subjekte konsulentë dhe ose mbikëqyrëse, veçanërisht atyre të huaja, kjo dhe për shkak të paqartësive që ekzistojnë në marrëveshjet e miratuara të huasë. Përfshirja e subjekteve të përfshira në zbatimin e projekteve nga sistemi shqiptar i tatim-taksave duhet të saktësohet, shoqëruar dhe me një minimum dokumentacioni të nevojshëm që të paraqitet në agjencitë ekzekutive të projektit.

5. Gjatë zbatimit të kontratave, mangësitë dhe cilësia e dobët e shërbimit të supervizionit, pasi ka raste që nuk arrihen parametrat teknike të përcaktuar në marrëveshje në punime të reja apo rehabilituese, duke rënë në ujdin me kontraktorin, për pasojë jo vetëm cilësia e punimeve, por dhe ligjërimi i padrejtë i vonesave gjatë zbatimit të projektit, ka sjellë si pasojë rritjen e kostos së projektit dhe mosarritjen në kohë të objektivave dhe përfitimeve publike prej tij.

6. Përsëri konstatohen mangësi në funksionimin e njërive të zbatimit të projektit në drejtim të funksionimit të tyre, të cilat sjellin pasoja në administrim, menaxhim



dhe performancën e projekteve, duke mos respektuar strukturën e pagesave, zbatimin e penaliteteve për vonesa, hartimin e kontratave pa penalitete të kontraktorit, raportimin me mangësi në MF, menaxhimin financiar të projekteve dhe nivelit të realizimit të disbursimit financiar të fondeve etj. Mungojnë analizat periodike të ecurisë së projektit dhe evidentimi i përgjegjësisë në rastet e problematikave të konstatuara, si dhe raste të mosarkivimit të dokumentacionit të projekteve.

*Sipas Projekteve të audituar, në mënyrë të përmbledhur, paraqesim:*

**1. Projekti “Ndërtimi i rrugës Levan – Tepelenë”**

Nga auditimi i zbatimit të këtij projekti, ndër mangësitë e konstatuara nga KLSH rendisim:

- vonesat e shkaktuara në procesin e shpronësimeve nga ARRSH, për të cilat është penalizuar në vlerën 111,628 Euro;
- ndryshime të mëdha nga projektimi në fazën e realizimit të tyre, për pasojë është rritur vlera e investimit në shumën 6,8 milionë Euro;
- mangësi në performancën e Njesisë së Zbatimit të Projektit për të realizuar në afat projektin;
- mosaplikim të penaliteteve për vonesa në përfundimin e punimeve; mungesë e provave dhe testeve, për të garantuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të parashikuara në kontratë për lote të veçanta etj.

Për shmangien e këtyre mangësive, KLSH ka rekomanduar masat e nevojshme organizative që duhen marrë.

**2. Projekti “Spitali Universitar Nënë Tereza Tiranë”**

Nga auditimi ka rezultuar se Ministria e Shëndetësisë:

- nuk ka analizuar marrjen e vendimeve dhe efektivitetin e tyre, në lidhje me marrëveshjet financiare të kredive ose huave, duke marrë një vendim në kundërshtim me marrëveshjen e kredisë dhe shkaktuar një efekt negativ financiar, duke rënduar koston e projektit në shumën 24,000 USD;
- nuk ka analizuar efektivitetin e dërgimeve me shërbim jashtë vendit, për seminare apo vizita studimore të punonjësve, duke shkaktuar efekt negativ financiar dhe rënduar koston e projektit në shumën 7,390 Euro;
- nuk ka marrë masa për kalimin e pajisjeve mjekësore në vlerën 2 milionë USD, të financuara nga Banka Botërore, në kuadër të projektit “Rimëkëmbja e sistemit shëndetësor”, në spitalin e ri;
- nuk ka planifikuar saktë shpenzimet për kostot lokale, duke shkaktuar vonesa në përfundimin e projektit;
- nuk ka marrë masa për arkivimin e të gjitha dosjeve të projektit të përfunduar.

Gjithashtu, Drejtoria e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, nuk ka marrë masa për plotësimin me stafin e specializuar mjekësor, për të gjitha repartet e shërbimeve që janë të kompletuara me pajisjet e duhura mjekësore.

*Dëmi ekonomik në vlerën 94,492 Euro, shkaktuar nga mosderdhja e tatimit mbi të ardhurat e përfituara dhe nga rritja e pabazuar e pagesës mujore të shoqërisë konsulente, është kërkuar për shpërblim në masën 100%.*

**3. Projekti “Ndërtimi i Banesave Sociale”**

Nga auditimi, ka rezultuar se, Njësia e Koordinimit të Projektit në bashkëpunim me Njësitë e Zbatimit të Projektit dhe bashkitë përfituese:

- nuk kanë paraqitur në këshillat bashkiak përkatës, procedurën për miratimin dhe zbatimin e fazës së dytë të projektit, sigurimin e strehimit për personat në nevojë;

- nuk kanë marrë masa për marrjen në dorëzim të punimeve në objektet e përfunduara;

- nuk kanë përcaktuar formën e administrimit dhe mirëmbajtjes së Banesave Sociale dhe nuk kanë depozituar për ruajtje dokumentacionin e projektit.

Madje, Njësia e Zbatimit të Projektit në Bashkinë Durrës, nuk ka njoftuar Drejtorinë Rajonale Tatimore, për shmangien e pagesës së t.v.sh.-së, në vlerën 14,000 Euro nga një studio projektimi.

Në fushën e zbatimit të kontratave për punime dhe shërbime vlera e dëmit ekonomik të konstatuar llogaritet në shumën 20,250 Euro dhe 5,719.5 mijë lekë, shkaktuar nga: klasifikimi i gabuar i strukturës së kostos në punimet e ndërtimit, shpenzim i bërë në kundërshtim me Manualin e Zbatimit të Projektit; diferencat e punimeve të realizuara në krahasim me volumet e përshkruara në situacionin përfundimtar; pagesa e pajustificuar ndaj shoqërisë konsulente; mosllogaritja e penaliteteve për përfundim me vonesë të punimeve dhe tejkalimi i shpenzimeve telefonike.

Për këtë vlerë dëmi, krahas shpërblimit të tij dhe masave disiplinore për drejtuesit e Projektit, KLSH ka rekomanduar ndëshkimin për kundërvajtje administrative dhe dënimin me gjobë të 6 shoqërive të ndërtimit dhe mbikëqyrëse të punimeve.

#### 4. Projekti “Ndërtimi i linjës 400 kV Tiranë -Podgoricë”

Nga auditimi ka rezultuar se, Sh.a Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST):

- nuk ka marrë masa për rakordimin e shumës 185,000 Euro (dëm ekonomik) të likuiduar kontraktorit, si diferencë midis shumave të likuiduara nëpërmjet kërkesave për disbursim dhe vlerës reale të mallrave (kjo referuar deklaratave doganore); për rakordimin e shumës 2,474.2 Euro (dëm ekonomik) të likuiduar kontraktorit, vlera e elementëve që mungojnë në materialet e dorëzuara; për rakordimin me organet tatimore për sistemimin e vlerës 4,772,784 lekë diferenca midis t.v.sh.-së së paguar sipas deklaratës doganore dhe asaj që realisht duhej të paguante Sh.a. OST; si dhe për rakordimin e shumës 171,540.83 Euro (dëm ekonomik) të likuiduara kompanisë konsulente, shërbime konsulente shtesë të pa justifikuara;

- nuk ka marrë masa për rishikimin dhe rakordimin e pagesave të kryera dhe pretendimeve, me kontraktorin dhe kompaninë konsulente për pjesën e mbetur të kredisë;

- nuk ka marrë masa për plotësimin dhe arkivimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimit për kontratat e lidhura;

- nuk ka marrë masa që, në bashkëpunim me KfË për përfundimin dhe marrjen e një vendimi sa më të shpejtë të fituesit të kontratës së ndërtimit “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë” etj.

Për parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara, KLSH ka rekomanduar dy masa zhdëmtimi, përkatësisht: 20,513 Euro shkaktuar nga subjekte të tjera si pasojë e plasjeve me eksploziv dhe 34,320 Euro për aksidentimin e një automjeti, gjithsej 54,833 Euro; masa disiplinore; si dhe ka depozituar një material kallëzues në organet e prokurorisë lidhur me moszbatimin e Marrëveshjes Financiare dhe mosimplementimit në kohë të projektit, me pasojë penalizimin e Sh.a. OST nga KfË në vlerë 348,935 Euro; për likuidimin e kontraktorit me 185,000 Euro më shumë se sa vlera reale e mallrave; për raportim të rremë të t.v.sh.-së në organet tatimore që llogaritet 4,772,784 lekë; dhe për blerjen e dy automjeteve në shumën 71,520 Euro, duke e pasqyruar dhe likuiduar si punime civile dhe jo blerje malli.

**5. Projekti “Rehabilitimi i rrugës Shkodër-Hani i Hotit”**

Nga auditimi, ka rezultuar se PIU i Transporteve/Kooperacioni Italian:

- nuk ka bërë me shkrim ndryshimet në lidhje me projektin;
- nuk ka kryer në afat pagesat e t.v.sh. për kontraktorin;
- nuk ka bërë rakordimet periodike të fondeve buxhetore me MF;
- nuk ka marrë masa për të rillogaritur çmimet e reja sipas shkresës përkatëse;
- ka lejuar që librezat e masave të mos hartohet në përqindjen e totalit të ri të vlerës së kontratës, në mënyrë që të evidentohen saktë punimet e kryera;
- nuk ka marrë masat e duhura për koordinimin dhe harmonizimin e punës për realizimin në afat të projektit.
- nuk ka arkivuar të gjitha dosjet e procedurave të përfunduar të prokurimit.

Në përfundim, KLSH ka rekomanduar që, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë 214,582.7 Euro, përfituar padrejtësisht nga kontraktori, si pasojë e likuidimit me çmime më të larta se ato të miratuara, si dhe për punime të pakryera; gjithashtu i ka rekomanduar ARSH-së që të shpallë një kompani të huaj si të papranueshme për lidhje të mëtejshme të kontratave për shërbime mbikëqyrje, pasi ka certifikuar punime të porealizuara dhe me çmime të pa miratuara, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 214,582.7 Euro.

**6. Projekti “Furnizimi me ujë dhe sanitetet në qytetin e Korçës”**

Megjithëse, nga auditimi i këtij Projekti, audituesit e KLSH nuk kanë konstatuar dëme ekonomike, vërehet se Sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Korçë:

- nuk ka analizuar ecurinë e projektit për realizimin brenda afatit, si dhe nuk ka përcaktuar përgjegjësitë për vonesat;
- ka lidhur shtesë kontrate pa u siguruar më parë financimi përkatës;
- nuk ka inventarizuar dhe arkivuar dosjet e prokurimit, si dhe nuk ka aplikuar penalitete për realizimin me vonesë të kontratës me objekt “Kanalizimet dhe impianti i trajtimit të ujërave të përdorura në qytetin e Korçës”.

▪ **Mbi saktësinë e evidentimit dhe raportimit të huaj**

Nga auditimi i të dhënave të MF, mbi saktësinë në evidentimin dhe raportimin e financimeve të huaja gjatë vitit 2011, rezulton se:

a) Gjatë vitit 2011, ndërmjet Drejtorisë së Borxhit dhe Drejtorisë Operacionale janë mbajtur akt-rakordime çdo muaj me të dhënat përkatëse të projekteve me financim të huaj. Nga aktrakordimi i fundit për periudhën janar – dhjetor 2011, ndërmjet të dhënave të raportuara nga donatorët/kreditorët pranë Drejtorisë së Borxhit dhe të dhënave të raportuara nga Njësitë e Zbatimit të Projekteve pranë Drejtorisë Operacionale, kanë rezultuar diferencat e mëposhtme:

<i>PROJEKTI</i>	<i>Monedha</i>	<i>Drejtorja Operacionale</i>	<i>Drejtorja e Borxhit</i>	<i>Diferenca</i>
Spitali i përgjithshëm i Kavajës	USD	221,284.58	210,575.30	10,709.28
Rehabilitimi i Ujitjes III	Lek	-	164,858.81	164,858.81
Porti i ri i peshkimit	USD	39,264.77	38,173.65	1,091.12
Kanalizime Korçë	Euro	7,134,074.67	7,012,809.07	121,265.60
Menaxhimi i Burimeve Ujore	USD	-	17,113.72	17,113.72
Projekti i Transportit-IDA 4262 ALB-IDA	Euro	39,106.65	42,370.89	3,264.24

Për disa nga diferencat e mësipërme, i është kërkuar shpjegim Njësive të Zbatimit të Projekteve, *por megjithatë ato sërish në fund të vitit janë paraqitur me diferencat e konstatuara*. Kështu:

- Projekti “Spitali i përgjithshëm i Kavajës” i financuar nga IDB, paraqitet me këtë diferencë, pasi sipas IDB kjo shumë është disbursuar në 31/12/2010, ndërsa në të dhënat kontabël të njësisë zbatuese të projektit, kjo shumë paraqitet si hyrje fondesh më 3/1/2011.

- Projekti “Rehabilitimi i ujitjes III” dhe “Menaxhimi i burimeve ujore” paraqiten me diferencat e mësipërme, pasi nuk kanë raportuar në fund të vitit 2011.

- Projekti “Porti i ri i peshkimit” paraqitet me diferencën 1,091.12 USD, si pasojë e ndryshimeve në kursin e këmbimit midis monedhës raportuese të kreditorit dhe monedhës raportuese të debitorit.

- Projekti “Kanalizime Korçë”, paraqitet me një diferencë prej 121,265.60 Euro, sepse sipas kreditorit kjo shumë është disbursuar në vitin 2009, ndërsa në të dhënat kontabël të njësisë zbatuese të projektit rezulton si fonde të hyra në vitin 2011.

- Projekti i Transportit - IDA 4262 ALB-IDA rezulton me diferencën 3,264.24 Euro, si pasojë e ndryshimeve në kursin e këmbimit të monedhës raportuese të kreditorit (SDR) me monedhën raportuese të projektit (EUR).

Gjithashtu, diferenca janë konstatuar dhe në raportimin e disa projekteve me thesar të plotë, të cilat vijnë si pasojë e regjistrimit në kohë. Nga Drejtoria e Thesarit, disbursimet regjistrohen në momentin që institucioni zbatues i projektit kërkon transfertën nga llogaria speciale në Depozitën e Qeverisë, ndërsa Drejtoria e Borxhit e regjistron në momentin që lajmërohet nga kreditori për disbursimin.

**b) Ka pasur vonesa në afatin e raportimit, si gjatë muajve të vitit, ashtu edhe në raportimin vjetor të financimit të huaj të Ministrive dhe institucioneve të tjera,** në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8, datë 17/2/2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”, në të cilin përcaktohet që njësitë e zbatimit të projekteve apo drejtoritë e buxhetit/financës në Njësitë e Qeverisjes Qendrore janë të detyruara të dërgojnë raportet e tyre mujore dhe progresive në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të MF brenda datës 5 të muajit pasardhës; po kështu, në kundërshtim me Udhëzimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në MF nr. 24128, datë 27/12/2011 “Procesimi i transaksioneve të fundvitit”, në të cilin përcaktohet se Njësitë e Projekteve me Financime të Huaja dorëzojnë raportin përfundimtar të të ardhurave dhe shpenzimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit brenda datës 10/1/2012.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se disa Njësi të Zbatimit të Projekteve, *nuk kanë raportuar fare gjatë disa muajve vitit 2011*, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8 datë 17/2/2003

Sa më sipër, edhe pse ka projekte që nuk e kanë përmbushur detyrimin e tyre për të raportuar gjatë vitit 2011, si dhe ka vazhdimisht vonesa të raportimeve në çdo muaj dhe në raportimin përmbledhës për të gjithë vitin, *asnjë masë nuk është ndërmarrë në këtë drejtim.*

*Mbi këtë bazë, për çdo projekt me financim të huaj, pjesë e ligjit të buxhetit të vitit 2011, duhet të ketë raportim të veçantë në MF.* Në kundërshtim me “kuadrin rregullator Njësitë e Zbatimit të Projekteve të cilat janë të detyruara të raportojnë në MF, *nuk kanë paraqitur pjesën dërmuese të raportimeve*, pavarësisht se të dhënat për projektet që ato menaxhojnë janë përmbledhur në raportin e ministrive të linjës nga të cilat ato varen. Për t’u veçuar janë projektet që i përkasin kryesisht MPPT-së dhe Ministrisë së Brendshme.

## V. DEFICITI I PËRGJITHSHËM BUXHETOR DHE FINANCIMI I TIJ

Bazuar në Ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011” me ndryshime, është përcaktuar:

1. Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 46,812 milionë lekë, nga i cili 300 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit dhe 300 milionë lekë nga rezultati financiar i ISKSH-së.

2. Në rast të mosrealizimit të ardhurave të buxhetit dhe të ardhurave nga privatizimi, huamarrja totale për financimin e deficitit prej 46,212 milionë lekë nuk ndryshon.

Kuotat e planifikuara për vitin 2011 me ndryshimet, realizimi faktik dhe burimet e financimit të deficitit buxhetor, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

<i>Në milionë/lekë</i>						
<i>Nr.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Plani me ndryshime</i>	<i>Fakti</i>	<i>Diferenca fakt-plan</i>	<i>Realizimi në %</i>	<i>Në % ndaj PBB</i>
<b>I.</b>	<b>DEFICITI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>46,812</b>	<b>45,877</b>	<b>- 935</b>	<b>98.0</b>	<b>3.49</b>
I.	<b>Financimi i deficitit</b>	<b>46,812</b>	<b>45,877</b>	<b>- 935</b>	<b>98.0</b>	<b>3.49</b>
I.1	<i>I Brendshëm</i>	<i>30,063</i>	<i>26,119</i>	<i>- 3,944</i>	<i>86.9</i>	<i>1.99</i>
1.	Të ardhura nga privatizimi	300	438	+ 138	146.0	0.03
2.	Huamarrje e brendshme	29,463	28,175	- 1,288	95.6	2.14
3.	Të tjera		- 2,494	- 2,494	-	0.19
-	Ndryshimi i gjendjes së ISKSH	300	0.0	- 300	0.00	0.00
I.2	<i>I Huaj</i>	<i>16,750</i>	<i>19,758</i>	<i>3,008</i>	<i>118.0</i>	<i>1.50</i>
A.	Hua afatgjatë gjithsej: Nga e cila:	26,601	27,371	+ 770	102.9	2.08
1.	Hua afatgjate (e marrë)	24,101	22,686	- 1415	94.1	1.72
2.	Mbështetje buxhetore	2,500	2,543	+ 43	0.0	0.19
3.	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-	2,142	+ 2,142	-	0.17
B.	Ripagesat	-9,851	-7,613	+ 2,238	77.3	- 0.58


Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme, rezulton se, *deficiti i përgjithshëm i buxhetit të shtetit per vitin 2011*, është realizuar në masën 98%, ose në vlerën 45,877 milionë lekë, nga 46,812 milionë lekë të kuotave të planifikuara, me një ulje në shumën prej 935 milionë lekë.

Ky tregues per vitin 2011, kundrejt PBB-së të këtij viti *arriti në 3.49%* nga 3.07% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Financimi i deficitit u financua në shumën 26,119 milionë lekë nga burime të brendshme dhe në shumën 19,758 milionë lekë nga burime të huaja.

Kundrejt kuotave të planifikuara huamarrja e brendshme për financim deficiti rezulton me një realizim në masën 95.6% ose 2.14% të PBB-së të rezultuar në vitin 2011; ndërsa financimi i huaj, rezulton më shumë se plani në masën 118% dhe kundrejt PBB-së ky tregues arriti në 1.5%.

Në mënyrë grafike, ecuria e deficitit buxhetor për periudhën 2007-2012 paraqitet:



### V.1 Mbi saktësinë dhe mbajtjen e llogarisë “Depozitë e Qeverisë”.

#### 1. Mbi mbajtjen dhe saktësinë e llogarisë “Depozitë e Qeverisë” pranë Bankës së Shqipërisë.

Për këtë çështje, auditimi nga audituesit e KLSH u krye duke u mbështetur në:

a) Udhëzimin nr. 4, datë 21/1/2011 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2011”, kapitulli 4.6 “Mbyllja e buxhetit të vitit 2011”, kapitulli 5.1 dhe 5.2

b) Aktmarrëveshjen e lidhur midis BSH dhe MF, neni 2: “Mbajtja dhe regjistrimi i veprimeve të llogarisë “Depozitë e Qeverisë”, konkretisht: në pikën 2.9 të aktmarrëveshjes të lidhur midis MF (Drejtorisë së Thesarit) dhe BSH-së, ku thuhet se: Ministria e Financës (çdo muaj dhe në fund të vitit) *brenda datës 27 të muajit pasardhës*, i kërkon BSH-së, konfirmimin për llogarinë “Depozitë e Qeverisë” në lekë, duke e shoqëruar shkresën me tabelat përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve të kësaj llogarie. Në pikën 2.10 të aktmarrëveshjes thuhet se, Banka e Shqipërisë, *brenda 3 ditëve pune* nga data e marrjes së këtyre të dhënave, bën konfirmimin e tyre me shkrim, në të kundërt, ato konsiderohen të mirëqena.

Nga verifikimi i korespondencës mujore midis MF dhe BSH-së dhe në fund të vitit 2011, rezultoi se, për të gjithë muajt e vitit 2011 dhe në fund të këtij viti, kishte aktrakordime midis sektorit të transaksioneve operacionale, sektorit të borxhit të brendshëm, sektorit të borxhit të jashtëm dhe shkresa për të konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie, të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit - Drejtoria Operacionale, që i drejtohej BSH-së, Departamentit të Operacioneve Monetare, në bazë të aktmarrëveshjes së nënshkruar për dy institucionet, si më poshtë:

ëë- Theksojmë se për të gjithë muajt deri në fund të vitit, shkresat e MF me gjendjen e kësaj llogarie dhe kërkesën për konfirmim dërguar BSH-së, si dhe përgjigja për konfirmim e BSH-së, janë bërë me vonesë nga 10 ditë deri në 1 muaj e gjysëm

Për vitin 2011, kanë rezultuar *diferenca midis zërave të ndryshëm të shpenzimeve apo të ardhurave*, si:

a) Diferenca për gjendjen në fund të vitit, në vlerë 241,553.94 mijë lekë, ardhur si rezultat i diferencës në zërin “Diferenca për veprimet Spot-Forëard” në shumën 241,562.30 mijë lekë, e cila rezulton vetëm në evidencën e MF. Ky zë shpreh shpenzimet e bëra nga veprimet Spot-Forëard (shitblerje Euro me BSH-së), pra shpreh shpenzimin në lekë të veprimit të shitblerjes në BSH-së të të njëjtës shumë në valutë. Pra kjo diferencë, apo ky zë sjell dhe diferencën ndërmjet gjendjes së llogarisë “Depozitë e Qeverisë në Euro” të konvertuar në lekë të regjistruar në MF

dhe asaj të regjistruar sipas BSH-së. *Ky veprim apo diferencë justifikohet nga BSH-së, si rezultat i mbajtjes së një evidence dhe jo kontabilizimi të llogarisë “Depozitë e Qeverisë”.* Gjithsesi, ky zë rregullohet në fund të vitit, pas sistemimit për kurse këmbimi nga të dyja institucionet, pra në datën 3/1/2012, gjendja fillestare e llogarisë “Depozitë e Qeverisë”, në total dhe për secilën monedhë e konvertuar në lekë, është e njëjtë për të dyja institucionet.

**b) “Diferencë konvertimi valutë-valutë”, në vlerë prej - 20.19 mijë lekë.**

Kjo diferencë dhe ky zë rezulton vetëm në evidencën e BSH-së, diferencë që nuk duhet të ekzistonte, pasi nuk ka kuptim që ky zë të ketë vlerë. Diferenca të vogla për këtë zë ka pasur në 57 konvertimet e kryera në vitin 2011, por në dy prej tyre diferenca ishte më e madhe, dhe pikërisht konvertimi i datës 14/2/2011, në vlerë 1,28 mijë lekë dhe konvertimi i datës 30/11/2011, në vlerë 11,87 mijë lekë. *Normalisht e njëjta shumë e konvertuar në lekë, e cila i zbritet “Depozitës në Euro”, i duhet shtuar “Depozitës në USD” dhe anasjelltas.* Pra, është gabim që rrjedh nga konvertimet ditore Euro-USD-Euro për shpenzimet e borxhit të jashtëm. Ky zë është i shpërndarë mes “shpenzimeve të borxhit të jashtëm” në vlerë 11.85 mijë lekë dhe “Depozitës së Qeverisë në Dollarë” në vlerë 8.36 mijë lekë.

**c) Diferenca të rezultuara midis zërave të ndryshëm të evidentuara në të dy institucionet, diferenca që rezultojnë nga mënyra e ndryshme e mbajtjes dhe kontabilizimit të kësaj llogarie midis dy institucioneve, si më poshtë:**

- “Sistemime për diferencat e Bankave të nivelit të dytë”, në vlerë 24.25 mijë lekë, rezultuar më shumë për MF Kjo shumë është derdhur në sistemin “Mofaal”, si shumë më e vogël se vlera prej 1,500,000 lekë, veprim që e bën të pamundur për BSH-së ta evidentojë si zë më vete, por ia ka shtuar zërit “Debitorë për financimin e Buxhetit”.

- “Garanci të tjera të vitit në vazhdim” në vlerë 16,932.84 mijë lekë, diferencë e rezultuar sepse BSH-së e ka regjistruar këtë shumë te zëri “Të ardhura të tjera”, pasi në evidencën e saj nuk eksiton zë më vete “Garanci të tjera të vitit në vazhdim”.

- “Interesa nga projektet” në vlerë 9,066.89 mijë lekë, diferencë e ardhur me BSH-së, sepse ajo i kalon këto shuma te zëri “Të ardhura të tjera”, për arsye se evidencia e BSH-së nuk ka zë me vete “Interesa nga Projektet”.

- “Kontributi për përmbytjet”, ka diferencë në shumën prej 2,529.02 mijë lekë më shumë për MF. Kjo shumë është derdhur në sistemin “Mofaal”, si shumë më e vogël se 1,500,000 lekë, veprim që e bën të pamundur për BSH-së ta evidentojë si zë me vete, por ia ka shtuar zërit “Debitorë për financimin e Buxhetit”.

- “Diferencë Cash-Accrual” në vlerë 771,051.62 mijë lekë, janë të ardhura të konstatuara në datën 31/12/2010 dhe janë derdhur në llogarinë “Depozitë e Qeverisë në datat 3 dhe 4 janar 2011.

Për MF kjo shumë është e përfshirë në zërin “Debitorë për financimin e buxhetit”.

Në fund të vitit në dhjetë zëra të ardhurash të kësaj llogarie, të regjistruara nga të dy institucionet, diferencat e rezultuara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë/lekë

Zërat që ndryshojnë me institucionet regjistruese	Regjistruar më shumë në BSH	Regjistruar më shumë në MF
<b>I. Shuma e diferencave tek të ardhurat</b>	<b>835,081.02</b>	<b>593,538.91</b>
Difer. të ardhura e shpenzime te bankat e nivelit II	-	24.25
Garanci të tjera të vitit në vazhdim	-	16,932.84



Interesa nga projektet	-	9,066.89
Kontributi për përmbytjet në Shkodër		2,529.02
Interesa spoti Forëard	-	- 241,562.30
Debitore për financimin e Deficitit Buxhetor	-	806,548.21
Të tjera	64,049.59	-
Diference cash dhe accrual	771,051.62	-
Diferenrsa konvertimi valutë valutë	- 20.19	-
<b>II. Shuma e diferencave tek shpenzimet</b>	-	<b>11.88</b>
Shpenzimet borxhi i jashtëm		11.88
<b>III. Gjendja sipas diferencave (I - II)</b>	<b>835,081.02</b>	<b>593,527.03</b>
<b>Diferenca e Gjendjes së llogarisë sipas tabelës</b>	<b>241,553.94</b>	

*Të ardhurat, shpenzimet dhe gjendja e llogarisë “Depozitë e Qeverisë” më 31/12/2011, sipas të dhënave të Drejtorisë së Thesarit të MF dhe asaj të BSH-së, paraqiten në tabelën e mëposhtme:*

*Në mijë/lekë*

<i>Nr.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Gjendja sipas BSH</i>	<i>Gjendja sipas Drejtorisë së Thesarit</i>	<i>Diferenca (MF-BSH)</i>
<b>I.</b>	<b>TË ARDHURAT</b>	<b>116,694,241.49</b>	<b>116.452,699.38</b>	<b>241,542.11</b>
1.	<i>Fitimi i Bankës së Shqipërisë (7101)</i>	<i>5,710,175.68</i>	<i>5,710,175.68</i>	-
-	<i>Fitimi i Bankës Shqipërisë viti 2011</i>	<i>2,700,000.00</i>	<i>2,700,000.00</i>	-
-	<i>Fitimi i Bankës së Shqipëri viti 2010</i>	<i>3,010,175.68</i>	<i>3,010,175.68</i>	-
2.	<i>Transferim Financim i Huaj (1060)</i>	<i>921,222.53</i>	<i>921,222.53</i>	.-
3.	<i>Nën/Huaja:</i>	<i>1,861,197.17</i>	<i>1,861,197.17</i>	-
-	<i>Principiali (2500)</i>	<i>827,206.60</i>	<i>1,426,986.42</i>	
-	<i>Interesa (7600)</i>	<i>1,359,176.03</i>	<i>434,210.75</i>	
-	<i>Diferenca cash accrual</i>	<i>15,785.09</i>	-	
-	<i>Të ardh nga konc. dhe garanci te reja</i>	<i>- 340,973.55</i>	-	
4.	<i>Arkëtime nga Borxhi i Brenshëm</i>	<i>28,105,520.77</i>	<i>28,105,520.77</i>	-
-	<i>Bono thesari neto</i>	<i>12,095,943.33</i>	<i>12,095,943.33</i>	-
-	<i>Bono thesari neto në Euro (konvertuar në lekë)</i>	<i>-2,149,725.08</i>	<i>-2,149,725.08</i>	-
-	<i>Obligacione me afat 2-vjeçar</i>	<i>4,183,770.00</i>	<i>4,183,770.00</i>	-
-	<i>Obligacione me afat 3-vjeçar</i>	<i>3,773,600.00</i>	<i>3,773,600.00</i>	-
-	<i>Obligacione me afat 5-vjeçar</i>	<i>10,201,932.52</i>	<i>10,201,932.52</i>	-
5.	<i>Huamarje nga inst. ndërkombëtare</i>	<i>2,536,872.92</i>	<i>2,536,872.92</i>	
6.	<i>Interesa depozitë me afat</i>	<i>25,448.48</i>	<i>25,448.48</i>	-
7.	<i>Të ardhura nga shitja e licencës</i>	<i>2,121,999.49</i>	<i>2,121,999.49</i>	-
8.	<i>Dif.të ardh. dhe shp. të bank.. niv. II</i>	-	<i>24.25</i>	<i>24.25</i>
9.	<i>Garanci te tjera të vitit në vazhdim</i>	<i>16,143.25</i>	<i>33,076.09</i>	<i>16,932.84</i>
10.	<i>Interesa nga projektet</i>	-	<i>9,066.89</i>	<i>9,066.89</i>
11.	<i>Kontrib. për përmbytje në Shkodër</i>	<i>153,635.44</i>	<i>156,164.46</i>	<i>2,529.02</i>
12.	<i>Kontrib. për përmbytjen nga KESH</i>	<i>125,029.88</i>	<i>125,029.88</i>	-
13.	<i>Të ardhura nga koncesionet</i>	<i>324,830.30</i>	<i>324,830.30</i>	
14.	<i>Interesa spoti Forëard</i>	-	<i>- 241,562.30</i>	<i>-241,562.3</i>
15.	<i>Diferencë kursi depozite me afat</i>	<i>4,500.00</i>	<i>4,500.00</i>	-
16.	<i>Debitore për financ. Defic. Buxhetor</i>	<i>73,527,520.11</i>	<i>74,334,068.32</i>	<i>806,548.21</i>
-	<i>Debitore për financimin e buxhetit</i>	<i>73,110,225.56</i>	<i>73,893,954.27</i>	<i>783,728,71</i>
-	<i>Kthim pagesash nga sistemi</i>	<i>417,294.55</i>	<i>440,114.05</i>	<i>22,819.50</i>
17.	<i>Të tjera</i>	<i>66,665.36</i>	<i>2,615.77</i>	<i>-64,049.59</i>
18.	<i>Gjendja e llogar. e trash. nga 2010</i>	<i>922,448.68</i>	<i>922,448.68</i>	-



Nr.	EMËRTIMI	Gjendja sipas BSH	Gjendja sipas Drejtorisë së Thesarit	Diferenca (MF-BSH)
19.	Depozitë garanci për Oracle	- 500,000.00	-500 000.00	-
20.	Diferencë cash e accrual	771,051.62		-771,051.62
21.	Diferencë konvertimi valutë-valute	- 20.19		20.19
<b>II.</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>114,165,483.00</b>	<b>114,165,494.88</b>	<b>11.88</b>
1.	Borxhi i Jashtëm	14,461,835.85	14,461,847.73	11.88
-	Principiali instit. financiare (1761)	7,697,926.45	7,614,586.39	-83,340.06
-	Interesa (6611)	6,763,909.40	6,633,043.70	-130,865.70
-	Komisione (6028)	-	214,217.64	214,217.64
2.	Inter. të borxh. të brend. (6500, 6520)	34,252,823.24	34,252,823.24	-
3.	Transf. për ISSH dhe ISKSH (6042)	51,063,600.00	51,063,600.00	-
4.	Transferte nga viti 2010	144,686.79	144,686.79	-
5.	Transferta për shpronësimet	200,000.00	200,000.00	-
6.	Transferta për kompesimin e pronave	1,997,458.04	1,997,458.04	-
7.	Rruga Durrës-Kukës	9,602,838.56	9,602,838.56	-
8.	Transferte të përdjek politikë (6040)	1,310,640.52	1,310,640.52	-
9.	Leter kredi helikopterët MM	1,131,600.00	1,131,600.00	-
<b>III.</b>	<b>Gjendja e llogarisë (5311)</b>	<b>2,528,758.43</b>	<b>2,287,204.49</b>	<b>241,553.94</b>
-	Në Lekë	2,041,854.37	2,041,854.37	-
-	Në Euro	463,619.14	222,056.84	241,562.30
-	Në Dollarë	23,284.92	23,293.28	8.36

Kontrolli mbi transaksionet e Buxhetit të Shtetit në llogarinë “Depozitë e Qeverisë”, u krye në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” dhe të udhëzimit të MF nr. 4, datë 27/1/2012 “Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011”, kapitulli 4.5 “Mbyllja e buxhetit të vitit 2011”, pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Nga kontrolli i mbylljes së kësaj llogarie (dokumentet e dhjetorit 2011) rezultoi se, data e fundit e transaksioneve ishte data 31/12/2011.

#### **V.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për arkëtimet dhe pagesat e kryera nëpërmjet llogarisë “Depozitë e Qeverisë” dhe mbajtjen e kontabilitetit sintetik dhe analitik.**

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit dhe dosjeve që prekin këtë llogari, u konstatua si më poshtë:

o Në MF, është bërë kontabilizimi i veprimeve çdo muaj, për të gjitha llojet e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë analitike. Llogaria “Depozitë e Qeverisë” është mbajtur në evidencë kronologjike dhe për lëvizjet e kësaj llogarie në Euro dhe Dollarë.

- Në fund të çdo muaji, për sistemimet dhe mosrakordimet që rezultojnë nga rakordimi i MF me BSH-së, nuk kishte një artikull kontabël, i cili të tregonte gjendjen e llogarive që debitohen apo kreditohen dhe me përshkrim për llojin e sistemit të kryer.

- Për çdo veprim në llogarinë “Depozitë e Qeverisë”, bashkangjitur është vendosur konferma bankare e shoqëruar me dokumentacionin justifikues përkatës. Nga BSH-

së për çdo transaksion të llogarisë “Depozitë e Qeverisë”, është vulosur dokumenti bazë konferma bankare.

Nga audituesit e KLSH, *u audituan me përparësi pagesa të tilla si:* Transferta për ISSH-në, shpenzime për rrugën Durrës–Kukës të firmës “Bechtel”, transferta për kompensimin e pronave, transferta për të përndjekurit politikë dhe Letër- kredi për blerjen e helikopterëve të Ministrisë së Mbrojtjes, nga të cilat rezultoi:

**a)** Për *“Transfertën për ISSH”, në vlerën 51,063,600 mijë lekë*, auditimi u krye në mbështetje të kapitullit 5, të udhëzimit nr. 4, datë 27/1/2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”, në të cilin përcaktohet: “...Në Bankën e Shqipërisë funksionon një llogari speciale për menaxhimin e transaksioneve të pagesave të buxhetit të ISSH. Ministri i Financave cakton personat e autorizuar për të vepruar me këtë llogari. Transfertat e likuiditeteve në këtë llogari do të kryhen nga Llogaria e Unifikuar e Thesarit në BSH-së periodikisht, *mbështetur në kërkesën e ISSH për furnizim të llogarisë me likuiditete dhe deri në kufirin e likuiditeteve disponibël për ISSH, të derdhura si kontribut i sigurimit shoqëror.* Detajimi i transfertës së buxhetit të shtetit për ISSH dhe ISKSH, bëhet nga vetë institucioni dhe depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.”

Në datën 10/1/2012 janë dorëzuar raportet e shpenzimeve dhe të ardhurave nga ISSH, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Nga verifikimi i dosjes së raportimit rezultoi se ky informacion ka mbërritur në Drejtorinë e Thesarit të MF më 12/1/2012, *pra 2 ditë me vonesë* dhe vlerat e kaluara nga llogaria “Depozitë e Qeverisë” për këtë zë rakordojnë me zërin në evidencën e kësaj llogarie që rezulton nga mbajtja në dy institucionet (BSH & MF).

Pagesat e kaluara në llogarinë “Depozitë e Qeverisë”, mbështetur në kërkesat e ISKSH, rezultuan të shoqëruara me shkresat e MF (Drejtorisë Operacionale) për transferim fondi nga “Depozita e Qeverisë” në llogaritë Speciale.

*Shumat e kaluara me këto shkresa ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të “Depozitës së Qeverisë” nga të dy institucionet.*

**b)** Për *“Shpenzimet për rrugën Durrës–Kukës”, firma “Bechtel” në vlerën 9,602,838.56 mijë lekë*, u audituan të 5 rastet e likuidimit të këtij zëri shpenzimesh (i cili është hapur në llogarinë “Depozitë e Qeverisë në Euro” që në vitin 2006). Nga verifikimi rezultoi se shuma e likuidimit për të 5 rastet e pagesave, në vlerë 69,053,566.87 Euro, ose 9,602,838.56 mijë lekë ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të “Depozitës së Qeverisë” nga të dy institucionet.

**c)** Për *“Transfertën për kompesimin e pronave”, në vlerën 1,997,458.04 mijë lekë*, ka kaluar nëpërmjet llogarisë “Depozitë e Qeverisë. Likuidimi i kësaj shume është bërë në zbatim të nenit 32, të ligjit nr. 9482, datë 3/04/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, në mbështetje të nenit 14, të ligjit nr. 10186, datë 5/11/2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin” dhe në zbatim të ligjit nr. 10239, datë 25/2/2010 “Për krijimin e Fondit special të kompensimit të pronave”.

*Shumat e kaluara me këto shkresa ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të “Depozitës së Qeverisë” nga të dy institucionet.*

**d)** Për *“Transfertën për të përndjekurit politikë”, në vlerë 1,310,640.52 mijë lekë*, ka kaluar nëpërmjet llogarisë “Depozitë e Qeverisë”, me shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.

*Shumat e kaluara me këto shkresa ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të “Depozitës së Qeverisë” nga të dy institucionet.*

**f)** Për “Letër kredi për blerjen e helikopterëve të Ministrisë së Mbrojtjes”, në vlerën 1,131,600 mijë lekë, e cila ka kaluar vetëm këtë vit nëpërmjet llogarisë “Depozitë e Qeverisë”, në zbatim të kontratës së amenduar, të nënshkruar më 17/12/2009, shkresë nr. 4063/2, datë 2/5/2011, të Ministrisë së Mbrojtjes.

Kjo pagesë është e shoqëruar me shkresën e MF nr. 13593, datë 1/7/2011, në shumën 8,000,000 Euro, nëpërmjet Bankës Credins me emërtimin “Ministria e Mbrojtjes, Reparti Ushtarak 3001”. Kjo shkresë është e shoqëruar me shkresën nr. ekstra, datë 1/7/2011 “Kërkesë për likuidim detyrimi”, të Degës së Thesarit Tiranë, për kontratën me nr. 6853/10, datë 17/12/2009, të lidhur midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shoqërisë EUROCOPTER Francë “Për blerjen e 5 helikopterëve të mesëm shumërolësh AS532 AL COAGAR dhe pajisjet shoqëruese”, në vlerë 78,633,288 Euro.

### **V.3 Rakordimi i bankave të nivelit të dytë me Bankën e Shqipërisë dhe me Degët e Thesarit në rrethe.**

Auditimi për rakordimin e Bankave të nivelit të dytë me BSH-së dhe Degët e Thesarit në Rrethe, është bazuar në zbatimin e ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, neni 38 të tij “Ministri i Financave nxjerr urdhra, udhëzime dhe rregullore në bazë dhe për zbatimin e këtij ligji”, si dhe në udhëzimin nr. 4, datë 27/1/2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”.

*Nga auditimi i këtij procesi, rezultoi se:*

- Transaksionet financiare të buxhetit të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, regjistrohen në sistemin online të MF, me bazë Oracle E-Business Suite, nga Degët e Thesarit dhe procesohen automatikisht për *pagesat elektronike me BSH-së, ndërsa për të ardhurat, regjistrimi në sistemin online nuk ka përfunduar.* Posta ditore ngarkohet elektronikisht në sistemin e MF nga BSH-së për kryerjen e pagesave elektronike dhe nga bankat e nivelit të dytë për të ardhurat tatimore, jo tatimore dhe të hyra të tjera.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, me shkresën nr. 24128, datë 27/12/2011 “Për procesimin e transaksioneve të fundvitit”, drejtuar BSH-së, 15 Bankave të nivelit të dytë, DPT-së, DPD-së, ISSH-së, ISKSH-së dhe të gjithë Institucioneve qendrore dhe Njësive të Zbatimit të Projekteve me financim të huaj, ka përcaktuar se:

- Bankat e nivelit të dytë, *do të kryejnë arkëtime për llogari të vitit 2011 brenda datës 31/12/2010, kërkesë e cila ishte plotësuar.*

- Raportimi i transaksioneve bankare në BSH-së për llogari të vitit 2011, të bëhet deri në datën 11/1/2012. *Këto afate janë realizuar.*

- Më datën 11/1/2012, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit e MF, i drejtohet BSH-së mbi rakordimin e të dhënave (të ardhura, shpenzime) të raportuara nga bankat e nivelit të dytë dhe të rakorduar me DPTH. Në rast mospërputhje bëhen sistemimet deri në datën 13/1/2012. *Ky afat është realizuar brenda afatit kohor.*

BSH-së me shkresën nr. 12/1, datë 12/1/2012, ka dhënë përgjigje për kërkesën e MF, të dërguar me shkresën nr. 445, datë 11/1/2011, të shoqëruar me pasqyrën për të 15 bankat, për raportimin e të ardhurave të realizuar nga Bankat e nivelit të dytë në BSH-së dhe raportimit të tyre në MF.

Në përfundim, nga rakordimi i Bankave të nivelit të dytë me BSH-së dhe me Degët e Thesarit në rrethe, diferencat e rezultuara nga regjistrimi dhe raportimi i të ardhurave, kanë ardhur kryesisht nga zbatimi i pjesshëm i sistemit "Oracle", diferenca rakordimi të sistemuara në datat 3 dhe 4 janar 2012, në vlerë 1,902,607.36 mijë lekë.

## VI. MBI BORXHIN E BRENDSHËM DHE TË JASHTËM SHETËTOROR.

Bazuar në Ligjin nr. 10496, datë 22/12/2011 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 14.12.2011 të KM "Për një ndryshim në Ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2011 të ndryshuar", dekretuar me dekretin e Presidentit nr. 7271, datë 10/1/2012, kufijtë e rritjes së borxhit shtetëror janë përcaktuar si më poshtë vijon:

"Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2011, është 84,690 milionë lekë, i detajuar si më poshtë:

1. Për huamarrjen vjetore neto, deri në 29,312 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja, deri në 45,800 milionë lekë.
3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, është 6,926 milionë lekë.
4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të huaja të papaguara, është 2,652 milionë lekë.
  - o Treguesi faktik i Borxhit Publik për vitin 2011, rezultoi në vlerën 772,581.8 milionë lekë ose 58.76% të PBB-së.

A. Borxhi publik i qeverisjes qendrore, rezultoi në vlerën 772,364 milionë lekë, nga 715,371 milionë lekë që rezultoi në fund të vitit 2010 ose e shprehur në përqindje kundrejt PBB-së rezultoi përkatesisht 58.75% nga 57.78% që rezultoi në vitin 2010, pra me një rritje të stokut të borxhit prej rreth 0.97% të PBB-së.

Borxhi i mësipërm i rezultuar në vitin 2011, përbëhet nga:


A.1. Borxhi i brendshëm, i cili rezulton në vlerën 438,582 milionë lekë ose 33.36% të PBB-së, nga 407,372 milionë lekë ose 32.90% e PBB-së që rezultoi në vitin 2010 dhe nga 415,028 milionë lekë ose 36.06% ndaj PBB-së që rezultoi në vitin 2009. Për vitin 2011 në krahasim me vitin 2010, ky tregues kundrejt PBB-së rezulton me një rritje prej 0.46 pikë përqindje të PBB-së.

A.2. Borxhi i jashtëm, i cili rezulton në vlerën 333,782 milionë lekë ose 25.39% të PBB-së nga 307,999 milionë lekë ose 24.88% e PBB-së që rezultoi në vitin 2010. Për vitin 2011 krahasuar me vitin 2010, ky tregues rezulton me një rritje prej 0.51 pikë përqindje.

B. Borxhi i qeverisjes vendore, rezultoi 217,8 milionë lekë ose 0.016% të PBB-së nga 147.5 milionë lekë ose 0.012% të PBB-së që rezultoi në vitin 2010.

Konstatojmë se, në raportin vjetor të borxhit publik të vitit 2011 të paraqitur nga KM në Kuvend, nuk është relatuar borxhi i qeverisjes vendore.

Me poshtë paraqesim dinamikën e stokut të borxhit në vite, e shprehur në terma kundrejt PBB-së:



o Nga auditimi i kryer nga KLSH, rezultuan pasaktësi të detajimit të kufirit të rritjes vjetore të totalit të borxhit ekzistues të përcaktuar me Ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”, neni 18, pasi kufiri është përcaktuar **79,288 milionë lekë** dhe detajimi i kufijve të borxhit në katër zërat përbërës **rezulton 80,288 milionë lekë, me një diferencë prej 1,000 milionë lekë**. Në observimet e bëra nga MF (Drejtoria e Borxhit), sqarohet se Drejtoria i ka paraqitur me saktësi të dhënat në nenin e sipërcituar, po ndryshimet e bëra në Kuvend rezultojnë me gabime.

o Po kështu, konstatohet se në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, në ligjet vjetore të buxhetit të vitit 2011, nuk janë vendosur përcaktimet në lidhje me totalin e borxhit shtetëror dhe totalin e shumës së garancive, sikurse përcakton neni 58 “Kufijtë e borxhit publik”, tekstualisht: “Borxhi publik përbëhet nga borxhi shtetëror dhe borxhi vendor.

Në ligjin e buxhetit vjetor vendoset kufiri për:

- a) borxhin e ri shtetëror, për t’u marrë në vitin buxhetor;
- b) totalin e borxhit shtetëror;
- c) garancitë e reja për t’u lëshuar gjatë vitit buxhetor;
- ç) totalin e shumës së garancive.

Borxhi total publik, përfshirë garancitë, nuk duhet të tejkalojë limitin 60 për qind të produktit të brendshëm bruto”.

Përsa më sipër, MF gjatë ballafaqimit dhe në argumentet e paraqitura, pretendon se, nuk i kemi vendosur kufijtë e rritjes së stokut, për arsye të lëvizjeve të kursit të këmbimit dhe të diferencave që lindin në raste të tilla, të cilat bëjnë që të kemi rezultate të ndryshme për stokun e borxhit, të cilat mund të interpretohen në mënyrë të gabuar. Më pas këto interpretime vështirësojnë më tej marrjen dhe shërbimin e borxhit, duke dëmtuar financat publike dhe menaxhimin e tyre.

Së fundi, me shkresën e Ministrisë të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012, cilësohet: - në lidhje me përcaktimin e kufijve të totalit të stokut të borxhit përsëri jemi të mendimit se në kushtet e ndryshimit të kursit të këmbimit, rezultatet e stokut të borxhit janë të ndryshme dhe mund të sjellin pasoja negative për tregun e jashtëm dhe të brendshëm, si dhe në perceptimin e kreditorëve për Shqipërinë.

Më poshtë paraqesim shtesat e rritjes së borxhit shtetëror në kuotat e planifikuara dhe ato faktike për vitin 2011:

		<i>Në mijë/lekë</i>		
<i>Nr.</i>	<i>PËRSHKRIMI</i>	<i>Plani</i>	<i>Fakti</i>	<i>Diferenca (P-F)</i>
<b>I.</b>	<b>TOTALI I BORXHIT</b>	<b>84,690</b>	<b>56,993</b>	<b>27,697</b>
1.	Huamarrje vjetore neto	29,312	28,104	1,208
2.	Huamarrje financim projekte të huaja	45,800	26,511	19,289
3.	Garancitë e shtetit në dobi të palëve të treta përfituese Nga e cila:	6,926	2,891	4,035
3.a	Garanci të brendshme	4,500	3,106	1,394
3.b	Garanci të huaja	2,426	- 215	2,641
4.	Borxh i riskeduluar	2,652	- 513	3,165

Sikurse konstatohet, rritja e kuotave faktike të borxhit shtetëror kundrejt kuotave të planifikuara *rezulton në shumën 56,993 milionë lekë, kundrejt 84,690 milionë lekë të planifikuara.*

Në raportin vjetor për borxhin publik që MF ka dorëzuar, kapitulli 7.2 realizimi i stokut të borxhit dhe respektimi i kufijve të tij, Tabela 12. Borxhi i riskeduluar tek kolona “Fakti i i riskedulimeve kundrejt kuotës së planifikuar të kufirit të rritjes”, *rezulton 3,165 milionë lekë dhe jo 2,138 milionë lekë.*

#### **VI.1 Borxhi i brendshëm dhe shërbimi i tij**

Bazuar në Ligjin nr. 10496, datë 22/12/2011 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 14.12.2011 të KM “Për një ndryshim në Ligjin nr. 10355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011 të ndryshuar”, dekretuar me dekretin e Presidentit nr. 7271, datë 10/1/2012, kufijtë e rritjes së borxhit shtetëror janë përcaktuar si më poshtë vijon:

“Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2011, është 84,690 milionë lekë, i detajuar si më poshtë:

1. Për huamarrjen vjetore neto, deri në 29,312 milionë lekë.
2. Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 46,812 milionë leke, nga i cili 300 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit dhe 300 milionë lekë nga rezultati financiar i ISKSH”.

Treguesit e planifikuar dhe ata faktikë të borxhit të brendshëm, rezultojnë me poshtë vijon:

		<i>Në milionë/lekë</i>		
<i>Nr.</i>	<i>PËRSHKRIMI</i>	<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>	<i>Diferenca (P-f)</i>
<b>I.</b>	<b>Borxhi i brendshëm</b>	<b>33,812</b>	<b>31,210</b>	<b>2,602</b>
1.	Huamarrje financim tregu i brendshëm	29,312	28,104	1,208
2.	Garanci në tregun e brendshëm	4,500	3,106	1,394


Treguesit e stokut faktik të borxhit të brendshëm shtetëror dhe rritja e tij për vitin 2011, në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	2007	VITET				Diferenca 2011/2010
			2008	2009	2010	2011	
I.	<b>TOTALI:</b>	369,536	400,456	415,028	407,372	438,582	31,210
1.	Instrumenta afatshkurtër <i>Bono thesari</i>	232,211	224,224	237,469	231,436	241,385	9,949
2.	Instrumenta afatgjatë <i>Obligacione</i>	121,820	144,740	153,162	170,385	188,539	18,154
3.	Kredi direkte Detyrime në obligac. të BKT	-	3,000	-	-	-	-
4.	Obligacioni rivlerësimit valutës	15,505	23,540	18,870	-	-	-
5.	Garanci për tregun e brendshëm	-	4,952	5,527	5,551	8,657	3,106

Sikurse konstatohet, për vitin 2011 rezulton një rritje e stokut të borxhit tëbrendshëm në shumën 31,210 milionë lekë. Nga analiza e portofolit të borxhit të brendshëm rezulton se, kjo rritje vjen 28,103 milionë lekë për efekt të rritjes së borxhit me instrumente përkatësisht ato afatshkurtër (bono thesari) 9,949 milionë lekë dhe 18,154 milionë lekë për efekt të instrumentave afatgjatë (obligacione). Kurse, shuma prej 3,106 milionë lekë rezulton nga garancitë e emetuara në favor të KESH sh.a.

Në mënyrë grafike, struktura e stokut të borxhit të brendshëm në fund të vitit 2011 paraqitet:



Pra, përbërja e portofolit të borxhit të brendshëm përbëhet në masën rreth 55% nga instrumente financiar afatshkurtër, nga të cilat bono thesari 12/mujore përfaqësojnë rreth 42.6% të stokut të instrumentave afatshkurtër; rreth 43% instrumenta afatgjatë, nga të cilat obligacionet me maturim 2 dhe 5/vjeçar përfaqësojnë përkatësisht 17% dhe 18% të totalit të instrumentave afatgjatë; ndërsa 2% garancitë e brendshme.

**VI.1.a Përcaktimi i nevojave për huamarrje, llogaritja e nevojave për sasinë e bonove të thesarit dhe obligacioneve që emetohen.**

Mbështetur në treguesin e kufirit maksimal të lejuar të deficitit buxhetor dhe financimit të tij me financim të brendshëm, të përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit për vitin 2011, nga sektori i borxhit të brendshëm janë parashikuar nevojat për huamarrje të brendshme.

Instrumentet e MF për mbulimin e nevojave për huamarrje të brendshme kanë qenë emetimi i bonove të thesarit 3, 6 dhe 12/mujore, si dhe emetimi i obligacioneve 2, 3 dhe 5/vjeçare.

Nga sektori i borxhit të brendshëm për nevojat të huamarrjes është hartuar kalendari për huamarrje për bono thesari dhe për obligacione.

Referuar njoftimeve zyrtare të MF bërë BSH-së (njoftim shkresor ose elektronik) për kalendarin e emetimit të instrumenteve të huamarrjes së brendshme rezultoi se, nga MF janë respektuar neni 3.1, i marrëveshjes midis BSH-së dhe MF “Për obligacionet” të nënshkruar me datën 28/9/2007, si dhe neni 2 i marrëveshjes datë 5/9/2006 midis MF dhe BSH-së “Për emetimin nga ana e RSH, të bonove të thesarit në formë regjistrimi dhe mbajtjen e regjistrit në dy nivele”, për njoftimet zyrtare çdo tre muaj ashtu dhe për njoftimet për ndryshim të kalendarit gjatë vitit ushtrimor.

Referuar informacionit të dhënë dhe të shpallur nga BSH-së, e cila njofton pjesëmarrësit e huamarrjes, rezultoi se, *asnjë ankand i obligacioneve nuk ka qenë ankand i jashtëzakonshëm*. Nga shqyrtimi i kalendarit të emetimit të letrave me vlerë të qeverisë, të dërguar në BSH-së nga MF, është planifikuar zhvillim ankandi obligacionesh 2/vjeçare për çdo muaj, pra 12 ankande dhe janë realizuar po 12; për ankande 3/vjeçare është planifikuar të zhvillohen 3 ankande dhe aktualisht janë zhvilluar 3 ankande të obligacioneve; si dhe ankande obligacionesh 5/vjeçare janë planifikuar 4 dhe janë realizuar 5, ku një ankand është i rihapur.

Për obligacionet shuma e planifikuar në kalendar për emetim prej 61,300,000 mijë lekë në total për ankande obligacionesh, *ka qenë më e vogël se ajo e shpallur për emetim nga MF prej 65,600,000 mijë lekë*.

Kalendari i nevojave për bono thesari referuar njoftimeve zyrtare në BSH-së është hartuar për periudhën janar-dhjetor të vitit 2011 për çdo parashikim ankandi, në mënyrë të njëpasnjëshme dhe për çdo lloj emetimi bono thesari 3/mujore, 6/mujore dhe 12/mujore. Pjesë e këtij kalendari është dhe parashikimi për emetim të obligacioneve 2/vjeçare, 3/vjeçare dhe 5/vjeçare.

Grupi i auditimit, shqyrtoi në MF kalendarin e vënë në dispozicion, për çdo 3/mujor të vitit 2011, si dhe ndryshimet përkatëse të këtij kalendari me shkresat përkatëse. Edhe për bonot e thesarit shuma e planifikuar për emetim në kalendar është e ndryshme nga shuma e shpallur nga MF në njoftimet për çdo zhvillim të ankandeve të bonove të thesarit. Kjo ka ndodhur për ankandet e zhvilluara në tremujorin e parë të vitit 2011, ku ndryshimi ka qenë për të tre llojet e ankandeve të bonove të thesarit 3/mujore, 6/mujore dhe 12/mujore.

Përsa më sipër, *MF nuk ka zbatuar nenin 3.1 të marrëveshjes midis BSH-së dhe MF “Për Obligacionet”, të nënshkruar me datën 28/9/2007, si dhe nenin 2 të marrëveshjes datë 5/9/2006 midis MF dhe BSH-së të sipërcituar, për pjesën e ndryshimit të programit ekonomik dhe njoftimit me korrektësi të tregut për këto ndryshime*.



Gjatë vitit 2011 ka ndryshime të shpeshta të kalendarit të huamarrjes, kjo në vartësi të nevojave për likuiditete, por jo të gjitha ndryshimet janë pasqyruar në programet (kalendarët e huamarrjes) dhe tregu është njoftuar për shumat e huamarrjes në këto raste, vetëm nga njoftimet për zhvillim ankandi.

Nga “Sektori i huamarrjes së brendshme” janë paraqitur problematika të borxhit të brendshëm të rezultuara gjatë vitit 2011. Mendimet e paraqitura në formën e vendimmarrjeve për ndryshimin e huamarrjes së brendshme në vitin 2011, janë të llojit të miratimit në hierarki dhe kryesisht referuar përmbajtjes së vendimeve, të cilët kanë qenë vendime për të ndryshuar huamarrjen me instrumente bono thesari dhe obligacione, referuar nevojave emergjente për likuiditete të kërkuara zyrtarisht nga DPTH, si dhe mundësisë e plotësimit nga tregu të nevojave sipas instrumentit, rezultuar nga testimi i tij.

Mbështetur në informacionin zyrtar të dhënë nga Drejtoria e Huamarrjes për vendimet e marra gjatë vitit 2011 në drejtim të huamarrjes së brendshme, ka rezultuar problematika e mëposhtme:

1. Nevoja për likuiditete në valutë të Qeverisë në muajin mars 2011, për rrjedhojë domosdoshmëria e kryerjes së ankandit të jashtëzakonshëm 9/mujor në Euro.
2. Ndryshim i kalendarit për muajin qershor 2011 për rritjen huamarrjes me ankand bono thesari 12/mujore dhe të huamarrjes me obligacion 2/vjeçar. Ky ndryshim bëhet në plotësim të nevojave me likuiditete për DPTH.

*Në këtë periudhë presioni për likuiditete nga DPTH ka qenë shumë i madh.* Gjithashtu, referuar memove në vazhdimësi ka ndryshime strukturore të kalendarit të huamarrjes pikërisht referuar mosbalancimit të nevojave për pagesa të regjistruara në sistemin AMoFTS, si dhe atyre të pritshme dhe të domosdoshme për t’u paguar si: paga, pagesa për maturim të huamarrjes, transferata e kontributeve të ISSH nga Depozita e Qeverisë e mbetur pa u transferuar nga arkëtimet e korrikut dhe më vonë të gushtit për mungesë likuiditeti etj.

*Duke konsideruar sa me sipër, arrijmë në përfundimin se huamarrja e brendshme e planifikuar në fillim të vitit sipas instrumenteve përkatës, ka qenë e ndryshueshme gjatë vitit, kjo dhe për faktin e mungesës së likuiditetit në sistem*

Kompetencat dhe detyrimet e MF për huamarrjen e brendshme, janë përcaktuar në marrëveshjet e lidhura për këtë qëllim midis saj me BSH-së, të cilat janë amenduar në vitin 2008. Gjithashtu, në Ligjin nr. 9665, datë 18/12/2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në RSH”, neni 50 “Përfaqësimi i Ministrit të Financave”, është përcaktuar kompetenca për çdo zyrtar në rolin e Ministrit gjatë mungesës së tij, referuar këtij ligji. *Ky nen për huamarrjen e brendshme gjatë vitit 2011 është zbatuar.*

Sipas parashikimeve të bëra në kalendarin e bonove të thesarit të hartuar, *shuma për emetim për gjithë vitin 2011, ka qenë e planifikuar 352,500 milionë lekë kundrejt 345,534 milionë lekë në vitin 2010 dhe 404,097 milionë lekë në 2009, dhe sasia e planifikuar e huamarrjes me instrumentin e obligacioneve ka qenë 61,300 milionë lekë në vitin 2011, kundrejt 50,200 milionë lekë në vitin 2010 dhe 57,550 milionë lekë në vitin 2009.* Pra, si tendencë për vitin 2011, *ka qenë një rritje e huamarrjes e afatshkurtër (nën 1 vit) dhe huamarrjes afatgjatë (obligacioneve) në krahasim me një vit më parë.*

Kjo huamarrje e planifikuar ka ndryshuar gjatë vitit 2011, sipas strukturës si më poshtë vijon:

**Huamarrja për vitin 2011**

<b><u>Bono thesari</u></b>	<b>Sipas kalendarit</b>	<b>Të ofruara</b> (shpallura nga MF)	<b><i>Në milionë/lekë</i></b> <b>Të emetuara</b>
3/mujore	48,400	50,200	48,068.8
6/mujore	88,600	96,200	93,788.5
12/mujore	215,500	198,000	199,343.9
<b>Totali bono thesari</b>	<b>352,500</b>	<b>344,400</b>	<b>341,201.2</b>

<b><u>Obligacione</u></b>	<b>Sipas kalendarit</b>	<b>Të ofruara</b> (shpallura nga MF)	<b>Të emetuara</b>
2/vjeçare	39,650	42,450	39,740.8
3/vjeçare	4,150	5,650	5,623.6
5/vjeçare	17,500	17,500	16,556.8
7/vjeçare	-	-	-
<b>Totali i obligacioneve</b>	<b>61,300</b>	<b>65,600</b>	<b>61,921.2</b>

Struktura e bonove të thesarit dhe obligacioneve në përqindje paraqitet në tabelë si më poshtë vijon:

<b><u>Bono thesari</u></b>	<b>Sipas kalendarit</b>	<b>Të kërkuara</b>	<b><i>Nëpërqindje</i></b> <b>Të emetuara</b>
3/mujore	13.7	14.6	14.1
6/mujore	25.1	27.9	27.5
12/mujore	61.2	57.5	58.4
<b>Totali bono thesari</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

**Obligacione**

2/vjeçare	65.2	64.7	64.2
3/vjeçare	6.8	8.6	9.1
5/vjeçare	28.0	26.7	27.7
7/vjeçare	-	-	-
<b>Totali i obligacioneve</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Sa më sipër rezulton se, në shumat e kërkuara nga MF për bono thesari 3/mujore dhe 6/mujore (referuar njoftimeve të bëra nga MF për çdo ankand), është ndryshuar struktura për huamarrje, krahasuar kjo me planifikimin e nevojave të paraqitura në kalendarin e huamarrjes të publikuar (sipas trajtimit më sipër këto ndryshime kanë ndodhur në tremujorin e parë të vitit 2011) dhe dërguar për njoftim BSH-së. Edhe emetimi ka ndryshuar në disa raste, kjo për vetë faktin e plotësimit të nevojave të shpallura me ofertën e tregut. Gjatë vitit 2011, vetëm në disa raste oferta e tregut nuk ka plotësuar kërkesën për bono thesari dhe konkretisht në ankandet e shpallura për bonot 3/mujore në muajin nëntor dhe për bono 12/mujore në muajin gusht dhe dhjetor. Në rastet e tjera, për ankandet e kryera në një datë, është përdorur kompensimi i shumave të shpallura për ankandet përkatëse, me kërkesat e ofruara, kjo në përputhje në marrëveshjen midis BSH-së dhe MF.

Nga studimi i tregut të zhvilluar të obligacioneve për vitin 2011, rezulton se, ka pasur raste, që shumat e kërkuara nga MF në ankandet përkatëse nuk janë plotësuar me ofertën e tregut dhe kjo në ankandin e obligacioneve 2/vjeçare të

organizuar në muajt mars, nëntor dhe dhjetor; në ankandin e obligacionit 3/vjeçare të organizuar në muajin mars; kurse për ankandet e obligacioneve 5/vjeçare shuma e pranuar është më e vogël se shuma e shpallur. Në këto ankande, ka rezultuar refuzimi i kërkesës nga MF, kjo e drejtë e mbështetur në marrëveshjen e lidhur me BSH-së.

Nga shuma e emetuar e obligacioneve për vitin 2011 prej 61,921 milionë lekë, janë maturuar obligacione me vlerë 43,767 milionë lekë dhe diferenca prej 18,154 milionë lekë ka shërbyer si e ardhur në Depozitën e Qeverisë, për kryerjen e likuiditeteve të saj (financim deficiti).

Gjithashtu, nga shuma totale e emetimit të bonove të thesarit për vitin 2011 prej 327,446 milionë lekë me çmim blerje (ose 344,892 milionë lekë në vlerë nominale), janë maturuar bono thesari në shumën 317,500 milionë lekë (ose 335,297 në vlerë nominale), pra për financim deficiti ka shërbyer diferenca prej 9,946 milionë lekë.

Gjatë vitit 2011, janë emetuar dhe bono në Euro në shumën me çmim blerje 3,502 milionë lekë dhe maturuar në shumën 5,651 milionë lekë. Në financim deficiti ankandet e bonove në Euro paraqiten me – 2,149,725 milionë lekë, pasi shuma e emetuar është më e vogël se shuma e maturuar.

Nga MF për huamarrjen e brendshme është kryer njoftimi për publikimin e të dhënave për ankandet e huamarrjes së brendshme (njoftim ankandi bono thesari dhe obligacioni). Për këtë, ka dalë urdhri i firmosur nga Ministri i Financave me nr. 2028, datë 31/1/2010 “Për publikimin e njoftimeve për ankand”. Realisht publikimi referuar e-mail të dhënë nga Drejtoria e Huamarrjes për zyrën e shtypit, në zbatim të urdhrin të mësipërm, është bërë për çdo njoftim ankandi për letrat me vlerë të qeverisë të zhvilluar gjatë vitit 2011.

Kurse, në drejtim të *publicitetit për këto ankande*, referuar rekomandimit të lënë nga KLSH “Për buxhetin faktik të vitit 2009 dhe 2010”, *rezultoi se gjatë vitit 2011 nuk kishte asnjë aktivitet për këtë qëllim. Dokumentacioni që vërteton kryerjen e këtij publiciteti është fundi i muajit qershor 2012*, material i vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit të KLSH, bashkarisht me observacionin e bërë nga zyra e shtypit të MF.

Nga auditimi i kryer për realizimin e njoftimeve për zhvillimin e ankandëve të bonove të thesarit dhe të obligacioneve në një televizion kombëtar dhe në një gazetë kombëtare u konstatua se:

Nga MF për huamarrjen e brendshme është kryer njoftimi për publikimin e të dhënave për ankandet e huamarrjes së brendshme (njoftim ankandi bono thesari dhe obligacioni). Për këtë ka dalë urdhri i firmosur nga Ministri i Financave me nr. 2028, datë 31/1/2011 “Për publikimin e njoftimeve për ankand”, ku në këtë urdhër theksohet:

- Paragrafi parë: “Të bëhet publikimi i njoftimeve të ankandëve të emetimit të letrave me vlerë të Qeverisë në një televizion kombëtar dhe në një gazetë me shtrirje të gjerë kombëtare për vitin 2011”.

- Paragrafi dytë: “Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Borxhit Publik (DPMBP), Zyra e Shtypit dhe Zyra e Financës në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe të Shërbimeve të Brendshme”.

Publikimi i të dhënave për ankandet e huamarrjes mbështetet në marrëveshjet ndërmjet MF dhe BSH-së për emetimin e bonove të thesarit në formë regjistrimi dhe mbajtjen e regjistrit të dy niveleve, dhe referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPMBP dhe nga Zyra e Shtypit të MF, rezultoi se:

1. Nga zyra e shtypit nuk janë kryer njoftimet për zhvillimin e ankandëve në një televizion kombëtar, në kundërshtim me urdhrin e Ministrit të Financave të sipërcituar, njëkohësisht me moszbatimin e kërkesës (njoftim me e-mail) të DPMBP, ku në çdo njoftim ka përcaktuar që publikimi të bëhet në shtyp dhe në media.

2. Nga zyra e shtypit janë realizuar njoftimet për zhvillimin e ankandëve të letrave me vlerë në një gazetë kombëtare, konkretisht në Gazetën “Standard” për të gjithë periudhën. Këto njoftime në gazetë kombëtare nuk janë kryer për çdo rast të njoftimit të bërë nga DPMBP. Mbështetur në urdhër shpenzimet e likuiduara për njoftimet e ankandëve të zhvilluara gjatë vitit 2011 (referuar njoftimit bashkëlidhur urdhër shpenzimit, kontratës dhe faturës) dhe krahasimi me njoftimet e realizuara nga DPMBP për zyrën e shtypit rezultoi se, nuk janë kryer njoftime për ankandë bono thesari 3/mujore, 6/mujore dhe 12/mujore, si dhe ankandë obligacioni 2/vjeçar, 3/vjeçar dhe 5/vjeçar.

Nga një analizë më e hollësishme, u konstatua se nuk janë njoftuar në gazetë ankandët: për bono thesari 3/mujore të zhvilluar me datë 1/11/2011; bono thesari 6/mujore të zhvilluar në datat 17/5/2011 dhe 16/8/2011; bono thesari 12/mujore në datat 17/5/2011 dhe 16/8/2011; për obligacione 2/vjeçare të emetuar në datën 22/8/2011; obligacione 3/vjeçare të emetuar në datat 7/1/2011, 7/4/2011 dhe 4/7/2011; si dhe ankand obligacioni 5/vjeçar të emetuar në datën 9/5/2011.

**VI.1.b Mbi rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit në BSH-së, në zbatim të marrëveshjeve të lidhura midis MF dhe BSH-së.**

Procesi i organizimit dhe zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit për vitin 2011, është bazuar në marrëveshjen midis BSH-së dhe MF lidhur më datë 5/9/2006, të ndryshuar me datë 14/12/2009 dhe datë 1/12/2010.

Për vitin 2011, shuma e shpallur e bonove të thesarit nga MF në total është 348,168,820,000 lekë në vlerë nominale dhe është realizuar 344,655,049,998 lekë, pra në masën 99%. Gjatë vitit janë realizuar 12 ankandë 3/mujore në vlerën totale të shpallur 48,677,500,000 lekë dhe janë pranuar 48,068,780,000 lekë. Yield-i maksimal i pranuar për këto ankandë varion në kufijtë 5.75% deri 5.15%.

Janë realizuar 13 ankandë 6/mujore me vlerë totale të shpallur 94,846,080,000 mijë lekë dhe vlerë të pranuar 93,788,509,999 lekë me yield maksimal të pranuar në kufijtë 6.9% deri në 6.35%. Përsa i takon ankandëve me afat 1/vjeçar, janë realizuar 25 të tillë, me vlerë totale të shpallur 204,645,240,000 lekë dhe vlerë të pranuar 202,797,759,999 lekë, me yield maksimal të pranuar në kufijtë 7.74% deri në 6.92%.

Gjatë vitit 2011, ka pasur një ankand të jashtëzakonshëm me afat 6/mujor, i cili është zhvilluar në datë 10/3/2011 dhe ku shuma e shpallur dhe e pranuar ka qenë 1,500,000,000 lekë, ndërsa yield-i maksimal i pranuar ka qenë 6.68%. Gjithashtu, gjatë këtij viti janë zhvilluar edhe dy ankandë në Euro. Ankandi i parë me afat 9/mujor, është zhvilluar në datën 25/3/2011 dhe shuma e shpallur ka qenë 20,000,000 Euro, ndërsa shuma e pranuar 17,501,500 Euro. Yield-i maksimal i pranuar ka qenë 6.68%. Ankandi i dytë në Euro është zhvilluar në datën 25/11/2011 dhe shuma e shpallur ka qenë 10,000,000 Euro, ndërsa shuma e pranuar 8,971,900 Euro. Yield-i maksimal i pranuar ka qenë 6.8%.

Këto ankandë në Euro janë *realizuar pjesërisht*, pasi shuma totale e kërkuar ka qenë më e ulët se sa ajo e shpallur. Në këto ankandë kanë marrë pjesë kryesisht

bankat e nivelit të dytë me kërkesa konkurruese dhe një numër shumë i vogël individësh me kërkesa jo konkurruese.

Gjatë vitit analizues, *realizimi i ankandeve në përgjithësi ka qenë i plotë*. Ka pasur pak ankande që janë realizuar pjesërisht, si për shembull ankandi nr. 1482 i realizuar në masën 86.76% apo ankandi nr. 1489 i cili është realizuar në masën 93.07%. Realizimi i pjesëshëm ka ardhur si pasojë e shumës së kërkuar më të ulët se shuma e shpallur.

Vihet re se yield-i i bonove të thesarit ka qenë më i ulët në 3/mujorin e parë të vitit 2011, më pas ka ardhur duke u rritur nga muaji prill deri në gusht dhe më pas është ulur nga muaji shtator deri në fund të vitit. Vlera maksimale e yield-it për bonot me afat 3/mujor ka qenë 5.75%, për ato me afat 6/mujor 6.90% dhe për bonot me afat 1/vjeçar 7.74%. Në krahasim me një vit më parë, në tregun e bonove të thesarit, *vihet re një rënie e vlerës së yield-eve të pranuar*.

<i>Bonot e thesarit</i>	<i>3/mujore</i>	<i>6/mujore</i>	<i>12/mujore</i>
Yield-i maksimal i pranuar për vitin 2010	6.23%	7.42%	8.93%
Yield-i maksimal i pranuar për vitin 2011	5.75%	6.90%	7.74%

Pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2011 në ankandet e zhvilluara ka qenë në vlerën 130,722,000,000 lekë për investimin e fondeve të saj dhe 6,055,000,000 lekë për investimin e fondit të pensionit. Nga auditimi i kryer mbi të drejtën për blerjen e bonove të thesarit me afat 1/vjeçar nga BSH-së, rezultoi se ajo ka marrë pjesë në tregun primar të bonove me afat maturimi 1/vjeçar vetëm me fonde të cilat janë riinvestim, pra fonde të ardhura pas investimeve në tregun sekondar. Banka e Shqipërisë nuk ka marrë pjesë në ankandet e zhvilluara në Euro.

*Ankandet për t'u audituar, janë përzgjedhur kryesisht në bazë të vlerës më të lartë të shpallur si dhe në periudhat me normë yield-i më të lartë*. U përzgjedhën 35 ankande me vlerë totale të pranuar 290,233,000,000 lekë, nga një total prej 344,655,049,998 lekë gjatë vitit 2011.

Nga auditimi i rregullshmërisë së ankandeve të përzgjedhur, u konstatua se në pjesëmarrjet gjatë vitit në ankandet e bonove të thesarit nr. 1468, 1474, 1485 dhe 1491, nga ana e subjektit "INSIG", yield-i i kërkuar paraqitet pjesërisht me fjalë dhe pjesërisht me shifra. Kështu, në ankandin nr. 1474, INSIG ka kërkuar të marrë pjesë me shumën 70,000,000 lekë me yield të kërkuar 6.99%, i cili me fjalë është shkruar "gjashtë e 99/100". Gjatë gjithë vitit 2011, yield-i i kërkuar nga ky subjekt në ankandet ku ka marrë pjesë, është shprehur në këtë mënyrë, duke mos ju përmbajtur kriterëve të plotësimit të formularit "Kërkesë", sipas kushteve të përcaktuara në aneksin nr. 1 të marrëveshjes.

Gjithashtu u konstatua se, në ankandin nr. 1478, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, ka kërkuar të marrë pjesë me shumën 12,000,000 lekë me yield të kërkuar 5.25%, por vërtetimi bashkëngjitur kërkesës i lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, është për shumën "12,000,000" lekë, e shprehur me shifra dhe "një milion e njëqind mijë lekë" e shprehur me fjalë. Nga Komisioni i ankandit, kjo kërkesë nuk është s'kualifikuar, megjithëse vërtetimi i shumës për pjesëmarrje nuk është i rregullt. Këto veprime bien në kundërshtim me pikën 8 dhe 9, të nenit 11, të marrëveshjes midis MF dhe BSH-së "Për emetimin nga ana e RSH, të bonove të thesarit në formë regjistrimi dhe mbajtjen e regjistrimit në dy nivele"

### **VI.1.c Mbi rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të obligacioneve të organizuara në Banka e Shqipërisë.**

Gjatë vitit 2011, referuar ankandëve të shpallura nga MF, në BSH-së janë zhvilluar ankandë të obligacioneve me afat maturimi 2/vjeçar, 3/vjeçar dhe 5/vjeçar. Për këtë vit, nuk janë planifikuar dhe emetuar ankandë obligacionesh 7/vjeçare. Organizimi i fundit i obligacioneve 7/vjeçare është bërë në vitin 2008.

Shuma e shpallur nga MF referuar njoftimeve të saj për çdo rast zhvillimi ankandi obligacioni, ka qenë në vlerën totale 65,600,000 mijë lekë (me vlerë nominale dhe çmim blerje) për 20 ankandë. Kjo shumë është e ndarë sipas llojit të obligacioneve si më poshtë:

1. Shuma 42,450,000 mijë lekë, për 12 ankandë obligacionesh me afat maturimi 2/vjeçar (me kupon fiks).
2. Shuma prej 5,650,000 mijë lekë, për 3 ankandë obligacionesh me afat maturimi 3/vjeçar (me kupon fiks).
3. Shuma e shpallur prej 16,500,000 mijë lekë, për 3 ankandë obligacionesh me afat maturimi 5/vjeçar (me kupon të ndryshueshëm), ku një ankand është rihapur.
4. Shuma prej 1,000,000 mijë lekë, për 1 ankand obligacionesh me afat maturimi 5/vjeçar (me kupon fiks).

Referuar informacionit të dhënë dhe njoftimit shkresor ose elektronik të MF për secilin ankand obligacionesh, *asnjë nga këto ankandë nuk ka qenë ankand i jashtëzakonshëm*. Referuar kalendarit të emetimit të letrave me vlerë të Qeverisë, të dërguar në BSH-së nga MF, ka ndryshueshmëri ndërmjet njoftimit në kalendar dhe zhvillimit të ankandëve për disa prej tyre. Kështu, nga krahasimi rezultoi se, është planifikuar zhvillim ankandi obligacionesh 2/vjeçar për çdo muaj pra gjithsej 12 ankandë dhe janë realizuar 12; për ankandë 3/vjeçare është planifikuar të zhvillohen 3 ankandë dhe në fakt janë zhvilluar 3; ndërsa për ankandët e obligacioneve 5/vjeçare janë planifikuar 4 dhe janë realizuar 5, ku një ankand është i rihapur. Ankandi i rihapur nuk është parashikuar në kalendar, ai ka qenë pjesë e njoftimit nga MF për zhvillim ankandi, por njoftimi nuk është bërë si një ankand i jashtëzakonshëm.

Është për t'u theksuar se, *ankandët e obligacioneve jo gjithnjë kanë qenë të plota*, pra jo gjithnjë shuma e shpallur është plotësuar me kërkesat e pranuar. Nga krahasueshmëria e shumave të shpallura për emetim dhe shumave të pranuar, rezulton se në total janë shpallur për emetim 65,600,000 mijë lekë për ankandët e obligacioneve dhe janë pranuar për emetim shuma 61,921,170 mijë lekë. *Kjo ka ndodhur për efekte të kërkesës së tregut më të vogël se sa shuma e shpallur ose të s'kualifikimit të kërkesave me përqindje kuponi të lartë, në krahasim me kuponin indikativ të shpallur nga MF* në 6 ankandë obligacionesh nga 20 gjithsej, ku 3 raste janë në ankandët e obligacioneve 2/vjeçare, 1 rast në ankandin e obligacioneve 3/vjeçar dhe 2 raste në ankandin e obligacioneve 5/vjeçar.

*Referuar pjesëmarrësve me kërkesa jo konkurruese (persona fizikë), rezultojnë se, janë shumë të vegjël në numër dhe në vlerë, ato zënë vetëm 0.18% të vlerës totale të pranuar (emetuar) të obligacioneve*. Pjesëmarrja me kërkesa konkurruese e personave fizik ka një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2010, ku përqindja ishte 0.1%. Në rastet e mësipërme janë zbatuar kërkesat e nenit 15.2 të marrëveshjes në

fuqi, kur shuma e kërkesave jo konkurruese nuk plotëson masën 20%, diferenca e pa plotësuar ofrohet për kërkesat konkurruese.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga BSH-së (njoftime shkresore) për programin kohor dhe shumat e emetimit të llojeve të ndryshme të obligacioneve nga Qeveria Shqiptare, rezultoi se, nga MF referuar nenit 3.1, të marrëveshjes midis BSH-së dhe MF “Për Obligacionet” hyrë në fuqi me datën 28/9/2007, i ndryshuar, janë dërguar për tërë vitin, çdo tre muaj, njoftimet në BSH-së dhe për rrjedhojë janë njoftuar pjesëmarrësit në tregun primar për programet 3/mujore për llojin, shumat dhe datat e emetimit të obligacioneve. *Karakteristikë për vitin 2011 kanë qenë ndryshimet për kalendarët e dërguar, referuar programimit të sasisë së emetimeve të letrave me vlerë të qeverisë.* Kështu, kalendarit për tremujorin e parë, të tretë dhe të katërt është ndryshuar referuar shkresave përkatëse respektivisht 2 herë, 4 herë dhe 3 herë.

Nga grupi i auditimit u krye auditim i procedurave të realizimit të ankandëve të obligacioneve hap pas hapi, për çdo ankand obligacioni me afat maturimi 2/vjeçar, 3/vjeçar dhe 5/vjeçar, pra për 20 ankande obligacionesh në vlerën e emetuar 61,921,170 mijë lekë. Nga ky auditim rezultoi:

- Kërkesat merren nga Komisioni përpara fillimit të ankandit nga kutia postare brenda ambienteve të BSH-së, ku në momentin e hapjes së kutisë mbahet procesverbal, në të cilin identifikohen pjesëmarrësit sipas zarfeve të pahapur dhe ky procesverbal firmoset nga Komisioni dhe nëpunësi i informacionit. *Për vitin 2011 përgjithësisht pjesëmarrësit kanë paraqitur kërkesat elektronikisht.* Të gjithë pjesëmarrësit janë regjistruar në konkurrim. Raste të përjashtimeve të kërkesave referuar ankandëve të obligacioneve të zhvilluara ka pak, ku është mbajtur procesverbali përkatës dhe subjektit i është dhënë argumenti referuar refuzimit. *Përjashtimi nga konkurrimi është bërë konform parashikimit të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e përbashkët midis BSH-së dhe MF.*

Në përgjithësi të gjitha ankandet e obligacioneve janë kryer brenda afateve të përcaktuara në marrëveshje. Të njëjtën gjë konfirmojmë dhe për njoftimet ndërmjet palëve për treguesit e ankandit dhe rezultatet e tij.

Gjithashtu, nga auditimi i ankandëve të obligacioneve, rezultoi se, në ankandin e obligacioneve 3/vjeçar nr. 21 të zhvilluar me datën 30/6/2011, shuma e shpallur për emetim nga MF ka qenë 1,500,000 mijë lekë dhe shuma e pranuar për emetim në rezultatin e shpallur nga Ministria ka qenë 1,750,000 mijë lekë, duke tejkaluar shumën e shpallur. *Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 14, pika 2, të marrëveshjes bazë midis BSH-së dhe MF “Për Obligacionet” të ndryshuar, në të cilën theksohet: “Ministria e Financave në marrjen e këtij vendimi mban parasysht shumën e shpallur për emetimin e obligacioneve. Në varësi të nevojave të huamarrjes dhe kostos së saj, Ministria mund të zvogëlojë ose të anulojë shumën e ofruar dhe të shpallur”. Referuar këtij citimi, marrëveshja nuk ofron mundësi për rritje të shumave të shpallura prej saj para zhvillimit të ankandit.*

**VI.1.d Mbi ecurinë e tregut të bonove të thesarit dhe obligacioneve, efektet në nivelin e yield-it. Vlerësimi i nivelit faktik të yield-it, në raport me nivelin e interesave të depozitave e repove. Aanaliza e shkaqeve të diferencës që rezulton midis tyre.**

Për vitin 2011, nga MF janë emetuar bono thesari me vlerë nominale në shumën 344,400 milionë lekë (shuma e ofruar nga kjo ministri), kundrejt 362,678.2 milionë

lekë në vitin 2010. Nga zhvillimi i ankandëve në tregun primar, blerjet e bonove të thesarit rezultojnë në shumën *341,201.2 milionë lekë* (emetimi i realizuar), referuar 361,384.7 milionë lekë në vitin 2010 dhe ku shuma e kërkuar në tregun primar për bono thesari në vitin 2011 është *397,655.8 milionë lekë*. *Shuma e pa realizuar e bonove të thesarit ka rezultuar si rrjedhojë e kërkesave më të vogla se sa oferta në 3 ankande bono thesari dhe në 6 ankande ka rezultuar refuzimi i kërkesës për efekte të yield-it të lartë.*

Gjatë vitit 2011, bonot e thesarit të emetuara në fakt prej 341,201.2 milionë lekë, rezultojnë në një nivel më të ulët se emetimi i realizuar gjatë 4 viteve të fundit. Për vitin 2011 janë kryer dhe dy ankande bonosh thesari në Euro me afat maturimi 9/mujor dhe 12/mujor.

- *Huazimi neto gjithsej (bono thesari + obligacione) për vitin 2011 me çmim blerje është 28,105.5 milionë lekë*, kundrejt huazimit neto për vitin 2010 prej 11,136.9 milionë lekë.

- *Huazimi neto për bono thesari është 9,946.2 milionë lekë* (bono në lekë 12,095.9 milionë lekë dhe bono në Euro -2,149.7 milionë lekë) kundrejt -6,086.3 milionë lekë në vitin 2010 (bono në lekë -9,350.6 milionë lekë dhe bono në Euro 3,264.3 milion lekë).

- *Huazimi neto për obligacione është 18,154.2 milionë lekë* kundrejt 17,223.2 milionë lekë në vitin 2010.

Pra, për vitin 2011 zgjedhja e instrumentit financiar me afat maturimi më të gjatë (bonot e thesarit 3/mujore janë më pak në numër dhe në shumë emetimi kundrejt bonove 6/mujore dhe sidomos 12/mujore ) ka bërë që huamarrja me instrumentin e bonove të thesarit të shërbejë jo vetëm për maturimin e bonove të thesarit gjatë vitit 2011, por dhe për financim deficitit, ashtu siç konfirmojmë dhe për huamarrjen e obligacioneve.

Portofoli i bonove të thesarit në vlerë nominale në fund të vitit 2011 është 255,414,210 milionë lekë, kundrejt 243,593.7 milionë lekë në vitin 2010. Kjo sasi është më e lartë gjithashtu nga portofoli i viteve 2009, 2008 dhe 2007. Pra, *në vitin 2011, ka një tendencë rritjeje drejt huamarrjes me afate më të gjata brenda huamarrjes me bono thesari.*

Struktura e bonove të thesarit, referuar totalit të bonove të thesarit të emetuara në lekë prej 341,201.2 milionë lekë me vlerë nominale dhe çmim blerje prej 323,944.1 milionë lekë, sipas afatit të maturimit të tyre, paraqitet si më poshtë:

**a) Me afat maturimi 3/mujor**, për vitin 2011, janë zhvilluar 12 ankande me vlerë nominale *48,068.8 milionë lekë* ose 11.7% ndaj totalit, ku për vitin 2010 ankandet 3/mujore paraqiten në një numër prej 12 ankande dhe me vlerë *76,585.9 milionë lekë* ose 21.2% ndaj totalit. Pra për vitin 2011, *bonot e thesarit me afat maturimi 3/mujor rezultojnë me një ulje të konsiderueshme në përqindje dhe në vlerë në krahasim me vitin 2010.* Kjo ulje thellohet më shumë duke u krahasuar dhe me vitin 2009.

**b) Me afat maturimi 6/mujor**, për vitin 2011 janë zhvilluar 14 ankande me vlerë nominale 93,788.51 milionë lekë ose 27.49% ndaj totalit, ku për vitin 2010 ankandet 6/mujore kanë qenë në numër 12 ankande, me një vlerë prej 95,150.72 milionë lekë ose 26.3% ndaj totalit. Nga krahasueshmëria rezulton se, *ankandet 6/mujore paraqiten me tendencë ulje në vlerë dhe një tendencë në rritje në përqindje ndaj totalit, krahasuar me një vit më parë.* Kjo gjendje është paraqitur për këto ankande dhe për vitin 2010 krahasuar me vitin 2009.



c) *Me afat maturimi 12/mujor*, për vitin 2011 janë zhvilluar 25 ankande me vlerë nominale 202,797.8 milionë lekë ose 59.44% ndaj totalit, ku për vitin 2010 numri i ankandeve ka qenë 24 me një vlerë prej 186,233.9 milionë lekë ose 51.5% ndaj totalit. Pra, *ankandet e bonove të thesarit 12/mujore për vitin 2011 paraqiten me rritje në përqindje dhe në vlerë absolute, në krahasim me vitin 2010*. Po kështu, dhe në krahasim me vitin 2009.

o *Ankandet në Euro*, për vitin 2011 janë zhvilluar 2 ankande bono thesari në Euro: 1 me afat maturimi 9/mujor në shumën 2,456.2 milionë lekë dhe 1 me afat maturimi 12/mujor në shumën 1,234.5 milionë lekë. Shuma e emetimit të ankandeve në Euro me vlerë nominale është 3,690.7 milionë lekë dhe me çmim blerjeje 3,501.7 milionë lekë.

*Gjatë vitit 2011, si dhe gjatë vitit 2010, shikohet tendenca drejt huamarrjes me bono thesari me afat maturimi 6/mujore dhe një/vjeçare, ku spikasin ankandet 12/mujore.*

o *Tregu primar i obligacioneve.*

Gjatë vitit 2011, nga MF në financimin e borxhit të brendshëm është përdorur dhe instrumenti i obligacioneve, i cili si dhe për vitin 2010, ka qenë instrument me afat maturimi 2, 3 dhe 5/vjeçar. Shuma e totale e obligacioneve të emetuara për këtë vit është 61,921.2 milionë lekë, kundrejt 56,113.2 milionë lekë emetim në vitin 2010.

a) *Emetimi i obligacioneve me afat maturimi 2/vjeçar* ka qenë 39,740.8 milionë lekë për 12 ankande, kundrejt 35,400 milionë lekë në vitin 2010. Blerja e obligacioneve 2/vjeçare ka qenë më pak se shuma e shpallur për emetim nga MF. Kjo ka ndodhur për faktin se *kërkesa e tregut ka qenë më e vogël se shuma për emetim* prej 42,450 milionë lekë, e ndodhur kjo në ankandet 2/vjeçare të zhvilluara në mars, nëntor dhe dhjetor. Gjatë vitit 2011, janë maturuar obligacione 2/vjeçare 35,557 milionë lekë, *pra shuma e maturimit është më e vogël se emetimi i tyre. Diferenca maturimit është përdorur për financim deficiti.*

b) *Emetimi i obligacioneve 3/vjeçare, në vitin 2011 paraqitet me ulje në krahasim me vitin 2010 dhe 2009.* Kjo edhe për faktin e sasisë së shpallur për emetim nga MF, e cila ka qenë në nivele më të ulta. Shuma e emetuar është 5,623.6 milionë lekë, kundrejt 5,650 milionë lekë të shpallur. Edhe këto ankande nuk janë realizuar në masën 100%, për efekt të kërkesës më të vogël të tregut në ankandin e zhvilluar në muajin prill. Këto ankande janë realizuar vetëm tre herë gjatë vitit 2011. Gjatë këtij viti, janë maturuar obligacione me afat maturimi 3/vjeçar në shumën 1,850 milionë lekë.

c) *Për vitin 2011, janë emetuar 5 ankande obligacionesh me afat maturimi 5/vjeçar*, ku nga këto me interes të ndryshueshëm 4 ankande dhe 1 ankand me interes fiks, në shumën e emetuar prej 16,556.8 milionë lekë, kundrejt shumës së shpallur prej 17,500 milionë lekë. Ankandet e obligacioneve 5/vjeçare janë emetuar më shumë se ankandet 5/vjeçare të organizuara në vitin 2010. Gjatë vitit 2011 ka filluar maturimi i këtyre ankandeve dhe ky maturim ka qenë në shumën 6,360 milionë lekë.

Pra, për vitin 2011, MF ka realizuar *huamarrje me vlerë nominale (bono thesari lekë + Euro dhe obligacione) në tregun e brendshëm në shumën 406,813.1 milionë lekë kundrejt 417,497 milionë lekë në vitin 2010, ndërkohë që janë maturuar (bono thesari dhe obligacione) me vlerë nominale në shumën 379,064.4 milionë lekë kundrejt 408,167 milionë lekë në vitin 2010, dhe huazimi neto i huamarrjes së*

*brendshme rezulton 27,748.7 milionë lekë në vlerë nominale dhe huazimi neto me çmim blerje 28,105.5 milionë lekë.*

Në tregun e letrave me vlerë pjesëmarrësit kryesor në ankandet e bonove të thesarit mbeten *BSH-së*, e cila ka investuar për këtë vit 37.9% të totalit të bonove të thesarit dhe në totalin e emetimit në tregun primar (bono dhe obligacione) kjo përqindje shkon tek 32.13%, *pra pjesëmarrja e saj është më e vogël se një vit më parë*. Megjithatë, *përsëri BSH-së dominon tregun e letrave me vlerë të Qeverisë në tregun primar*. Me përqindje të lartë pas BSH-së paraqitet Raiffeisen Bank me 12.01%, BKT 7.5%, Intesa SanPaulo 4.9%, Alfa Bank 3.84%, Tirana Bank 2.91%, Agjencia e Sigurimit të Depozitave 4.57% etj.

Gjatë vitit 2010 është rritur përqindja e pjesëmarrësve me kërkesa jo konkurruese “non competitive” (ku përveç individëve janë paraqitur dhe shoqata të ndryshme). Pjesëmarrja e tyre ka arritur në 17.74%, kurse individ me kërkesa konkurruese (competitiv) 0.30%. *Vetë individët paraqiten në nivele më të larta se një vit më parë.*

Kurse, *në tregun e obligacioneve*, pjesëmarrësit kryesorë janë *Raiffeisen Bank* e cila mbizotëron tregun e obligacioneve me 65.6%, kundrejt 59% në vitin 2010, BKT me 12.3%, Intesa SanPaulo 7.47%, Banka Societa Generale 5.43%, Union Bank 3.39% etj.

Për vitin 2011, *karakteristikë ka qenë niveli i yield-it, i cili vazhdon të jetë më i lartë se niveli mesatar i depozitave bankare*. Gjatë vitit, këto nivele janë paraqitur me ndryshueshmëri për të tre llojet e bonove të thesarit. *Luhatjet nga ankandi në ankand kanë rezultuar referuar raportit kërkesë-ofertë dhe domosdoshmërisë së marrjes së huamarrjes së brendshme*. Nga MF në disa raste është refuzuar kërkesa e blerjes së bonove të thesarit dhe blerja e tyre është realizuar nën shumën e shpallur të saj, për arsyen e nivelit të lartë të yield-it të paraqitur nga blerësit. *Nivelet e yield-eve gjatë vitit 2011 kanë qenë më të larta se sa në fillim viti për bonot e thesarit 3/mujore dhe 12/mujore, kurse për bonot e thesarit 6/mujore ulja nën nivelin e yield-it të fillim vitit ka ndodhur vetëm në muajin dhjetor 2011*. 6/mujori i parë i vitit 2011, është karakterizuar nga rritja e yield-eve, si për bonot 3/mujore ashtu dhe 6/mujore, kurse për bonot 12/mujore kjo rritje ka vazhduar deri në muajin shtator.

Në ndryshim nga bonot e thesarit, *niveli i interesit të depozitave ka ardhur duke u ulur, në krahasim me fillim vitin, sidomos për depozitat 12/mujore*, kurse për depozitat 3/mujore dhe 6/mujore ka pasur luhatje në ngritje të nivelit të interesit krahasuar me fillim vitin. Gjithashtu, theksojmë ndryshimin e konsiderueshëm midis niveleve të yield-eve me interesat e depozitave. Niveli mesatar i interesave të depozitave bankare dhe niveli mesatar i yield-it për vitin 2011 (marrë këto të dhëna nga raportet statistikore të BSH-së), krahasuar me vitin 2010, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*Në përqindje*

Muaji	3/mujore		6/mujore				12/mujore					
	Niveli yield-it		Niveli int. dep.bank.		Niveli yield-it		Niveli int. dep.bank.		Niveli yield-it		Niveli int. dep.bank.	
	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010
Janar	-	-	4.21	5.06	6.32	7.48	5.10	5.57	6.83	8.99	5.98	6.77
Shkurt	5.21	6.27	4.25	4.94	6.38	7.46	4.86	5.64	6.95	8.88	5.89	6.74
Mars	5.35	6.22	4.14	4.67	6.72	7.39	4.82	5.48	7.27	8.65	5.80	6.6

Muaji	3/mujore				6/mujore				12/mujore			
	Niveli yield-it		Niveli int. dep.bank.		Niveli yield-it		Niveli int. dep.bank.		Niveli yield-it		Niveli int. dep.bank.	
	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010
Prill	-	6.04	<b>4.21</b>	4.75	<b>6.84</b>	7.30	<b>4.83</b>	5.45	<b>7.41</b>	8.44	<b>5.90</b>	6.59
Maj	<b>5.47</b>	5.9	<b>4.13</b>	4.73	<b>6.82</b>	7.15	<b>4.94</b>	5.43	<b>7.36</b>	8.02	<b>5.87</b>	6.46
Qershor	<b>5.65</b>	5.86	<b>4.15</b>	4.62	<b>6.80</b>	7.12	<b>4.77</b>	5.42	<b>7.54</b>	7.91	<b>5.71</b>	6.39
Korrik	-	5.86	<b>4.39</b>	4.48	<b>6.82</b>	7.11	<b>4.85</b>	5.46	<b>7.69</b>	7.94	<b>6.82</b>	6.39
Gusht	<b>5.61</b>	5.74	<b>4.21</b>	4.49	<b>6.78</b>	7.03	<b>4.84</b>	5.24	<b>7.68</b>	7.86	<b>5.87</b>	6.29
Shtator	<b>5.62</b>	5.59	<b>4.41</b>	4.56	<b>6.77</b>	6.98	<b>4.87</b>	5.25	<b>7.68</b>	7.75	<b>5.92</b>	6.27
Tetor	-	-	<b>4.23</b>	4.41	<b>6.49</b>	6.8	<b>4.89</b>	5.25	<b>7.50</b>	7.71	<b>5.89</b>	6.31
Nendor	<b>5.49</b>	5.51	<b>4.14</b>	4.49	<b>6.44</b>	6.7	<b>4.84</b>	5.22	<b>7.40</b>	7.55	<b>5.85</b>	6.15
Dhjetor	<b>5.31</b>	5.29	<b>4.06</b>	4.42	<b>6.23</b>	6.41	<b>4.77</b>	5.16	<b>6.95</b>	7.09	<b>5.82</b>	6.07

Nga tabela e mësipërme rezulton se gjatë vitit 2011, nivelet e yield-eve paraqiten me tendencë rritje në 7 muajt e parë të vitit dhe në muajt pauses me luhatje në ngritje dhe ulje. Kurse, për depozitat bankare, karakteristikë ka qenë luhatja me ngritje dhe ulje e nivelit të interesit gjatë gjithë vitit, madje, tendenca e tyre është drejt uljes.

Një pamje më e plotë e përqindjeve të interesave për periudhën fillim viti dhe fund viti, si dhe diferenca ndërmjet tyre, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në përqindje

Emërtimi	Diferenca e interesave fillim dhe fund viti 2011					
	Bono thesari			Depozita bankare		
	Fillim 2011	Fund 2011	Diferenca	Fillim2011	Fund 2011	Diferenca
3/mujore	5.21	5.31	+ 0.1	4.21	4.06	- 0.15
6/mujore	6.32	6.23	- 0.09	5.10	4.77	- 0.33
12/mujore	6.83	6.95	+ 0.12	5.98	5.82	- 0.16

Nga këto të dhëna, konstatohet dhe njëherë fakti se, interesat e bonove të thesarit vazhdojnë të kenë përqindje më të lartë se sa interesat e depozitave bankare.

Tendenca e interesave të bonove të thesarit dhe depozitave bankare për disa vite rresht, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Norma e interesit	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Norma e depozitave 3/mujore	3.83	3.88	4.12	5.13	5.05	4.64	4.22
Norma bonove të thesarit 3/mujore	5.42	6.25	6.32	6.27	6.30	5.29	5.31
Norma e depozitave 6/mujore	4.60	4.53	4.83	5.72	5.74	5.38	4.87
Norma bonove të thesarit 6/mujore	6.91	7.18	7.41	7.45	7.52	6.41	6.23
Norma e depozitave 12/mujore	5.08	5.23	5.67	6.93	6.78	6.40	5.87
Norm bonove të thesarit 12/mujore	6.91	7.88	8.26	8.56	9.14	7.09	6.95

Nga këto të dhëna të marra nga BSH-së, normat e depozitave paraqesin normat mesatare të ponderuara vjetore të depozitave, gjithashtu, normat e bonove të thesarit paraqesin normat mesatare të ponderuara të interesit të ofertave të pranuarra për periudhën e fundit të vitit.

BSH-së, nëpërmjet Këshillit Mbikëqyrës të saj, për zhvillimin e ankandëve të repove (ankande të shitjes dhe të blerjes të likuiditeteve të lira në sistemin bankar), ka marrë vendimet përkatëse për përcaktimin e normës së interesit të tyre. Kjo normë ka qenë në nivelet më të ulëta se sa gjatë vitit 2010, dhe sidomos në fund të vitit 2011, ku me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 76, datë 30/11/2011, kjo

*normë interesi u ul në nivelin e 4.75%, dhe që është përqindja e interesit të repove më e ulët në tre vitet e fundit.*

Të dhëna më të plota për treguesit e sistemit bankar në drejtim të huamarrjes së brendshme për vitin 2011, si dhe ecurinë e treguesit të nivelit mesatar të yield-it të bonove të thesarit, në krahasueshmëri me normat mujore të repove, jepen në tabelën e mëposhtme:

*Në përqindje*

<i>Muajt e vitit</i>	<i>Niveli mesatar i yield-it të bonove të thesarit</i>			<i>Normat mujore të repove</i>		
	<i>Viti 2011</i>	<i>Viti 2010</i>	<i>Viti 2009</i>	<i>Viti 2011</i>	<i>Viti 2010</i>	<i>Viti 2009</i>
Janar	<b>6.57</b>	8.23	7.53	<b>5.00</b>	5.25	5.75
Shkurt	<b>6.18</b>	7.53	7.44	<b>5.00</b>	5.25	5.75
Mars	<b>6.45</b>	7.42	7.59	<b>5.25</b>	5.25	5.75
Prill	<b>7.12</b>	7.26	7.70	<b>5.25</b>	5.25	5.75
Maj	<b>6.55</b>	7.02	7.70	<b>5.25</b>	5.25	5.75
Qershor	<b>6.66</b>	6.96	7.76	<b>5.25</b>	5.25	5.75
Korrik	<b>7.25</b>	6.97	7.75	<b>5.25</b>	5.25	5.75
Gusht	<b>6.69</b>	6.87	7.75	<b>5.25</b>	5.00	5.75
Shtator	<b>6.69</b>	6.77	7.79	<b>5.25</b>	5.00	5.75
Tetor	<b>6.99</b>	7.25	7.84	<b>5.00</b>	5.00	5.25
Nëntor	<b>6.44</b>	6.58	7.76	<b>5.00</b>	5.00	5.25
Dhjetor	<b>6.16</b>	6.26	7.65	<b>4.75</b>	5.00	5.25

Në muajt janar, prill, korrik dhe tetor nuk janë zhvilluar ankande bonosh 3/mujore, kështu norma e interesit për këto muaj paraqitet me mesataret e bonove të thesarit 6/mujore dhe 12/mujore. Megjithatë, pavarësisht se norma e interesit mesatare e bonove është më e ulët krahasuar me vitin 2010, *përsëri ajo paraqitet me diferencë të konsiderueshme me normat e interesit të repove për çdo muaj.*

Gjithashtu, referuar tabelës së mësipërme rezultojnë se *normat e repove në vitet 2010 dhe 2011, janë afërsisht të barabarta. Madje, për vitin 2011, ulja rezultojnë në muajin dhjetor.* Kjo ulje ka pasur ndikimin e vet dhe në uljen e interesit të bonove të thesarit 3, 6 dhe 12/mujore të huazuara në muajin dhjetor 2011.

#### ***VI.1.e Mbi borxhin e garantuar në tregun e brendshëm.***

Në Aktin normativ nr. 4, datë 14.12.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011” të ndryshuar, është parashikuar që:

- Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, është 6,926 milionë lekë.

*Në milionë/lekë*

<i>Nr.</i>	<i>PËRSHKRIMI</i>	<i>Plani</i>	<i>Fakti</i>	<i>Diferenca (P-F)</i>
<b>1.</b>	<b>Garancitë e shtetit në dobi të palëve të treta përfituese</b>	<b>6,926</b>	<b>2,891</b>	<b>4,035</b>
1.a	Garanci të brendshme	4,500	3,106	1,394
1.b	Garanci të huaja	2,426	- 215	2,641

Për vitin 2011 janë emetuar letër garancitë nr. 23770, datë 20/12/2011 me vlerë 1,500 milionë lekë dhe nr. 23770, datë 28/12/2011 me vlerë 1,600 milionë lekë.

Nga shqyrtimi i relacionit të projektligjit rezultojnë se ndryshimi i kufijve të borxhit të garantuar vjen për efekt të dy faktorëve (citimi i relacionit):

- Emergjencia dhe nevoja detyrojnë KM të miratojë aktin normativ që ka të bëjë me situatën e vështirë financiare më të cilën po përballet KESH sh.a., e cila ka ardhur

kryesisht për:

- Mungesë të rreshjeve dhe domodoshmëria e importit të energjisë elektrike të kërkuar nga CEZ shpërndarje, për kërkesën e planifikuar në fillim të vitit.

Konstatohet se për lëshimin e këtyre garancive qeveritare nuk janë ndjekur procedurat nga MF, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9665 datë 18/12/2006 “Për huamarrjen shtetërore dhe garancitë shtetërore të huasë në RSH”, neni 38.c, sipas së cilës:

“Ministri i Financave miraton dhënien e garancisë shtetërore të huasë pasi shqyrton .....marrëveshjen e mirëkuptimit të nënshkruar nga huamarrësi. Nënshkrimi i marrëveshjes së garancisë dhe i marrëveshjes së mirëkuptimit bëhet në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave”.

*Auditimi ka konstatuar se për të dy garancitë e lartpërmendura nuk rezultojnë vendime të KM, si dhe mungon marrëveshja e mirëkuptimit të huamarrësit.*

Përsa i përket analizës së riskut sipas dokumentacionit të paraqitur grupit të auditimit “Analizë financiare e KESH sh.a., portofoli i kredive”, theksohet se: Vlerësojmë se kjo kompani nuk ka aftësi financiare për huamarrje të re”.

o Mbi huamarrjen vendore

Gjate vitit 2010 janë miratuar hua dhe janë kryer disbursimet në vitin 2010 dhe 2011, si më poshtë vijon:

Në mijë/lekë

INSTITUCIONI	Vlera e Huasë	Maturimi (në vite)	Viti 2010 Disbursuar	Viti 2011 Disbursuar
Bashkia Lezhë	120,000.00	6	-	8,241.00
Komuna Petrelë	15,000.00	6	6,000.00	3,000.00
Bashkia Pogradec	113,000.00	10	18,000.00	18,000.00
Bashkia Korçë	100,000.00	10	45,000.00	23,800.00
Bashkia Vlorë	420,000.00	10	59,702.00	0.00
Bashkia Elbasan	800,000.00	10	19,203.00	32,033.00
<b>Gjithsej:</b>	<b>1,568,000.00</b>		<b>147,905.00</b>	<b>85,073.00</b>

Sa më sipër, konstatohet se gjatë vitit 2010 janë miratuar gjithsej 6 marrëveshje (5 bashki dhe 1 komunë) në vlerën 1,568 milionë lekë, ndërsa për vitin 2011 nuk janë miratuar hua të reja për qeverisjen vendore.

Nga vlera e huasë, në vitin 2010 janë disbursuar 147.9 milionë lekë dhe në vitin 2011 gjithsej 85 milionë lekë. Masa e miratuar për disbursim në nivel vjetor për njësitë e qeverisjes vendore, është kryer në zbatim të urdhërit të Ministrit të Financave nr. 17752, datë 28/12/2010, për një disbursim vjetor jo më të lartë se 2.5% të shpenzimeve buxhetore të vitit 2009. Të dhëna më të detajuara paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

INSTITUCIONI	Shpenzimet buxhetore	Dibursime 2011	
	Viti 2009	Miratuar (2.5%)	Disbursuar
Bashkia Lezhë	326,558.00	8,164.00	8,241,19
Komuna Petrelë	119,800.00	2,995.00	3,000,00
Bashkia Pogradec	395,464.00	9,886.00	18,000.00
Bashkia Korçë	952,004.00	23,800.10	23,800.00
Bashkia Vlorë	1,194,810.00	29,870.25	0.00
Bashkia Elbasan	1,297,590.00	32,439.75	32,032,52
<b>Gjithsej:</b>	<b>4,286,226.00</b>	<b>107,155.65</b>	<b>85,073.71</b>

Nga këto të dhëna konstatohet se, për Bashkinë Pogradec, nga Ministri i Financave për disbursim gjatë vitit 2011 është miratuar vlera 9,886 mijë lekë, në fakt nga banka është disbursuar dyfishi i shumës së miratuar, *duke shkelur në këtë mënyrë kriterin e miratuar në urdhërin e Ministrit të Financave nr. 17752, datë 28/12/2010*. Nga auditimi ka rezultuar se, për të dy vitet buxhetore 2010 dhe 2011, pagesat e principalit (shërbimi i borxhit) kanë qenë respektivisht 644 mijë lekë dhe 14,450 mijë lekë.

Me poshtë paraqitet stoku i borxhit vendor, në nivel njësie qeverisjeje vendore, si dhe pagesat e kryera për shërbimin ndaj tij:


*Në mijë/lekë*

<i>Institucioni vendor</i>	<i>Disbursime 30/12/2010</i>	<i>Pagesa (Principal) 30/12/2010</i>	<i>Stoku 30/12/2010</i>	<i>Disbursime 30/12/2011</i>	<i>Pagesa (Principal) 30/12/2011</i>	<i>Stoku 30/12/2011</i>
Korçë	45,000.00	644.69	44,355.32	23,800.00	4,172.12	63,983.19
Pogradec	18,000.00	-	18,000.00	18,000.00	2,283.28	33,716.72
Vlorë	59,702.55	-	59,702.55	-	4,477.69	55,224.86
Petrelë	6,000.00	-	6,000.00	3,000.00	-	9,000.00
Elbasan	19,203.50	-	19,203.50	32,032.52	2,978.48	48,257.54
Lezhë	-	-	-	8,241.19	545.94	7,695.25
<b>Totali:</b>	<b>147,906.05</b>	<b>644.69</b>	<b>147,261.36</b>	<b>85,073.71</b>	<b>14,457.51</b>	<b>217,877.57</b>

○ **Mbi shpenzimet për shërbimin e borxhit të brendshëm.**

Per vitin 2011, *shpenzimet për shërbimin e borxhit të brendshëm u planifikuan në shumën 38,700 milionë lekë, në fakt janë realizuar 34,253 milionë lekë, ose në nivelin 88.5%, me një mosshpenzim kundrejt kuotave të planifikuara në shumën 4,400 milionë lekë. Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2011, ajo ze 2.61%.*

Më poshtë paraqitet tendenca e stokut të borxhit, si dhe shpenzimet e shërbimit të tij në disa vite:



○ Në lidhje me *saktësinë e regjistrimit dhe ligjshmërinë e veprimeve për kryerjen e pagesave për shërbimin ndaj borxhit të brendshëm*, në mbështetje të nenit 46, të ligjit nr. 9665, datë 18/12/2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në RSH", nga MF është mbajtur regjistri i borxhit të brendshëm dhe përditësimi i tij.



Nga grupi i auditimit është kërkuar dhe audituar ky regjistër për çdo tremujor të vitit 2011, nga ku rezultoi se, *të dhënat e regjistrit përputhen me të dhënat e huamarrjes së brendshme dhe të maturimit të saj për periudhat e mësipërme.*

Gjithashtu, nga specialisti i Drejtorisë së Regjistrimit dhe Pagesave janë mbajtur aktrakordimet me Sektorin e Transaksioneve Qendrore për pagesat e borxhit të brendshëm për çdo muaj të vitit. *Nga këto aktrakordime nuk pasqyrohen deviacione. Rakordim me të dhënat e borxhit është bërë dhe me BSH-së, Drejtorinë e Operacioneve Monetare.*

Në zbatim të Rekomandimit të lënë nga KLSH në auditimin për “Raportimin e Borxhit Publik”, Ministri i Financave ka nxjerrë udhëzimin nr. 22, datë 5/10/2011 “Për publikimin e të dhënave të borxhit të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimin e Raportit të tij”. Nga MF (Drejtoria e Regjistrimit dhe Pagesave), i është qëndruar korrekt zbatimit të nenit 3 “Afatet e Publikimit” dhe nenit 4 “Kompetencat për publikimet” të udhëzimit të lartpërmendur, për raportimet e 9/mujorit të vitit 2011 dhe si vijtor.

## VI.2 BORXHI I JASHTËM SHETETËROR DHE SHËRBIMI I TIJ.

Bazuar në Ligjin nr. 10496, datë 22/12/2011 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 14/12/2011 të KM “Për një ndryshim në Ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011” të ndryshuar, dekretuar me dekretin e Presidentit nr.7271, datë 10/1/2012, kufijtë e rritjes së borxhit shtetëror janë përcaktuar si më poshtë vijon:

“Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2011, është *84,690 milionë lekë*, i detajuar si më poshtë:

1. Për huamarrjen vjetore neto, deri në 29,312 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja, deri në 45,800 milionë lekë.
3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, 6,926 milionë lekë.
4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të huaja të papaguara, është 2,652 milionë lekë.

*Në milionë/lekë*

Nr.	PËRSHKRIMI	Plani	Fakti	Diferenca (P-F)
<b>I.</b>	<b>Totali i Borxhit të Jashtëm</b>	<b>50,878</b>	<b>25,783</b>	<b>25,095</b>
1.	Huamarrje financim projekte të huaja	45,800	26,511	19,289
2.	Garancitë e shtetit në dobi të palëve të treta përfituese	2,426	- 215	2,641
3.	Borxhi i riskeduluar	2,652	- 13	3,165

Nga analiza e kategorive të borxhit të jashtëm rezulton se, *shtesa e borxhit për efekt të financimit të projekteve është 26,511 milionë lekë, duke reflektuar një mosrealizim të parashikimeve prej 19,289 milionë lekë. Rreth 67.5% e kësaj shume ka rezultuar si efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të aplikuar gjatë planifikimit të shtesës së borxhit me atë faktike (nga 145 All/Euro në planifikim, në 138.93 në fakt në fund të vitit 2011), ndërsa pjesa tjetër për efekt të disbursimeve në rreth 45 milionë lekë më pak se sa parashikimi. Konkretisht, vlerësimet e ndikimit të kursit të këmbimit (145 All/Euro - 138.9 All/Euro = 6.1 x 2,117 milionë Euro = 12,900*

milionë lekë. Përsa i përket disbursimeve në plan janë parashikuar 45 milionë Euro më shumë (248 milionë Euro plan minus 204 milionë Euro në fakt), me një efekt prej 6,250 milionë lekë (45x138.93 kursi këmbimit).

Të dhëna më të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Viti 2010</i>	<i>Viti 2011</i>	<i>Shtesa e borxhit të jashtëm në milionë/lekë</i>
1.	Borxhi neto kreditor shumpalësh dhe dypalësh	256,575 1,848.92x138.77	283,086 2,037.6x138.93 2,037.6-1,848.9 188.7	26,511
2.	Borxhi neto i garantuar	39,873 287.34x138.77	39,658 285.46x139.93	- 215
3.	Borxhi neto i riskeduluar	11,549.8= 83.23x138.77	11,036.6 79.44x138.93	- 513
	<b>Totali i Borxhit Neto:</b>	<b>307,998.6</b> <b>2,219.49x138.77</b>	<b>333,779</b> <b>2,402.4x138.93</b>	<b>25,783</b>

Në shtesën e borxhit të jashtëm shtetëror prej 26,511 milionë lekë kanë ndikuar:

1. Shtesa e disbursimeve prej 26,185 milionë lekë (188.7x138.7).

2. Diferenca e kursit të këmbimit 326 milionë lekë (138.77 -138.93=0.16 x 2,037 milionë Euro).

Gjatë viti 2011, rezultojnë disbursime për financimin e projekteve, nga ku rreth 120 milionë Euro janë disbursuar në sektorin e transportit, 33 milionë Euro për sektorin e energjisë, 10 milionë Euro për sektorin e shëndetësisë, 5 milionë Euro për sektorin e arsimit etj.

*Përsa i përket garancive*, gjatë vitit 2011 borxhi neto rezulton në 285.46 milionë Euro nga 287.34 milionë Euro rezultuar në vitin 2010, duke rezultuar me një ulje prej -1.88 milionë Euro.

Gjatë vitit 2011, rezulton të jenë tërhequr rreth 16 milionë Euro, nga i cili rreth 9 milionë Euro nga EBRD, 4 milionë nga Gjermania (kreditor) etj.

*Për riskedulimet* konstatohet ulje e borxhit neto dhe mosrealizim të shtesës së planifikuar për efekt të mosbërjes efektive të marrëveshjeve të planifikuara, ndërkohë është bërë efektive gjatë vitit 2011 marrëveshja me Serbinë, që reflekton një rritje të borxhit me 5.94 milionë Euro.

#### **VI.2.a Mbi rregullshmërinë e evidentimit të marrëveshjeve të nënshkrimit dhe subjekteve që kanë marrë garanci, si dhe shlyerja e detyrimeve të tyre.**

Gjatë vitit 2011, janë lidhur 15 marrëveshje të reja nënshkrimit (6 marrëveshje kredie dhe 9 marrëveshje grant). Nga këto marrëveshje, rezultojnë marrëveshje nënshkrimit të lidhura midis MF dhe nënshkrimit, referuar marrëveshjeve të miratuara midis Qeverisë së Shqipërisë dhe kreditorit, kryesisht në Infrastrukturën e ujësjellës kanalizimeve dhe në projekte për financimin e “Rrugëve dytësore dhe lokale”, “Fondi për investime sociale” dhe “Mbrojtje e ambientit të Liqenit të Ohrit”. Përfituesit dhe financimi i fondeve për marrëveshjet e nënshkrimit për vitin 2011, paraqiten si më poshtë vijon:



<i>Përfituesit e nënshkruar</i>	<i>Fondi mbi bazën e të cilit është lidhur marrëveshja</i>	
	<i>Kredi</i>	<i>Grant</i>
Ujësjetellës Kanalizime Gjirokaster	4,000,000 Euro	2,310,750 Euro
Ujësjetellës Kanalizime Sarandë, infrastruktura bashkiake	4,000,000 Euro	
Ujësjetellës Kanalizime Fier	4,900,000 Euro	2,310,750 Euro
Ujësjetellës Kanalizime Lezhë	3,100,000 Euro	
Ujësjetellës Kanalizime Pogradec -“Mbrotjtja e ambjentit të Liqenit të Ohrit, Kanalizime Pogradec, faza III”	10,000,000 Euro	3,456,250 Euro
(SHRMM), Korçë (Agjencia e Zbatimit të Projektit) -“Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore”		2,000,000 Euro
Ujësjetellës Kanalizime Berat-Kuçovë -“Shërbime Konsulence për forcimin e kapacitetit të Ujësjetellës Kanalizimeve Berat-Kuçovë”		770,000 Euro
Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) -“Fondi i investimeve sociale IV”. -“Furnizimi me ujë, Faza II” -“Për shërbime konsulence për Projektin e rrugëve dytësore dhe lokale”	20,000,000 Euro Marrëveshje bazë kredie	8,820,000 Euro 1,500,000 Euro 1,000,000 Euro
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetellës Kanalizime (DPUK) “Zhvillimin e një Master Plani për furnizimin me Ujë dhe për Kanalizime për Shqipërinë”.		2,000,000 Euro
<b>SHUMA:</b>	<b>46,000,000</b>	<b>22,169,750</b>

Nga grupi i auditimit u audituan procedurat e evidentimit dhe regjistrimit të marrëveshjeve të reja të nënshkruar të lidhura gjatë vitit 2011, ku rezultoi se janë hedhur në programin DAMFAS marrëveshjet e nënshkruar që rrjedhin nga kredi të lidhura pra 6 marrëveshje nga 15 gjithsej (9 marrëveshje janë grant). Gjithashtu, marrëveshjet e nënshkruar janë të regjistruara dhe në programin Exel, për të gjitha marrëveshjet edhe për ato që janë grant. Referuar paraqitjes të të dhënave në programin DAMFAS për nënshkruar të lidhura në vitet e tjera, rezultoi se ky proces i hedhjes së të dhënave në këtë program ka filluar, *por përfundimi i tij kërkon kohë (sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Regjistrimit dhe Pagesave). Ky proces është i rëndësishëm, ndaj duhet të përfundojë brenda afateve sa më të afërta.*

Nga auditimi për kryerjen e pagesave për principal dhe interesa të kryera, kjo e krahasuar dhe me njoftimet zyrtare të MF për kryerje pagesash rezultoi se, për vitin 2011 janë kryer arkëtimet për principal dhe interesa nga marrëveshjet e nënshkruar, në vlerë gjithsej 1,861,197.16 mijë lekë, kundrejt planit prej 2,648,455.08 mijë lekë (në këtë plan janë përfshirë detyrimet për vitin 2011).

Aktualisht plani i arkëtimeve që duhet përfshirë në të ardhurat në buxhet nga nënshkruar për vitin 2011, është në shumën 2,447,332.79 mijë lekë. *Diferenca midis planit të rezultuar në fillim të vitit me atë në fund të vitit, ka ardhur si rezultat i pamundësisë së parashikimit në mënyrë të saktë të nivelit të disbursimeve që do të realizohen gjatë vitit 2011, për rrjedhojë dhe pagesa e interesave për këto disbursime.* Likuidimi i detyrimeve për vitin 2011 rezultoi në nivelin 70% ose në shumën prej 1,861,197.16 mijë lekë. Në këtë shumë janë të përfshira dhe detyrimet e paguara prej 54,545.9 mijë lekë, që përfaqësojnë pagesa të prapambetura të viteve të mëparshme dhe të paguara gjatë vitit 2011 për interesa, të disa projekteve të KESH sh.a., projektit të “Rrugëve bashkiake”

Bashkia Tiranë dhe projekti i “Ujësjellësit Elbasan”, si dhe *shuma 52,509.11 mijë lekë që përfaqëson pagesa të prapambetura të viteve të mëparshme dhe të paguara gjatë vitit 2011 për principalet*, të projektit të “Rrugëve Bashkiake” Bashkia Tiranë dhe “IFAD III” për fondin e financimit të zonave malore.

Për vitin 2011 treguesit e planifikuar dhe të realizuar të të ardhurave nga nënhuaja, paraqiten si më poshtë vijon:

*Në mijë/lekë*

EMËRTIMI	Plani i detyrimeve për vitin 2011	Fakti i arkëtimit të detyrimeve gjatë vitit 2011			Likujduar detyrime të prapambetura gjatë vitit 2012
		Gjithsej	Arkëtuar në Depozitë Qeverie gjatë		
			Për detyrime të vitit 2011	Për detyrime prapambetura deri në vitin 2010	
Principal	2,080,233.90	1,426,986.41	1,374,477.30	52,509.11	122,271.50
Interesa	568,221.18	434,210.76	379,664.86	54,545.9	46,045.76
<b>Gjithsej:</b>	<b>2,648,455.08</b>	<b>1,861,197.17</b>	<b>1,754,122.16</b>	<b>107,055.01</b>	<b>168,317.26</b>

Shuma prej 168,317.26 mijë lekë në kolonën “Likujduar detyrime të prapambetura gjatë vitit 2012”, përfaqëson arkëtimet në “Depozitën e Qeverisë” për detyrimet nga marrëveshjet e nënhuave dhe garancive për principal e interesa për projektet:

a) Rrugët bashkiake BERZH, Bashkia Tiranë;

b) Projekte të Sh.a. OST për linjën 110 kV Shqipëria e Jugut (2 projekte) dhe linja e trasmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë;

c) Projekte të KESH sh.a. për projektet “Furnizimi me energji elektrike Shqipëri e Jugut (transhi i parë + transhi i dytë).

Nga auditimi rezultoi se, *këto pagesa janë kryer në janar të vitit 2012 dhe për këto arkëtime është kryer aktrakordimi me sektorin e transaksioneve qendrore në janar të vitit 2012.*

Për arkëtimet e bëra në “Depozitën e Qeverisë” për vitin 2011, referuar detyrimeve të rrjedhura dhe të paguara për principal dhe interesa, është realizuar aktrakordimi midis sektorit të “Menaxhimit të llogarisë qendrore dhe aseteve financiare” dhe sektorit të “Menaxhimit dhe raportimit borxhit të jashtëm”, për çdo muaj të vitit 2011. Nga auditimi rezultoi se, *ky rakordim paraqitet me një deviacion prej 1 mijë lekë me shifrat e paraqitura në pasqyrat e detyrimeve për principal dhe interesa (devijacion që ka rezultuar nga rumbullakimet përkatëse) dhe totali i arkëtimit nga nënhuaja sipas rakordimeve rezulton në shumën 1,426,986.42 mijë lekë për principalet dhe 434,210.75 mijë lekë për interesat.*

Nga auditimi i pagesave për interesa dhe principalet të marrëveshjeve të nënhuave sipas afatit si dhe shumës për t’u paguar, rezultoi se:

Sipas procedurës së caktuar, MF ka njoftuar në mënyrë shkresore subjektet huamarrës, duke përcaktuar dhe shumën për pagesë. Nga ana e huamarrësve duhen kryer pagesat sipas afateve dhe shumave për principalet dhe interesa. Nga auditimi i tyre rezultuan projekte që nuk kanë paguara detyrimet e tyre deri në fund të vitit 2011 në shumën 1,853,755 mijë lekë. Këtu përfshihen KESH sh.a. me një numër projektësh, 11 ujësjellësa në qytete të ndryshme të vendit përfshirë Bovillën, Hekurudha Shqiptare etj.

Deri më 16/5/2012 janë paguar disa nga detyrimet e papaguara deri në fund të vitit 2011, për disa projekte si:

- o Për KESH sh.a.

- Projekti “Furnizimi me energji elektrike Shqipëri e Jugut, transhi I”, paguar në janar 2012 shuma 50,682.81 mijë lekë dhe Projekti “Furnizimi me energji elektrike Shqipëri e Jugut, transhi II”, shuma 98,403.13 mijë lekë.

o *Për OST sh.a.*

- Projekti “Linja 110 kV Shqipëri e Jugut (500 mijë lekë)” paguar në janar 2012 shuma 86.83 mijë lekë.

- Projekti “Linja 110 kV Shqipëri e Jugut (10,750 mijë lekë)” paguar në janar 2012 shuma 1,866.87 mijë lekë.

- Projekti “Linja transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë (42 milionë lekë)” paguar në janar 2012 shuma 7,293.83 mijë lekë.

o *Për Bashkinë Tiranë*

- Projekti “Rehabilitimi i rrugëve të Tiranës” (BERZH), paguar në janar 2012 shuma 9,983.78 mijë lekë.

*Nga detyrimet e rezultuara se në fund të vitit 2011, në shumën 1,853,755.14 mijë lekë, janë paguar në janar të vitit 2012 shuma prej 168,317.25 mijë lekë dhe kanë mbetur të pa paguara deri më 16 maj 2012 gjithsej 1,685,437.89 mijë lekë.*

*Është për tu theksuar se, detyrimet e papaguara nga ndërmarrjet kundrejt buxhetit të shtetit në fund të vitit 2011, detyrime të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuave dhe garancive, janë shumë të larta në krahasim me këto lloj detyrime në fund të vitit 2010 në shumën totale 794,618.06 mijë lekë, ku nga këto 398,174.6 mijë lekë janë detyrime nga marrëveshjet e garancive.*

Nga auditimi i korrespondencës së mbajtur me ndërmarrjet që kanë lidhur marrëveshje garancie me MF rezultoi se, nga MF gjatë vitit 2011 është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme paraqitja e dokumentacionit financiar të tyre, gjendje që duhet të shoqërojë në çdo rast shkresat për aktivizimin e garancive, si rezultat i pamundësive për pagesë të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e huave me kreditorin. Disa nga subjektet përfituese, konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave, nuk paguan për efekte të gjendjes së saj financiare, po kështu Drejtoria e Përgjithshme e UK Tiranë, e cila ka të aktivizuara 5 marrëveshje garancie dhe nuk ka paguar për arsye të mungesës së likuiditetit dhe në disa raste për mungesë dokumentacioni. Nga këto subjekte, është paraqitur vetëm kërkesa se këto nuk kanë mundësi financiare dhe jo dokumentacioni që vërteton këtë gjë.

Referuar kërkesës së MF këto dokumentacione janë vënë në dispozicion, dhe sipas raportanalizës të sektorit ka rezultuar se Ujësjellës Kanalizime Krujë dhe Hekurudha Shqiptare në bazë të pasqyrave financiare të audituara, rezultojnë me pamundësi financiare për shlyerje të detyrimeve. Kurse, UK Tiranë, sipas të dhënave të pasqyrave financiare për periudhën 2007-korrik 2011, rezulton se ka nivel të lartë të detyrimeve të të tretëve të pa arkëtuara (të ardhura të arkëtueshme). Pra, *me një menaxhim më të mirë të nivelit të arkëtimit, detyrimet e borxhit si dhe ato afatshkurtra të ndërmarrjes do të ishin të likuiduara.*

Vlen të theksohet se, *MF me shkresat përkatëse i ka tërhequr vëmendjen subjekteve përfituese, duke cilësuar se shlyerja e pagesave të detyrimeve duhet të jetë parësore në radhën e detyrimeve të tyre.*

Kurse, lidhur me mungesën e dokumentacionit në Ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Tiranë për kreditë Italiane 22 miliardë lireta dhe 6 miliardë lireta, nuk i është dhënë drejtim, megjithëse ka një korrespondencë midis MPPT, MF, Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve dhe vetë Ujësjellës Kanalizime Tiranë. Mungesa e këtij dokumentacioni bëhet pengesë për kryerjen e pagesave në vazhdim, si

dhe kontabilizimin e shumave për t'u paguar. *Deri në momentin e kryerjes së auditimit nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret.*

Referuar nenit 43, të ligjit për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas, ku theksohet se: “Ministri i Financave duhet të ndërmarrë të gjitha masat e përcaktuara në këtë Ligj, në ligjet e tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përfituar nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë dhe kostot që lidhen me të”, grupi i auditimit të KLSH ka konstatuar se, aktualisht për marrëveshjet e garancive që janë aktive, *nuk ka marrëveshje mirëkuptimi*, pasi ato janë të lidhura para daljes së ligjit të mësipërm. Kështu që, *marrëdhëniet dhe dokumentacioni që kërkohet në mënyrë të herëpashërshme nga MF për efekte të kryerjes së pagesave dhe likuidimit të tyre në mënyrë të detajuar, nuk është i sanksionuar në akt nënligjor.*

*Marrëveshjet e mirëkuptimit nuk janë lidhur dhe për marrëveshjet e reja të garancive, që rezultojnë mbas daljes së ligjit.*

o *Në drejtim të marrëveshjeve të nënhuasë me ujësjellsat, vazhdon e njëjta situatë si dhe në vitin e kaluar,* ku argumentet kryesore vazhdojnë të jenë:

1. Gjendja e vështirë financiare për shkak të mosarkëtimit të faturave të ujit.
2. Mosarkëtimet kanë çuar në situatat e mosmbulimit të kostove dhe kjo në përgjithësi për të gjitha ndërmarrjet që paraqiten me detyrime.
3. Për disa projekte të financuar nga BEI dhe IDA, në disa ndërmarrje si Ujësjellës Kanalizime Lezhë, Sarandë dhe Durrës, megjithëse disbursimi ka vazhduar, këto ndërmarrje nuk paguajnë me argumentin se akoma nuk kanë bërë hyrje të aseteve apo për mungesë dokumentacioni, problem i trashëguar nga vitet e kaluara.

Referuar zbatimin të projekteve, *Njësitë e Zbatimit të Projekteve ku këto ujësjellës janë pjesë e implementimit të projektit, nuk kanë dërguar në Drejtoritë e ujësjellësve dokumentacionin përkatës, si dhe nuk kanë bërë hyrje të aseteve.* Për t'u përmendur Ujësjellës Kanalizime Sarandë dhe Lezhë për “Projektin bashkiak të furnizimit me ujë dhe kanalizime” të IDA dhe projektin “Infrastruktura ujore bashkiake” të BEI-t.

Ndër ujësjellësit që vazhdojnë të kenë detyrime pa paguar, përveç Lezhës dhe Sarandës, paraqesim ujësjellësit Kavajë, Lushnjë, Kuçovë, Durrës dhe Tiranë.

Në referencë të ligjit për huamarrjen, borxhin dhe garancitë shtetërore të huas, MF, *nuk ka bërë ndonjë përcaktim të veprimeve konkrete për të ardhmen për çdo subjekt të përfitimit të nënhuasë me detyrime të pa paguara.* Duhet theksuar se, për vitin 2011 janë lidhur marrëveshje të reja nënhuaje me disa nga ujësjellsat që në këtë periudhë vazhdojnë të jenë debitorë për detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ekzistuese të nënhuasë, si: Lezha, Fieri dhe Saranda. Ndonëse, për këto marrëveshje janë bërë analiza të riskut, ku janë përcaktuar risku i mospagesave në vazhdim prej këtyre subjekteve.

*Koment:* Në sqarimin e dhënë nga Drejtoria e Strategjisë dhe Riskut në MF, në lidhje me problemin e trajtuar më sipër, nga ana e saj theksohet se *mungon baza ligjore për ndërhyrje në llogaritë bankare të ujësjellësve*, dhe në këto kushte, *po shikohet mundësia e riskedulimit të këtyre kredive në mënyrë që të lehtësohen në pagesa këto subjekte*, ndërkohë që, *ndërmarrja e një inspektimi financiar do të saktësonte veprimet konkrete dhe në drejtim të mirmenaxhimit të fondeve publike.*

o *Në drejtim të monitorimit të projekteve, të cilët janë të lidhura me marrëveshje nënhuaje dhe garancie,* bazuar në materialet e audituar, paraqesim problematikën e konstatuar:

1. Tre kreditë e KfË-së të akorduara për projektin “Furnizimi me energji i Shqipërisë së Jugut”, nuk kanë pasur disbursim gjatë vitit 2011, si rrjedhojë e vështirësive të hasura në fillimin e projektit si:

- Vonesa në projektin e zbatimit me të cilin janë të lidhura nxjerrja e lejes së ndërtimit të projektit dhe vijimi i mëtejshëm me procedurat e shpronësimit.

- Probleme me komunat dhe bashkitë që preken nga kalimi i linjës (procesi i zgjatur i zgjedhjeve vendore, vonesa në marrjen e lejes së mjedisit).

2. Kredia me KfË për projektin “Linja 400 kV Tiranë-Prishtinë” nuk ka pasur disbursime gjatë vitit 2011, pasi ka patur probleme në procesin e tenderimit (procedura e përzgjedhjes së fituesit).

3. Kredia nr. 200 465 377 me KfË-në për projektin “Ujësjiellësi Pogradec” është në fazën përfundimtare dhe është duke u trajtuar çështja e fondeve të mbetura pa disbursuar.

4. Kredia nr. 21438 me EIB për projektin e Portit të Durrësit, është në diskutim e sipër përdorimi i fondeve të mbetura pa disbursuar nga kjo kredi.

5. Kredia nr. 36228 me EBRD për projektin “Zhvillimi i rrugëve bashkiake” nuk ka pasur disbursim gjatë vitit 2011, pasi ka pasur vonesa në tenderimin e komponentit “Qendra e Kontrollit të Trafikut” (vlëra e mbetur pa disbursuar i referohet këtij komponenti). Procesi i vlerësimit të ofertave dhe nënshkrimi i kontratës përfunduan në vitin 2012.

6. Kredia nr. F/ROT/AID-04/009/00 e Artigiancassas për projektin 5 Poliklinikat, nuk është kryer asnjë veprim për vitin 2011, si rrjedhojë e vonesave të gjata nga pala Italiane në shpalljen e datave të prokurimit.

7. Kredia nr. F/ROT/AID-04/006/00 me Artigiancassan për projektin e Zonave periferike të Tiranës, komponentët e tenderuar të projektit kanë përfunduar dhe janë marrë në administrim nga Bashkia Tiranë. Gjatë vitit 2011 ka qenë në diskutim përdorimi i shumës së mbetur papërdorur për komponentët e tjerë.

8. Kredia nr. F/ROT/AID-04/011/00 e Artigiancassan për projektin e rrugës Lushnjë-Fier, ku përfshihen financimi i ndërtimit dhe supervizionit të rrugës Lushnjë-Fier (i përfunduar), supervizioni i rrugës Levan-Vlorë (i përfunduar), si edhe supervizioni i Bypass Fier–Levan nuk ka pasur disbursim pasi pritet të zhvillohet tenderi.

#### **VI.2.b Mbi shpenzimet për shërbimin e borxhit të jashtëm.**

Bazuar në Ligjin për buxhetin e shtetit të vitit 2011, të ndryshuar, shërbimi i borxhit të jashtëm është planifikuar në total në vlerën 17,989 milionë lekë.


Të dhënat faktike të shpenzimeve të shërbimit të borxhit, paraqiten si më poshtë:

<i>Në milionë/lekë</i>						
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani</i>	<i>Fakti</i>	<i>Diferenca (P-F)</i>	<i>Realizimi në %</i>	<i>Në % ndaj PBB</i>
1.	Principal	9,851	7,613	2,238	77.3	0.58
2.	Interesa	8,138	6,868	1,270	84.4	0.52
<b>Gjithsej:</b>		17,989	14,481	3,508	80.5	1.1

Sa më sipër, shpenzimet për shërbimin e borxhit të jashtëm për vitin 2011, rezultojnë në shumën *14,481 milionë lekë kundrejt 12,533 milionë lekë që rezultuan gjatë vitit 2010, ose më shumë 1,948 milionë lekë.*

Kuotat e planifikuara të shpenzimeve për *pagesat e principalit janë realizuar në rreth 77.3% dhe të interesave të jashtme në 84.4%, duke reflektuar mosshpenzim të fondeve të planifikuara, përkatësisht 2,238 milionë lekë për shpenzimet e principalit dhe 1,270 milionë lekë për interesat.*

Më poshtë paraqesim tendencën e shërbimit të borxhit të jashtëm në disa vite:



- *Rregullshmëria e paraqitjes në planet vjetore të buxhetit të shpenzimeve për shërbimin e borxhit.*

Nga Drejtoria e Borxhit në projektbuxhetin e vitit 2011 dërguar KM, është paraqitur një analizë e menaxhimit të borxhit dhe parashikimi i treguesve të pritshëm të vitit 2010. Gjithashtu për këtë vit, janë llogaritur shpenzimet për shërbimin e borxhit, ku janë futur interesat e borxhit të brendshëm, interesat e borxhit të jashtëm dhe ripagesa të jashtme.

Për vitin 2011, treguesit e këtij shërbimi janë në rritje për pasojë të:

1. Rritjes të shpenzimeve për interesa për borxhin e brendshëm, si rezultat i peshës që zenë instrumentet afatgjatë për stokun e borxhit, kryesisht të obligacioneve 2, 3 dhe 5/vjeçare.

2. Rritjes së interesit për borxhin e jashtëm, si rezultat i parashikimit të rritjes së normës së interesit Euribor, si dhe shtesës së disbursimeve për implementimin e projekteve të huaja prej 10 miliardë lekë. Në këtë vlerësim është përfshirë dhe parashikimi për pagesat e garancive, si dhe ndikimet e mundshme të kursit të këmbimit.

3. Janë parashikuar me rritje shpenzimet e borxhit të jashtëm për principal si rezultat i grafikut të shlyerjes së tij, parashikimit të riskedulimit të borxhit të jashtëm dhe pagesat e garancive për vitin 2011.

Në shpenzimet për borxhin e trashëguar që do të riskedulohet gjatë vitit 2011, në shumën e paraqitur në projektligj, parashikohen marrëveshjet me ish-Jugosllavinë, për të cilën janë parashikuar shpenzime për principal dhe interesa në shumën 1,145 milionë lekë.

4. Në këtë buxhet janë planifikuar fonde dhe për shlyerjen e detyrimeve në kuadrin e garancive që ka lëshuar Qeveria për kreditë e marra nga institucionet dhe qeveritë e huaja.

o Përsa i përket, zbatimit të detyrimit ligjor për hartimin dhe miratimin e strategjisë së borxhit publik, të parashikuar në nenin 6, të ligjit për huamarrjen, borxhin dhe garancitë shtetërore të huasë, konkretisht:

“Ministri i Financave përgatit strategjinë afatmesme për vlerësimin e portofolit të borxhit dhe të ecurisë së tij. Kjo strategji rishikohet dhe paraqitet për miratim në KM së bashku me parashikimet e buxhetit afatmesëm”.

Nga auditimi rezultoi se, është përgatitur strategjia e borxhit publik për vitin 2011-2013 konform këtij përcaktimi ligjor. Në lidhje me objektivat e strategjise së borxhit publik rezultoi se, *nuk janë ruajtur targetet e vendosura për ditët mesatare në maturim (Duration i portofolit të borxhit të brendshëm)*, sipas të cilit në strategji këto janë vendosur për instrumentet në tregun e brendshëm rreth 380 ditë, në fakt kanë rezultuar 360 ditë, kurse për instrumentet në tregun e jashtëm me përfshirjen e Eurobondit targeti është 460 deri 466 ditë, në fakt ka rezultuar 448 ditë.

### **VI.2.c Mbi zbatimin e planit të buxhetit të shtetit, bazuar në ligjin “Për buxhetin e vitit 2011 me ndryshimet gjatë vitit.**

Për vitin 2011, buxheti i shtetit është miratuar me ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010, ndryshuar me ligjin nr 10450, datë 14/7/2011 dhe ligjin nr. 10496, datë 22/12/2011. Në mbështetje të nenit 24 dhe 27 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondeve speciale, referuar programit buxhetor afatmesëm 2011-2013, MF ka nxjerrë udhëzimet nr. 7, datë 22/2/2010 “Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale” dhe nr. 7/2, datë 9.07.2010 “Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale”. Këto udhëzime u janë dërguar ministrive dhe institucioneve qendrore me shkresat përkatëse. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2011-2013, janë përgatitur në bazë të vlerësimit të kuadrit makroekonomik dhe fiskal miratuar me vendimet përkatëse të KM.

Nga auditimi me zgjedhje i kryer për mënyrën e paraqitjes së projektbuxheteve nga Ministritë, në zbatim të udhëzimit të sipërcituar rezultoi se:

Drejtoria e Analizave, Politikave dhe Programimit Buxhetor (DAPPB) ka ndjekur hap pas hapi problematikën e konstatuar në draft dokumentin e PBA-ve dhe draft dokumentin e buxhetit vjetor të ministrive të linjës, duke kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e tyre sipas përcaktimeve dhe formularëve tip të miratuar në udhëzimet e mësipërme, si dhe ka tërhequr vëmendjen kur janë tejkaluara afatet e përcaktuara. Në përfundim të këtij procesi, *me shkresën nr. 13879, datë 4/11/2010, MF ka dërguar në KM projektligjin për buxhetin e shtetit të vitit 2011*. Ky draft në bazë të dokumentacionit të paraqitur *nuk rezultoi t’i jetë dërguar për mendim dhe sugjerim Ministrisë së Drejtësisë*, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në lidhje me miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga KM.

Ndërkohë, draftbuxheti me shkresën nr. 13879/3 dhe nr. 13879/4 datë 9/11/2010, i është dërguar Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë dhe Guvernatorit të BSH-së, pra pas dërgimit në KM-ve (datë 4/11/2010), në një kohë që në nenin 25, të ligjit nr. 9665, datë 18/12/2006 për huamarrjen, borxhin dhe garancitë shtetërore të huas në RSH, *përcaktohet detyrimi i marrjes paraprakisht të opinionit të BSH-së “këshillime për borxhin” si shumë të rëndësishme, në kushtet kur borxhi publik konsiderohet prioritet referuar dhe situatës së krizës ekonomike në eurozonë*.

Draftbuxheti është miratuar me ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 dhe dekretuar me Dekretin e Presidentit nr. 6799, datë 13/12/2010.

Në bazë të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, treguesit e buxhetit vjetor të shtetit, referuar nenit 46 të tij, ndryshohen me propozim të paraqitur nga



KM-ve Kuvendit të Shqipërisë, mbas një analize të realizimit të buxhetit faktik dhe domosdoshmërinë e ndryshimit të tij, të paraqitur nga Ministri i Financave, procedura këto që duhet të përfundojnë brenda muajit korrik të çdo viti. Për vitin 2011, projektligji për buxhetin e rishikuar është dërguar nga MF në Këshill të Ministrave me shkresën nr.13596, datë 1/07/2011 dhe ky projekt është miratuar me vendimin e KM nr. 470, datë 2/7/2011. Ndryshimi i ligjit të fillim vitit është miratuar me ligjin nr. 10450, datë 14/7/2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”, të dekretuar nga *Presidenti me Dekretin nr. 7064, datë 27/7/2011.*

Ligji i buxhetit për vitin 2011, është ndryshuar dhe me ligjin nr. 10496, datë 22/12/2011 “Për miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 14/12/2011, të KM “Për një ndryshim në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011” të ndryshuar, i cili është dekretuar nga *Presidenti me dekretin nr. 7221, datë 10/1/2012.*

Referuar relacionit shoqërues të projektbuxhetit suplementar, argumentet e ndryshimit të buxhetit janë kryesisht *vlërësimi i situatës makroekonomike, duke korrigjuar nivelin e të ardhurave referuar kësaj shtate, për rrjedhojë reduktimi i shpenzimeve dhe ruajtja brenda normave të lejuara të deficitit buxhetor.* Kurse, me aktin normativ ka ndryshim “Rritja vjetore e garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese”, ku kjo rritje sipas akteve të mësipërme ka ndryshuar nga 7,370 milionë lekë në fillim viti, në 2,426 milionë lekë me Ligjin e muajit korrik 2011 dhe 6,926 milionë lekë me Aktin Normativ.

*Ndryshimi i ligjit të fillim vitit, duke pakësuar si të ardhurat e parashikuara për t’u arkëtuar, ashtu dhe financimi i shpenzimeve me të njëjtën vlerë, tregojnë se nga institucionet përgjegjëse të realizimit të të ardhurave, vazhdojnë planifikimet optimiste dhe jo realiste të realizimit të tyre.*

Nga analiza e raportimit të realizimit të treguesve buxhetorë të konsoliduar të institucioneve qendrore rezultoi se, disa zëra të strukturës buxhetore paraqiten me mosrealizim, në një kohë që ligji i fillim vitit ka ndryshuar, si më poshtë vijon:

1. *Mosrealizimi i fondit të pagave të disa institucioneve*, megjithëse ndikim në këtë mosrealizim ka patur dhe vendimi i KM mbi përdorimin e fondit të veçantë të institucioneve. Institucionet me mosrealizime të konsiderueshme janë: METE në masën 91% artikulli 600 “Paga” dhe 90% artikulli 601 “Sigurime shoqërore”; Kuvendi 93% artikulli 600 dhe 91% artikulli 601; Këshilli i Ministrave 92% artikulli 600 dhe 87% artikulli 601; MBUMK 94% artikulli 600, me një mosrealizim prej 83.2 milionë lekë; MPPT 95% artikulli 600, me një mosrealizim prej 44.6 milionë lekë dhe 12.3 milionë lekë në artikullin 601; Ministria e Financave 94.7% në artikullin 600 dhe 93.2% në artikullin 601, me mosrealizim përkatësisht 146,9 milionë lekë dhe 28.8 milionë lekë); Ministria e Punëve të Jashtme me 87% në paga dhe 91% sigurimet shoqërore; Ministria e Brendshme 96% pagat dhe mosrealizim 356.8 milionë lekë; po kështu Ministria e Integritetit me 88%; MMPAU 92%; MPÇSSHB 93%; Akademia e Shkencave 85%; Gjykata Kushtetuese 90%; Avokati i Popullit 92.6%; Komisioni i Shërbimit Civil 82.8%; Autoriteti i Konkurrencës 88.6%; ATSH 93% etj.

*Nga MF janë marrë iniciativa për të kontrolluar menaxhimin e fondit të pagave, por pa efektivitetin e duhur. Mosrealizimi i fondit të pagave duhen kërkuar në*



mosplotësimin e strukturave organike, mbajtja e vendeve vakand, gjë e cila është pranuar dhe nga drejtoria përkatëse e buxhetit në MF.

*KLSH ka dhënë opinionin mbi domosdoshmërisë e rishikimit të strukturave në ministritë dhe institucionet qendrore, ku dukuria e mbajtjes së vendeve vakante konstatohet prej disa vitesh buxhetore.*

**2. Mosrealizimi i fondeve për shpenzime operative (artikulli 602) në disa ministri dhe institucione qendrore,** ndonëse fondet u janë rialokuar gjatë vitit brenda programeve. Ndër institucionet, përmendim MPPT me nivel realizimi në masën 91%, me një mosrealizim në vlerë prej 129.9 milionë lekë; Ministrinë e Integritimit 83%; Komisionin e Shërbimit Civil 87%; Institucione të tjera qeveritare 94% etj.

**3. Ndryshimi i fondeve të subvencioneve, nga 1,830.6 milionë lekë alokuar me buxhetin fillestar në fillim viti, në 3,372 milionë lekë me rishikimin, me një rritje prej 1,541 milionë lekë ose në masën 84% (referuar raporteve të konsoliduara).** Kjo rritje konstatohet kryesisht në MF, për të cilën nuk ka pasur të pasqyruar subvencion në planin e fillimit të vitit 2011.

Gjatë vitit 2011, kanë përfituar subvencione institucionet si më poshtë vijon:

GRUPI	Në milionë/lekë				
	Buxheti i fillim vitit	Buxheti përfundimtar	Ndryshimi buxhetit	Realizimi në vlerë	Realizimi në %
Pushteti vendor (grupi 00)	81.6	80.26	- 1.34	71.93	89.6
MPPT (grupi 06)	1,189	1,192.6	+ 3.58	1,192.4	99.9
Ministria Financave (grupi 10)	0	1,524.4	+ 1,524.4	1,524.4	100
MASH (grupi 11)	380	380	0	379.9	100
MPÇSSHB (grupi 25)	100	100	0	109.7	110
Institucione të tjera Qeveritare (grupi 87)	80	94.8	+ 14.8	94.8	100
<b>Subvencioni në total:</b>	<b>1,830.6</b>	<b>3,372.0</b>	<b>+ 1,541.4</b>	<b>3,373.3</b>	<b>100</b>

Nga krahasimi i shifrave të buxhetit të fillim vitit me buxhetin përfundimtar, konstatohet shtesë e paket e subvencioneve për MPPT dhe Institucione të tjera qeveritare, kurse për MF subvencioni i shtuar ze 83.3% të subvencionit të shtuar nga 84% gjithsej, dhe në vlerë 1,524.4 milionë lekë.

**3. Mbi çeljen e fondit subvencion për Ministrinë e Financave gjatë vitit 2011.**

Nga auditimi rezultoi se, me disa vendime të KM, MF i është çelur fond subvencion (artikull 603) për “Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetra tek njësitë e qeverisjes vendore” në shumën 1,524,395,812 lekë, sipas situacionit të shpenzimeve të konfirmuar nga thesari.

Referuar shkresave të çeljes së fondit në MF, këto fonde janë marrë nga Fondi i Kontigjencës (për mbulim deficiti) i vitit 2011.

Në kushtet ku ruajtja e kufijve të deficitit buxhetor merr rëndësi të veçantë dhe planifikimi i një kontigjence për ruajtjen e deficitit është një ndër standardet aktuale me rëndësi në planifikimin buxhetor të një vendi, *KLSH ka rekomanduar bërjen e përmirësimeve ligjore*<sup>4</sup>. Në drejtim të planifikimit dhe zbatimit të shpenzimeve buxhetore, jo nga të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore janë zbatuar kriteret dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të përcaktuara në udhëzimet përkatëse të nxjerra nga MF për vitin 2011, si udhëzimet

*nr. 7, datë 22/2/2010 dhe nr. 7/2, datë 9/7/2010* “Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale”. Për këtë, MF referuar udhëzimeve të mësipërme ka kryer monitorimin e drafteve të dërguar për realizimin e fondeve buxhetore sipas politikave të programeve, produkteve të tyre, përqindjes së realizimit të produkteve dhe kostove përkatëse, sipas formularëve përkatës të miratuar në këto udhëzime. Nga auditimi rezultoi se, *nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Raportimit të Buxhetit ka pasur mbikëqyrje dhe vlerësime për raportet e paraqitura nga institucionet përkatëse, monitorim ky që i shërben procesit të planifikimit për vitin pasardhës.* Njëpërmjet këtij monitorimi janë konstatuar një sërë të metash, të cilat rezultojnë që nga mënyra e planifikimit të programeve dhe përcaktimi i kostove të tyre, të paraqitur nga institucionet përkatëse.

#### **5.1 Mbi Raportet e monitorimit të paraqitura për vitin 2011.**

Në raportin “Mbi monitorimin e realizimit të shpenzimeve të vitit 2011”, i cili është pjesë e raportit që MF ka dërguar në KM “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2011”, u konstatua që në këto raporte, në shumë raste, *treguesit e realizimit të shpenzimeve i referohen shifrave të paraqitura nga Ministritë e linjës dhe jo raporteve të konsoliduara të MF të nxjerra për faktin.* Diferencat, kanë ardhur për shkak se, *në faktin e shpenzimeve të ministrive nuk janë përfshirë shpenzimet e financuara nga të ardhurat jashtë limitit të realizuara nga ministrinë dhe mospërputhjet në shpenzimet me burim financimi të huaj.*

Përsa më sipër:

##### o Ministria e Shëndetësisë

Nga krahasimi i raportit të konsoliduar të MF me atë të paraqitur në KM, rezultojnë diferenca për faktin e shpenzimeve në vlerën 439 milionë lekë më pak se plani. Diferenca ekzistojnë dhe përsa i përket faktit të shpenzimeve të investimeve publike, të cilat në raportin për ministrinë e linjës paraqitet 4,364 milionë lekë, ndërsa në raportin e konsoliduar rezulton të jetë 3,644 milionë lekë.

Për financimin e huaj, sipas raportit të monitorimit realizimi i investimeve kapitale rezulton në masën 164%, ndërsa sipas MF ky realizim është 111.7%.

Diferenca midis raportit të monitorimit dhe MF për financimet e huaja për vitin 2011, është rezultat i mosraportimit nga Ministria e Shëndetësisë në MF të grantit japonez për shërbimin e urgjencës (rreth 700 milionë lekë). Të ardhurat jashtë limitit për këtë grup rezultojnë 289.7 milionë lekë.

##### o MASH

Nga krahasimi i raporteve të konsoliduar për MASH me raportin e monitorimit të paraqitur nga MF, rezulton se nuk ka diferenca për shpenzimet e planifikuara, por ka diferenca në shpenzimet faktike në vlerën prej 3,058 milionë lekë. Të ardhurat jashtë limitit për këtë grup rezultojnë 3,041 milionë lekë, nga ku për investimet publike rezultojnë 740 milionë lekë.

Po kështu dhe për investimet publike për shpenzimet faktike në total rezulton një diferencë prej rreth 700 milionë lekë.

##### o MBUMK

Referuar krahasimit të shifrave të paraqitura në raportin e monitorimit dhe atyre të konsoliduara të MF, rezultojnë diferenca për faktin e shpenzimeve në shumën prej 145.5 milionë lekë. Të ardhurat jashtë limitit për këtë grup rezultojnë 101 milionë lekë. Nga një shqyrtim më të hollësishëm, konstatohet se këto ndryshime rezultojnë në paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime për mallra dhe shërbime.

MF ka dhënë sqarimin se, 43.8 milionë lekë diferencë, ka ardhur pasi shifra për shpenzimet kapitale në relacionin e raportit të monitorimit të buxhetit faktik është hedhur gabim.

o MPCSSH

Nga krahasimi i raportit të konsoliduar të MF me atë të paraqitur në KM, rezultojnë diferenca për faktin e shpenzimeve në vlerën 102 milionë lekë. Kapitulli 6 “shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit” për këtë ministri rezulton në total 26 milionë lekë. MF ka dhënë sqarimin se: - Lidhur me diferencat e buxhetit faktik me faktin e MPCSSH dhënë në raportet e monitorimit për vitin 2011, ato vijnë si rrjedhojë e mospërfshirjes së financimit të huaj (pa plan fillestar) në shpenzimet kapitale të Projektit PIU “Për programin e sigurimit shoqëror”, konkretisht, në vlerë artikulli 230 = 40,453,940 lekë dhe artikulli 231 = 34,996,970 lekë.

o MMPAU

Nga krahasimi i raportit të konsoliduar të MF me atë të paraqitur në KM, rezultojnë diferenca për faktin e shpenzimeve në vlerën rreth 347 milionë lekë. Vihet re se në raportin e ministrive të linjës, tek monitorimi i kësaj ministrie, shënohet se, fakti i vitit 2011 është i shprehur në mijë lekë, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse është shënuar se, është e shprehur në milionë lekë.

Kapitulli 6 “shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit” për këtë ministri, rezulton në total 30.6 milionë lekë.

o Ministria e Integritit

Raporti për ministrinë e linjës i paraqitur në KM, nuk paraqet asnjë shifër mbi planin dhe faktin e shpenzimeve, por vetëm përqindjen e realizimit. Për pasojë, nuk mund të bëhet krahasimi i vlerave të paraqitura me ato të raportit konsuntiv të MF. Përsa i përket përqindjes të realizimit të programeve, u konstatua se ka diferenca në një nga tre programet e menaxhuar nga kjo ministri. Kështu, programi “Mbështetja institucionale në procesin e integritit” raportohet i realizuar 29.2%, ndërkohë që sipas raportit konsuntiv ky program është realizuar 37.6%.

Përsa më sipër, MF ka dhënë këto sqarime:

*Plani i shpenzimeve për vitin 2011 për të gjitha ministrinë dhe institucionet është i rakorduar me to dhe është e njëjta shifër e raportuar në relacionin e raportit të ligjit për buxhetin faktik dhe në raportin final të konsoliduar të MF. Përsa i përket shpenzimeve faktike, diferencat e raportimit të paraqitura ndërmjet shpenzimeve faktike të raportuara në relacionin e buxhetit faktik për monitorimin dhe shpenzimeve faktike të raportuara në raportin e konsoliduar të MF, nuk kanë të njëjtë bazë krahasimi, pasi në raportin e monitorimit pjesë e raportit faktik paraqiten realizimi i shpenzimeve për zërat e planifikuar dhe të miratuar me ligjin e buxhetit; ndërsa në shpenzimet faktike të konsoliduara paraqiten shpenzimet e realizuara me “Të ardhurat jashtë limitit”, të cilat nuk janë planifikuar në buxhet dhe nuk janë të përfshira në faktin e shpenzimeve të raportuara nga buxheti.*

*Gjithashtu, diferencat përbëhen dhe nga shpenzimet faktike për financimin e huaj, për të cilat nuk ka përputhje midis të dhënave që raportohen nga sistemi i thesarit, me ato që raportojnë ministrinë e linjës.*

Nga auditimi ka rezultuar se, paraqitja e të dhënave për ministrinë përkatëse nuk ka një standard paraqitje në këtë raport, pavarësisht dhënies së të njëjtit informacion. Për disa ministri, jepen treguesit sipas programeve për shpenzime korrekte dhe kapitale veç e veç, për disa të tjera jepen shpenzimet sipas artikujve, niveli i shpenzimeve sipas buxhetit të planifikuar, akorduar dhe përfundimtar,

madje shpesh herë në tabela nuk jepet nëse shifrat janë të shprehur në mijë lekë apo në milionë lekë etj. *Kjo gjë e bën të vështirë gjykimin e menaxhimit të fondeve të institucioneve në këtë raport sipas një standardi.*

Cilësojmë se, *KLSH ka pasur parasysh standardin e raportimit (prezantimit) të shifrave për ministritë e linjës nga ana e MF në raportin e monitorimit. Në këtë kontekst, MF në prezantimin e treguesve duhet të paraqitet konform standardit të miratuar në udhëzim nga ajo vetë dhe jo sipas stilit të prezantimit të ministrive të linjës, të cilat mund të paraqiten dhe me gabime. **Ky konstatim është bërë dhe në raportin e monitorimit të vitit të kaluar.***

o Raportet e monitorimit janë shoqëruar dhe me disa analiza të realizimit të programeve dhe produkteve, të cilat aktualisht nxjerrin në pah dhe disa probleme të rëndësishme të menaxhimit të fondeve gjatë vitit 2011, si më poshtë vijon :

a) Referuar analizës së realizimit të produkteve, një pjesë e mirë e tyre rezultoi në përfundim si rezultat i shkurtimit të fondeve nga MF edhe Ministria e linjës. Shumë fonde të ngrira në detajimin e fillim vitit janë shkurtuar më pas me buxhetin e rishikuar. Referuar raporteve të monitorimit të paraqitura nga ministritë, kjo ka rezultuar në Ministrinë e Mbrojtjes, MPPT, MPJ, në produktet G.H.I të programit “Planifikim, menaxhim, administrim” dhe disa produkte në programet e tjera.

b) Mosmbulimi me financim të “rikonstruksioneve të rrugëve C2 me dy korsi (të përfunduara apo në proces ndërtimi) për MPPT, të pa financuara dhe ku janë të tejkaluara ndjeshëm punimet fizike mbi planin e vitit 2011.

c) Shpenzimet për t.v.sh. dhe kosto lokale për projektet me financim të huaj në MPPT, janë të pamjaftueshme për të mbuluar aktualisht projektet e përfunduara apo në proces zbatimi.

o ***Mbi zbatimin e planit të buxhetit.***

Në zbatim të nenit 38, të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, MF ka nxjerrë udhëzimin nr. 4, datë 27/1/2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”, ndërsa, në zbatim të kompetencave të dhëna në nenet 41 dhe 42 të këtij ligji, si dhe në udhëzimin e mësipërm, referuar ligjit vjetor të dekretuar, bën shpërndarjen e fondeve buxhetore sipas klasifikimit buxhetor për institucionet sa më poshtë vijon:

a) për njësitë e qeverisjes qendrore për fondet buxhetore;

b) për njësitë e qeverisjes vendore për shpërndarjen e fondeve për transfertën e pakushtëzuar.

Njoftimi me shkrim nga nëpunësi i parë autorizues, për çdo njësi të qeverisjes qendrore për shpërndarjen e fondeve buxhetore sipas klasifikimit buxhetor është bërë me shkresat nr. 13879/x, datë 18/12/2010 deri në janar të vitit 2011. Pra, detajimi i fondeve për shpenzimet korrente dhe kapitale bazuar në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të dekretuar me Dekretin nr. 6799, datë 13/12/2010, *ka vazhduar dhe mbas afatit 10 ditor të dekretimit të ligjit*, duke mos respektuar përcaktimin në nenin 42 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, ku theksohet se, *fondet shpërndahen brenda 10 ditëve nga dekretimi i ligjit të buxhetit vjetor* E njëjta gjë është konstatuar dhe me zbatimin e ligjit nr. 10450, datë 14/7/2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”, dekretuar me Dekretin nr. 7064, datë 27/7/2011, ku detajimi i fondeve është bërë me shkresën nr. 14568/x, duke filluar nga data 22/8/2011 deri më 6/9/2011, *pra*

*pas dekretimit nga Presidenti, por jo brenda afateve të përcaktuara me nenin 42 të ligjit të sipërcituar.*

o Përsa i përket procesit të rakordimeve në nivel institucional dhe zbatimit të kompetencave për transferimet e kryera, nga auditimi me zgjedhje i kryer, rezultoi se:

*Janë kryer rakordimet e të gjitha niveleve. Këto rakordime janë kryer për të gjitha fondet buxhetore në nivel titulli, kapitulli, artikulli, distrikti dhe lokal, brenda afateve të rakordimit të përcaktuara.*

Në drejtim të saktësisë së rakordimit u krye auditim më i hollësishëm referuar dhe krahasimit me raportet e monitorimit, ku rezultoi se rakordimi për planin ishte i saktë; *kurse për faktin ka mospërputhje midis raporteve të monitorimit dhe faktit të konsoliduar të ministrive.*

Përsa i përket zbatimit të nenit 44 “Rishpërndarja e fondeve buxhetore”, të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008, rezultoi se:

- Janë zbatuar kompetencat e transferimit referuar parashikimeve në nenin 44 të ligjit dhe është respektuar kufiri prej 10% për fond të rishpërndarë, kundrejt totalit të fondit të programuar dhe miratuar.

Në vijim paraqesim rezultatet e auditimit në:

#### **1. Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit**

Për vitin 2011, kjo ministri me shkresën nr. 4403/3, datë 25/8/2010, ka dërguar në MF projektbuxhetin afatmesëm 2011-2013 dhe p/buxhetin e vitit 2011, të shoqëruar me analizën dhe relacionin sqarues mbi hartimin e tij. Në hartimin dhe përcaktimin e kërkesës për buxhet të programeve, MTTP ka mbajtur parasysh kërkesat e parashikuara në programin buxhetor 2011-2013, ka pasqyruar realizimin e treguesve buxhetorë për vitin 2009, si dhe realizimin e pritshëm për vitin 2010.

Nga MPPT janë respektuar tavanet përfundimtare të përcaktuara dhe dërguara me udhëzimin plotësues të MF nr. 7/2, datë 9/7/2010 “Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale”. Referuar këtij udhëzimi, tavani përfundimtar për totalin e MPPT është 31,183 milionë lekë, *me një ulje të konsiderueshme nga realizimi i pritshëm i vitit 2010.*

Në lidhje me kërkesat e paraqitura nga MPPT, *MF ka bërë vërejtje mbi projektbuxhetin e paraqitur, si për fazën e parë, ashtu dhe për fazën e dytë*, disa nga të cilat kanë qenë në vazhden e vërejtjeve të bëra dhe në proceset e mëparshme të hartimit të projektbuxheteve.

Komenti përfundimtar i MF mbi projektbuxhetin e dërguar për fazën e dytë në nivel ministrie, tekstualisht është:

“Si konkluzion, shprehemi se paraqitja e kërkesave për buxhet në nivel ministrie, nuk është bërë plotësisht në përputhje me udhëzimin nr. 7, datë 22/2/2010 “Për përgatitjen e buxhetit dhe fondet speciale” dhe cilësia e paraqitjes se tyre herë pas herë le për të dëshiruar, prandaj reflektimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve tona, duhet të përbëjë prioritet për Ekipet e Menaxhimit të këtyre programeve gjatë hartimit të PBA 2012-2014, duke u mbështetur gjerësisht edhe në Guidën sektoriale të MF të miratuar së fundi.”

Referuar programit buxhetor afatmesëm 2011-2013 të MPPT, vërejtjet e shprehura në shkresën e mësipërme të MF, janë kryesisht për dy programet kryesore të cilët zenë përqindjen më të lartë të fondeve buxhetore të MPPT, dhe konkretisht:

**a) Për programin ujësjellës kanalizime:**

- Në drejtim të përshkrimit të programit, MF shprehet se, duhet të jepet me qartë kalimi i këtij programi nga sigurimi i ujit të pijshëm dhe kanalizime, në politikbërjen dhe hartimin e rregullave, pasi që nga viti 2008, organi përgjegjës për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm është Pushteti Vendor, kjo vërejtje është bërë dhe vitin e kaluar.

- Në drejtim të qëllimit të programit, qëndrojnë të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e bëra më parë, të cilat nuk janë reflektuar, dhe konkretisht:

Duhet të jepet informacion lidhur me gjendjen aktuale, p.sh. si është situata aktuale në përqindje dhe në vlera absolute për vitin 2011, për qëllimet e listuara në këtë program, në mënyrë që ky vit të shërbejë si vit bazë dhe vit krahasimi për ecurinë e realizimit të qëllimeve. Kjo nuk është bërë për vitin 2011, por duhet të kihet parasysh në planifikimet e radhës. Gjithashtu është e rëndësishme që ky program të vendosë në Qëllimet e Politikës, qëllime për të cilat ajo është përgjegjëse, pra të vendoset në një farë mënyre kufiri i veprimit të këtij programi, duke pasur parasysh kompetencat e deleguara tek pushteti vendor.

Një nga vërejtjet thelbësore në lidhje me produktet e programit ka të bëjë me faktin që sasia e alokuar për Produktin “Subjekte të ujësjellës-kanalizimeve të subvencionuara” është përlllogaritur konstante përgjatë viteve të PBA, gjë që bën ndesh me objektivat e përcaktuara nga vetë programi për reduktim të ndërmarrjeve të subvencionuara nga shteti për periudhën 2011-2013. *Këtu duhet pasur parasysh dhe objektivi i qeverisë për subvencionim në masën 0 në vitin 2015.*

Për këtë program, nga MPPT janë paraqitur kërkesa shtesë. Fondet shtesë kërkohen për projekte në vazhdim, me qëllim avancimin e fondeve për përshpejtimin dhe përfundimin e tyre, për të mos lejuar degradimin e punimeve të kryera, por edhe për faktin se shpesh këto projekte janë në zona turistike.

**b) Për programin “Rrjeti i rrugëve nacionale”:**

Referuar analizës së bërë nga MF, ky program ka një regres në paraqitjen e të dhënave për projektbuxhetin afatmesëm, ballafaquar me kërkesat e udhëzimit të MF, si për fazën e parë dhe të dytë. Për këtë është dhënë rekomandimi për EMP që duhet të: përcaktojë standarde të qarta dhe më specifike të politikës, duke reflektuar sugjerimet e vazhdueshme në drejtim të:

1. Futjes së standardeve të reja si standardi “Indeksi i Ashpërsisë së Rrugëve”, i cili jep një tregues shumë të mirë të cilësisë së rrugëve nacionale në Shqipëri, dhe që gjen zbatim në objektivat e programit.
2. Dhënies së lejes së drejtimit (patentën), duke synuar dhe prezantimin e patentës me pikë, siç e kanë shumica e vendeve të BE dhe që ka dhënë efekte pozitive në uljen dhe parandalimin e aksidenteve rrugore.
3. Futjes së standardit të “Kontrollit teknik të automjeteve në Shqipëri në nivelin X%, në përputhje me standardet e BE”.

Në këtë program, duhet bërë përmirësim në drejtim të eliminimit të mungesës së sasisë apo vendosjes së njësisë matëse të gabuar, pasi nuk mundësohet një analizë e përshtatshme. *Gjithashtu, vërehen luhajtje të kostove për njësi për rrugë të të njëjtit tip si për ndërtime, rikonstruksionet apo asfaltimet, gjë që nuk gjen shpjegim të argumentuar.*

Nga ky program, janë paraqitur kërkesa shtesë. Fondet shtesë për vitin 2011 kërkohen për projekte në vazhdim me qëllim avancimin e fondeve për përshpejtimin dhe përfundimin e tyre në afatet e përcaktuara. Referuar argumenteve të dhëna

nga MPPT, kërkesat shtesë kanë për qëllim përsheptimin e përfundimit të punimeve të nisura. Pothuajse, për të gjithë projektet, fondet shtesë kërkohen për ndërtimin në afat të objekteve (respektimin e datës së përfundimit të kontratës), duke pasur parasysh rishikimin që ju bë buxhetit të vitit 2010 dhe ngrirjes së fondeve në këtë vit për shpenzimet kapitale.

Përsa i përket, *komenteve për strukturën e programeve, vazhdon i pandryshuar komenti i bërë dhe në vitet e mëparshme për dy programet: “Menaxhimi i transportit” dhe “Shërbimet publike”, që rezultojnë të paqarta në aspektin e aktivitetit të tyre.*

Për vitin 2011, MPPT në bazë të ligjit nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me shkresat e MF nr. 13879/98, datë 30/12/2010 dhe nr. 319/1, datë 19/1/2011, i janë *akorduar fonde në shumën totale 48,479,310 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet kapitale në shumën 44,055,269 mijë lekë dhe shpenzimet korrente në shumën 4,432,000 mijë lekë.*

Në rezultatet e realizimit të treguesve buxhetore, ndikim ka pasur avancimi i punimeve nga vitet e kaluara për kontrata të lidhura dhe të pafinancuara ose të financuara sa plani, kjo kryesisht për programet që përdorjnë fonde të mëdha si “Rrjeti i rrugëve nacionale” dhe “Ujësjellës kanalizime”.

Praktikat e përdorura dhe domosdoshmëria e ecurisë së punimeve dhe financimit të tyre, do të çojnë në shtimin e deficitit në masë të konsiderueshme të firmave kontraktore.

Përsa më sipër, KLSH ka rekomanduar *përmirësimin e udhëzimit të zbatimit të buxhetit në lidhje me domosdoshmërinë e financimit të punimeve të realizuara dhe pa financuar, si dhe financimin e pjesës së mbetur të kontratave që përbën prioritet “në radhë të parë”, në mënyrë që të eliminohet borxhi i krijuar kundrejt kontraktorëve.*

#### □ *Mbi subvencionet*

Specifike për MPPT ka qenë vlera e konsiderueshme e subvencioneve për energjinë elektrike. Referuar politikave afatmesme të qeverisë, udhëzimeve të MF në hartimin e projektbuxheteve të ministrive, si dhe vërejtjeve të bëra në mënyrë të vazhdueshme ministrive (përgjegjësve të programeve), në drejtim të parashikimit të fondeve për subvencione, ky fond në vend që të prirë drejt pakësimit nga viti në vit, ka ardhur duke u rritur realisht (pavarësisht planifikimit në fillim të vitit).

Për vitin 2011 fondi i çelur me ligj, për subvencion, është në masën 737,000 mijë lekë për sektorin e ujësjellës kanalizime. Me vendimin e KM nr. 329, datë 17/5/2011 ky fond është shtuar me 36,000 mijë lekë fonde të mara nga programi “Transporti hekurudhor”, pra shuma totale e subvencionit për 6/mujorin e parë të vitit 2011 është 773,000 mijë lekë. Nga ky fond, shuma prej 608,308.9 mijë lekë u është shpërndarë 20 ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, pjesa tjetër u është dhënë ndërmarrjeve si subvencion në fillim të vitit.

Ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve, pavarësisht politikave të mirë përcaktuara prej tyre, aplikojnë praktikën që të mos paguajnë detyrimet për konsumin e energjisë elektrike prej tyre, pavarësisht se kanë apo nuk kanë mjete financiare disponibël, *me synimin që këto detyrime herët ose vonë, meqenëse prekin çështje sociale (furnizimin e popullatës me ujë) do të paguhet nga buxheti i shtetit.* Kjo ka çuar në grumbullimin e detyrimeve të prapambetura në masë të konsiderueshme.

Referuar të dhënave të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime dhe analizës së bërë, rezultoi se ka pasur subjektivizëm në shpërndarjen e subvencionit në fillim të vitit 2011 nga kjo Drejtori.

Për këtë, paraqesim të dhënat e disa ndërmarrjeve, si me poshtë vijon:

*Në mijë/lekë*

<i>Emërtimi i Sha.a Ujësjellës Kanalizime</i>	<i>Diferencë midis të ardhurave dhe kostos viti 2010</i>	<i>Subvencion i dhënë me buxhet për vitin 2010</i>	<i>Subvencion i akorduar me VKM për pagesa të energjisë elektrike viti 2010</i>	<i>Subvencion i dhënë me buxhet për vitin 2011</i>		<i>Subvencion i dhënë me VKM për vitin 2011</i>
				<i>Detajimi në fillim të vitit</i>	<i>Subvencioni i realizuar</i>	
Shkodër	-81,076	12,340	24,986	3,000	15,000	13,695
Këlcyrë	- 6,188	2,200	5,814	1,000	1,000	-
Ura Vajgurore	-10,454	4,000	9,206	1,000	1,000	-
Korçë	- 32,891	15,000	18,668	4,000	4,000	-
Bilisht	-11,190	5,300	5,697	1,000	1,000	-
Selenicë	-11,701	4,500	8,901	3,000	3,000	-
Peqin	-14,226	6,100	10,860	1,000	1,000	-
Bulqizë	-16,523	10,300	17,148	1,000	1,000	-
Tepelenë	-32,947	12,000	25,647	1,000	1,000	-
Has	-14,851	4,650	12,378	7,000	7,000	-
Kurbin	-72,082	10,000	62,751	15,500	15,500	36,216
Patos	- 142,152	56,000	88,171	23,500	23,500	82,912
Kamëz	-33,981	13,000	17,929	9,000	9,000	-
Orikum	-33,600	8,250	500	10,000	10,000	-
Tropojë	-16,828.12	11,400.00	27,692.00	7,000	7,000	9,522

Cilësojmë se, të dhënat e mësipërme janë vetëm një pjesë e ujësjellësve të trajtuar për pasqyrim në këndvështrimin e grupit të auditimit.

Aktualisht me ligjin nr. 10340, datë 28/10/2010 “ Për pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe Sh.a.-ve në pronësi të pushtetit vendor”, në nenin 2 theksohet se: “Në rastet kur ndërmarrjet publike dhe/ose sh.a., në pronësi të pushtetit vendor, nuk paguajnë në kohë detyrimet e tyre ndaj të tretëve, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për pagimin e tyre”.

Kjo kërkesë e ligjit, rezulton e pazbatuar për vitin 2011, pasi pushteti qendror nëpërmjet ministrisë së linjës (MPPTT) u ka çelur fonde ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime me ligj buxheti dhe me vendime të Këshillit të Ministrave, kryesisht për pagesat e energjisë elektrike. Të dhënat e paraqitura me sipër e tregojnë këtë gjë.

Gjithashtu, në zbatim të ligjit të sipërcituar ka dalë udhëzimi nr. 14, datë 16/6/2011 “Për pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe Sh.a.-ve në pronësi të pushtetit vendor”, udhëzim i cili ka përcaktuar procedurat dhe masat që do të merren në rastet e moskryerjes së këtyre pagesave nga ndërmarrjet përkatëse apo nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat kanë në pronësi këto ndërmarrje.



## VII. PËR PËRGATITJEN DHE SAKTËSINË E RAPORTIT VJETOR TË KONSOLIDUAR TË ZBATIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2011 DHE RAPORTET QË I PARAQITEN KM DHE MË PAS KUVENDIT PËR MIRATIM

Në ligjin nr. 9936 datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 62 dhe 63 përcaktohet që:

Neni 62. Ministri i Financave brenda *muajit maj* paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të shoqëruar me një informacion për arritjen e objektivave, situatën e MFK-së dhe auditimit të brendshëm. Një kopje e raportit i dërgohet Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 63. Këshilli i Ministrave brenda *muajit qershor* dërgon në Kuvend raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit i cili përmban:

1. Llogaritë e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit.
2. Raportin për zbatimin e buxhetit vjetor në nivelin e fondeve të miratuara.
3. Raportin për borxhin publik dhe përbërjen e tij.
4. Raportin për perdorimin e fondit rezervë dhe kontigjencës.
5. Informacion për arritjen e objektivave, situatën e menaxhimit dhe të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e nenit 62 rezultoi se, me shkresën nr. 8879 datë 30/5/2012 është dërguar ky raport në KM dhe në KLSH.

Bazuar sa më sipër është nxjerrë VKM nr. 374, datë 6/6/2012 “Për propozimin e projektligjit “Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2011”, relacioni përkatës teksti i projektligjit së bashku me materialet që e shoqërojnë atë:

1. Raport vjetor i konsoliduar i buxhetit të shtetit të vitit 2011 dhe analizë për situatën makroekonomike dhe buxhetore për vitin 2011.
2. Raporti për borxhin shtetëror dhe operacionet e lidhura me borxhin dhe shërbimet e tij gjatë vitit 2011.
3. Mbi përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave për vitin 2011.
4. Informacion për kontrollin e brendshëm financiar dhe auditimin e brendshëm.

*Nga institucioni i Kuvendit me shkresën nr. 1423/1, datë 22/6/2012 është dërguar në KLSH projektligji “Per miratimin e buxhetit faktik të vitit 2011”.*

Të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit faktik në vitin 2011, deficiti dhe burimet e financimit të tij, referuar projektligjit të paraqitur në Kuvend me shkresat e mësipërme, rezultojnë si më poshtë:

### I. BUXHETI I SHTETIT

	275,479 milionë lekë
a) Të ardhurat gjithsej	
b) Shpenzimet gjithsej	309,297 milionë lekë

### II. BUXHETI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

a) Të ardhurat	86,267 milionë lekë
b) Shpenzimet	85,317 milionë lekë

### III. BUXHETI I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

a) Të ardhurat	13,965 milionë lekë
b) Shpenzimet	26,974 milionë lekë

### IV. DEFICITI BUXHETOR

- <i>Financimi i deficitit buxhetor</i>	45,877 milionë lekë
---	---------------------

Nga i cili:	
<b>IV.1 I brendshëm</b>	26,119 milionë lekë
Nga i cili:	
<b>A) Me instrumente financiare</b>	28,175 milionë lekë
<b>A.1 Kredi marrje nga Pushtetit Qendror</b>	28,106 milionë lekë
- Bono Thesari	- 9,947 milionë lekë
- Obligacione të Qeverisë 2 ,3, 5 /vjeçare	18,159 milionë lekë
<b>A.2 Kredimarrje nga pushteti vendor</b>	69 milionë lekë
<b>B. Të ardhura nga privatizimi</b>	438 milionë lekë
<b>C. Të tjera</b>	- 2,494 milionë lekë
<b>D.1 Ndryshimi i gjendjes arkës</b>	- 2,283 milionë lekë
<b>D.2 Të tjera</b>	- 211 milionë lekë
<b>IV.2 Financimi i jashtëm neto</b>	19,758, milionë lekë
Nga i cili:	
- Mbështetje buxhetore	2,543 milionë lekë

## VIII. ZBATIMI REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA KLSH NË KONTROLLIN E VITIT TË MËPARSHËM

Bazuar në akt-verifikimin e datës 12.12.2011 të mbajtur nga audituesit e KLSH në MF, nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga kontrolli i mëparshëm, rezultoi si më poshte vijon:

### ***Rekomandimi***

#### ***Rekomandimi nr. 1***

Në udhëzimin që Ministri i Financave nxjerr çdo vit për zbatimin e buxhetit vjetor të përcaktohet:

**a)** Njësitë shpenzuese të paraqesin në Degët e Thesarit kontratat për punë, shërbime dhe mallra, brenda tre ditësh nga data e hyrjes në fuqi e tyre.

**b)** Për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme të cilat nuk përmbushin detyrimin për paraqitjen dhe regjistrimin e angazhimit brenda tre ditëve, por kontratat i paraqesin në momentin e kryerjes së likuidimit të faturave nga ana Degëve të Thesarit, t'i dërgohet njoftim Nëpunësit të Parë Autorizues për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve zbatues të këtyre njësive.

#### ***Rekomandimi nr. 2***

### ***Veprimet e ndërrmara nga MF***

#### ***Për rekomandimin nr. 1***

Është realizuar përcaktimi sipas pikës a, ndërsa nuk është zbatuar rekomandimi sipas pikës b.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

#### ***Për rekomandimin nr. 2***

Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të kryejnë rinovimin e aktmarrëveshjes të datës 27/3/2003, me qëllim që të parashikohet në të, mënyra se si do të derdhet dhe kur do të derdhë fitimin neto të Bankës së Shqipërisë, në llogarinë “Depozitë e Qeverisë”.

Rekomandimi nr. 3

Nga ana e MF të evidentohen të gjithë projektet që kanë vonesa në raportim ose që nuk kanë raportuar fare dhe t’i dërgohet shkresë çdo institucioni ku të kërkohet nxjerrja e përgjegjësive ndaj personave përkatës, si dhe procedimi me masa disiplinore ndaj tyre, në zbatim të pikës 6 të udhëzimit të MF nr. 8, datë 17/2/2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”. Në fund të procesit, institucionet të informojnë MF për masat e marra në këtë drejtim.

Rekomandimi nr. 4

a) Të saktësohet në rregulloren aktuale në detyrat e përgjegjësit të sektorit dhe të specialistit të sektorit të garancive, nënhuamarrjes dhe huamarrjes lokale, të funksionit të ndjekjes së detyrimeve dhe menaxhimit e procesit të kthimit të pagesave të kryera në kuadrin e garancive nga buxheti i shtetit, referuar kjo dhe funksionit nr. 4 të “Drejtorisë së Strategjisë dhe Riskut” .

b) Krijimin e një baze të dhënash të mirëfillta ku të jenë të identifikuara marrëveshjet e garancive në kuptimin dhe klasifikim, referuar ligjit nr. 9665, datë 18/12/2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të

Nga kontrolli i zbatimit rezulton se Ministri i Financave ka nxjerrë urdhrin e datës nr. prot. 22619, datë 1/12/2011, ndaj ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

Për rekomandimin nr. 3

Nga shqyrtimi i shkresave të vëna në dispozicion, rezultoi se nga MF nuk është proceduar sipas rekomandimit të lënë, por është mjaftuar me një ri-kujtesë, drejtuar institucioneve përgjegjëse, për sanksionet e ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RH”, në rast të përsëritjeve të mangësive në drejtim të raportimit të financimit të huaj.

Ky rekomandim konsiderohet i pa zbatuar.

Për rekomandimin nr. 4

Ky rekomandim nuk është zbatuar, pasi ai nuk është reflektuar në rregullore, por gjatë ushtrimit të funksioneve për 2011 është kryer funksioni i ndjekjes së detyrimeve.

huas në RSH”, si dhe detyrimet e tyre, referuar buxhetit të shtetit.

c) Njoftimet zyrtare për subjektet që kanë përfituar garanci, për detyrimin deri në fund të vitit 2010 prej 398,174.6 mijë lekë dhe shlyerjen e tij kundrejt buxhetit të shtetit.

## IX. ADMINISTRIMI I BUXHETIT TË PUSHTETIT VENDOR

Bazuar në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, ligjin nr. 10450, datë 14/07/2011 dhe ligjin nr. 10496, datë 22/12/2011, buxheti për pushtetin vendor është si më poshtë:

- |   |                     |
|---|---------------------|
| 1. Të ardhurat .....                                | 29,314 milionë lekë |
| Nga të cilat:                                       |                     |
| 1.a Granti i pakushtëzuar nga buxheti qendror ..... | 14,014 milionë lekë |
| 2. Shpenzimet .....                                 | 29,314 milionë lekë |

Për vitin 2011, të ardhurat nga vetë pushteti vendor janë planifikuar në vlerën 15,300 milionë lekë, përkatësisht nga 29,314 milionë lekë shuma totale e të ardhurave të planifikuara për pushtetin vendor, minus shumën 14,014 milionë lekë Grant i pakushtëzuar nga buxheti qendror.

Nga shuma e planifikuar janë realizuar 11,792 milionë lekë ose në masën 77.1% kundrejt tij, me një impakt deficitar në vlerë prej 3,508 milionë lekë. Madje, dhe kundrejt të ardhurave të realizuara në vitin 2010, përkatësisht në shumën 11,898 milionë lekë, ato paraqiten me ulje në vlerën 106 milionë lekë më pak.

Kundrejt PBB-së të vitit 2011, të ardhurat nga vetë pushteti vendor zënë 0.90%, nga 0.96% të PBB-së që zinin në vitin 2010.


*Sipas llojit të të ardhurave vendore, tre zërat kryesorë, paraqiten si më poshtë:*

- o Taksa lokale, rezulton me mosrealizim të theksuar, ajo është realizuar në masën 66.6% kundrejt planit, me një mosrealizim në vlerë prej 3,650 milionë lekë.
- o Taksa mbi pasurinë (ndërtesat) paraqitet me realizim në masën 105%, nga 1,850 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 1,942 milionë lekë, me një tejkalim në vlerë prej 92 milionë lekë.
- o Të ardhurat nga tatimi mbi biznesin e vogël paraqiten me realizim në masën 102%, nga 2,520 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 2,570 milionë lekë, me një tejkalim në vlerë prej 50 milionë lekë.

*Shpenzimet faktike të pushtetit vendor për vitin 2011, rezultojnë në shumën 28,119 milionë lekë nga 29,314 milionë lekë të planifikuara ose në masën 95.9%, me një mosshpenzim në vlerë prej 1,195 milionë lekë. Krahasuar me nivelin e shpenzimeve të realizuar në vitin 2010 (30,764 milionë lekë), ato rezultojnë në masën 8% më të ulta, e barabartë me 2,645 milionë lekë fond shpenzimesh në pak.*

Kundrejt PPB-së të rezultuar në vitin 2011, ato zënë 2.14% të tij, nga 2.48% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit vendor për periudhën 2007-2011, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Për llogari të zbatimit të buxhetit të pushtetit vendor të vitit 2011, KLSH ka ushtruar auditim në 41 njësi të pushtetit vendor, përkatësisht në 18 bashki, 1 prefekturë, 16 komuna, 4 njësi rajonale ALUIZNI dhe 2 zyra të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Gjatë auditimeve të ushtruar, krahas punës së bërë janë konstatuar dhe mjaft të meta dhe parregullsi, të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave vendore.

Ndër mangësitë, parregullsitë dhe shkeljet me pasojë dëm ekonomik paraqesim:

### IX.1. Në fushën e të ardhurave.

1. *Si pasojë e mosndjekjes dhe moszbatimit me rigorozitet të përcaktimeve në kuadrin ligjor që rregullon grumbullimin e të ardhurave vendore, përfshirë udhëzimet e përbashkëta, ndërmjet MF me MB-me dhe DPT-në,* janë pakësuar ndjeshëm të ardhurat e realizuara nga njësitë e qeverisjes vendore.

Në kontekstin e mësipërm, vlen të cilësohen konstatimet e audituesve të KLSH në disa nga njësitë e qeverisjes vendore të audituara gjatë vitit 2011, lidhur me planifikimin me rezervë të të ardhurave nga tatimet dhe taksat në nivel vendor, si dhe mosargumentimin për mënyrën e llogaritjes të masës së treguesit fiskal, si: xhiroja vjetore nga subjektet e biznesit të vogël, numri i familjeve për tarifën e pastrimit apo të gjelbërimit; sipërfaqja e ndërtesave, taksa e regjistrimit të automjeteve etj. Ndër subjektet ku kemi konstatuar planifikim me rezerva për lloje të ndryshme taksash apo tarifash përmendim: *bashkitë Rrëshen, Rubik, Peqin, Delvinë, Bajram Curri, komunat Milot dhe Lenie Gramsh etj.*

Sipas llojit të taksës e të tarifave vendore, gjatë auditimeve janë konstatuar përsa vijon:

- *Për tarifën e pastrimit;* në *Bashkinë Bajram Curri*, nuk kanë paguar këtë tarifë 991 familje me një vlerë të llogaritur prej 464 mijë lekë, po kështu disa subjekte private me një vlerë prej 1,478 mijë lekë; gjithashtu, në *Bashkinë Shijak* 1,554 mijë lekë; *Bashkinë Ura Vajgurore* 521 mijë lekë etj.
- *Për taksën e ndërtesës,* ka rezultuar se, *Bashkia Rubik* ka realizuar të ardhurat nga kjo taksë në masën 63%, pasi prej saj nuk është programuar taksimi i ndërtesave të disa ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore; në *Bashkinë Prrenjas* nga niveli i planifikuar i kësaj takse nuk janë arkëtuar 270 mijë lekë; po kështu në *Bashkinë Ura Vajgurore* 1,365 mijë lekë; *Komunën Bradashesh Elbasan* 408 mijë lekë etj.
- *Për taksën e tokës bujqësore,* në 9 njësi të pushtetit vendor vlera e mosrealizimit të të ardhurave nga kjo taksë llogaritet në 15,010 mijë lekë; përkatësisht: në *bashkitë Prrenjas* shuma 167 mijë lekë dhe *Ura Vajgurore* 1,533

mijë lekë; *komunat Farkë, Tiranë* 1,868 mijë lekë; *Kuman Fier* 3,680 mijë lekë; *Milot* 3,086 mijë lekë; *Xarë Sarandë* 3,285 mijë lekë etj.

- *Për tarifën e ndriçimit*, të ardhurat e realizuara në disa bashki janë fare minimale, si në *Bashkinë Shijak* realizuar në masën 28%, po kështu në *Bashkinë Ura Vajguore* ku nuk janë arkëtuar për llogari të kësaj tarife 389 mijë lekë. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për taksën e reklamës, të regjistrimit të automjeteve etj.

**2. Të metat dhe mangësitë në bashkëpunimin dhe rakordimin ndërmjet zyrave të taksave në njësitë vendore, Drejtorive Rajonale Tatimore në Qarqe dhe qytete, zyrave të gjendjes civile, zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, zyrave të kadastrës dhe zyrave të urbanistikës, gjë që ka ndikuar si në planifikimin e jo real ashtu dhe në realizimin në nivele të ulëta të taksave dhe tarifave vendore.** Për t'u pasqyruar:

- *Bashkia Bajram Curri*, e cila nuk ka planifikuar dhe nuk ka arkëtuar taksën e tokës bujqësore, megjithëse në territorin në juridiksionin e saj, sipas evidencës të zonës kadastrale të zyrës së urbanistikës rezultojnë 88,443 m<sup>2</sup> tokë arë të zaptuara nga pretendues si pronar të ligjshëm, por pa dokumente pronësie.

- *Komuna Lenie Gramsh*, për taksën e tokës bujqësore, pasi nuk ka kërkuar në ZVRPP informacionin e nevojshëm mbi tokën bujqësore që disponojnë qytetarët, me qëllim llogaritjen dhe arkëtimin e taksës dhe konfirmimin nga Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark për të dhënat për klasifikimin e tokës bujqësore dhe bonitetit sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" me ndryshimet.

- *Komuna Farkë, Tiranë*, e cila për taksën mbi tokën bujqësore nuk ka kryer rakordimin me zyrën e kadastrës dhe urbanistikës për ndryshimin e sipërfaqes së tokës bujqësore në tokë truall, pasi fizikisht dhe juridikisht kjo sipërfaqe nuk rezulton si tokë bujqësore, por tokë truall me ndërtime.

**3. Moskryerja periodikisht e kontrollin fiskal dhe mosmarrja e masave ndëshkimore ndaj subjekteve të parregullta, konformë dispozitave ligjore në fuqi.**

KLSH ka konstatuar se, pothuajse në të gjitha bashkitë e audituara, ka subjekte të parregullta të cilët ushtrojnë aktivitet pa leje dhe nuk paguajnë detyrimet për taksat vendore. Ndërkohë, nga zyrat e taksave vendore në Bashki nuk zbatohen procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve vendore.

Gjithashtu, jo në të gjitha rastet për subjektet debitorë, i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Transporteve vendosja e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme (mjetet e transportit), apo dërguar degëve të Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive, në kundërshtim me nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, *ç'ka tregon se efektiviteti i punës së punonjësve të taksave dhe policive bashkiake apo komunave në drejtim të vjeljes së detyrimeve fiskale ende nuk është efiçente.*

Për subjektet debitorë, në mjaft njësi të qeverisjes vendore nuk janë zbatuar procedurat ligjore të vjeljes së detyrimeve, të cilat arrijnë në vlerën 52,738 mijë lekë, kjo dhe për arsye të daljes së ligjit të faljes nr. 10418, datë 21/4/2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor".

Për t'u përmendur:

- *Bashkia Elbasan*, për 837 subjekte debitorë në vlerën 23,165 mijë lekë.

- *Bashkia Peqin dhe Bajram Curri*, përkatësisht 4,255 mijë lekë dhe 500 mijë lekë.

- *Bashkia Shijak*, 29 subjekte në vlerën 834 mijë lekë.

- *Bashkia Rubik*, 18 subjekte të biznesit të vogël me vlerë 460 mijë lekë dhe 6 shoqëri tregtare me vlerë 640 mijë lekë.
- *Bashkia Poliçan*, 5 subjekte të biznesit të vogël me vlerë 460 mijë lekë dhe 3 shoqëri tregtare me vlerë 419 mijë lekë.
- *Bashkia Cërrik*, 12 subjekte në shumën 507 mijë lekë.
- *Bashkia Peshkopi*, 49 subjekte të pa licencuara të cilët nuk kanë arkëtuar vlerën 744 mijë lekë.
- *Bashkia Rrëshen*, 33 subjekte me vlerë 882 mijë lekë.
- *Komuna Bradashesh*, 48 subjekte me vlerë 12,311 mijë lekë.
- *Komuna Kuman Fier*, vlera 6,194 mijë lekë.
- *Komuna Lenie Gramsh*, 298 debitorë me një shumë prej 171 mijë lekë.
- *Komuna Bushat*, 42 subjekte me vlerë 1,004 mijë lekë.
- *Komuna Qukës*, 15 subjekte biznesi i vogël me vlerë 244 mijë lekë dhe 4 subjekte të biznesit të madh me vlerën 362 mijë lekë etj.

4. *Mangësitë në dokumentimin e taksave dhe tarifave vendore*, si në: *zyrat e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Poliçan dhe Komunën Qukës Librazhd*, ku regjistrat e taksapaguesve rezultojnë të pa azhurnuar, gjithashtu rezultojnë të paplotësuar kartelat për taksat dhe tarifave vendore sipas të dhënave për vendndodhjen, numrin e identifikimit dhe llojin e aktivitetit me qëllim evidentimin dhe ndjekjen e tyre.

o Në disa bashki edhe komuna nuk janë të pasqyruar në kontabilitet detyrimet tatimore vendore në kundërshtim me ligjin, duke mos ndjekur në vazhdimësi arkëtimin e debitorëve, fenomen ky i konstatuar në: *Bashkinë Bajram Curri, Komunitat: Karinë Peqin, Lenie Gramsh dhe Qukës Librazhd* etj.

Megjithëse në shumicën e subjekteve janë vendosur kasat fiskale dhe rimbursimi i tyre po u bëhet duke zbritur detyrimet, mjaft prej subjekteve nuk i përdorin ato, për pasojë nuk pasqyrojnë xhiron reale. Shteti u njeh detyrim çdo subjekti 44,000 lekë për kasë, ndërkohë nuk konstatohet rritje e xhiros apo të detyrimeve fiskale, ç'ka bën që vendosja e tyre të mos i shërbejë qëllimit të administrimit.

5. *Shkeljet e ndryshme ekonomiko financiare të konsideruara me dëm ekonomik përfshi ALUIZMIN*, si pasojë e mosarkëtimit të burimeve të të ardhurave të parashikuara me dispozitat ligjore llogariten **në 155,828 mijë lekë**, si më poshtë:

a) *Në fushën administrimit të aseteve për shitjen dhe dhënien me qira të tyre në vlerën 1,827 mijë lekë*, përkatësisht në:

- *Bashkinë Berat*, në vlerën 111 mijë lekë, si rezultat i mosarkëtimit të qirasë së objekteve të dhëna me qira.
- *Bashkinë Laç*, në vlerën 843 mijë lekë, si rezultat i mosarkëtimit të qirasë së objekteve të dhëna me qira dhe kamatëvonesave për pagesat me vonesë.
- *Bashkinë Elbasan*, në vlerën 120 mijë lekë, si rezultat i mosarkëtimit të qirasë së objekteve të dhëna me qira dhe kamatëvonesave për pagesat me vonesë.
- *Bashkinë Rrëshen*, në vlerën 543 mijë lekë, si rezultat i mosarkëtimit të kamatëvonesave për pagesat me vonesë.
- *Bashkinë Delvinë*, në vlerën 210 mijë lekë, si rezultat i mosarkëtimit të qirasë së objekteve të dhëna me qira.

b) *Në fushën e urbanistikës vlera e shkeljeve arrin në 25,256 mijë lekë*, përkatësisht në:

- *Bashkinë Berat*, në vlerën 118 mijë lekë, si rezultat i mospagesës së detyrimeve

nga subjektet për marrjen e lejes së ndërtimit.

- *Bashkinë Lezhë*, në vlerën 6 mijë lekë, si rezultat i mospagesës së detyrimeve nga subjektet për marrjen e lejes së ndërtimit.

- *Bashkinë Bajram Curri*, në vlerën 12 mijë lekë dhe *Bashkinë Rrëshen*, në vlerën 11,228 mijë lekë, si diferenca në llogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi.

- *Bashkitë Peqin*, në vlerën 30 mijë lekë, *Shkodër* në vlerën 8,222 mijë lekë dhe *Rubik* në vlerën 64 mijë lekë, si rezultat i mospagesës së detyrimeve nga subjektet për marrjen e lejes së ndërtimit.

- *Bashkinë Peshkopi*, në vlerën 6,220 mijë lekë si rezultat i mosarkëtimit të detyrimeve nga financimi i studimeve urbanistike dhe i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi.

- *Bashkinë Përrenjas*, në vlerën 356 mijë lekë diferenca në përllogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi.

c) *Në fushën e legalizimeve të ndërtimeve pa leje vlera e shkeljeve arrin në 127,745 mijë lekë*, përkatësisht në:

- *Drejtorinë Qendrore të AUIZNI*, në vlerën 51,881 mijë lekë, nga e cila:

- vlera 46,391 mijë lekë, për moszbatim dhe mosarkëtim të penaliteteve për ndryshim destinacioni të objektit ndërtimor; 3,971 mijë lekë diferenca në llogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe të moszbatimit të penaliteteve për vonesat nga vetëdeklarimi; 1,185 mijë lekë penalitete për legalizimin e shtesave pa leje për kalim pronësie; 113 mijë lekë diferenca në pagesat e subjekteve si rezultat i llogaritjes së gabuar të vlerës së parcelës ndërtimore; dhe 221 mijë lekë diferenca nga llogaritja gabim e gjobave dhe penaliteteve për shkelje të projektit dhe shkelje të disiplinimit të punimeve.

- *Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI, Durrës*, në vlerën 31,529 mijë lekë diferenca nga llogaritja gabim e vlerës së parcelës ndërtimore.

- *Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI, Tiranë*, në vlerën 8,777 mijë lekë, nga e cila: 8,714 mijë lekë diferenca të paarkëtuara si rezultat i llogaritjes së gabuar të vlerës së parcelës ndërtimore; 47 mijë lekë diferenca në llogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe të moszbatimit të penaliteteve për vonesat nga vetëdeklarimi; dhe 16 mijë lekë diferenca nga llogaritja dhe arkëtimi i tarifës së shërbimit.

- *Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI, Vlorë*, në vlerën 35,558 mijë lekë, nga e cila: 35,116 mijë lekë diferenca të paarkëtuara nga llogaritja e gabuar e vlerës së parcelës ndërtimore; 426 mijë lekë diferenca në llogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë; dhe 16 mijë lekë diferenca nga llogaritja dhe arkëtimi i tarifës së shërbimit.

## **IX.2. Në fushën e shpenzimeve.**

Auditimet e ushtruara nga KLSH gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2011, në fushën e shpenzimeve, kryesisht janë përqendruar në zbatimin e ligjshmërisë, lidhur me administrimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, në përfundim të të cilave krahas punës së bërë, janë konstatuar edhe *mjaft parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, me një dëm ekonomik në shumën 24,749 mijë lekë*, nga e cila 17,172 mijë lekë ose rreth 70% e vlerës totale të zbulimeve është konstatuar në fushën e prokurimeve.



Pasqyruar sipas natyrës së shkeljeve, gjendja paraqitet:

**a) Në fushën e pagave dhe shpërblimeve, vlera e shkeljeve të disiplinës financiare me dëm ekonomik rezulton 3,340 mijë lekë.** Sipas subjekteve ku janë konstatuar shkeljet paraqesim:

- *Bashkinë Laç*, në vlerën 482 mijë lekë pagesë tepër mbi kohën normale të punës.
- *Bashkinë Shkodër*, në vlerën 120 mijë lekë dhe *Bashkinë Rubik* në vlerën 524 mijë lekë, pagesa tepër për paga.
- *Bashkinë Delvinë*, në vlerën 225 mijë lekë pagesa tepër nga fondi i veçantë.
- *Bashkinë Peshkopi*, në vlerën 1,143 mijë lekë, nga e cila 1,008 mijë lekë pagesë tepër mbi kohën normale të punës dhe 135 mijë lekë pagesa tepër për shpërblime dhe aktivitet social-kulturor për personelin.
- *Bashkinë Tepelenë*, në vlerën 666 mijë lekë, *Polican* në vlerën 82 mijë lekë dhe *Komunën Milot, Qarku Lezhë* në vlerën 49 mijë lekë, pagesa tepër për paga.
- *Komunën Lenie Gramsh*, në vlerën 49 mijë lekë, pagesë tepër për dy funksione njëkohësisht.

**b) Në fushën e shpenzimeve operative, vlera e shkeljeve arrin në 4,229 mijë lekë,** përkatësisht në:

- *Bashkinë Lezhë*, në vlerën 1,484 mijë lekë pagesa tepër për shpërblime të sportistëve të klubit sportiv.
- *Bashkinë Rrëshen*, në vlerën 279 mijë lekë, nga e cila 255 mijë lekë pagesa tepër për udhëtim e dieta dhe 24 mijë lekë pagesa tepër për pritje e përcjellje.
- *Bashkinë Peshkopi*, në vlerën 54 mijë lekë pagesa tepër për udhëtim e dieta.
- *Bashkinë Tepelenë* në vlerën 120 mijë lekë dhe *Bashkinë Prrenjas* në vlerën 426 mijë lekë, pagesa tepër për telefoninë celulare.
- *Komunën Milot, Qarku Lezhë* në vlerën 358 mijë lekë, pagesa tepër mbi tarifën e përcaktuara të studim projektimit.
- *Komunën Dajç Shkodër*, në vlerën 206 mijë lekë, nga e cila 85 mijë lekë pagesa tepër për udhëtim e dieta dhe 121 mijë lekë pagesa tepër për koktejt për administratën.
- *Komunën Kryevidh Kavajë*, në vlerën 15 mijë lekë pagesa tepër për udhëtim e dieta.
- *Komunën Qukës Librazhd*, në vlerën 392 mijë lekë, nga e cila 53 mijë lekë pagesa tepër për siguracion ndërkombëtar mjete dhe 339 mijë lekë shpenzime të pajustificuara për karburant.
- *Komunën Lenie Gramsh*, në vlerën 403 mijë lekë, nga e cila 245 mijë lekë pagesa tepër për udhëtim e dieta, 80 mijë lekë pagesa tepër për pritje e përcjellje dhe 78 mijë lekë pagesa tepër për telefoninë celulare.
- *Drejtoria Rajonale të ALUIZNI në Tiranë*, në vlerën 480 mijë lekë pagesa tepër për shërbim lyster dhe në *Vlorë* në vlerën 12 mijë lekë pagesa tepër për qiranë e zyrave.

**c) Në fushën e prokurimeve, vlera e shkeljeve prej 17,172 mijë lekë** është konstatuar gjatë procesit të zbatimit të procedurave të prokurimit dhe konkretisht: Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011, në subjektet e audituar në nivel vendor, nga 196 procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë 2,622 milionë lekë, janë audituar 127 procedura prokurimi në vlerën 2,076 milionë lekë, përkatësisht 65% të numrit dhe 80% të vlerës. Në procedurat e audituara, janë konstatuar shkelje në 88 procedura prokurimi me një efekt financiar prej 17,172 mijë lekë, shkelje të cilat janë konstatuar në drejtimet e mëposhtme:

- Nga mosargumentimi i fondit limit në 28 procedura prokurimi, në kundërshtim me nenin 28 të ligjit të prokurimit publik (LPP).
- Nga mosdokumentimi i zhvillimit të proceduarve të prokurimit, duke mos mbajtur procesverbale në 10 subjekte, në kundërshtim me nenin 12 të LPP.
- Në mospërcaktimin e dokumenteve të tenderave në 38 procedura prokurimi, në kundërshtim me nenin 41 të LPP.
- Në mospërcaktimin e qartë të specifikimeve teknike dhe përgatitjen e dokumenteve të tenderëve në 57 procedura, në kundërshtim me nenet 23,41 dhe 42, të LPP.
- Në hapjen dhe shqyrtimin e ofertave në 31 procedura prokurimi në kundërshtim me nenet 45,52,53 dhe 57 të LPP.
- Në paraqitjen e ofertave në vlera anomalisht të ulta në 25 procedura prokurimi, në kundërshtim me nenin 56 të LPP.
- Në lidhjen e aktmarrëveshjeve të përbashkëta, në 23 procedura prokurimi në kundërshtim me VKM “Për prokurimin Publik”, Kapitulli VII, pika 1.
- Në mosmbikëqyrjen dhe moszbatimin e kontratave në 25 procedura në kundërshtim me nenin 58 të LPP.
- Në mosarkivimin e dosjeve në 19 procedura prokurimi, në kundërshtim me ligjin për Arkivat etj.
  - Në mënyrë të detajuar, shkeljet në fushën e prokurimeve sipas subjekteve dhe llojit të tyre, paraqiten si më poshtë:
    - *Bashkinë Lezhë*, në vlerën 168 mijë lekë paguar më tepër volume për shërbim gjelbërimin.
    - *Bashkinë Bajram Curri*, në vlerën 2,340 mijë lekë penalitete për mospërfundim punimesh në afat.
    - *Bashkinë Elbasan*, në vlerën 780 mijë lekë pagesa për punime të pakryera në investime
    - *Bashkinë Rrëshen*, në vlerën 958 mijë lekë, nga e cila 739 mijë lekë pagesa më tepër nga rritja e artificiale e fondit limit dhe kontratës dhe 219 mijë lekë pagesë tepër për mall të munguar.
    - *Bashkinë Peqin*, në vlerën 298 mijë lekë pagesa për punime të pakryera për pastrimin e qytetit dhe llogaritje më pak e vlerës së preventivit.
    - *Bashkinë Shkodër*, në vlerën 268 mijë lekë pagesa për punime të pakryera në kundërshtim me kontratën.
    - *Bashkinë Peshkopi*, në vlerën 320 mijë lekë pagesa tepër për ndryshim të çmimit të bukës nga kontrata bazë në atë të kontratës shtesë.
    - *Komunën Golem Kavajë*, në vlerën 1,942 mijë lekë; *Komunën Gjepalaj Durrës* në vlerën 395 mijë lekë; *Komunën Farkë Tiranë* në vlerën 248 mijë lekë; *Komunën Petrelë Tiranë* në vlerën 562 mijë lekë; dhe *Komunën Bradashesh Elbasan* në vlerën 482 mijë lekë; pagesa për punime të pakryera në kundërshtim me kontratën.
    - *Komunën Qukës Librazhd*, në vlerën 8,411 mijë lekë, nga e cila 5,011 mijë lekë penalitete për mospërfundim punimesh në afat, 3,271 mijë lekë diferenca ofertash si pasojë e s’kualifikimit të padrejtë të tyre dhe 129 mijë lekë paguar tepër projektuesin mbi tarifën e përcaktuara të studimit projektimit.
- d) Në fusha të tjera vlera e shkeljeve arrin në 8 mijë lekë, e konstatuar në Komunën Lenie Gramsh.**

## X. ADMINISTRIMI I BUXHETIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Miratimi i buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është bërë me ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”, ndryshuar me ligjin nr. 10450, datë 14/7/2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”; ligjin nr. 10496, datë 22/12/2011 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 14/12/2011 të KM “Për një ndryshim në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar”. Gjithashtu, me vendimin e KM nr. 909, datë 28/12/2011, ISSH-së i janë akorduar 800 milionë lekë dhe nga këto janë kaluar në llogari të tij vetëm 700 milionë lekë (100 milionë lekë janë pakësuar me shkresën e MF nr. 24151, datë 30/12/2011).

Referuar dispozitave ligjore të mësipërme, pas ndryshimeve përfundimtare, programi financiar për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, paraqitet si më poshtë vijon:

### 1. Për sigurimet shoqërore

a) *Të ardhurat gjithsej*, janë programuar në shumën 86,734 milionë lekë, nga të cilat nga mbledhja e kontributeve 50,010 milionë lekë dhe transferta e buxhetit të shtetit 36,724 milionë lekë.

b) *Shpenzimet gjithsej*, janë programuar në vlerën 86,734 milionë lekë, nga të cilat për skemën e detyrueshme 81,262 milionë lekë dhe skemën suplementare 5,472 milionë lekë. Këto shpenzime janë planifikuar të përballohen me të ardhurat e programuara si më sipër.

### 2. Për sigurimet shëndetësore

a) *Të ardhurat gjithsej*, janë programuar në shumën 27,767 milionë lekë, nga të cilat nga mbledhja e kontributeve 6,510 milionë lekë, transferta e buxhetit të shtetit 20,857 milionë, të tjera 100 milionë lekë dhe nga ndryshimi i gjendjes së arkës së ISKSH 300 milionë lekë.

b) *Shpenzimet gjithsej*, janë programuar në vlerën 27,767 milionë lekë, nga të cilat për financimin e shërbimit spitalor 13,045 milionë lekë, financimin e kujdesit parësor 6,470 milionë lekë, rimbursimin e barnave 6,900.5 milionë lekë, financimin e spitalit Durrës 669.5 milionë lekë; investime 15 milionë lekë dhe shpenzime administrative 667 milionë lekë. Këto shpenzime janë planifikuar të përballohen me të ardhurat e programuara si më sipër.

Në mënyrë të detajuar, plani dhe realizimi i të ardhurave nga kontributet, sipas zërave dhe nëzërave për vitin 2011, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Në milionë/ lekë*

Nr.	EMËRTIMI	Realizimi faktik i të ardhurave sipas llojeve				TOTALI			
		Sigurimet Shoqërore	Sigurimet Shëndet.	Sigurimet Suplem.	Të tjera	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
1.	Nga subjektet juridike dhe fizike	44,532	6,357	637	-	53,560	51,526	- 2,034	96.2
2.	Të vetpunësuarit në bujqësi	2,413	125	-	-	2,394	2,538	+ 144	106.0
3.	Sigurimi vullnetar	377	-	-	-	381	377	- 4	99.0
4.	Subjekte të ndryshme	8	-	4	-	-	12	12	-
5.	Të ardhura të tjera	-	-	-	426	185	426	+ 241	230.3

## RAPORT PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2011

Nr.	EMËRTIMI	Realizimi faktik i të ardhurave sipas llojeve				TOTALI			
		Sigurimet Shoqërore	Sigurimet Shëndet.	Sigurimet Suplem.	Të tjera	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
	Nga kjo:						0	0	
5.1	Të ardhura nga investimet financiare				341	185	341	156	184.3
5.2	Kamatvonesa të kontratave të fermerëve	-	-	-	77	-	77	77	-
5.3	Shërbime administrat.	-	-	-	2	-	2	2	-
5.4	Shitje të aktiveve	-	-	-	6	-	6	6	-
<b>I.</b>	<b>TOTALI (1+2+3+4+5):</b>	<b>47,330</b>	<b>6,482</b>	<b>641</b>	<b>426</b>	<b>56,520</b>	<b>54,879</b>	<b>-1,641</b>	<b>97.1</b>
	Nga kjo:								
I.1	DPT	44,532	6,357	637	0	53,560	51,526	-2,034	96.2
I.2	ISSH	2,798	125	4	426	2,960	3,353	393	113.3
<b>I.</b>	<b>TOTALI (1+2+3+4+5)::</b>	<b>47,330</b>	<b>6,482</b>	<b>641</b>	<b>426</b>	<b>56,520</b>	<b>54,879</b>	<b>-1,641</b>	<b>97.1</b>
	Nga kjo:								
I.1	Sigurimi shoqëror	47,330	-	-	426	49,730	47,756	-1,974	96.0
I.2	Sigurimi suplementar	-	-	641	-	280	641	361	228.9
I.3	Sigurimi shëndetësor	-	6,482	-	-	6,510	6,482	-28	99.6
<b>I.</b>	<b>TOTALI (II.1+II.2):</b>	<b>47,330</b>	<b>6,482</b>	<b>641</b>	<b>426</b>	<b>56,520</b>	<b>54,879</b>	<b>-1,641</b>	<b>97.1</b>
I.1	<i>Nga DPT</i>	<i>44,532</i>	<i>6,357</i>	<i>637</i>	<i>-</i>	<i>53,560</i>	<i>51,526</i>	<i>-2,034</i>	<i>96.2</i>
a)	Për ISSH	44,532	-	637	-	47,220	45,169	-2,051	95.7
b)	Për ISKSH	-	6,357	-	-	6,340	6,357	17	100.3
II.2	<i>Nga ISSH</i>	<i>2,798</i>	<i>125</i>	<i>4</i>	<i>426</i>	<i>2,960</i>	<i>3,353</i>	<i>+ 393</i>	<i>111.3</i>
a)	Për ISSH	2,798	-	4	426	2790	3,228	438	115.7
b)	Për ISKSH	-	125	-	-	170	125	-45	73.5

Në këtë tabelë, krahas të dhënave të detajuara për vitin 2011, paraqiten dhe shifrat e planit dhe realizimit të të ardhurave veçmas për ISSH dhe veçmas për ISKSH, madje të ndara dhe sipas përgjegjëseve, dhe konkretisht:

a) Nga ISSH, të ardhurat nga 2,960 milionë lekë të programuara, u realizuan 3,353 milionë lekë ose *në masën 113.3%*, me një tejkalim prej 393 milionë lekë.

b) Nga DPT, të ardhurat nga 53,560 milionë lekë, në fakt janë realizuar 51,526 milionë lekë ose *në masën 96.2%*, me një mosrealizim në vlerë prej 2,034 milionë lekë.

Realizimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore sipas DRT-ve në rrethe, për vitin 2011, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë/lekë

Nr.	Degët Rajonale Tatimore	PERIUDHA 12 - MUJORE							
		Realizimi Faktik		Plani	Diferenca Plan – Fakt		Diferenca Fakt 2011-2010		
		2010	2011	2011	+ ose -	%	+ ose -	%	
<b>I.</b>	<b>Kontribute gjithsej</b>	48,169	51,526	53,560	- 2,034	96	+ 3,357	107	
Nga të cilat:									
1.	Berat	1,505	1,598	1,696	- 98	94	+ 93	106	
2.	Dibër	1,137	1,208	1,257	- 49	96	+ 71	106	
3.	Durrës	3,995	4,297	4,634	- 337	93	+ 302	108	
4.	Elbasan	2,593	2,703	2,935	- 232	92	+ 110	104	
5.	Fier	2,667	2,771	3,024	- 253	92	+ 104	104	
6.	Gjirokastrë	1,136	1,175	1,296	- 121	91	+ 39	103	
7.	Korçë	2,322	2,397	2,652	- 255	90	+ 75	103	
8.	Kukës	819	843	906	- 63	93	+ 24	103	

9.	Lezhë	1,354	1,440	1,507	- 67	96	+ 86	106
10.	Sarandë	656	672	738	- 66	91	+ 16	102
11.	Shkodër	2,420	2,523	2,706	- 183	93	+ 103	104
12.	Tiranë	14,978	16,689	16,405	+ 284	102	+ 1,711	111
13.	NJTPM Tiranë	10,738	11,263	11,710	- 447	96	+ 525	105
14.	Vlorë	1,849	1,947	2,094	- 147	93	+ 98	105

Nga këto të dhëna të disponueshme të DPT, rezulton se të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2011, kundrejt planifikimit janë realizuar *në masën 96.2% dhe në vlerë 2,034 milionë lekë më pak se parashikimi* (nga 53,560 milionë lekë plani, janë realizuar 51,526 milionë lekë). Në krahasim me faktin e vitit 2010, në vitin 2011 rezulton një rritje prej 3,357 milionë lekë ose në masën rreth 7% më shumë.

Analizuar sipas DRT-ve, rezulton se për vitin 2011, paraqitet me realizim vetëm DRT Tiranë në masën 101.7% ose 284 milionë lekë më shumë se sa parashikimi, kurse të gjithë DRT-të e tjera paraqiten me mosrealizim, i cili varion nga 4%-10%.

Në totalin e të ardhurave tatimore gjithsej, *të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore zenë rreth 17% të totalit të të ardhurave tatimore dhe 47.5% të totalit të të ardhurave tatimore të realizuar nga DPT.*

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore në shumën 51,527 milionë lekë, janë realizuar nga:

**a)** Sektori shtetëror në vlerën 25,342 milionë lekë ose 49% e të ardhurave, kjo për numrin mesatar kontribuesish (160,318), me një nivel mesatar pagese për kontribues prej 158.2 mijë lekë/vit.

**b)** Sektori privat në vlerën 26,188 milionë lekë ose 51% e të ardhurave, kjo për numrin mesatar kontribuesish (260,900), me një nivel pagese për kontribut prej 97.4 mijë lekë/vit.

Nga të dhënat e mësipërme *të raportuar nga DPT*, rezulton se, numri mesatar i kontribuesve me deklaram dhe pagesë për vitin 2011 paraqitet prej 421,218 kontribues, ose 33,012 kontribues më shumë se në vitin 2010, me një numër mesatar kontribuesish për subjekt prej rreth *5.4 kontribues/subjekt (421,218 kontribues mesatar me pagesë kundrejt 78,636 subjekte me pagesë)*, kurse numri i subjekteve mosdeklarues në fund të vitit 2011 paraqitet *37,887 subjekte*. Në krahasim me vitin 2010, ky tregues paraqitet me rritje përkatësisht *10,359 subjekte* mos deklarues.

Nisur sa më sipër, si dhe nga mundësitë që ekzistojnë në tregun e punës, konstatojmë se, *angazhimi i strukturave përkatëse në DPT dhe në njësitë vartëse të saj, për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve, ka pasur mangësi të theksuara*, të cilat kanë penguar realizimin e detyrave të planit të miratuar nga MF.

Nga auditimet e kryera e të evaduara nga KLSH në ISSH dhe në ISKSH, si dhe njësitë vartëse të tyre, për llogari të buxhetit të vitit 2011, vlen të pasqyrohen rastet e shkeljeve të dispozitave ligjore në fuqi *me pasojë dëm ekonomik, të cilat llogariten në vlerën 70,367 mijë lekë* (kjo vlerë është raportuar si gjetje në Kapitullin IV “Administrimi i shpenzimeve të buxhetit të shtetit”).

Sipas subjekteve ku janë konstatuar këto shkelje, paraqesim:

**1. ISSH Tiranë në shumën 8,924 mijë lekë**, nga e cila: 8,785 mijë lekë shkaktuar nga përfitimi më tepër i pensioneve të pleqërisë dhe invaliditetit me anë të

përdorimit të dokumenteve fiktive dhe mashtrimit; 75 mijë lekë përfituar punonjësit më tepër nga fondi i veçantë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 929, datë 17/10/2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” dhe VKM nr. 493, datë 6/7/2011; dhe 64 mijë lekë përfituar padrejtësisht për shpenzime për udhëtim e dieta brenda vendit, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 997, datë 10/12/2010.

2. *DRSSH Tiranë* në shumën 60,103 mijë lekë, nga e cila: 59,216 mijë lekë përfaqësojnë pagesa të kundërligjshme nga fondet e sigurimeve shoqërore, për të cilat nuk janë nxjerrë urdhërat e pezullimit; 542 mijë lekë paguar punonjës në kundërshtim me vendimin e Këshillit Administrativ të ISSH; dhe 345 mijë lekë nga përdorimi i fondit të veçantë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 929, datë 17/10/2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”.

3. *ISKSH Tiranë*, në fushën e të ardhurave në shumën 270 mijë lekë, si pasojë e mosaplikimit të penaliteteve për farmacitë që kanë kryer aktivitet tregtimi pa dokumentacionin e nevojshëm ligjor, në kundërshtim me udhëzimin metodik të MSH nr. 2, datë 1/1/2003; në fushën e shpenzimeve në shumën 1,070 mijë lekë, nga e cila 965 mijë lekë përfitime të padrejta nga subjekte juridikë privatë, si pasojë e moszbatimit të kushteve të kontratave të lidhura; dhe 105 mijë lekë shpenzime për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 997, datë 10/12/2010 dhe VKM nr. 304, datë 8/5/2003 të shfuqizuar me VKM nr. 870, datë 14/12/2011.

## X.1 BUXHETI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Plani fillestar, shtesat dhe pakësimet e tij, sipas të dhënave të përpunuara dhe raportuara nga ISSH, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Në milionë/lekë

EMËRTIMI	Plani fillestar	Shtesa	Pakësim	Plani përfundimtar
1. Sigurimi i detyrueshëm	79,828	1,634	200	81,262
2. Sigurimet suplementare	5,472	0	0	5,472
<b>TOTALI:</b>	<b>85,300</b>	<b>1,634</b>	<b>200</b>	<b>86,734</b>

Pas reflektimit të të gjitha ndryshimeve të bëra me dispozitat ligjore të sipërcituara, *buxheti përfundimtar për ISSH-në për vitin 2011*, paraqitet si më poshtë:

Në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	Plani fillestar	Shtesa dhe Pakësime	Plani me ndryshime
<b>I.</b>	<b>Skema e detyrueshme</b>			
<b>I.1</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>79,828</b>	<b>1,434</b>	<b>81,262</b>
I.1.a	Nga kontributet	50,930	-1,200	49,730
I.1.b	Transferte nga buxheti i shtetit	28,898	2,634	31,532
<b>I.2</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>79,828</b>	<b>1,434</b>	<b>81,262</b>
<b>II.</b>	<b>Skema suplementare</b>			
<b>II.1</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>5,472</b>	<b>0.0</b>	<b>5,472</b>
II.1.a	Nga kontributet	280	0.0	280
II.1.b	Transferte nga buxheti i shtetit	5,192	0.0	5,192
<b>II.2</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>5,472</b>	<b>0.0</b>	<b>5,472</b>
<b>III.</b>	<b>Gjithsej (I+II)</b>			



<b>III.1</b>	<b><i>Të ardhurat (I.1 + II.1):</i></b>	<b><i>85,300</i></b>	<b><i>1,434</i></b>	<b><i>86,734</i></b>
III.1.a	Nga kontributet (I.1.a + II.1.a)	51,210	-1,200	50,010
III.1.b	Transferte nga buxheti i shtetit (I.1.b + II.1.b)	34,090	2,634	36,724
<b>III.2</b>	<b><i>Shpenzimet (I.2 + II.2):</i></b>	<b><i>85,300</i></b>	<b><i>1,434</i></b>	<b><i>86,734</i></b>

Buxheti i sigurimeve shoqërore, për shkak të ndryshimeve të parashikuara me ligj dhe me VKM, është rishikuar duke reflektuar mbi *kuotat fillestare të fondeve të programuara*. Si përfundim, programi i ISSH-së për vitin 2011, paraqitet si më poshtë vijon:

		<i>Në milionë/lekë</i>	
<i>Nr.</i>	<i>SHPENZIMET</i>	<i>Plani me ndryshime</i>	<i>Masa relative (në %)</i>
<b>I.</b>	<b>Shpenzimet për përfitime</b>	<b>70,343.5</b>	<b>81.1</b>
1.	Shpenzime për sëmundje	352.6	0.5
2.	Shpenzime për barrë lindje	1,871.0	2.6
3.	Shpenzime për pensione	68,100.9	96.8
4.	Shpenzime për aksidente e sëmundje profesionale.	19.0	0.1
<b>II.</b>	<b>Për programet e tjera</b>	<b>9,055.5</b>	<b>10.4</b>
<b>III.</b>	<b>Shpenzimet administrative</b>	<b>1,863.0</b>	<b>2.1</b>
<b>IV.</b>	<b>Shpenzime për skemat suplementare</b>	<b>5,472.0</b>	<b>6.4</b>
<b>TOTALI (I+II+III+IV):</b>		<b>86,734.0</b>	<b>100.0</b>

Për vitin 2011, buxheti i ISSH përbëhet nga **tre programe bazë dhe një program mbështetës**, përkatësisht shpenzimet e administrimit.

Hartimi i kërkesave dhe nevojave për fonde për mbulimin e këtyre programeve është bazuar dhe kushtëzuar nga faktorë të tillë si: numri i popullsisë aktive dhe numri i forcave të punës; numri i personave të punësuar dhe numri aktual i kontribuesve; rritja e numrit të kontribuesve për shkak të zhvillimeve ekonomike, ulja e evazionit dhe minimizimi i informalitetit; niveli i pagës mesatare aktuale, politikat në fushën e pagave dhe masat për minimizimin e evazionit në këtë fushë; norma e kontributeve mbi pagën (bazën kontributeve); numri i personave të vetëpunësuar në bujqësi, kontribuesit dhe gradualizimi i rritjes së përqindjes së kontributeve për këtë kategori deri në barazimin me normën dhe masën e kontributit minimal në qytet; numri i pensionistëve dhe përfituesve të tjerë, niveli mesatar i pensionit apo trajtimit, raporti pagë/pension etj.

Në përfundim të vitit buxhetor 2011, rezulton se **fondet gjithsej për ISSH-në janë realizuar në masën 98.4%; ose nga 86,734 milionë lekë të programuara, janë realizuar 85,820 milionë lekë (nga të cilat 48,396 milionë lekë nga kontributet dhe 37,424 milionë lekë nga transfertat e buxhetit të shtetit), me një mosrealizim prej 914 milionë lekë.**

Në zbatim të ligjit nr. 10450, datë 14/7/2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”, MF me shkresën nr. 15460, datë 2/9/2011, i ka dërguar ISSH-së planin përfundimtar të të ardhurave kontributive, ndarë sipas përgjegjësisë si më poshtë :

<b>A. Të ardhura kontributive gjithsej.....</b>	<b>56,520 milionë lekë</b>
<b>A.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve .....</b>	<b>53,560 milionë lekë</b>
<b>A.2 ISSH plus ISKSH .....</b>	<b>2,960 milionë lekë</b>

<b>B. Kontribute për sigurimet shoqërore.....</b>	<b>50,010 milionë lekë</b>
B.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve .....	47,220 milionë lekë
B.2 Instituti i Sigurimeve Shoqërore .....	2,790 milionë lekë

Ndërsa, plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore në përgjegjësi të DPT, sipas subjekteve është .....

<b>47,220 milionë lekë</b>	
1. Subjektet buxhetore .....	19,610 milionë lekë
2. Subjektet me t.v.sh. ....	22,930 milionë lekë
3. Subjektet biznesi i vogël .....	4,310 milionë lekë
4. Sigurime suplementare .....	370 milionë lekë

Këto të ardhura janë të detajuara nga DPT për çdo muaj të vitit dhe për çdo DRT dhe Agjenci në rrethe. Ndërkohë që, plani i të ardhurave gjithsej në përgjegjësi të ISSH-së, sipas subjekteve është në shumën .....

1. Nga të vetëpunësuarit në bujqësi .....

2. Nga sigurimi vullnetar .....

3. Të tjera .....

Këto të ardhura janë detajuar nga ISSH për çdo muaj dhe për çdo DRSSH në rrethe. DRSSH-të kryejnë detajimin për çdo Agjenci të Sigurimeve Shoqërore në rrethe, si për të ardhurat kontributive dhe numrin e kontribuesve për të vetpunësuarit në bujqësi dhe për sigurimin vullnetar, si dhe i dërgojnë në ISSH.

o Për vitin 2011, të ardhurat kontributive gjithsej nga 56,520 milionë lekë programimi, janë realizuar në shumën 54,879 milionë lekë **ose në masën 97.1%, me një mosrealizim në vlerë prej 1,641 milionë lekë.**

Të ardhurat kontributive në total për ISSH-në, nga 50,180 milionë lekë sipas planit përfundimtar të miratuar (përfshirë 170 milionë lekë për llogari të ISKSH), janë realizuar 48,522 milionë lekë, **ose në masën 96.7%, me një mosrealizim në vlerë prej 1,658 milionë lekë.**

o Të ardhurat në fondin e sigurimeve shoqërore janë realizuar në shumën 48,396 milionë lekë, nga 50,010 milionë lekë të programuara, **në masën 96.8%, me një mosrealizim në vlerë prej 1,614 milionë lekë.** Në krahasim me një vit më parë, në vitin 2011 janë mbledhur 3,200 milionë lekë më shumë se në vitin paraardhës. Kundrejt PBB-së të vitit 2011 këto të ardhura zenë 3.68% të tij, nga 3.64% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Nga këto të ardhura, plani i të ardhurave për fondin e sigurimeve shoqërore, nën përgjegjësinë e DPT-së, nga 47,220 milionë lekë të planifikuara, është realizuar 45,169 milionë lekë, **ose në masën 95.7%, me një mosrealizim në vlerë prej 2,051 milionë lekë.**

o Niveli i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave në përgjegjësi të ISSH për vitin 2011, sipas grup-kontribuesve, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Treguesi Grup-Kontribuesit	Në milionë/lekë			
	Plan	Realizimi	Diferenca	Në %
1. Të vetëpunësuar	2,394	2,615	+221	109.2
2. Sigurimet vullnetare	381	377	-4	99.0
3. Të tjera	185	361	+176	195.1
<b>TOTALI:</b>	<b>2,960</b>	<b>3,353</b>	<b>+393</b>	<b>113.3</b>



Nga shqyrtimi i këtyre të dhënave rezulton se, *ISSH* nga 2,960 milionë lekë të programuar ka realizuar 3,353 milionë lekë ose në masën 113.3%, me një tejkalim prej 393 milionë lekë, fakt që shpreh një performancë të mirë të *ISSH* dhe të strukturave të saj vartëse. Në këtë tejkalim mbi kufirin e programuar, kanë pasur ndikim kryesor realizimi dhe tejkalimi i të ardhurave nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe të ardhura të tjera.

Gjatë auditimit në *ISSH*, audituesit e *KLSH* kanë konstatuar përpjekje serioze për realizimin e programit të të ardhurave kontributive, konsolidimin dhe fuqizimin e skemës për të vetëpunësuarit në bujqësi dhe ngritjen në një shkallë më të lartë të evidentimit të të dhënave të dokumentuara sidomos në formatin elektronik.

Meqenëse gjatë vitit 2011, skema e sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi, ishte nën favorizimet e ligjit të faljes të kamatëvonesave për të vetëpunësuarit në bujqësi (në fuqi për periudhën maj 2011 - 31 mars 2012), kjo ka influencuar pozitivisht si në rritjen e numrit të fermerëve të siguruar, ashtu dhe në realizimin dhe tejkalimin e të ardhurave të programuara nga kategoria e të vetëpunësuarve në bujqësi.

o Në kategorinë e vetëpunësuarve në bujqësi, nga 2,394 milionë lekë të programuara për vitin 2011, janë realizuar 2,615 milionë lekë ose në masën 109.2%, me një tejkalim në vlerë 221 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2010, gjatë këtij viti, janë realizuar 122,8 milionë lekë të ardhura më shumë. Me realizim dhe tejkalim të të ardhurave të programuara, rezultojnë DRSSH-të Gjirokastër 127%, Lezhë 119%, Vlorë 116.7%, Shkodër 116%, Korçë 115.6%, Kukës 112.9%, Fier me 112%, Dibër 109% dhe Elbasan 104.6%; ndërkohë që 3 DRSSH paraqiten me mosrealizim, respektivisht Durrës me 84.6%, Berat 91% dhe Tiranë me 98%.

o Të ardhurat nga sigurimi vullnetar, nga 381 milionë lekë të programuara, janë realizuar 377 milionë lekë ose në nivelin 99% kundrejt planit, me një mosrealizim në vlerën 4 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2010, gjatë këtij viti janë realizuar më shumë të ardhura kontributive në këtë kategori në shumën rreth 8 milionë lekë. Rezultojnë me tejkalim të të ardhurave të programuara të vitit 2011, DRSSH-të Shkodër 157%, Tiranë 107%, Korçë 107%, Lezhë 105%, Berat 103% dhe Fier 100%; ndërkohë që me mosrealizime rezultojnë DRSSH-të Kukës me 0% (megjithëse kufiri i programuar ishte 1 milionë lekë), Dibër 69%, Durrës 71%, Gjirokastër 74%, Vlorë 90% dhe Elbasan me 91%.

o Në grupin e të ardhurave të tjera, tejkalimi prej 176 milionë lekë (nga 185 milionë lekë plani janë realizuar 361 milionë lekë), ka ardhur kryesisht nga investimi efektiv i fondeve përkohësisht të lira të *ISSH*, në trajtën e bonove të thesarit dhe të interesave bankare.

o Përsa i përket, transfertës nga buxheti i shtetit për vitin 2011, është realizuar tërheqja e plotë e saj për fondin e sigurimeve shoqërore, e rakorduar dhe e shoqëruar me dokumentacionin përkatës, në shumën prej 37,424 milionë lekë.

#### **A. Realizimi i numrit të kontribuesve.**

o Numri i kontribuesve në përgjegjësi të organeve tatimore (sipas *ISSH*-së)

Për kontribuesit urban, ku përfshihen numri i kontribuesve në sektorin publik dhe privat, numri gjithsej në vitin 2011 rezulton 422,520 kontribues ose 31,915 kontribues më shumë se sa në vitin 2010, të ndarë:

a) *për subjektet publike* 161,164 dhe krahasuar me vitin 2010 evidentohen 5,940 kontribues më shumë.

b) *për sektorin privat* 261,356 kontribues dhe krahasuar me vitin 2010 evidentohen 25,975 kontribues më shumë.

o *Numri i kontribuesve në përgjegjësi të organeve të sigurimeve shoqërore.*

Nga analiza e numrit të kontribuesve *për të vetëpunësuarit në bujqësi* rezulton se, bazuar në normën kontributive për vitin 2011, janë realizuar 176,956 kontribues nga 164,041 kontribues të planifikuar, për pasojë janë evidentuar *12,915 më shumë kontribues*, rezultat ky dhe i tejkalimit të të ardhurave kontributive nga të vetëpunësuarit në bujqësi. Nga analiza e numrit të kontribuesve *për personat e siguruar vullnetarisht* rezulton se, nga 24,861 kontribues në fillim të vitit 2011, në fund të vitit rezultojnë 26,504 kontribues, *gjë që tregon se në skemë kanë hyrë 1,643 kontribues të rinj.*

Në tabelën e mëposhtme paraqesim numrin e kontribuesve për vitet 2009-2011:

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	Realizimi i numrit te kontribuesve sipas viteve		
		2009	2010	2011
1.	Buxhetore	134,035	132,885	139,177
2.	Jobuxhetore	23,998	22,339	21,987
3.	Firma	158,785	170,121	182,358
4.	Individë	64,200	65,260	78,998
5.	Të vetëpunësuar në bujqësi	294,783	252,604	261,097
6.	Sigurim vullnetar	8,784	8,670	8,493
	<b>GJITHSEJ:</b>	<b>684,585</b>	<b>651,879</b>	<b>692,110</b>

Struktura dhe numri i subjekteve dhe kontribuesve për subjektet urbane për vitin 2011, jepet në tabelën në vijim:

Nr.	Emertimi i Grup-subjekteve	Numri i subjekteve	Numri i Kontribuesve
<b>I.</b>	<b>Spektori publik</b>	<b>2,160</b>	<b>161,164</b>
1.	Buxhetor	1,910	139,177
2.	Jobuxhetor	250	21,987
<b>II.</b>	<b>Spektori privat</b>	<b>76,476</b>	<b>261,356</b>
1.	Firma	15,705	182,358
2.	Individe	60,771	78,998
	<b>TOTALI:</b>	<b>78,636</b>	<b>422,520</b>

Sipas këtyre të dhënave (që disponon ISSH), rezulton se për vitin 2011 janë regjistruar gjithsej *78,636 subjekte që derdhin kontribute për 422,520 kontribues në sektorin urban.* Për pasojë, numri mesatar i kontribuesve gjithsej (pa përfshirë të vetëpunësuarit në bujqësi dhe siguresit vullnetarë), është *5.37 persona/subjekt* (422,520/78,636). Konstatohet se numri mesatar i kontribuesve për një subjekt është respektivisht *74.6 persona/subjekt në sektorin publik (161,164/2,160) dhe 3.41 persona/subjekt në sektorin privat (261,356/76,476).*

Nga verifikimi dhe krahasimi i të dhënave mbi numrin e kontribuesve për vitin 2011, KLSH ka konsatuar se:

1. Në total ka një *rënie të numrit të kontribuesve në vitet 2007-2010 dhe ngritje në vitin 2011 kundrejt vitit 2010,* dhe konkretisht: nga 801,075 persona që kontribuonin në këtë skemë gjatë vitit 2007, ky numër ka rënë në 684,585 persona në vitin 2009 dhe në 651,879 persona në vitin 2010, kurse në vitin 2011 është rritur

në 692,110 persona, *pra një rënie prej 149,196 kontribuesish nga viti 2007 në vitin 2010 dhe rritje në vitin 2011 kundrejt vitit 2010 me 40,231 kontribuesish.*

**2.** Klasifikuar sipas kategorive të subjekteve, numri mesatar vjetor i kontribuesve për secilën kategori është:

- a) Në subjektet buxhetore *72.8 persona;*
- b) Në subjektet jobuxhetore *87.9 persona;*
- c) Në firmat *11.6 persona;* dhe
- d) Në subjektet fizikë *1.29 persona.*

**3.** Ndonëse nga sektori publik (buxhetor dhe jobuxhetor) është ruajtur numri i kontribuesve, konstatohet *rënie e numrit të kontribuesve të vetëpunësuar në sektorin bujqësor dhe nga siguruesit vullnetarë.* Konkretisht, numri i kontribuesve të vetëpunësuar në bujqësi nga 294,783 persona që regjistroheshin në vitin 2009, ka rënë në 261,097 persona në vitin 2011, duke u *pakësuar me 33,686 persona ose në masën 11.4%;* ndërsa në sigurimet vullnetare nga 8,784 në vitin 2009 ka rënë në 8,493 në vitin 2011, duke u *pakësuar me 291 persona ose në masën 3.3%.*

o Sipas të *dhënave të bilancit të shpallur nga INSTAT për Forcën e Punës për vitin 2011,* rezulton se, ***numri i të punësuarve gjithsej ka qenë 932,388 persona.***

Sipas këtij Bilanci, pesha specifike në përqindje e forcave të punës sipas sektorëve, paraqitet:

- 1. Në sektorin shtetëror: 165,000 persona, ose 17% e totalit të forcave të punës.
- 2. Në sektorin privat jobujqësor: 260,724 persona, ose në masën 27%.
- 3. Në sektorin privat bujqësor 506,664 persona, ose 56% e totalit të forcave të punës.

Struktura e forcave të punës në 3/mujorin e katërt të viteve 2009, 2010 dhe 2011, paraqitet në tabelën vijuese:

<i>EMËRTIMI</i>	<i>Njësia</i>	<i>Trem.IV-rt 2009</i>	<i>Trem.IV-rt 2010</i>	<i>Trem.IV-rt 2011</i>	<i>Diferenca 2011-2010</i>
<b>PUNËSIMI:</b>					
<b>I. Forcat e Punës</b>	Numër	1,042,618	1,059,959	1,075,338	+ 15,379
<b>II. Të punësuar</b>	"	899,278	916,919	932,388	+ 15,469
Prej të cilëve:					
<b>a) Në sektorin shtetëror</b>	"	166,250	166,000	165,000	- 1,000
<b>b) Në sektorin privat jobujqësor</b>	"	236,838	244,255	260,724	+ 16,469
<b>c) Në sektorin privat bujqësor</b>	"	496,190	506,664	506,664	0.0
<b>Papunësia e regjistruar</b>					
<b>III. Të papunë të regjistruar</b>	'	143,340	143,040	142,950	- 90
Prej të cilëve:					
<b>a) Përfitues të pagesës papunësisë</b>	"	10,050	9,509	9,247	- 260
<b>IV. Niveli i papunësisë</b> (raporti të papunë kundrejt forcave të punës)	Në %	13.75	13.49	13.29	-

o Nga ballafaqimi i të dhënave të ISSH dhe INSTAT, evidentohet *niveli i evazionit në pagesën e kontributeve, si pasojë e informalitetit,* i cili sipas grupeve reflekton këto devijime:

Nr.	SEKTORI	Numri i të siguruarve sipas ISSH	Numri i të punësuarve sipas INSTAT	Diferenca INSTAT-ISSH
a	b	1	2	3=2-1
I.	Sektori publik	161,164	165,000	+ 3,836
II.	Sektori privat jobujqësor	261,356	260,724	- 632
III.	Sektori privat Bujqësor	261,097	506,664	+ 245,567
IV.	Sigurimi vullnetar	x	x	-
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>683,617</b>	<b>932,388</b>	<b>+ 248,771</b>

Nga këto të dhëna, duket qartë se ekonomia informale, në drejtim të pagesës së kontributeve është e lartë dhe jep ndikim në të ardhurat e buxhetit të shtetit, sepse nga verifikimi i të dhënave të INSTAT figurojnë 245,567 persona që nuk janë përfshirë në skemën e sigurimeve të detyrueshme nga ana e strukturave të ISSH. Ndaj nga ISSH, kërkohet një analizë e hollësishme e këtyre treguesve, të cilat duhen saktësuar, rakorduar dhe vlerësuar në vazhdimësi, si dhe duhen marrë në konsideratë gjatë procesit të planifikimit të treguesve vjetorë nga të gjithë institucionet si: DPT, ISHP, INSTAT dhe ISSH, në hartimin e programeve të argumentuara për treguesit e kontributeve.

Bazuar në të dhënat që disponon ISSH sipas “census-it” dhe statistikave mbi shpërndarjen e popullsisë, teorikisht ISSH duhet të sigurojë 195,900 fermerë, ndërkohë që ka arritur të realizojë vetëm 95,296 fermerë (persona fizikë). Këtë përlllogaritje, ISSH e bazon në disa kritere si popullsinë në moshën e sigurimit 16-65 vjeç përkatësisht 1,189,140 persona, në numrin e të punësuarve në sektorët e tjerë, të nxënësve dhe studentëve, të personave në ndihmë ekonomike, emigrantëve dhe atyre që nuk kanë tokë.

KLSH nënvizon se nuk ka një rakordim të të dhënave statistikore midis ISSH dhe INSTAT-it, dhe se shifra e vendosur nga INSTAT është një shifër zyrtare, prandaj mbetet detyrë rakordimi përfundimtar i këtij informacioni dhe mbi këtë bazë të bëhet analiza e plotë e kësaj situate të informalitetit, në pagesat e detyrimeve të kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi.

*Edhe nëse do të merret si bazë shifra 195 mijë fermerë të vetëpunësuar, të deklaruar nga ISSH (sipas bilancit të popullsisë agrare që disponon ISSH për vitin 2011) duke zbritur 95 mijë fermerë të vetëpunësuar të siguruar, mbeten 100 mijë fermerë të tjerë të pa inkuadruar në skemë, gjë që sërish argumenton një shifër të lartë të informalitetit.*

#### **A.1 Marrëdhëniet e bashkëpunimit të ISSH e DRSSH-ve me Degët e Tatimeve.**

Në kreun VII, pika 1/a të VKM nr. 1114, datë 30/7/2008 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11/5/1993.....”, i ndryshuar, janë përcaktuar detyrimet që mbartin organet tatimore për raportimin dhe evidentimin e kontributeve individuale për llogari të sigurimeve shoqërore. Sipas këtij vendimi, organet tatimore kanë përgjegjësitë për dërgimin e raporteve mujore dhe depozitim të të dhënave si vijon:

- a) për kontribute dhe interesa të paguara, *deri më datë 10 të muajit pasardhës;*
- b) formatin përmbledhës të listëpagesave sipas subjekteve, *deri më datë 25 të muajit pasardhës;*
- c) listëpagesat origjinale dhe në format elektronik *deri më datë 28 të muajit pasardhës;*

d) numrin e subjekteve, kontribuesve dhe shumën e kontributeve mujore dhe progresive; si dhe të dhënat mujore mbi kontributet e papaguara ose paguar tepër nga çdo subjekt *deri më datën 28 të muajit pasardhës*.

Auditimi i KLSH ka konstatuar se gjatë vitit 2011, DRSSH-të dhe Agjencitë nëpër rrethe janë përpjekur dhe kanë vijuar ndjekjen e zbatimit të VKM-së të sipërcituar, ndërkohë, janë vërejtur raste kur *nuk janë dërguar brenda afateve kohore të përcaktuara të dhënat statistikore dhe listëpagesat e subjekteve të biznesit të madh dhe të vogël*, pavarësisht se nga ana e DRSSH-ve dhe Agjencive të tyre në rrethe u është kërkuar zyrtarisht DRT-ve dërgimi i tyre. Madje, për shkeljet e afateve kohore dhe mangësi sidomos të natyrës së evazionit kontributiv dhe transferimit të subjekteve debitore, DRSSH-të kanë njoftuar ISSH-në, e cila ka kërkuar ndërhyrjen e DPT-së për zgjidhjen e tyre.

o Problemi më shqetësues në raportet e koordinimit me organet tatimore ka qenë dhe vijon të mbetet ai *i mosdorëzimit brenda afatit të përcaktuar të listëpagesave nga degët e tatimeve në organet e sigurimeve shoqërore; dërgimi i këtyre borderove shpeshherë jashtë afateve kohore të përcaktuara në VKM-në e sipërcituar; apo të dërgimit në disa raste të veçanta të listëpagesave jo të rregullta (plotësimi i tyre me mangësi) nga ana e subjekteve*. Për t'u veçuar, DRT Vlorë që për vitin 2011, në periudhën e auditimit të KLSH në ISSH, ende nuk i kish dërguar listëpagesat e subjekteve të biznesit të vogël në DRSSH Vlorë; po kështu DRT-të Tiranë, Elbasan, Fier, Dibër e Gjirokastrë, që listëpagesat e subjekteve të biznesit të madh apo të vogël i kanë i dorëzuar me vonesë. Për rastet e konstatuara lidhur me mungesat e listëpagesave sipas subjekteve, është komunikuar zyrtarisht me DRT-të, me qëllim që ato të përmbushin përgjegjësitë ligjore të cituara më lart.

o Problem përbën dhe *mospërmbushja e detyrimit për dorëzimin e listëpagesave të viteve të kaluara*. Nga analiza e të dhënave të paraqitura nga ISSH rezulton se, në fund të vitit 2011, për periudhën 2006-2011, *mungojnë gjithsej 225,321 listëpagesa*, të ndara sipas subjekteve:

- Biznesi i vogël 185,420 listëpagesa ose në masën 82.3%.
- Biznesi i madh 34,220 listëpagesa ose 15.2%.
- Buxhetore 4,367 listëpagesa ose 1.9%; dhe
- Jobuxhetore 1,314 listëpagesa ose në masën 0.6%.

Analizuar sipas DRSSH-ve, gjendja e listëpagesave të pa dorëzuara, për periudhën 2006-2011, paraqitet si vijon:

Nr.	DRSSH	Listëpagesa	Listëpagesa	Listëpagesa	Listëpagesa
		Subjekte publike	Firma	Persona Fizikë	Total
1.	Berat	32	443	21,144	21,619
2.	Dibër	787	3,126	24,102	28,015
3.	Durrës	32	2,967	8,374	11,373
4.	Elbasan	919	2,667	8,550	12,136
5.	Fier	614	3,685	9,027	13,326
6.	Gjirokastrë	278	1,278	15,172	16,728
7.	Korçë	210	1,263	13,618	15,091
8.	Kukës	1,488	4,773	16,531	22,792
9.	Lezhë	0	1,359	2,246	3,605
10.	Shkodër	224	2,034	3,035	5,293
11.	Tiranë	105	1,177	9,943	11,225
12.	Vlorë	992	9,448	53,678	64,118
<b>TOTALI:</b>		<b>5,681</b>	<b>34,220</b>	<b>185,420</b>	<b>225,321</b>

Sa më sipër, më keq me gjëndjen e listëpagesave paraqitet DRSSH Vlorë, ku mungojnë 64,118 listëpagesa gjithsej, DRSSH Dibër 28,015 listëpagesa, DRSSH Kukës 22,792 listëpagesa dhe DRSSH Berat 21,619 listëpagesa, të periudhës 2006-2011.

### **A.2 Subjektet debitoare dhe detyrimet e prapambetura.**

Në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11/9/2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”, përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme, u ka kaluar organeve tatimore. Madje, në VKM nr. 477, datë 30/6/2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1114, datë 30/7/2008, të Këshillit të Ministrave.....”, pika 6, është konkretizuar problemi i borxheve:

“Për subjektet, juridike dhe fizike, përveç personave të vetëpunësuar në bujqësi, shuma e detyrimit kontributiv dhe e interesave llogaritet, evidentohet dhe administrohet nga administrata tatimore, e cila është përgjegjëse edhe për vjeljen e detyrimeve të prapambetura, që këto subjekte kanë ndaj organeve të sigurimeve shoqërore. Për subjektet debitoare aktive me detyrime të prapambetura në organet e sigurimeve shoqërore dhe të pa arkëtuara deri me 1/7/2010, të behet transferimi i detyrimeve të prapambetura të tyre në organet tatimore”.

Ndërkohë, që në Rregulloren e Kontributeve nr. 2, datë 2/12/2008, pika 2, nënpika 2.3/“iii”, të miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH, përcaktohet se:

“Mbledhja e detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë, pas kalimit të tyre në organet tatimore bëhet nga Zyrat e Shërbimit apo Drejtoritë Rajonale Tatimore. Zyrat e Shërbimit apo DRT-të evidentojnë, ndjekin dhe mbledhin detyrimet e prapambetura të krijuara nga subjektet pas transferimit të tyre në organet tatimore. Gjithashtu, Zyrat e Shërbimit apo Drejtoritë Rajonale Tatimore në bashkëpunim me organet e sigurimeve shoqërore, evidentojnë, ndjekin dhe mbledhin detyrimet e prapambetura të subjekteve debitoare aktive të rezultuara para transferimit të shërbimit të mbledhjes së kontributeve në organet tatimore.”

Sa më sipër, auditimi i KLSH ka konstatuar se gjatë vitit 2011, DRSSH-të kanë vijuar punën për uljen e numrit të subjekteve debitorë dhe pakësimin e detyrimeve të prapambetura të tyre, duke qenë dhe në kushtet e favorizimit të ligjit nr. 10418, datë 21/4/2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”, nga ku ISSH dhe DRSSH përfitonin efektet pozitive të faljeve për kamatëvonesat. Nga ana tjetër, nga DRSSH-të ka vijuar procesi i transferimit të detyrimeve të prapambetura të debitorëve aktivë jobujqësorë, që kanë lindur përpara marrjes së përgjegjësisë mbledhëse të kontributeve nga DPT dhe strukturat e saj varëse.

Gjendja, shtesat dhe pakësimet e detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë në organet e sigurimeve shoqërore, gjatë vitit 2011, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*Në mijë/lekë*

Nr.	EMËRTIMI	Numri i Subjekteve	Gjithsej	Nga këto:	
				Kontribut	Kamatë
1.	Gjendja më 1/1/2011	1,363	983,797	522,634	461,163
2.	Shtesat e periudhës	6	606	577	29
3.	Pakësimet e periudhës	531	448,004	18,209	429,795
4.	<b>Gjendja më 31.12.2011</b>	<b>838</b>	<b>536,399</b>	<b>505,002</b>	<b>31,397</b>



Referuar këtyre të dhënave, rezulton se gjatë vitit 2011 detyrimet e prapambetura janë pakësuar me 531 subjekte debitoare dhe në vlerë 448,004 mijë lekë. Por, duhet evidentuar fakti se, në këtë pakësim të numrit të subjekteve dhe të vlerës së detyrimeve debitoare, 436 prej tyre me vlerë 441,711 mijë lekë detyrime të prapambetura, janë rrjedhojë e efekteve nga zbatimi i ligjit nr. 10418, datë 21/4/2011, dhe vetëm diferenca prej 95 subjekte debitoare me 6,293 mijë lekë detyrime të prapambetura është rrjedhojë e transferimit të tyre në organet tatimore.

Në zbatim të pikës 6, të VKM nr. 477, datë 30/6/2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1114, datë 30/7/2008 të KM.....”, vetëm dy DRSSH përkatësisht Elbasan dhe Gjirokastër kanë kryer transferimet e subjekteve debitorë aktivë dhe të detyrimeve të prapambetura të tyre në DRT-të respektive.

Auditimi i KLSH në periudhën e kryerjes së tij, ka konstatuar se, në llogari të organeve të sigurimeve shoqërore rezultojnë 253 subjekte debitoare aktive të pa transferuara, për të cilat ISSH me shkresën nr. 571, datë 31.1.2012 dërguar drejtuesve të DRSSH-ve, u ka kërkuar transferimin e tyre në DRT-të respektive. Përmendim DRSSH-të, Tiranë me 211 subjekte dhe 142,9 milionë lekë detyrime; Shkodër me 20 subjekte dhe 2,8 milionë; Gjirokastër me 7 subjekte dhe 2,7 milionë lekë; Fier me 3 subjekte dhe 1,8 milionë lekë etj.

Për të ndihmuar teknikisht dhe për t'i dhënë mbështetjen ligjore dokumentacionit të dorëzimit të subjekteve debitorë aktivë, nga organet e sigurimeve shoqërore në organet tatimore, ISSH në muajin prill 2012 formuloi dhe një Akt-Transferimi “Për kalimin e administrimit të subjekteve debitorë aktivë dhe të detyrimeve të tyre të prapambetura, nga organet e sigurimeve shoqërore në organet tatimore”, të cilin ja dërgoi për zbatim DRSSH-ve të përmendura më sipër.

## B. SHPENZIMET E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Nga auditimi ka rezultuar se, limitet e shpenzimeve të miratuara për vitin 2011 përgjithësisht janë ndjekur dhe respektuar çdo muaj. Sipas zërave kryesorë, niveli i realizimit të shpenzimeve të vitit 2011, paraqitet:

Nr.	SHPENZIMET	Plani me ndryshime	Fakti	Në milionë/lekë	
				Diferenca Plan -Fakt	Në %
I.	Sigurimi shoqëror i detyrueshëm	70,343	69,737	606	99.1
II.	Programe të veçanta	9,056	9,038	18	99.8
III.	Përfitime suplementare e trajtime	5,472	4,889	5,823	89.4
IV.	Menaxhimi i sigurimeve shoqërore	1,863	1,653	210	88.6
<b>TOTALI (I+II+III+IV):</b>		<b>86,734</b>	<b>85,317</b>	<b>1,417</b>	<b>98.4</b>

Nga të dhënat e mësipërme, në total shpenzimet janë realizuar në masën 98.4% ose nga 86,734 milionë lekë të programuara gjithsej, janë shpenzuar 85,317 milionë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 1,417 milionë lekë. Kundrejt PBB-së të vitit 2011 këto shpenzime zenë 6.49% të tij, nga 6.40% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Rreth 98% e totalit të shpenzimeve faktike të ISSH (85,317 milionë lekë – 1,653 milionë lekë/85,317 milionë lekë x 100), përbëhet nga transfertat në buxhetet familjare.

**B.1 Transfertat faktike në buxhetet familjare nga programet e ISSH:**

Nga analiza e dinamikës së shifrave të transfertave për buxhetet familjare të vitit 2011, krahasuar me ato të vitit 2009 dhe 2010, konstatohen luhatje, që sipas grupeve, programeve, produkteve dhe aktiviteteve paraqiten si më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi i zërave të shpenzimeve	Transferta në buxhetet familjare			Shtesa transfertës 2011-2010	
		2011	2010	2009	Në vlerë	%
<b>1.</b>	<b>Shpenzime për paaftësi të përkoheshme në punë</b>	<b>363.9</b>	<b>326.3</b>	<b>276.1</b>	<b>37.6</b>	<b>11.5</b>
a)	Shpenzime për paaftësi të përkoheshme	363.9	326.3	276.1	37.6	11.5
<b>2.</b>	<b>Shpenzime për paaftësi dhe dëme shkak aksidenti</b>	<b>11.6</b>	<b>7.9</b>	<b>11.8</b>	<b>3.7</b>	<b>47.6</b>
b)	Kompensim për paaftësi të përkoheshme për shkak të dëmtimit në punë	11.6	7.9	11.3	3.7	47.6
<b>3.</b>	<b>Shpenzime për barrë lindje</b>	<b>1,890.7</b>	<b>1,572.3</b>	<b>1,238.3</b>	<b>318.4</b>	<b>20.3</b>
a)	Shpenzime për barrë lindje në qytet	1,305.3	1,092.2	913.7	213.2	19.5
b)	Shpenzime për barrë lindje në fshat	485.2	389.1	247.9	96.0	24.7
c)	Shpenzime për shpërblime për lindje	100.2	91.0	76.8	9.2	10.2
<b>4.</b>	<b>Shpenzime për pensione</b>	<b>67,470.5</b>	<b>63,785.5</b>	<b>59,239.9</b>	<b>3,685.0</b>	<b>5.8</b>
4.1	<i>Pensione për moshë madhore</i>	<i>55,877.7</i>	<i>53,051.6</i>	<i>49,554.1</i>	<i>2,826.1</i>	<i>5.3</i>
a)	Shpenzime për pensione pleqërie shteti	43,610.0	41,673.1	39,403.4	1,936.9	4.6
b)	Shpenzime për pensione pleqërie fshati.	12,113.1	11,235.7	10,021.2	877.4	7.8
c)	Shpenzime për pagesa në rast vdekje	154.7	142.9	129.5	11.8	8.3
4.2	<i>Pension paaftësi (Invaliditeti)</i>	<i>7,339.1</i>	<i>6,558.6</i>	<i>5,687.0</i>	<i>780.5</i>	<i>11.9</i>
a)	Shpenzime për pensione invaliditeti shteti	6,902.5	6,165.9	5,351.0	736.7	11.9
b)	Shpenzime për pensione invaliditeti fshat	436.6	392.7	336.0	43.9	11.2
<b>4.3</b>	<i>Pension mbijetese (Familjare)</i>	<i>4,253.6</i>	<i>4,175.2</i>	<i>3,998.8</i>	<i>78.4</i>	<i>1.9</i>
a)	Shpenzime për pensione familjare shteti	3,885.4	3,804.0	3,643.4	81.3	2.1
b)	Shpenzime për pensione familjare fshati	368.3	371.2	355.4	-2.9	-0.8
<b>5.</b>	<b>Shpenzime për programe të veçanta shtetërore</b>	<b>9,038.2</b>	<b>8,699.9</b>	<b>8,368.9</b>	<b>338.3</b>	<b>3.9</b>
a)	Kompensim suplementar të çmimeve (energji, bukë)	3,735.1	3,592.1	3,534.2	143.0	4.0
b)	Pensione të veçanta shtetërore	80.5	83.3	70.2	-2.8	-3.3
c)	Kompensim suplementar për ish të persekutuariat	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0
d)	Kompensim për veteranët dhe invalidët e luftës	426.9	477.1	523.7	-50.2	-10.5
e)	Kompensim suplementar për invalidët e punës	48.9	44.7	41.7	4.2	9.3
f)	Kompensim të ardhura për pensionet e shtetit	3,970.2	3,651.1	3,284.6	319.1	8.7
g)	Kompensim të ardhura për pensionet e fshatit	776.6	851.6	914.4	-75.0	-8.8
<b>6.</b>	<b>Shpenzime për programe e skema suplementare</b>	<b>4,889.9</b>	<b>3,445.3</b>	<b>3,204.1</b>	<b>1,444.6</b>	<b>41.0</b>
a)	Sigurim suplementar për ish-ushtarakët	3,371.1	2,325.4	2,134.9	1,045.7	45.0
b)	Kompensim për dëshmorët e luftës	27.2	21.9	22.6	5.3	24.2
c)	Sigurim suplementar shtetëror për ish funksionarët	338.7	262.4	211.2	76.3	29.1
d)	Pagesa të parakohshme për minatorët	430.1	405.0	364.9	25.1	6.2
e)	Pagesa të punëtorëve të industrisë ushtarake	121.2	127.0	127.6	-5.8	-4.6
f)	Pagesa të pilotëve	54.2	50.7	59.5	3.5	7.0
g)	Pagesa për ushtarakët e nëndetëseve	5.7	5.2	5.7	0.5	10.4
h)	Pagesa të policisë së shtetit	370.7	110.5	147.0	260.2	235.4
i)	Shpenzime për funeralin	142.0	137.2	130.7	4.8	3.5
j)	Pagesa nga statusi i profesorit	29.0	32.3	0.0	-3.3	-10.2
<b>TOTALI:</b>		<b>83,664.8</b>	<b>77,837.2</b>	<b>72,339.2</b>	<b>5,827.6</b>	<b>7.4</b>

Nga treguesit e mësipërm evidentohet se në vitin 2011, transfertat në buxhetet familjare krahasuar me vitin 2010, janë rritur me 5,827 milionë lekë ose në masën 7.4%. Ndikimin kryesor në rritjen e transfertës e kanë dhënë dy zëra, konkretisht:

- shpenzimet në zërin pensione për 3,685 milionë lekë; dhe
- shpenzimet në zërin përfitime nga skema suplementare për 1,444 milionë lekë.



o Në total transfertat në buxhetet familjare nga skemat e pensioneve janë rritur me 5.8% dhe janë pasojë e efekteve të rritjes së pensioneve në korrik 2010 me 4% për qytetin dhe 10% për fshatin; vendosja e një kompensimi të të ardhurave për pensionet minimale në masën 200 lekë për person; dhe rritjes së pensioneve në korrik 2011 me 4% për qytetin dhe 7% për fshatin, të cilat përlllogariten në shumën 3,227 milionë lekë; ndërsa diferenca prej 458 milionë lekë është kryesisht pasojë e rritjes së përvitshme të numrit të përfituesve, i cili për vitin 2011 ndaj vitit 2010 është rritur mesatarisht me 5,622 persona, nga të cilat mbi 60% e zenë rritjet neto të numrit të invalidëve.

o Rritja e shpenzimeve në skemën *pensione suplementare* është kryesisht pasojë e shtimit të numrit të përfituesve nga kjo skemë me 4,670 persona, për shkak të fillimit të zbatimit të legjislacionit të ri lidhur me pensionet suplementare të ish-ushtarakëve me të drejta përfitimi nga 1/7/2009 dhe në vazhdim. Kështu, në zërin “sigurimi suplementar ushtarak” konstatohet një rritje në masën 45% ose nga rreth 2,325.4 milionë lekë shpenzuar në vitin 2010, në 3,371.1 milionë lekë në vitin 2011; dhe zërin “pagesa të Policisë së Shtetit” në masën rreth 2.5 herë më tepër, ose nga 110.5 milionë lekë në vitin 2010 në 370.7 milionë lekë në vitin 2011.

o Rritje e shpenzimeve evidentohet edhe në zërat “shpenzime për paaftësi të përkohshme në punë” në masën 11.5% ose nga 326.3 milionë lekë shpenzuar në vitin 2010, në 363.9 milionë lekë në vitin 2011; dhe “shpenzime për barrëlindje” në masën 20.3% ose nga 1,572.3 milionë lekë shpenzuar në vitin 2010, në 1,890.7 milionë lekë në vitin 2011.

*Këto rritje, janë kryesisht pasojë e shtimit të numrit të përfituesve dhe të rritjes së pagës mesatare mbi të cilën llogariten përfitimet.*

Ndonëse, në përgjithësi shpenzimet janë mbajtur nën nivelin e tavaneve të programuara, *problem vazhdon të mbetet rritja nga njëri vit në tjetrin e shpenzimeve për pensionet e invaliditetit, të cilat në vitin 2011 kundrejt vitit 2010 rezultojnë me rritje 11.9%, ndërkohë që sipas ritmeve të rritjes së pensioneve, duhet të ishin në nivelin më të ulët (llogaritet 6%).*

Në mënyrë të sintetizuar, gjendja e shpenzimeve sipas katër programeve të ISSH-së, paraqitet si vijon:

*Në milionë/lekë*

<i>Nr.</i>	<i>SHPENZIMET</i>	<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Në %</i>
<b>I.</b>	<b>Shpenzimet për përfitime</b>	70,343	69,737	- 606	99.1
I.1	Shpenzime për sëmundje	353	364	+ 11	103.2
I.2	Shpenzime për barrëlindje	1,871	1,891	+ 20	101.1
I.3	Shpenzime për pensione	68,101	67,471	- 630	99.1
I.4	Për aksidente dhe sëmundje profesionale	19	12	- 7	61.1
<b>II.</b>	<b>Shpenzime për programet e tjera</b>	9,056	9,038	- 18	99.8
<b>III.</b>	<b>Shpenzime për skema suplementare</b>	5,472	4,889	- 583	89.4
<b>IV.</b>	<b>Shpenzime administrative</b>	1,863	1,653	- 210	88.7
<b>TOTALI (I+II+III+IV):</b>		<b>86,734</b>	<b>85,317</b>	<b>-1,417</b>	<b>98.4</b>

Nga auditimi ka rezultuar se:

a) Shpenzimet për skemën e detyrueshme janë realizuar në masën 99.1%, nga 70,343 milionë lekë të programuara janë shpenzuar 69,737 milionë lekë, *me një mosshpenzim në shumën 606 milionë lekë.*

b) Shpenzimet për programet e tjera të shtetit 99.8%, nga 9,056 milionë lekë të programuara janë shpenzuar 9,038 milionë lekë, *me një mosshpenzim në shumën*

*18 milionë lekë.*

c) Shpenzimet për skemën suplementare 89.4%, nga 5,472 milionë lekë të programuara janë shpenzuar 4,889 milionë lekë, *me një mosshpenzim në shumën 583 milionë lekë.*

d) Shpenzimet administrative janë realizuar në masën 88.7%, nga 1,863 milionë lekë të programuara, janë shpenzuar 1,653 milionë lekë, *me një mosrealizim prej rreth 210 milionë lekë.* Nga ISSH, këto shpenzime janë llogaritur dhe mbajtur brenda kuotës 5%, i cili është dhe niveli maksimal ligjor i përcaktuar. Më konkretisht, ato janë planifikuar në masën rreth 2.14% të shpenzimeve të drejtpërdrejta (1,863 milionë lekë/86,734 milionë lekë) dhe janë realizuar 1.94% e tyre (1,653 milionë lekë/85,317 milionë lekë).

Ndonëse në nivel programi, të katër grupimet e shpenzimeve rezultojnë të porealizuara, në zëra të veçantë konstatohen zëra me tejkalim të treguesit vjetor të shpenzimeve të planifikuara dhe të miratuara, konkretisht:

□ Në grupimin e parë *paraqiten me tejkalim* zërat “Shpenzimet për sëmundje” dhe “Shpenzimet për barrë lindje” përkatësisht 11 milionë lekë dhe 20 milionë lekë; në grupimin e dytë zëri “Kompensime për të ardhurat e pensioneve” në shumën 69,5 milionë lekë etj., kurse në grupimin e katërt *nuk rezulton asnjë zë brenda tij me tejkalim.*

**B.2 Respektimi i kuotave të programuara të shpenzimeve dhe zbatimi i ligjshmërisë në administrimin e tyre. Administrimi i përfitimeve.**

Për vitin 2011, veprimtaria e ISSH-së ka patur si synim:

a) Zbatimin e njëzuar në të gjithë vendin të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e përfitimeve. Mbi këtë bazë janë përgatitur dhe dërguar për zbatim rregullore, udhëzime e qarkore të ndryshme, në funksion të dhënies së përfitimeve të të gjitha llojeve, sipas parimit të të drejtave të lindura për përfitime.

b) Administrimin e përfitimeve nëpërmjet rritjes së nivelit profesional (trajnime dhe kualifikime).

Përveç zbatimit të treguesve të programit të shpenzimeve, si *tregues të matshëm të performancës për programet e përfitimit*, kanë qenë: - afati i caktimit të pensioneve; cilësia e caktimit të tyre dhe shmangia e falsitetit; rritja e nivelit dhe cilësisë së shërbimit; dhe krijimi i bazës së të dhënave dhe regjistrit kombëtar të pensioneve.

□ Gjatë vitit 2011, nga strukturat rajonale të ISSH-së *janë caktuar e rillogaritur gjithsej 21,992 pensione*, nga të cilat 18,010 ose në masën 84% janë pensione urbane dhe 3,440 ose 16% janë pensione rurale. Nga krahasimi i këtyre shifrave me ato të rezultuara në vitin 2010, konstatohet një *tendence në ulje e numrit të pensioneve në tre kategoritë e pensioneve të caktuara*, konkretisht në vitin 2011, *janë caktuar e rillogaritur pensione 11% më pak se në vitin 2010*, nga të cilat pensione pleqërie 7% më pak.

□ *Indikatori i zbatimit të afatit ligjor në caktimin e pensioneve*, tregon se janë caktuar në afat 21,257 pensione ose në masën 97%, ndërsa 735 pensione ose në masën 3% janë lidhur jashtë afatit. Si shkaqe të vonësave për *moslidhjen e një pensioni brenda 21 ditëve*, konstatohet ngarkesa e punës e inspektorëve verifikues, sidomos verifikimi për periudha të gjata i regjistrave dhe borderove të para vitit 1993 dhe listëpagesave për periudhën pas 1/1/1994 dhe deri në momentin e ndërprerjes së punës, gjithashtu, vonesat në mbylljen e urdhërpagesës nga zyrat e postës në rastet e pensioneve familjare.

Gjatë vitit 2011, *janë mbyllur gjithsej 16,370 pensione*, nga të cilat 11,407 pensione pleqërie, 2,303 pensione invaliditeti dhe 2,660 pensione familjare.

Në fund të vitit 2011, numri i përfituesve të pensioneve nga skema e detyrueshme rezulton si më poshtë:

<b>I.</b>	<b>Pensionistë në total</b>	<b>548,675</b>
<b>I.1</b>	<b><i>Pensionistë urban</i></b>	<b><i>390,956</i></b>
a)	Pensione pleqërie	288,533
b)	Invaliditeti	52,023
c)	Familjarë	50,400
<b>I.2</b>	<b><i>Pensionistë rural</i></b>	<b><i>157,719</i></b>
a)	Pensione pleqërie	140,776
b)	Invaliditeti	6,662
c)	Familjarë	10,281

### **B.3 Përfitimet afatshkurtra.**

Gjatë vitit 2011, shpenzimet për përfitime afatshkurtra në total (barrë lindje, sëmundje dhe aksidente në punë) *janë realizuar në masën 101%, me një tejkalim prej 23.600 mijë lekë*. Shpenzimet për barrë lindje janë realizuar qyteti 101% dhe fshati 101%; shpenzimet për sëmundje 103% dhe aksidentet në punë 61%. Në tejkalimet e shpenzimeve për sëmundje kanë ndikuar faktorët që lidhen me rritjen e nivelit të sëmundshmërisë, shtimin e numrit të kontribuesve, për pasojë shtimin e numrit të personave të mbrojtur, rritja e pagës mesatare për efekt shpërblimi krahasuar me programimin, por edhe faktorët që lidhen me punën e mjekëve të KML-ve në spitale, ku në disa raste janë konstatuar shkelje të rregullores së lëshimit të raporteve mjekësore.

Problematike gjatë 5 viteve të fundit ka qenë tejkalimi i shpenzimeve për pensionet e invaliditetit. Ky aktivitet lidhet drejtpërdrejt me punën e komisioneve mjekoligjore dhe të sektorit të ekspertizës mjekësore. Gjatë vitit 2011, nga Komisionet Eprore janë shqyrtuar dhe marrë vendime për 1,672 të sëmurë apo invalidë.

Nga këto, 443 ose në masën 26.5% ndaj totalit janë raste të reja dhe 1,229 ose 73.5% raste rikontrolli (pensione të lidhura). Nga rastet e reja, 201 prej tyre ose në masën 45.4% janë deklaruar invalidë, ndërkohë që në vitin 2010 janë deklaruar 40.7% e rasteve, kurse në vitin 2007 vetëm 24.2% e rasteve të reja, çka tregon se *numri i invalidëve të rinj të deklaruar nga KMCAP-të Eprore ka tendencë rritjeje nga viti në vit*.

### **B.4 Deficiti i Degës së Pensioneve.**

Bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, Sigurimi shoqëror i detyrueshëm jep përfitime për 4 degë të sigurimeve shoqërore, sëmundje, barrë lindje, pensione (pleqërie, invaliditeti dhe familjare) dhe aksidente në punë e sëmundje profesionale. Përfitimet që parashikon ky ligj, financohen nga kontributet e punëdhënësve, të të punësuarve dhe personave të tjerë ekonomikisht aktivë dhe këto përbëjnë *kontributet e drejtpërdrejta*.

Norma kontributive sipas degëve në vite, paraqitet në tabelën e mëposhtme:


*Në përqindje*

Nr.	EMËRTIMI	VITET				
		2007	2008	2009	2010	2011
1.	Sëmundje	0.8	0.8	0.3	0.3	0.3
2.	Barrë lindje	2.3	2.3	1.4	1.4	1.4
3.	Pensione	23.9	23.9	21.6	21.6	21.6
4.	Aksidente në punë dhe sëmundje profesionale	0.5	0.5	0.3	0.3	0.3
5.	Papunësi	2.0	2.0	0.9	0.9	0.9
<b>TOTALI:</b>		<b>29.5</b>	<b>29.5</b>	<b>24.5</b>	<b>24.5</b>	<b>24.5</b>


Sipas nenit 9, të ligjit të sipërcituar, Buxheti i Shtetit paguan kontribute për kategori të veçanta personash, përcaktuar me ligje dhe vendime të KM, duke bërë të mundur që periudha e parashikuar për këta persona të quhet *periudhë sigurimi*. *Këtu përfshihen shtetasit që kryejnë shërbimin ushtarak, të papunët në pagesë papunësie, personat në pagesë kalimtare, ushtarakët në reformë, punonjësit e nëntokës, punonjësit e industrisë ushtarake, gratë që dalin në pension në vitin respektiv*. Nga ana tjetër, Buxheti i Shtetit paguan diferencë për kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi (të cilët nga ana e tyre paguajnë më pak se të vetëpunësuarit e tjerë, në kuota fikse të përcaktuara me vendim të KM çdo vit), me qëllim që kontributi i tyre të plotësohet deri tek kontributi minimal që paguan çdo i vetëpunësuar tjetër. *Këto përbëjnë kontributet e paguara nga Buxheti i Shtetit për kategori të ndryshme.*

Buxheti i Shtetit për disa kategori, përveç kontributit për degën e pensioneve paguan dhe *për degën e barrë lindjes*.

Bazuar në të dhënat e rezultuara për periudhën 2007–2011, kontributet e drejtpërdrejta në total dhe kontributi për degën e pensioneve, paraqitet në këtë trajtë grafike:



Nga ana tjetër, kontributet e paguara nga Buxheti i Shtetit në total dhe për degë e pensioneve, paraqiten në grafikën e mëposhtme.



Nga analiza e këtyre grafikëve, konstatohet qartë që, në të dy rastet kontributi për pensione zë një pjesë shumë të madhe të kontributeve në total.

Duke i mbledhur kontributet e drejtpërdrejta dhe kontributet e paguara nga Buxheti i Shtetit sipas degëve rezultojnë se, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore në periudhën 2007-2011, paraqiten:

Në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	VITET				
		2007	2008	2009	2010	2011
1.	Sëmundje	870	1,019	712	472	503
2.	Barrë lindje	4,395	4,345	3,840	3,262	3,441
3.	Pensione	47,843	47,481	50,979	50,510	52,629
4.	Aksidente në punë dhe sëmundje profesionale	544	637	544	472	503
5.	Papunësi	2,094	2,441	1,834	1,356	1,457
<b>TOTALI:</b>		<b>55,746</b>	<b>55,923</b>	<b>57,910</b>	<b>56,073</b>	<b>58,532</b>
<b>Gjithsej pa papunësi:</b>		<b>53,652</b>	<b>53,482</b>	<b>56,076</b>	<b>54,717</b>	<b>57,075</b>

Nga ana tjetër, shpenzimet sipas degëve të përfitimit në periudhën 2007-2011, paraqiten si vijon:

Në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	VITET				
		2007	2008	2009	2010	2011
1.	Sëmundje	237	244	281	333	371
2.	Barrë lindje	865	1,045	1,262	1,602	1,928
3.	Pensione	48,862	53,507	60,391	64,998	68,803
4.	Aksidente në punë dhe sëmundje profesionale	9	12	12	8	12
<b>TOTALI:</b>		<b>49,972</b>	<b>54,808</b>	<b>61,947</b>	<b>66,941</b>	<b>71,114</b>

Kontributet e secilës degë do të përballojnë shpenzimet e veta dhe bilanci fillestar (diferenca e shpenzimeve me të ardhurat nga kontributet) sipas degëve, për periudhën 2007-2011, rezultojnë si më poshtë:

Në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	VITET				
		2007	2008	2009	2010	2011
1.	Sëmundje	634	775	431	140	132
2.	Barrë lindje	3,530	3,300	2,578	1,660	1,513
<b>3.</b>	<b>Pensione</b>	<b>- 1,019</b>	<b>- 6,026</b>	<b>- 9,412</b>	<b>- 14,488</b>	<b>- 16,175</b>

4.	Aksidente në punë dhe sëmundje profesionale	535	625	533	464	491
<b>TOTALI:</b>		<b>3,679</b>	<b>- 1,326</b>	<b>- 5,871</b>	<b>- 12,224</b>	<b>- 14,039</b>

Bazuar në nenin 8, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, periudhë e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore për efekt të pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe të pensionit familjar është edhe periudha kur personi përfiton të ardhura nga sigurimet shoqërore për shkak sëmundjeje, barrëindjeje, aksidenti në punë ose sëmundje profesionale dhe për papunësinë. Kontributet në favor të tyre transferohen nga llogaritë e degëve përkatëse.

Nga të ardhurat që mbeten pas zbritjes së shpenzimeve për secilën nga degët e tjera përveç degës së pensioneve, transferohen drejt degës së pensioneve, kontributet e personave që përfitojnë të ardhura nga sigurimet shoqërore për shkak sëmundje, barrëindje, aksidenti në punë ose sëmundje profesionale.

Bazuar në nenin 68, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar dhe në nenin 4, të ligjit nr. 10355, datë 2/12/2010 "Për buxhetin e vitit 2011", i ndryshuar, tepricat e degëve të sigurimeve shoqërore përdoren për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve. Pjesa tjetër e mbetur tepricë në degët e tjera, përveç degës së pensioneve transferohen përsëri drejt degës së pensioneve. Pas këtij transferimi, deficitit i degës së pensioneve, rezulton si më poshtë:

Në milionë/lekë


Nr.	EMËRTIMI	VITET				
		2007	2008	2009	2010	2011
1.	Sëmundje	169	345	36	0.0	0.0
2.	Barrëindje	2,498	2,312	1,656	1,166	852
3.	Aksidente në punë dhe sëmundje profesionale	529	613	527	460	486
<b>TOTALI:</b>		<b>3,196</b>	<b>3,271</b>	<b>2,220</b>	<b>1,626</b>	<b>1,338</b>
<b>Deficiti i degës së pensioneve</b>		<b>3,679</b>	<b>- 1,326</b>	<b>- 5,871</b>	<b>- 12,224</b>	<b>- 14,039</b>
<b>Deficiti pensioneve ndaj PBB-së</b>		<b>0.38</b>	<b>- 0.12</b>	<b>- 0.51</b>	<b>- 0.99</b>	<b>- 1.07</b>

Rritja e pensioneve, e cila caktohet me VKM çdo vit, ka qenë gjithmonë më e madhe se inflacioni. Sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, ISSH indeksin çdo vit masën e pensioneve për të kompensuar pasojat e ndryshimit të çmimeve të mallrave (inflacionit). Pjesa e shpenzimeve që përballon rritjen mbi inflacionin paguhet nga Buxheti i Shtetit. Duke llogaritur këtë pjesë të shpenzimit për vitet 2007 - 2011, deficiti i degës së pensioneve paraqitet si më poshtë:

Në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	VITET				
		2007	2008	2009	2010	2011
1.	Deficiti i degës së pensioneve	<b>3,679</b>	<b>- 1,326</b>	<b>- 5,871</b>	<b>- 12,224</b>	<b>-14,039</b>
2.	Indeksi i pensioneve mbi inflacionin			2,652	1,347	838
3.	Deficiti i degës pensioneve (1-2)	3,679	- 1,326	- 2,319	- 10,877	-13,202
<b>Deficiti i degës së pensioneve ndaj PBB-së</b>		<b>0.38</b>	<b>- 0.12</b>	<b>- 0.28</b>	<b>- 0.88</b>	<b>- 1.00</b>

Grafikisht në përqindje, deficitit i degës së pensioneve në vitet 2007-2011 kundrejt PBB-së respektive, paraqitet përsa vijon:



o Disa nga arsyet e rritjes së deficitit të degës së pensioneve në vitet e fundit, i cili në fund të vitit 2011 ka arritur në 1% të PBB-së të këtij viti, janë:

- Ulja e normës kontributeve;
- Ulja e numrit të personave të vetëpunësuar në bujqësi;
- Rritja e pensioneve; dhe
- Numri i pamjaftueshëm i kontribuesve për balancimin e skemës.

### C. MBI REZULTATIN FINANCIAR TË ISSH.

Rezultati pozitiv në të ardhurat nga kontributet e bujkut dhe atij vullnetar; bashkëveprimi dhe koordinimi i punës me MF për mbulimin e deficiteve të kontributeve nga sektorët private në qytet; mbledhja, realizimi dhe tejkalimi i të ardhurave të tjera; impenjimi i plotë dhe drejtimi i fokusuar për realizimin e të ardhurave; kanë bërë të mundur që rezultati fiskal i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore të detyrueshme dhe suplementare të jetë me një tejkalim të të hyrave mbi daljet për 503 milionë lekë.

Të dhëna të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

<i>Në milionë/ lekë,</i>					
Nr.	EMËRTIMI	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
<b>I.</b>	<b>SKEMA E DETYRUESHME</b>				
I.1	<b>Të ardhura</b>	<b>81,262</b>	<b>79,987</b>	<b>-1,275</b>	<b>98.4</b>
a)	Nga kontributet	49,730	47,755	-1,975	96.0
b)	Transferte nga buxheti	31,532	32,232	700	102.2
I.2	<b>Shpenzime</b>	<b>81,262</b>	<b>80,331</b>	<b>-931</b>	<b>98.9</b>
<b>II.</b>	<b>SKEMA SUPLEMENTARE</b>				
II.1	<b>Të ardhura</b>	<b>5,472</b>	<b>5,833</b>	<b>338</b>	<b>106.6</b>
c)	Nga kontributet	280	641	338	220.7
d)	Transferte nga buxheti	5,192	5,192	0	100.0
II.2	<b>Shpenzime</b>	<b>5,472</b>	<b>4,986</b>	<b>-486</b>	<b>91.1</b>
<b>III.</b>	<b>GJITHSEJ (I+II):</b>				
III.1	<b>Të ardhura (I.1+II.1)</b>	<b>86,734</b>	<b>85,820</b>	<b>-914</b>	<b>98.9</b>
e)	Nga kontributet (a+c)	50,010	48,396	-1,614	96.8
f)	Transferte nga buxheti (b+d)	36,724	37,424	700	101.9
III.2	<b>Shpenzime (I.2+II.2)</b>	<b>86,734</b>	<b>85,317</b>	<b>-1,417</b>	<b>98.4</b>
	Tejkalim i të hyrave mbi daljet	-	503		

#### C.1 Krijimi dhe përdorimi i fondit rezervë.

Mbajtja e fondit rezervë të sigurimeve shoqërore është detyrim që buron nga neni 70, i ligjit 7703, datë 11/05/1993. Në fund të vitit 2011, gjendja e fondit rezervë ishte në vlerën 3,888,559,107.75 lekë, nga 3,431,791,251.75 lekë që ishte në vitin 2010.



Sipas Vendimit të Këshillit Administrativ, në vitin 2011 është shtuar gjendja e rezervës me vlerën 456.7 milionë lekë dhe gjatë këtij viti nuk ka pasur rast për përdorimin e fondit rezervë.

Në nenin 4, të VKM nr. 1022, datë 09.07.2008 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 161, datë 11.4.1994 “Për miratimin e statutit të ISSH” përcaktohet se: “ISSH krijon një fond rezervë, të barabartë me shumën e pagesave që nevojiten për të përballuar, të paktën 3/muaj, shpenzimet për pensione. Fondi rezervë mbahet në një llogari të veçantë”.

Faktikisht shpenzimet vjetore për pensionet kanë arritur në vlerën 67,470 milionë lekë, ndërsa niveli mesatar 3/mujor i tyre përlllogaritet 16,867 milionë lekë. Për pasojë, nga krahasimi i kësaj shume me të dhënat e gjendjes së llogarisë së fondit rezervë rezulton se, rezerva aktuale mbulon vetëm 23% të fondit rezervë të përlllogaritur (3,888 milionë lekë / 16,867 milionë lekë x 100).

Deri në përfundim të auditimit të KLSH në muajin korrik 2012, nga ana e Këshillit Administrativ nuk është kryer ndonjë veprim për destinacionin përfundimtar të rezultatit prej 503 milionë lekë.

#### **D. Marrëdhëniet me ISKSH.**

Bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 4, datë 27/1/2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011” dhe në dispozita të tjera nënligjore, ISSH është ngarkuar të mbledhë dhe transferojë në llogaritë e ISKSH kontributet e bujkut dhe personave të vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të transferojë në llogaritë e ISKSH kontributet e sigurimeve shëndetësore të derdhura në Llogarinë e Unifikuar të Kontributeve pranë Bankës së Shqipërisë. Gjendja e detyrimeve dhe marrëdhënieve midis ISSH dhe ISKSH për kontributet e akumuluar dhe të transferuara, paraqitet si më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>EMERTIMI</i>	<i>Detyrimi në lekë</i>
1.	Gjendja e detyrimit ndaj ISKSH në çelje te periudhës	229,768,510.3
2.	Kontribute të sigurimeve shëndetësore të arkëtuara gjatë vitit	6,482,154,527.0
3.	Shuma e xhiruar ISKSH-së gjatë vitit	6,029,514,208.0
4.	Gjendja e detyrimit në fund të periudhës ushtrimore	682,408,829.3

Nga këto të dhëna, konstatohet rritje e detyrimit të ISSH ndaj ISKSH në shumën 453 milionë lekë, si pasojë e kontributeve të akumuluar në llogaritë e përgjithshme, por të pa transferuara në llogaritë e ISKSH. Detyrimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit ndaj ISSH për kontribute të mbledhura, por të pa derdhura është 462.9 milionë lekë. Nga këto kontribute, në janar të vitit 2012 janë derdhur 187 milionë lekë, të cilat i janë kaluar ISKSH.

## **X.2 BUXHETI I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE**

Miratimi i buxhetit të sigurimeve shëndetësore është bërë me ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”, ndryshuar me ligjin nr. 10450, datë 14/7/2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”; ligjin nr. 10496, datë 22/12/2011 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 14/12/2011 të KM “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”, të ndryshuar”. Referuar dispozitave ligjore të mësipërme, pas ndryshimeve përfundimtare, programi financiar për sigurimet shëndetësore, paraqitet si më poshtë:



a) *Të ardhurat gjithsej*, janë programuar në shumën 27,767 milionë lekë, nga të cilat nga mbledhja e kontributeve 6,510 milionë lekë, transferata e buxhetit të shtetit 20,857 milionë lekë, të ardhura të tjera 100 milionë lekë dhe nga ndryshimi i gjendjes së arkjës së ISKSH 300 milionë lekë.

b) *Shpenzimet gjithsej*, janë programuar në vlerën 27,767 milionë lekë, nga të cilat për financimin e shërbimit spitalor 13,045 milionë lekë, financimin e kujdesit shëndetësor parësor 6,470 milionë lekë, rimbursimin e barnave 6,900.5 milionë lekë, financimin e spitalit Durrës 669.5 milionë lekë; investime 15 milionë lekë dhe shpenzime administrative 667 milionë lekë. Këto shpenzime janë planifikuar të përballohen me të ardhurat e programuara si më sipër.

Treguesit përfundimtarë të të ardhurave dhe shpenzimeve për ISKSH për vitin 2011, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

				<i>Në milionë/lekë</i>		
<b>TË ARDHURAT</b>				<b>SHPENZIMET</b>		
1.	Nga kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	6,510	23.9	Rimbursimi i barnave	6,900.5	24.9
2.	Transferime nga buxheti i shtetit	20,857	75.1	Financimi i kujdesit shëndetësor parësor	6,470	23.25
3.	Ndryshimi i gjendjes së arkës së ISKSH-së	300	1.0	Financimi i shërbimit spitalor	13,045	47
4.	Të tjera	100		Financimi i spitalit Durrës	669.5	2.4
				Investime	15	0.05
				Shpenzime administrative	667	2.4
<b>TOTALI:</b>		<b>27,767</b>	100.0	<b>TOTALI:</b>	<b>27,767</b>	100.0

Plani i të ardhurave i detajuar nga ISKSH sipas Drejtorive Rajonale, me shkresën nr. 710, datë 15/4/2011, u është dërguar atyre, të cilat kanë detyrën dhe përgjegjësinë për mbledhjen dhe transferimin e kontributit nga fermerët dhe kontributin e mbledhur nga organet e tatim taksave. Në shkresë është cilësuar dhe detyrimi ligjor për rakordimin mujor dhe progresiv me ISSH, DPT dhe njësitë vartëse të tyre.

Kontributi i sigurimeve shëndetësore prej 6,510 milionë lekë është programuar të sigurohet nga DPT në shumën 6,340 milionë lekë dhe nga ISSH 170 milionë lekë. Sipas subjekteve, shumat e programuara për vitin 2011, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

<i>Në milionë/lekë</i>		
Nr.	EMËRTIMI SUBJEKTEVE	KONTRIBUTI
1.	Subjekte të biznesit të madh	2,950
2.	Subjekte të biznesit të vogël	1,040
3.	Institucionet buxhetore	2,350
4.	Fermerët	170
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>6,510</b>

#### ***A. Realizimi i Buxhetit të vitit 2011.***

Për vitin 2011, me propozim të ISKSH, Këshilli i Ministrave ka miratuar disa akte nënligjore, të cilët kanë sjellë ndryshime në mënyrën e zbatimit të buxhetit 2011, në krahasim me atë vitit 2010, më konkretisht:

1. Me vendimin e KM nr. 53, datë 26/1/2011, është miratuar ndryshimi i raporteve për financimin e kujdesit shëndetësor parësor, ndryshim i cili, konsiston në uljen e

pagesës fikse nga 85% në 80%, duke rritur masën e pagesës për realizimin e treguesve të bonusit nga 5% në 10%. Një masë e tillë, e shoqëruar me rritjen e numrit të indikatorëve për matjen e cilësisë së shërbimit, i detyron qendrat shëndetësore të rritin përpjekjet për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ato detyrohen dhe për ngritjen profesionale të stafit mjekësor, me qëllim përfitimin e buxhetit të planifikuar për këtë tregues.

2. Me vendimin e KM nr. 543 datë 27/7/2011, janë miratuar ndryshimet në ulje të përqindjeve të marzheve që përfitojnë subjektet farmaceutike nga barnat e listës së rimbursimit dhe marzheve të barnave spitalore. Sipas ndryshimeve të miratuara, marzhi i cili i shtohet çmimit CIF të importit të barnave nga importuesit dhe shpërndarësit farmaceutikë u ul nga 18% në 14%, ndërsa marzhi që i shtohet çmimit të blerjes nga shpërndarësit farmaceutikë për tregtimin me pakicë të barnave u ul nga 33% në 29%. Gjithashtu, është vendosur edhe kufiri maksimal i marzhit në masën deri 10% që mund t'i shtohet çmimeve CIF të barnave të fabrikuara në vend që blihen nga institucionet shëndetësore publike. *Marrja e këtyre masave ndikon në përfitimin e më shumë barnave për shtresat në nevojë.*

3. Sipas ligjit nr. 10355, datë 2/12/2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, neni 5, buxheti i shërbimit spitalor, u parashikua të detajohet e përdoret me VKM, ndaj ai u miratua me VKM nr. 24, datë 19/1/2011 “Për disa ndryshime në VKM nr. 140, datë 17/2/2010 për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”.

4. Në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 4, datë 27/1/2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”, pika 23, buxheti për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit spitalor u transferua direkt nga MF në çdo degë thesari, duke u konsideruar si grant për ISKSH-në. Pra, *shpenzimet e shërbimit spitalor nuk përfshihen në raportin mujor e vjetor që ISKSH raporton pranë MF për zbatimin e buxhetit.* Për këtë arsye, buxheti i shërbimit spitalor analizohet në terma të përgjithshme në një kapitull të veçantë.

5. Gjithashtu, vlen të përmendet vendimi i KM nr. 401, datë 1/6/2011 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga ISKSH dhe masën e mbulimit të tyre” dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 31/1/2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 13/5/2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar, për përfshirjen dhe aplikimin e t.v.sh.-së për barna; mbasi lista e re e barnave ka filluar nga zbatimi nga data 1 korrik 2011.

o Të ardhurat për sigurimet shëndetësore, për vitin 2011, nga 27,767 milionë lekë të programuara, janë realizuar në shumën 26,877 milionë lekë ose në masën 96.8%, me një mosrealizim në vlerë prej 890 milionë lekë. Në krahasim me realizimin faktik të vitit 2010 (25,679 milionë lekë), ato paraqiten me rritje në shumën 1,198 milionë lekë, ose në masën 4.7% më shumë. Kundrejt PBB-së të vitit 2011 këto të ardhura zenë 2.04% të tij, nga 2.07% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Të dhëna më të detajuara për realizimin e të ardhurave për sigurimet shëndetësore për vitin 2011 sipas zërave, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	TË ARDHURAT	Plan	Fakt	Në %	Në milionë/ lekë
					Pesha specifike në fakt
1.	Kontributi i shtetit	7,812	7,812.0	100.0	29.1
2.	Kontributi i sigurimeve shëndetësore nga DPT dhe ISSH	6,510	6,029.5	92.6	22.4
3.	Të ardhura të tjera	100	123.7	123.7	0.5

<i>Nr.</i>	<i>TË ARDHURAT</i>	<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>	<i>Në %</i>	<i>Pesha specifike në fakt</i>
4.	Nga gjendja e arkës	300	0.0	-	-
	Gjithsej (1+2+3+4):	14,722	13,965.2	96.8	
5.	Financimi shërbimit spitalor	13,045	12,911.7	99.0	48.0
<b>TOTALI (1+2+3+4+5):</b>		<b>27,767</b>	<b>26,876.9</b>	<b>96.8</b>	<b>100.0</b>

Referuar të dhënave të mësipërme rezultojn se:

o Të ardhurat e ISKSH (pa financimin e shërbimit spitalor trajtuar më sipër), janë realizuar në masën 13,965.2 milionë lekë ose 96.8% të kuotave të programuara, me një mosrealizim në vlerë prej 456.8 milionë lekë më pak se programimi. Në krahasim me realizimin faktik të vitit 2010, ato paraqiten me rritje në masën 3.3%, ose në vlerë absolute 454.2 milionë lekë.

o Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore janë realizuar në masën 92.6%, me një mosrealizim në vlerë prej 480.5 milionë lekë. Në krahasim me realizimin faktik të vitit 2010 (6,148 milionë lekë), ato paraqiten me ulje në masën 2% ose 118.5 milionë lekë më pak.

o Të ardhurat e tjera janë realizuar në masën 123.7%, me një tejkalim në vlerë prej 23.7 milionë lekë. Në krahasim me realizimin faktik të vitit 2010 (127.9 milionë lekë), ato paraqiten me ulje në masën 3.1% ose 4.2 milionë lekë më pak.

Ndërsa *kontributi i shtetit*, nga 7,235 milionë lekë të realizuar në vitin 2010, në vitin 2011 është realizuar në vlerën 7,812 milionë lekë, me një rritje në masën rreth 8% dhe e shprehur në vlerë 577 milionë lekë më shumë se në vitin 2010.

Transferimet janë bërë çdo muaj, në përputhje me grafikun e përcaktuar, si dhe bazuar në raportimet përkatëse të ISKSH, në zbatim të udhëzimeve të MF.

#### A.1 Realizimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore

Këto të ardhura kundrejt totalit të të ardhurave të ISKSH-së të realizuara në vitin 2011, përfshirë kontributin e shtetit, zenë 22.4% të tij. Realizimi i këtyre të ardhurave në strukturë paraqitet si më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Struktura e Kontributeve</i>	<i>Në milionë/lekë</i>		
		<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>	<i>Në %</i>
1.	Subjekte të biznesit të madh (SHA, SHPK)	2,950	2,577	87.4
2.	Subjekte të Biznesit të vogël	1,040	803	77.2
3.	Institucionet buxhetore	2,350	2,401	102.2
4.	Fermerët	170	129	75.9
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>6,510</b>	<b>6,029</b>	<b>92.6</b>

ISS, ka transferuar në llogarinë e ISKSH-së shumën prej 6.029 milionë lekë, pra 92.6% të shumës së planifikuar ose 481 milionë lekë më pak se se kuota e planifikuar prej 6,510 milionë lekë.

Sipas aktrakordimit përfundimtar të mbajtur midis ISKSH dhe ISSH, lidhur me arkëtimin dhe transferimin e kontributeve të sigurimeve shëndetësore nga ISSH në ISKSH, rezultojn se shuma e arkëtuar dhe e pa transferuar për vitin 2011 përfshirë gjëndjen në fillim të vitit 2011, është 682.6 milionë lekë, shumë kjo e evidentuar edhe në bilancin kontabël të ISKSH-së në aktivet qarkulluese.

Siç e kemi trajtuar dhe në pikën D. Marrëdhëniet e ISSH me ISKSH, në janar të vitit 2012, ISSH ka kaluar për llogari të ISKSH 187 milionë lekë nga shuma e kontributeve të prapambetura të vitit 2011.

Të ardhurat nga kontributet shëndetësore të fermerëve, janë realizuar në masën 76%, nga 170 milionë lekë të programuara janë arkëtuar 129 milionë lekë. Ky

mosrealizim sipas ISKSH ka ardhur për shkak se, fluksi më i madh i sigurimit të fermerëve është muaji dhjetor. Në katër rajone, konkretisht, Dibër, Gjirokastrë, Kukës, Tropojë dhe Sarandë këto të ardhura janë realizuar deri në masën 120%, ndërsa në rajonet e tjera realizimi varion nga 53-94%.

## **B. MBI ADMINISTRIMIN E SHPENZIMEVE**

o Shpenzimet për sigurimet shëndetësore, për vitin 2011, nga 27,767 milionë lekë të programuara, janë realizuar në shumën 26,974.5 milionë lekë ose *në masën 97.1%, me një mosshpenzim në vlerë prej 793.5 milionë lekë*. Në krahasim me realizimin faktik të vitit 2010 (25,268 milionë lekë), ato paraqiten me rritje në shumën 1,706 milionë lekë, ose në masën 6.7% më shumë. Kundrejt PBB-së të vitit 2011 këto shpenzime zenë 2.05% të tij, nga 2.03% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

*Në milionë/lekë*

<i>Nr.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Në %</i>
I.	Shpenzimet gjithsej:	27,767	26,973.9	- 793.1	97.1
	Nga të cilat:				
1.	Financimi i spitaleve nga Degët e Thesarit	13,045	12,912	- 133	99.0
2.	Financimi i qendrave të kujdesit shëndetësor parësor	6,470	5,905	- 565	91.2
3.	Financimi për rimbursimin e barnave	6,900.5	6,884.6	- 15.9	99.8
4.	Financimi i spitalit të Durrësit	669.5	669.5	0.0	100.0
5.	Shpenzime administrative	667	598.2	- 68.8	89.7
6.	Shpenzime për investime	15	4.6	- 10.4	30.6

o *Financimi nga Buxheti për shërbimin spitalor për vitin 2011*, është miratuar me VKM nr. 24, datë 19/1/2011 “Për disa ndryshime në vendimin e KM nr. 140, datë 17/2/2010 për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”. Në total, për mbulimin e këtyre shpenzimeve u planifikuan 13,045 milionë lekë dhe sipas situacionit përfundimtar, për këtë shërbim, janë shpenzuar 12,912 milionë lekë ose *99% e fondit të programuar, me një mosrealizim në vlerë prej 133 milionë lekë me pak*. Në krahasim me vitin 2010 (12,167 milionë lekë), financimi i shërbimit spitalor rezulton me rritje në masën 6.1% ose në vlerë 745 milionë lekë më shumë.

Sipas zërave të shpenzimeve rezulton se, për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore janë shpenzuar 7,259 milionë lekë ose rreth 56% e programit të shpenzimeve të vitit 2011, kurse për mallra e shërbime janë shpenzuar 5,653 milionë lekë ose 44% e programit. Vetëm për blerjen e barnave e materialeve të tjera mjekësore, spitalet kanë shpenzuar 2,439 milionë lekë, shifër kjo e barabartë me 43.2% të buxhetit për mallra e shërbime ose 19% të buxhetit total për vitin 2011. Sipas vendimeve të nxjerrë nga Këshilli Administrativ për shërbimin spitalor, rritjet e pagave duke filluar nga data 15 korrik 2011, kanë qenë:

*Për spitalin universitar*, pagat e shefave të shërbimeve 15% dhe të mjekëve të tjerë 11%; *për spitalet rajonal dhe në nivel bashkiak*, pagat e shefave të shërbimeve dhe mjekëve të tjerë nga 5.5%-6.1%; në spitalet universitare dhe spitalet e tjerë pagat e personelit infermier mesatarisht 3%; ndërsa pagat e personelit tjetër mbështetës deri në 5%.

o Shpenzimet faktike në total për vitin 2011 (pa shërbimin spitalor), nga 14,722 milionë lekë të planifikuara, janë shpenzuar 14,061.9 milionë lekë ose *në masën 95.5% e vlerës së programuar, me një mosshpenzim prej 660.1 milionë lekë*. Në

krahasim me vitin 2010 (13,100.9 milionë lekë), financimi i shërbimit spitalor rezulton me rritje në masën 7.3% ose në vlerë 961 milionë lekë më shumë.

Në strukturën e shpenzimeve, paraqiten me realizim në masën 100 përqind të kuotave të planifikuara vetëm financimi i Spitalit të Durrësit, ndërsa zërat e tjerë paraqiten me mosrealizim, ndonëse mosrealizimi në rimbursimin e barnave është fare minimal. Më konkretisht:

1. *Shpenzimet për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor*, për vitin 2011, nga 6,470 milionë lekë të programuara, janë shpenzuar 5,905 milionë lekë ose në *masën 91.2%, me një mosshpenzim në vlerë prej 565 milionë lekë.*

Buxheti i miratuar ka përballuar nevojat e qendrave shëndetësore për paga, sigurime shoqërore, mallra dhe shërbime, veçanërisht për mbulimin e nevojave për barnat të cilat përdoren nga këto qendra. Konkretisht, treguesit më të lartë të financimit për aktivitetin i përkasin Rajoneve të Korçës në masën 98%, Tropojës 96%, Beratit e Elbasanit 95%, Dibrës e Shkodrës 94%, Tiranës 93% etj., ndërsa në nivele më të ulëta paraqiten rajonet Sarandë me 74%, Kukës dhe Lezhë me 85%.

Nga analiza e treguesit të performancës (numrit të vizitave të MPF) në shkallë vendi, rezulton se ai është realizuar në masën 89.5%, nga 83.8% i realizuar në vitin 2010, gjë që tregon se kujdesi shëndetësor parësor gjatë vitit 2011 ka arritur përmirësime në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj pacienteve, të menaxhimit, administrimit dhe monitorimit të qendrave shëndetësore, si dhe përcaktimit të treguesve të matshëm të aktivitetit të cilësisë së tyre.

Treguesi i cilësisë apo bonusi është realizuar në masën 49.1%, nga 83.8% i realizuar një vit më parë. Në vlerë qendrat shëndetësore kanë arritur të përfitojnë rreth 315 milionë lekë dhe në krahasim me një vit më parë 141 milionë lekë më shumë ose në masën 87% më shumë nga viti i kaluar. Kjo është rrjedhojë e rishikimit të metodës së financimit të qendrave shëndetësore, ku bonusi u programua 10% e buxhetit të qendrave nga 5% që ishte një vit më parë dhe rritjes së treguesve të cilësisë së shërbimit. Rajonet me realizim më të mirë të treguesit të bonusit janë Tirana me 58%, Korça me 57%, Dibra me 57% dhe Durrësi me 56%; kurse më dobët paraqiten rajonet e Beratit me 38%, Lezhës me 35% dhe Vlorë me 40%.

Mbështetur në realizimin e treguesve për vitin 2011, rezulton se 416 qendrat shëndetësore të kujdesit shëndetësor parësor kanë përfituar pagesa bonus, kundrejt realizimit të treguesve të performancës dhe cilësisë, në fund të 6/mujorit të parë dhe në fund të vitit. Treguesi i numrit të vizitave në rreth 215 qendra shëndetësore është realizuar në masën mbi 80%, në 168 qendra mbi 50% dhe diferenca nën 49%

Brenda buxhetit të programuar për vitin 2011, Këshilli Administrativ ka miratuar ndryshimin e udhëzimit të shpërblimit të punonjësve të qendrave shëndetësore në të cilin përcaktohen rritjet përkatëse në pagat për çdo kategori sipas elementeve përkatës, shtesat për kualifikime, tituj e grada shkencore, rritje të cilat u aplikuan nga data 15/7/2011.

Për mjekët e përgjithshëm e të familjes, pagat pësuhan ndryshime në rritje në tre nga katër elementet përbërës të saj. Si rrjedhojë e ndryshimeve pësuhan rritje të diferencuar nga 2%-5%, pagat e mjekëve sipas zonave, qendrore, fushore e kodrinore; po kështu, rritje pësuhan pagat e mjekëve specialistë nga 4.81%-5.32% të personelit infermieristik rreth 3%, dhe personelit tjetër jo shëndetësor (sanitarë, shoferë, ekonomiste) nga 4%-5%. *Efekti financiar nga rritja e pagave dhe kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore që paguhet nga punëdhënësi, për rreth 9.300 punonjës gjithsej për vitin 2011 arriti në 71.5 milionë lekë.*

## 2. *Shpenzimet e rimbursimit të barnave*

Gjatë vitit 2011, shpenzimet e rimbursimit kanë qenë në nivelet e programuara, ose janë likuiduar 6,884.6 milionë lekë nga 6,900.5 milionë lekë të planifikuara, *ose në masën 99.8%, me një mosshpenzim në vlerë prej 15.9 milionë lekë*. Në krahasim me vitin 2010, shpenzimet e rimbursimit janë rritur në vlerë absolute për 928 milionë lekë.

Ritmet e pranimit dhe likuidimit të listë-treguesve në krahasim me vitin 2010 paraqiten me rritje. Kështu, nëse për vitin 2010 pranoheshin dhe likujdoheshin mesatarisht 495.7 milionë lekë rimbursim në muaj, gjatë vitit 2011 kjo shifër është mesatarisht 576 milionë lekë në muaj.

Gjatë 6/mujorit të parë të vitit 2011, mesatarja mujore e rimbursimit krahasuar më të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka pësuar një rritje prej 12.8%, ndërsa në 6/mujorin e dytë të (2011/2010) ritmet mesatare mujore janë rritur me 19.2%. Kjo rritje është rrjedhojë e efekteve financiare të futjes në listën e rimbursimit të 11 barnave të reja, të miratuara me VKM dhe aplikimit të t.v.sh. për barna, duke filluar nga muaji korrik 2011, efekti i cili llogaritet në 55 milionë lekë në muaj ose 331 milionë lekë gjithsej për periudhën korrik-dhjetor 2011. Ndërkohë që, *ulja e marzheve për importuesit dhe shpërndarësit e barnave, ashtu edhe për rrjetin e hapur farmaceutik, kanë pasur efekte financiare në ulje. Marzhet e ndryshuara filluan nga aplikimi në muajin shtator 2011 dhe kanë sjell kursim të fondeve mujore mesatarisht me rreth 20 milionë lekë*.

3. *Shpenzimet administrative*, në vitin 2011, nga 667 milionë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 598.2 milionë lekë, *ose në masën 89.7%, me një mosrealizim në shumën 68.8 milionë lekë*. Në strukturë, pagat dhe shpërblimet janë realizuar në masën 92.4%; sigurimet shoqërore e shëndetësore 93.1%; shpenzimet për mallra e shërbime 80.6% etj.

ISKSH qendër dhe të gjitha Drejtoritë Rajonale, si njësi shpenzuese kanë ruajtur kufijtë e planifikuar të shpenzimeve si për pagat, sigurimet shoqërore e mallra e shërbime.

4. *Shpenzimet për investime*, në vitin 2011 u realizua në masën 30.6%, ose nga 15 milionë lekë të planifikuara janë shpenzuar 4.6 milionë lekë, *me një mosshpenzim në vlerë 10.4 milionë lekë*.

5. *Shpenzimet për spitalin e Durrësit*, për vitin 2011 janë financuar sipas parashikimit të bërë në buxhetin e vitit 2011 respektivisht 669.5 milion lekë, me një rritje ndaj vitit 2010 (654 milionë lekë) prej 2%, ose 15.5 milionë lekë më shumë. Financimi është bërë për të mbuluar të tre zërat kryesorë të shpenzimeve korrente, konkretisht 380 milionë lekë për pagat, 60.5 milionë lekë për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe 229 milionë lekë për mallra e shërbime.

Brenda fondeve të dhëna, Spitali ka aplikuar rritjen e pagës mesatare prej 3%-4% me efekte financiare nga data 15 korrik 2011, rritje e cila është miratuar nga Këshilli Administrativ.

□ Duke analizuar përsa më sipër, arrihen në përfundimin se trendi i financimit për vitin 2011, paraqitet *me rënie të peshës specifike të financimit nëpërmjet kontributeve të sigurimeve shëndetësore, duke u rritur peshë specifike e financimit nga buxheti i shtetit*. Një tendencë i tillë shtron detyrë para organeve përkatëse si ISKSH dhe DPT për organizimin e punës dhe marrjen e masave të efekshme për *arkëtimin e të gjitha detyrimeve nga të gjitha subjektet që duhet të paguajnë kontribute*. Nuk është normale që shuma e kontributeve të transferuara në ISKSH



në vitin 2011 të realizohet në nivelin 6,029 milionë lekë, ndërkohë që, në vitin 2010 janë siguruar dhe shpenzuar 6,148 milionë lekë, *pra të ardhurat kanë pësuar një ulje në masën 2% dhe në vlerë 119 milionë lekë*. Për më tepër që, paga minimale dhe maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shëndetësore *në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010, është rritur me 4.2%*.

Ndonëse, duhet konsideruar mostransferimi në kohë (brenda vitit) i kontributeve të akumuluar në fakt për vitin 2011 në *shumën 682.4 milionë lekë*, gjë e cila denatyrton rezultatin real të realizimit të planit nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.

### **C. GJENDJA E LIKUJDETETEVE DHE FONDI REZERVË.**

Nisur nga fakti që buxheti i ISKSH-së si pjesë e fondeve speciale është parashikuar i balancuar dhe niveli i të ardhurave e shpenzimeve rezulton në nivele pothuaj të barabarta, gjatë vitit 2011 janë siguruar në kohë të ardhura, duke garantuar financimin e qendrave shëndetësore dhe subjekteve farmaceutike brenda afateve të përcaktuara në kontratat dypalëshe.

Mosrealizimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore nuk ka sjellë vështirësi financimi, për faktin se rishikimi i buxhetit të shtetit, i kryer në muajin korrik 2011, ku të ardhurat nga kontributet u ulën në shumën 120 milionë lekë, duke rritur pjesën e transfertës së buxhetit të shtetit po për 120 milionë lekë, plotësuan nevojat e ISKSH për fonde. Gjithashtu, gjatë rishikimit të buxhetit, u konsiderua dhe vendimi i Këshillit Administrativ për rritjen e tavanit të shpenzimeve të ISKSH-së për 300 milionë lekë, rritje e cila u përballua nga prekja e gjendjes së arkës së ISKSH të vitit 2010. Një veprim i tillë, bëri të mundur që ISKSH ditët e fundit të muajit dhjetor 2011 të kalonte në fondin rezervë shumën prej 74.6 milionë lekë. Në këtë mënyrë fondi rezervë i ISKSH-së në Bankën Qendrore në datën 31/12/2011 rezulton 3,064.1 milionë lekë. Ndërsa, gjendja e likuiditeteve në llogaritë rrjedhëse të ISKSH-së në fund të vitit ishte 207.7 milionë lekë.

Për vitin 2011, rezultati i veprimtarisë së ISKSH është pozitiv, me një tepricë të të ardhurave ndaj shpenzimeve për rreth *207.3 milionë lekë*. Fondi rezervë prej 3,064.1 milionë lekë, që përbën rreth 21% të totalit të buxhetit të parashikuar të vitit 2011 (pa buxhetin e spitaleve) ose rreth 11% të buxhetit së bashku me spitalet, *është një bazë financiare për përballimin e situatave të paparashikuara apo edhe mbulimin e shpenzimeve të ndryshme për zgjerimin e skemës*.

### **X.3 REKOMANDIMET E DËRGUARA NGA KLSH DHE ZBATIMI I TYRE**

**I. Rekomandimet e përgatitura dhe të adresuara ISSH-së nga KLSH në përfundim të auditimit të ushtruar në vitin 2011 në ISSH, për zbatimin e buxhetit të vitit 2010.**

Nga KLSH përfundimet e auditimit të ushtruar në vitin 2011, janë dërguar me shkresën nr.156/5, datë 29/7/2011 dhe protokolluar në ISSH me nr. 2035/3,

**I. Nga ISSH, përgjigjet lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, janë dërguar me shkresën nr. 2035/4, datë 05.09.2011.**

Lidhur me zbatimin nga ISSH të detyrimit ligjor për kthimin e përgjigjes mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për përmirësimin e gjendjes, brenda afatit

datë 1/8/2011.

*Nga KLSH, ISSH-së i janë dërguar për ndjekje dhe zbatim 13 rekomandime, të cilat janë konfirmuar nga ISSH të gjitha.*

Bazuar në autorizimin e Kryetarit të KLSH nr. 285/32, datë 26/11/2011, nga audituesit e KLSH është kryer verifikim për zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe është mbajtur akt-verifikimi përkatës më datë 12/12/2011.

□ Nga verifikimi, niveli i zbatimit të rekomandimeve paraqitet:

- Janë zbatuar plotësisht 4 rekomandime ose në masën 30.8% të totalit të tyre;
- Pjesërisht dhe në proces ndjekjeje 8 ose në masën 61.5%; dhe
- Nuk është zbatuar 1 rekomandim ose në masën 7.7% të tyre.

Rekomandimi nr. 1

Të analizohen nga Këshilli Administrativ arsyet e moszhvillimit të mbledhjeve të tij minimumi 4 (katër) herë në vit, në zbatim të dispozitave ligjore për organet drejtuese të institucioneve të pavarur dhe statutit të këtij institucioni.

Rekomandimi nr. 2

Të analizohen me përgjegjësi nga Këshilli Administrativ, ndryshimet në buxhet dhe konkretisht: rritja e transfertave nga buxheti në vlerën 9,275 milionë lekë, kur raporti kontribute dhe transferat e buxhetit të shtetit janë përkatësisht 57.1% me 42.9%, duke sjell pasoja në skemën e sigurimeve. Rritja e transfertave ka ardhur kryesisht nga rritja e pensioneve, në nivele më të larta se kontributet e realizuara dhe konkretisht:

- Mosrealizimi i të ardhurave nga kontribuesit urbane ka sjellë për pasojë rritjen e pjesëmarrjes së buxhetit të

20 ditor të parashikuar në nenin 16, të Ligjit Organik të KLSH-së, nga auditimi i kryer, KLSH ka konstatuar se ISSH me shkresën nr. 2035/4, datë 5/9/2011 ka njoftuar KLSH-në për shqyrtimin e rekomandimeve të bëra dhe bashkëlidhur kësaj shkrese, ka dërguar programin e masave, ku përcaktohen masat që duhen marrë, strukturat e personat përgjegjës për ndjekjen e tyre, sipas afateve kohore të përcaktuara, si dhe urdhrat përkatës të nxjerrë për realizimin e tyre.

Për rekomandimin nr. 1

Auditimi i KLSH ka konstatuar se kjo normë e parashikuar nga neni 15, i VKM nr. 161, datë 11/4/1994 “Për miratimin e Statutit të ISSH”, i cili përcakton në mënyrë nominale se: “Këshilli Administrativ mbledhet jo më pak se 4 herë në vit”, ndonëse është trajtuar, nuk ka gjetur zbatim, pasi dhe për vitin 2011, janë zhvilluar 3 (tre) mbledhje datë 4/3/2001, 4/7/2011 dhe 26/12/2011.

Ky rekomandim konsiderohet i realizuar pjesërisht.

Për rekomandimin nr. 2

Deficiti i skemës së pensioneve është analizuar edhe në KM, por mbetet domosdoshmëri përcaktimi si nevojë urgjente i ndërmarrjes së një reforme të plotë parametrike dhe administrative për përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe të administrimit të sistemit të sigurimeve shoqërore.

Nga verifikimi i KLSH rezultoi se, ky rekomandim është në proces zbatimi si pjesë e projektit të modernizimit të sistemit të sigurimeve shoqërore.



shtetit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore përkatësisht për vitet 2009 dhe 2010 në shumën 6.7 miliardë lekë dhe 7.3 miliardë lekë.

- Aktualisht deficitin e krijuar, në mënyrë periodike është mbuluar me subvencionet e buxhetit, por duhet të analizohen pasojat e drejtpërdrejta në gërryerjen e qëndrueshmërisë financiare të skemës së detyrueshme, sipas projeksioneve të bëra nga Banka Botërore dhe ISSH në vitin 2007.

Rekomandimi nr. 3

Të merren masat e nevojshme për mbajtjen e kontabilitetit të pagesave me arkë dhe bankë në valutë, nga sektori i financës në aparatit e ISSH-së, konformë rregullave të përcaktuara në udhëzimin për mbajtjen e kontabilitetit nga institucionet buxhetore, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin e vlerave materiale dhe monetare.

Rekomandimi nr. 4

Të merren masa nga specialistët e njësisë së prokurimit, që të kërkojnë oferta në firmat që merren me prodhimin ose importimin e mallrave të veçantë, për të llogaritur fondin limit, në zbatim të dispozitave ligjore për prokurimin publik.

Rekomandimi nr. 5

Të analizohet në Këshillin Administrativ, duke përcaktuar detyrat konkrete për 2 institucionet në varësi të Ministrisë së Financave (ISSH dhe ISKSH), për ecurinë dhe ndjekjen me përparësi të shkëmbimeve dhe rakordimeve të informacionit me DPT, për numrin e subjekteve, numrin e kontribuesve, nivelin e shlyerjes së detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore etj., me qëllim reduktimin e evazionit në tregun e punës dhe pagesën e kontributeve për sigurimet shoqërore.

Për rekomandimin nr. 3

Nga auditimi i zbatimit të këtij rekomandimi rezultoi se, është kryer kontabilizimi i shpenzimeve të administrimit në monedhë të huaj, është kryer rakordimi i gjendjes fizike të arkës në monedhë të huaj me gjendjen kontabile, dhe ka vijuar procedura e rregjistrimit në kontabilitet konform normrave ligjore në fuqi.

Referuar masave të marra, ky rekomandim vlerësohet *i realizuar*.

Për rekomandimin nr. 4

Nga auditimi i zbatimit të këtij rekomandimi rezultoi se, ka përpjekje serioze nga departamenti përkatës për implementimin e kërkesave të ligjit të prokurimit, ndaj ky rekomandim vlerësohet në *proces zbatimi*.

Për rekomandimin nr. 5

Nga auditimi i zbatimit të këtij rekomandimi rezultoi se, nga DPT është ndërfaqësuar një sistem i automatizuar për pagesën e kontributeve dhe informacion mbi pagat dhe kontributet, i emërtuar “listë pagesat online”. Në harmoni me këtë program edhe ISSH ka përfunduar procedurat e tenderimit dhe është lidhur kontrata për sistemin e automatizuar të kontributeve, i cili parashikon pritjen e informacionit nga tatimet, pozicionimin e llogarive individuale dhe të statistikave. Referuar masave të marra për përmirësimin e raporteve të bashkëpunimit, ky

Rekomandimi nr. 6

Të analizohet nga Këshilli Administrativ vjelja e borxheve të prapambetura, që rezultojnë në vlera shumë të larta, rreth 5,778 milionë lekë për periudhën 1/1/2007 deri më 31/2/2010, të cilat në ISSH janë të evidentuara, kurse në DPT nuk janë evidentuar në kontabilitet, me qëllim krahasimin e shifrave midis palëve, për të saktësuar gjendjen e detyrimit të prapambetur në fund të çdo viti kalendarik, përmes një veprimi koordinues më aktiv me organet tatimore.

Rekomandimi nr. 7

Të merren masat e nevojshme për përfundimin e ndërtimit të rrjetit informatik të të dhënave mbi aktivitetin financiar në zbatim të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, për të mundësuar miradministrimin, saktësimin dhe kuadrimin e të dhënave mbi përfitimet me pagesat e kryera nga qendrat paguese, pas përfundimit të informatizimit të të dhënave mbi numrin e sigurimit dhe përfitimet afatgjata, nëpërmjet skanimit të dokumentacionit bazë, me qëllim shfrytëzimin e tyre në drejtim të përpunimit të mëtejshëm të praktikave administrative dhe financiare.

Rekomandimi nr. 8

Të merren masa për përfundimin e marrëveshjes me DPT për kalimin e të dhënave në format elektronik, të

rekomandim vlerësohet në proces zbatimi.

Për rekomandimin nr. 6

Auditimi konstaton se ende kanë mbetur në llogari të organeve të sigurimeve shoqërore 253 subjekte debitoare aktive të patransferuara, për të cilën Drejtori i Përgjithshëm i ISSH me shkresën nr.571, datë 31/1/2012 u ka kërkuar Drejtuesve të DRSSH-ve transferimin e detyrimeve të subjekteve aktive në DRT. Në kushtet kur afati i zbatimit të ligjit “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit”, pati një shtyrje, dhe ISSH me shkresën nr. 571/1, datë 16.02.2012 konfirmoi shtyrjen e afatit të transferimit të subjekteve debitorë, duke caktuar datën 20 prill 2012. Madje, për të ndihmuar teknikisht dhe ligjërisht procesin e dorëzimit të dokumentacionit nga organet e sigurimeve shoqërore në ato tatimore, ISSH formuloi Akt-Transferimin, i cili ju dërgua 6 DRSSH-ve që kanë subjekte debitorë aktivë të patransferuar ende në organet tatimore. Ky rekomandim vlerësohet në proces zbatimi

Për rekomandimin nr. 7

Nga auditimi i zbatimit të këtij rekomandimi rezultoi se, kjo çështje është në vazhdimësi, si pjesë e projektit të modernizimit të sistemit të sigurimeve shoqërore. Detyra ndiqet nga koordinatoret e projekteve dhe njësia e zbatimit të projektit të BB. Sipas raportimit të ISSH, konfirmohet se ka përfunduar programi i sistemit financiar, është bërë trajnimi i personelit dhe pritet të implementohet në të gjitha DRSSH-të dhe Agjencitë (konsulente FASTECH). Me masat e marra, ky rekomandim vlerësohet në proces zbatimi.

Për rekomandimin nr. 8

Nga auditimi i zbatimit të këtij rekomandimi rezultoi se ISSH ka përfunduar të gjitha procedurat dhe me

kontributeve të sigurimeve shoqërore të paguara, nga drejtoritë rajonale tatimore në DRSSH nisur nga mangësitë e defektet e vërejtura në praktikat e deritanishme të bashkëpunimit lidhur me raportimin dhe evidentimin e kontributeve, shkëmbimin e informacioneve të detyrueshme (formulari përmbledhës i listëpagesave, dorëzimin e listëpagesave origjinale në drejtoritë rajonale, informacioni statistikor mbi numrin e subjekteve të regjistruara dhe atyre aktive, numrin e kontribuesve krahas shumave të kontributeve mujore të derdhura, dërgimin e raporteve mujore etj.), si dhe të organizohen kontrole të përbashkëta dhe efektive mbi bazë marrëveshesh të nënshkruara.

Rekomandimi nr. 9

Nga Drejtoria e Auditimit Brendshëm të zbatohen standardet për praktikat profesionale dhe të korrigjohen mangësitë e evidentuara në raportin e auditimit, si për treguesit e performancës, cilësinë e akteve, nivelin e raporteve, dokumentimin e zbulimeve, përmirësimin e sistemit të raportimit statistikor të institucionit, si dhe arkivimin e dosjeve të auditimit, sipas përcaktimeve në manualin e auditimit të brendshëm dhe ligjin nr. 9154, datë 6/11/2003 “Për Arkivat”.

Rekomandimi nr. 10

Të studiohen normat e auditimit dhe të gjykohet për mjaftueshmërinë e kapaciteteve profesionale në auditimin e brendshëm, duke përfunduar procedurat e emërimit të personelit të rekrutuar në këtë shërbim mbi baza konkurimi, për rastet e plotësimit të kriterëve të arsimimit dhe certifikimit sipas nenit 19, të ligjit nr. 9720 dhe Rregullores nr. 3 datë 26/2/2008 të miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH.

shkresën nr 4620/1, datë 26/7/2011, ka dërguar për miratim në DPT një akt-marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave, e cila është nënshkruar dhe protokolluar në ISSH me nr. 4620/2, dhe në DPT me nr. 18534/4, datë 10/11/2011. Nga DPT janë dërguar periodikisht pranë ISSH të dhënat mujore mbi numrin e kontribuesve për çdo rreth, nivelin e detyrimit dhe shlyerjes, gjendjen e borxhit etj.

Megjithkëtë, përsëri në dorëzimin e listëpagesave, janë konstatuar disa mangësi të karakterit të zbatimit të afateve të caktuara për dërgimin e tyre. Ndaj, ky rekomandim vlerësohet në proces zbatimi.

Për rekomandimin nr. 9

Auditimi i zbatimit të këtij rekomandimi ka vlerësuar se është punuar mirë në drejtim të konkretizimit të gjetjeve dhe arsytimit të shkeljeve me informacionin respektiv justifikues dhe se ecuria e ndjekjes së kësaj mase është në proces zbatimi.

Për rekomandimin nr. 10

Nga ISSH është realizuar ndarja e procesit të auditimit të brendshëm nga procesi i inspektimit. Konkretisht, me urdherin nr. 140, datë 1/12/2010 është krijuar Sektori i Njësisë së Inspektimit, (atashuar brenda Drejtorisë së Përfitimeve me 1 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë), kurse Drejtoria e Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut është e plotësuar me 1 drejtor dhe 12 auditues. Pra, janë marrë masa për plotësimin e organikës duke përcaktuar e zbatuar edhe normativat profesionale. Referuar këtyre masave të marra, ky

Rekomandimi nr. 11

Të vijohet ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit, sipas një plani të veçantë tematik, në përputhje me përcaktimet e pikës nr. 6, seksioni V të Manualit të Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik, miratuar me VKM nr. 345, datë 1/6/2004, pasi nga disa auditime kanë rezultuar neglizhenca në vlerësimin e detyrave, kontabilizimin dhe arkëtimin e shumave të lëna për zhdëmtim etj.

Rekomandimi nr. 12

Të administrohet rregullisht në dosjen e auditimit dokumentacioni mbi ndarjen e pikave të programit midis anëtarëve të misionit të auditimit, dokumentimin e harxhimit të kohës së punës në objekt, takimin e hapjes me titullarin e subjektit të audituar, takimi pajtues, pyetsorët mbi vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, akti i mbylljes së dosjes, për të gjykuar mbi efektivitetin dhe performancën e strukturës në harmoni me produktet e nxjerra.

I.1 Rekomandimet e përgatitura dhe të adresuara ISSH-së nga KLSH në përfundim të auditimit të ushtruar në vitin 2012 në ISSH, për zbatimin e buxhetit të vitit 2011.

Nga KLSH janë dërguar përfundimet e auditimit të ushtruar në vitin 2012 me shkresën nr.456/7, datë 3/8/2012.

Nga KLSH, ISSH-së i janë dërguar për ndjekje dhe zbatim 21 rekomandime, të cilat janë konfirmuar të gjitha nga ISSH.

Rekomandimi nr. 1

Nga auditimi i zbatimit të ligjit nr. 10142, datë 15/5/2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, .....” ka rezultuar se në nenin 2, gjejnë rregullim “.....ushtarakët në rezervë/lirim për pension pleqërie”, duke mospërfshirë

rekomandim vlerësohet i realizuar.

Për rekomandimin nr. 11

Nga auditimi i zbatimit të këtij rekomandimi rezultoi se, nga ana e DAB të ISSH janë ndjekur rekomandimet në DRSSH-të e programuara sipas tematikës (programit të auditimit) nr. 7171, datë 7/12/2001.

Për sa sipër, ky rekomandim vlerësohet i realizuar.

Për rekomandimin nr. 12

Nga auditimi rezultoi se nga ISSH janë marrë masat për të sistemuar dosjet e auditimit me indeksin e përbërësve të çdo dosje. Me procesverbalin e datës 6/1/2012 të mbajtur me zyrën e arkivit, janë dorëzuar në arkiv 20 praktika/dosje që i përkasin vitit 2010, të inventarizuara me numra faqesh dhe pjesë përbërëse për çdo seksion, sipas rregullave të përcaktuara.

Për sa sipër, ky rekomandim vlerësohet i realizuar.

I.1 Përgjigjet e ISSH lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

ISSH me shkresën nr. 3739/11, datë 3/9/2012 ka informuar KLSH-në se për zbatimin e rekomandimeve të dërguar nga KLSH, ka hartuar programin e masave me nr. 3739/12, date 3/9/2012.

Referuar këtij programi paraqesim pa koment përgjigjet e cilësuar nga ISSH për secilin rekomandim:

Për rekomandimin nr. 1

Do të përgatitet një projektvendim lidhur me procedurën dhe rregullat e plotësimit të dokumentacionit për dokumentimin e vjetërsisë në shërbim dhe pagës referuese për ish prokurorët ushtarakë, për aq kohë sa prokurorët kanë gëzuar statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura.

prokurorët e gjyqtarët ushtarak  
*Sa më sipër, kemi rekomanduar që:*

Të bëhen përmirësimet e nevojshme në nenin 2, të ligjit nr. 10142, datë 15/5/2009, ku pas fjalëve “.....ushtarakë në rezervë/ lirim/ pension pleqërie”, të përfshihen prokurorët dhe gjyqtarët ushtarakë.

Këto ndryshime të pasqyrohen dhe në kreun III “Procedurat e përfitimeve dhe dokumentacioni”, të VKM nr. 252, datë 09/2/2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 793, datë 24/9/2010 të KM “Për zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15/5/2009, ku të shtohen fjalët “Për kategoritë e prokurorëve dhe gjyqtarëve ushtarakë, Ministria e Mbrojtjes duhet të përgatisë dokumentacionin përkatës për trajtimin suplementar të ushtarakëve”.

Brenda muajit dhjetor 2012

Rekomandimi nr. 2

Të fillojnë procedurat për shfuqizimin e germës “dh” të nenit 74 “Kompetencat e Këshillit Administrativ”, të ligjit nr. 7703, datë 19/1/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH” i ndryshuar, sipas të cilës Këshilli Administrativ miraton Komisionin e Kontroll-Revizionit për veprimtarinë e ISSH-së, meqenëse:

a) kjo e drejtë e Këshillit Administrativ e parashikuar në nenin 12 të Statutit të ISSH, miratuar me VKM nr. 161, datë 11/4/1994, është shfuqizuar nga pikat 4/c dhe 5 të VKM nr. 1022, datë 9/7/2008, ku përcaktohet shprehimisht që:

“Neni 12 ndryshohet si më poshtë vijon:  
Në përbërje të ISSH ngrihet njësi e auditimit të brendshëm, e cila auditon veprimtarinë e strukturave të saj jo më pak se një herë në 2 vjet. Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm emërohet/shkarkohet me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm dhe me miratim të Këshillit Administrativ. Drejtuesi i njësisë raporton periodikisht dhe sipas kërkesave të Këshillit”.

b) Ky përcaktim është i papajtueshëm

Afati: Deri më 30/10/2012

Për zbatim: ISSH në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

Për rekomandimin nr. 2

Do të bëhet me dije për këtë detyrë të përcaktuar në raportin e auditimit të KLSH.

Sipas analizës do të njoftohet KLSH.

Afati: Në mbledhjen më të afërt.

Për zbatim: Këshilli Administrativ

me ligjin nr. 9720, datë 23/4/2007 "Për auditimin e brendshëm të sektorit publik", i ndryshuar.

Brenda muajit mars 2013.

Rekomandimi nr. 3

Të përmirësohet Kreu V "Lëshimi i raporteve mjekësore për lejen e barrës dhe të lindjes" i Rregullores së përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISSH nr. 494, datë 11/5/1993 "Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohshme në punë", i ndryshuar me Rregulloren nr. 3/1, datë 11.04.2006.

Për sa sipër, të gjejnë rregullimin juridik rastet e trajtimit me raport barrëlindje kur fëmija lind jashtë shtetit dhe përfituesi paraqitet me vonesë të mjeku i familjes apo tek institucioni përgjegjës për lëshimin e raporteve mjekësore me prapaveprim, dokumentimi i posaçëm i këtyre procedurave dhe listimi i një portofoli dokumentesh të detyrueshme që duhen paraqitur, numri i regjistrimit që do të shënohet në fletën e raportit në rubrikën "numri i regjistrimit të vizitës së fëmijës", etj.,

Brenda muajit dhjetor 2012.

Rekomandimi nr. 4

Të kryhen përmirësimet e duhura në pikën 1.2 të "Pjesës së dytë", "Bilanci i popullsisë.....", të Rregullores nr. 2, datë 2/12/2008 "Për kontributet e sigurimeve shoqërore", të miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH.

Për këtë, të vendoset detyrimi që inspektorët e të vetëpunësuarve në bujqësi të marrin konfirmimet zyrtare mbi numrin e personave që trajtohen nga skema e ndihmës ekonomike dhe atyre që nuk kanë përfituar tokë sipas ligjit nr. 7501, datë 19/7/1991 "Për tokën" nga bashkitë dhe komunat për të vetëpunësuarit në bujqësi, duke ndryshuar formularët 4 dhe 5 të Rregullores. Brenda muajit nëntor 2012.

Rekomandimi nr. 5

Të merren masa për përfundimin e regjistrimit të bazës së të dhënave

Për rekomandimin nr. 3

Me një grup pune nga Drejtoria e Përfitimeve, Drejtoria Juridike e ISSH, perfaqesues nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga ISKSH, do të përgatiten dhe implementohen rekomandimet për ndryshimet në rregulloren nr. 494, datë 11/5/1993.

Afati: Deri më 30/11/2012.

Për zbatim: Drejtore e Përgjithshme, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Përfitimeve.

Për rekomandimin nr. 4

Do të përgatiten ndryshimet në Rregulloren e Kontributeve, sipas rekomandimeve. Përfundimi i materialit për ndryshime në rregullore, deri më 15/10/2012.

Paraqitja për miratim në Këshillin Administrativ deri më 30/10/2012.

Afati: Deri më 30/11/2012.

Për zbatim: Këshilli Administrativ dhe Drejtore e Përgjithshme.

Për rekomandimin nr. 5

Deri në datën 5/9/2012, të nxiret urdhëri i Drejtores së Përgjithshme për

kontributive për të vetëpunësuarit në bujqësi, duke kryer rakordimin përfundimtar të të dhënave të regjistrave me dokumentacionin justifikues dhe ditarët financiarë për periudhën 1/10/1993 deri 31/12/2005, si dhe të përfundojë regjistrimi dhe azhurnimi i bazës së të dhënave për sigurimin vullnetar për vitin 2011 dhe progresiv.

Brenda muajit nëntor 2012.

Rekomandimi nr. 6

Të hartohet bilanci i popullsisë agrare në kushtet e sigurimit shoqëror në zonat rurale në total, sipas fshatrave dhe analitik për popullsinë në moshën nga 16 vjeç deri në moshën e daljes në pension, duke u mbështetur në të dhënat e gjendjes civile dhe forcat aktive të punës në fshat. Ky bilanc do t'i shërbejë programimit dhe realizimit të të ardhurave nga kontributet e të vetpunësuarve në bujqësi, në zbatim të nenit 2 të ligjit nr. 7703, datë 11/5/1995, me ndryshimet, pasi evidentohet një numër i konsiderueshëm i personave të pasiguruar dhe që janë në moshë për t'u siguruar.

Brenda muajit janar 2013.

Rekomandimi nr. 7

Të hartohen programe të argumentuara për të ardhurat nga kontributet, me qëllim reduktimin e evazionit në zonat rurale, pasi ekonomia informale, në drejtim të pagesës së kontributeve është e lartë dhe jep ndikim në të ardhurat e buxhetit të shtetit.

Për sa sipër, të saktësohen dhe rakordohen këto tregues me INSTAT, pasi ka diferenca të mëdha të numrit të fermerëve që duhet t'i nënshtrohen sigurimit, ku sipas INSTAT rezultojnë 506,664 persona dhe sipas ISSH janë llogaritur të sigurohen çdo vit 195,900 fermerë. Vazhdimisht

Rekomandimi nr. 8

Të programohen detyrat me afate

përfundimin e regjistrimit.

Puna në drejtoritë rajonale do të përfundojë deri në datën 20/11/2012.

Unifikimi përfundimtar në ISSH deri në datën 30/11/2012

Afati: Deri më 30/11/2012.

Për zbatim: Drejtoria e Kontributeve, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e IT.

Për rekomandimin nr. 6

Do të përgatitet një metodikë për hartimin e bilancit të popullsisë, e cila do të përcillet me një urdhër të Drejtores së Përgjithshme.

Puna në terren do të kryhet në periudhën dhjetor deri 15 janar 2013. Konsolidimi i treguesve të bilancit të popullsisë rurale deri në 31/1/2013.

Afati: Deri më 31/1/2013.

Për zbatim: Drejtoria e Kontributeve.

Për rekomandimin nr. 7

Pas përfundimit të Bilancit të popullsisë dhe ballafaqimit të treguesve të këtij bilanci me treguesit e INSTAT do të analizohet dhe programohen mundësitë për rritjen e numrit të kontribuesve dhe reduktimin e evazionit të kontributeve në zonat rurale.

Afati: Vazhdimisht.

Për zbatim: ISSH, Drejtoria e Kontributeve.

Për rekomandimin nr. 8

Do të bëhet një analizë e plotë e

konkrete, për zbatimin e pikës 6, të vendimit të KM nr. 477, datë 30/6/2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008, të KM.....”, për përfundimin e procesit të transferimit të subjekteve debitorë aktive dhe të detyrimeve të tyre të prapambetura, në organet tatimore.

Për këtë, Drejtoritë Rajonale të ISSH të bëjnë evidentimin analitik të të gjithë subjekteve debitorë joaktivë, duke i klasifikuar detyrimet e tyre nën emërtimin “borxh i keq”, nëpërmjet evidentimit të plotë të veprimtarisë së këtyre subjekteve, periudhës deri kur u janë llogaritur detyrimet dhe kohës kur është mbyllur aktiviteti. Vazhdimisht.

Rekomandimi nr. 9

Të ndiqen dhe zbatohen detyrimet e nenit 15 të ligjit dhe të pikës 6 të VKM nr. 1114, datë 30.07.2008 “Për disa çështje në zbatimin e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për sigurimin e detyrueshëm të fermerëve të vetëpunësuar në bujqësi, duke zbatuar gjithë sanksionet e parashikuara për fermerët që nuk sigurohen dhe për pagesën e kontributeve të paguara prej tyre, pasi asnjë çështje nuk është ndjekur me Zyrat e Përmbarimit.

Vazhdimisht

Rekomandimi nr. 10

Të zbatohen kërkesat e Akt-marrëveshjes së lidhur midis ISSH dhe DPT me nr. 4620/2 prot., datë 10/11/2011 “Për dërgimin nga Drejtoritë Rajonale Tatimore tek DRSSH, të të dhënave, për kontributet e paguara nga çdo subjekt”, për përmirësimin e marrëdhënieve institucionale dhe dorëzimin e listëpagesave të munguara duke i detajuar për çdo subjekt dhe sipas viteve, meqenëse për periudhën 2006-2011, mungojnë gjithsej 225,321 listëpagesa. Vazhdimisht.

Rekomandimi nr. 11

borxheve të pa transferuara si dhe një riklasifikim i detyrimeve.

Do të hartohet një program pune për ndjekjen e detyrimeve deri në arkëtimin e tyre në bashkëpunim me DPT.

Afati: Deri më 30/9/2012 dhe vazhdimisht.

Për zbatim: Drejtoria e Kontributeve.

Për rekomandimin nr. 9

Deri në 31/3/2012 ka shtrirë efektet ligji i faljes së kamatvonesave. Në vazhdim do të ndiqen procedurat ligjore të evidentimit të detyrimeve dhe penaliteteve, konform kërkesave të pikës 6, të VKM nr. 1114, i ndryshuar.

Afati: Në vazhdim.

Për zbatim: Drejtoria e Kontributeve dhe Drejtoria e Financave.

Për rekomandimin nr. 10

Në vazhdim do të ndiqen dërgimi/pranimi i informacionit financiar për kontributet e paguara si dhe grumbullimi, kontrolli dhe arkivimi i dokumentacionit që personalizon kontributet e paguara.

Do të bashkërendohet puna me DPT për grumbullimin e dokumentacionit të munguar.

Afati: Në vazhdim.

Për zbatim: Drejtoria e Kontributeve.

Për rekomandimin nr. 11



Të fillojnë procedurat e emërimit për anëtarët e Këshillit Administrativ të ISSH, pasi 5 anëtarëve u ka përfunduar mandati dhe vijojnë të qëndrojnë në këtë funksion, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të nenit 72, të ligjit nr. 7703, datë 11/5/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar, ku përcaktohet se emërimi i anëtarëve të Këshillit Administrativ është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

Rekomandimi nr. 12

Të rindërtohet organigrama e Drejtorisë së Përgjithshme dhe të rishikohet, përputhet dhe plotësohet Rregullorja e Brendshme e ISSH-së, duke harmonizuar përshkrimet e posteve të punës me organigramën, me qëllim që, të ofrohet siguria e duhur se aktivitetet operative dhe administrative funksionojnë në pajtim me standardet më të mira dhe objektivat strategjike të ISSH. Njëkohësisht, të hartohet dhe miratohet një sistem monitorimi mbi treguesit themelorë, sipas përgjegjësisë të çdo hallke dhe drejtorie, me qëllim mbajtjen e tyre nën kontroll.

Brenda muajit janar 2013.

Rekomandimi nr. 13

Në zbatim të neneve 10 dhe 21 të ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Drejtoria e Përgjithshme e ISSH të hartojë Strategjinë e Menaxhimit të Riskeve sipas prioriteteve dhe drejtimeve.

Brenda muajit tetor 2012.

Rekomandimi nr. 14

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e Përfitimeve në ISSH, të kryejnë verifikimet në DRSSH Kukës, për saktësimin e të dhënave lidhur me: 2

Kjo detyre është kryer. Janë derguar shkresat sipas institucioneve përfaqësuese në KA si dhe janë kthyer konfirmimet për të gjithë anëtarët që kanë plotësuar ciklin për ndryshim ose rikonfirmim.

Afati: Menjëherë.

Për zbatim: Drejtore e Përgjithshme.

Për rekomandimin nr. 12

Brenda muajit nëntor 2012, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive të përgatisin studimin për strukturën organizative të ISSH, në përmbushje të kërkesave për vënien në funksionim të sistemit të informatizuar të Sigurimeve Shoqërore si dhe të përmbushjes së rekomandimeve në funksion të mirëqeverisjes së ISSH dhe efektivitetit të strukturave.

Afati: Deri më 30/1/2013.

Për zbatim: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm.

Për rekomandimin nr. 13

Me urdhër të Titullarit të Institucionit ngrihet grupi i punës i cili do të hartojë strategjinë e menaxhimit të riskut, e cila do të përmbajë identifikimin, vlerësimin dhe masat prioritare të menaxhimit të riskut. Grupi i punës, përgatit strategjinë e menaxhimit të riskut mbi bazen e problematikave të çdo shërbimi. Afati: hartimi nga Grupi i Punës i strategjisë deri më 20/10/2012, analiza dhe miratimi deri më 30/10/2012.

Për rekomandimin nr. 14

Për zbatimin e kësaj detyre është hartuar një program i veçantë auditimi për Drejtorinë Rajonale Kukës me nr. 5425, datë 01/8/2012.

Afati: Menjëherë.

raste, ku nuk u gjenden të dhënat e përfituesve në Regjistrin Kombëtar të Shtetasve dhe 47 raste, ku është evidentuar një diferencë e përgjithshme ndërmjet të dhënave të Regjistrin Kombëtar të Shtetasve dhe Regjistrin Elektronik të Pensioneve të ISSH, për 373 vite, 7 muaj dhe 22 ditë.

Rekomandimi nr. 15

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të analizojnë në mënyrë të njëpasnjëshme dhe përfundimtare rregullaritetin e caktimit të pagave të personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së dhe DRSSH-ve, si dhe të bëhen korrigjimet e nevojshme sipas Rregullores “Për personelin ISSH”, miratuar nga Këshilli Administrativ me Vendimin nr. 3/2, datë 26.02.2008, me ndryshimet.

Brenda muajit mars 2013.

Rekomandimi nr. 16

Të zbatohen procedurat lidhur me njoftimet për mbledhjet dhe rregullshmërinë e nënshkrimit të akteve të Këshillit Administrativ në ISSH, sipas përcaktimeve të nenit 17 të VKM nr. 161, datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të ISSH” dhe ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, sepse për 3 raste në vitin 2011, për aktet e lëshuara u konstatuan mangësi në zbatimin e kërkesave të mësipërme. Vazhdimisht.

Rekomandimi nr. 17

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të hartojë një tematikë të veçantë për të ndjekur në të gjithë DRSSH-të, ecurinë e kontabilizimit dhe vënies në kushte arkëtimi të dëmeve të rezultuara në fondet e pensione, si nga korrigjimet në certifikatat e lindjes ashtu dhe nga abuzimet me periudhat e vjetërsisë në punë.

Brenda muajit dhjetor 2012.

Për zbatim: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Procesi i auditimit në momentin e kthimit të përgjigjes nga ISSH kishte filluar dhe përfundon brenda datës 15/9/2012.

Për rekomandimin nr. 15

Do të përgatitet një material mbi rregullaritetin e caktimit të pagave dhe vlerësimeve për gjendjen e zbatimit të sistemit të pagave dhe vlerësimet.

Afati: Deri më 31/3/2013.

Për zbatim: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Për rekomandimin nr. 16

Njoftimi për mbledhje dhe materialet do t'i njoftohen çdo anëtar të Këshillit Administrativ, sipas procedurave të përcaktuara.

Afati: Vazhdimisht.

Për zbatim: Drejtore e Përgjithshme dhe Sekretare e Këshillit Administrativ.

Për rekomandimin nr. 17

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në programet e auditimit të njëjësive zbatuese, do të ketë të evidentuar si çështje të veçantë, kontabilizimin dhe masat për vënien në arkëtim të dëmeve për shkak të falsitetit të certifikatave apo periudhave të sigurimit. Në muajin dhjetor do të programohet një tematikë e veçantë lidhur me këtë çështje.

Afati: Deri më 31/12/2012.

Rekomandimi nr. 18

Sipas kërkesave të pikës 2.4, kapitulli IV të Rregullores “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, miratuar me vendimin nr. 3/2, datë 26/2/2008 të Këshillit Administrativ, të plotësohen dosjet e personelit me vlerësimet periodike të punonjësve. Brenda muajit dhjetor 2012.

Rekomandimi nr. 19

Mbështetur në nenin 27 të ligjit nr. 7961, datë 12/7/1995 “Për Kodin e Punës” me ndryshime:

a) Të kërkohe në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit nga 60 persona, për 9 raste, me vlerë 64,330 lekë, përfituar padrejtësisht shpenzime për udhëtime e dieta, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit. Brenda muajit shkurt 2013.

b) Të kërkohe në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit nga 7 persona, me vlerë 63,000 lekë, përfituar padrejtësisht shpërblim nga ana e Këshillit Administrativ me urdhërin nr. 4, datë 27/12/2011, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit. Brenda muajit shkurt 2013.

c) Të kërkohe në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit për tejkalimin e fondit të prokuruar për 12,000 lekë, paguar në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 18/7/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Brenda muajit dhjetor 2012.

Rekomandimi nr. 20

a) Mbështetur në nenet 71, 74, 75 dhe 78 të ligjit nr. 7703, datë 11/5/1993, të ndryshuar, VKM nr. 161, datë 11/4/1994

Për zbatim: Drejtorja e Auditimit të Brendshëm dhe Drejtorja e Financës.

Për rekomandimin nr. 18

Do të përgatitet një informacion mbi rregullaritetin e plotësimit të dosjeve të personelit dhe vlerësimeve për gjendjen e zbatimit të istemit të pagave dhe vlerësimet.

Afati: Deri më 31/12/2012.

Për zbatim: Drejtorja e Administrimit të Përgjithshëm.

Për rekomandimin nr. 19

Për sa kërkohe në rekomandimin nr. 19 paraqesim:

a) Mbi bazën e urdhërit të Drejtores së Përgjithshme, Sektori i Buxhetit të Brendshëm të bëjë ndalesat nga paga për personat e cilësuar në akt kontroll.

Afati: Deri më 30/10/2012.

Për zbatim: Drejtore e Përgjithshme dhe Drejtorja e Financës.

b) Mbi bazën e urdhërit të Drejtores së Përgjithshme, Sektori i Buxhetit të Brendshëm të bëjë ndalesat nga paga për personat e cilësuar në akt kontroll.

Afati: Deri më 31/12/2012.

Për zbatim: Drejtore e Përgjithshme dhe Drejtorja e Financës.

c) Mbi bazën e urdhërit të Drejtores së Përgjithshme, Sektori i Buxhetit të Brendshëm të bëjë ndalesat nga paga për personat e cilësuar në akt kontroll.

Afati: Deri më 31/12/2012.

Për zbatim: Drejtore e Përgjithshme dhe Drejtorja e Financës.

Për rekomandimin nr. 20

a+b) Urdhër i Drejtores së Përgjithshme për shpërblim dëmi dhe pezullimin e përfitimeve për 35 persona sipas

“Për miratimin e Statutit të ISSH”, ndryshuar me VKM nr. 1022, datë 9/7/1998, në Kreun V, pika 2 e Rregullores “Për personelin e ISSH”, miratuar me vendimin e KA nr. 3/2, datë 26/2/2008 dhe shkresës nr. 768, datë 13/2/2009 “Për evadimin e raporteve përfundimtare të auditimit” të ISSH, për 35 raste, në vlerën 8,784,867 lekë, të nxirren urdhrat për shpërblim dëmi, të pezullohen përfitimet dhe të njoftohen personat mbi shkaqet e pezullimit, si dhe të kontabilizohen detyrimet e të bëhen ndalesat.

b) Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit për shumën 751,550 lekë përfituar padrejtësisht nga një person; po kështu në DRSSH Elbasan për shkelje të dispozitave ligjore në 11 dosje me vlerë 302,640 lekë, dhe DRSSH Lezhë 17 raste me shkelje me vlerë 886,981 lekë, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Rekomandimi nr. 21

Gjatë auditimit të fondeve të pensioneve u konstatuan shkelje të rënda të ligjit nr. 7703, datë 11/5/1993 të ndryshuar dhe dispozitave në zbatim të tij, ku evidentohen elementë të veprave penale, sa vijon:

Në DRSSH Tiranë, Durrës, Kukës e Lezhë janë përfituar padrejtësisht me anë të mashtrimit e përdorimit të dokumentacionit fiktiv, pensione në 6 raste, me vlerë të përgjithshme 6,843,696 lekë.

Për këtë, KLSH i ka rekomanduar ISSH-së të studiojë rast pas rasti dëmet e shkaktuara sipas përfituesve të parashtruar në Raportin e Auditimit dhe në përfundim të bëjë kallëzimin pranë organit të Prokurorisë.

II. Rekomandimet e përgatitura dhe të adresuara ISKSH-së nga KLSH në përfundim të auditimit të ushtruar në vitin 2011, për zbatimin e buxhetit të

drejtorive. Veç sa sipër, janë realizuar edhe kallëzimet për ndjekje ligjore nga organet e prokurorisë.

Afati: Menjëherë.

Për zbatim: Drejtoria e Auditimit të brendshëm, Drejtore e Përfitimeve dhe Drejtoria e Financës, si dhe DRSSH-të Tiranë, Durrës, Elbasan, Lezhë dhe Kukës .

Për rekomandimin nr. 21

Me shkresë të Drejtores së Përgjithshme për evadimin e këtij rekomandimi është realizuar saktësimi i dëmeve dhe është urdhëruar dërgimi i materialeve në organet e prokurorisë, nëpërmjet DRSSH-ve Tiranë, Durrës, Lezhë, Kukës, të 6 çështjeve me dëm efektiv për 6,843,696 leke.

Kjo detyrë është zbatuar.

II. Nga ISKSH, përgjigjet lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, janë dërguar me shkresën nr. 1049/7, datë 8/9/2011.

vitit 2010.

Nga KLSH përfundimet e auditimit të ushtruar në vitin 2011, janë dërguar me shkresën nr. 240/5, datë 19/8/2011.

*Nga KLSH, ISKSH-së i janë dërguar për ndjekje dhe zbatim 7 rekomandime, të cilat janë konfirmuar nga ISKSH të gjitha.*

Bazuar në autorizimin e Kryetarit të KLSH nr. 235,34 datë 26/10/2011, nga audituesit e KLSH është kryer verifikim për zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe është mbajtur akt-verifikimi përkatës më datë 12/12/2011.

Gjithashtu nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të kontrollit të mëparshëm të pasqyruar në Raportin Përfundimtar të auditimit të evaduar me shkresën nr. 448/5, datë 30/7/2012, rezulton se:

□ Niveli i zbatimit të rekomandimeve paraqitet:

- Janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime ose në masën 72% të totalit të tyre; 1 është në proces zbatimi dhe 1 rezulton i pazbatuar.

Rekomandimi nr. 1

Të ndiqen procedurat me MF për ndryshimin e udhëzimit nr. 1, datë 21/1/2010 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010", paragrafi 5, pika 106, Kapitulli 4.1 Buxheti i Sigurimeve Shoqërore, ku ISKSH ka llogaritë në bankat e nivelit të dytë për arkëtimet e të ardhurave dhe për kontributet e sigurimeve shëndetësore, prandaj në bashkëpunim dhe me DPT-në, të hapen llogari bankare në emër të ISKSH-së, ku të transferohen direkt shumat e arkëtuara për llogari të ISKSH-së, pra të ardhurat e realizuara nga DPT, ndërsa të ardhurat nga të vetëpunësuarit në bujqësi të vazhdojnë marëdhëniet me ISSH-në.

Deri më 31/12/2011

Rekomandimi nr. 2

Lidhur me zbatimin nga ISKSH të detyrimit ligjor për kthimin e përgjigjes mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për përmirësimin e gjendjes, brenda afatit 20 ditor të parashikuar në nenin 16, të Ligjit Organik të KLSH-së, nga auditimi i kryer, KLSH ka konstatuar se ISSH me shkresën nr. 1049/7, datë 8/9/2011 ka njoftuar KLSH-në për shqyrtimin e rekomandimeve dhe bashkëlidhur kësaj shkrese ka dërguar urdhërin e Drejtores së ISKSH nr. 14, datë 8/9/2011, ku përcaktohen masat që duhen marrë, strukturat e personat përgjegjës për ndjekjen e tyre, sipas afateve kohore të përcaktuara për realizimin e tyre.

Këtu përfshihen dhe rezultatet e auditimit të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të evaduar me shkresën nr. 448/5, datë 30/7/2012.

Për rekomandimin nr. 1

Nga ISKSH me shkresën nr. 2019, datë 17/10/2011, i është kërkuar Ministrisë së Financave bërja e ndryshimeve të propozuara nga KLSH, në udhëzimin për zbatimin e buxhetit, me qëllim hapjen e një llogarie bankare në BSH-së në emër të ISKSH-së, ku të transferohen direkt nga DRT-të shumat e arkëtuara nga kontributet e sigurimeve shëndetësore për llogari të ISKSH.

Sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërcituar, nga verifikimi ky rekomandim rezulton i realizuar.

Për rekomandimin nr. 2

Të studiohen dhe të bëhen rregullimet përkatëse në statutin e ISKSH, në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10383, datë 24/2/2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në RSH”, sepse me statutin aktual ka dublime të kompetencave ndërmjet organeve drejtuese.

Rekomandimi nr. 3

Të rivlerësohen, analizohen dhe rivendosen në afat, nga ana e institucionit detyrat në proces për Spitalin Rajonal Durrës, duke programuar masa afatshkurtra për realizimin e tyre, në veçanti në lidhje me ndjekjen e procedurave ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën 671,580 lekë dhe 88,200 lekë.

Deri në përfundimin e gjykimit.

Rekomandimi nr. 4

Të analizohen me përgjegjësi nga KA ndryshimet në buxhet kryesisht të ardhurat nga kontributet, kur kontributet ulen dhe transfertat e buxhetit të shtetit janë në nivele më të lartë dhe konkretisht:

- Mosrealizimi të ardhurave nga kontribuesit

urbanë ka sjell për pasojë rritjen e pjesëmarrjes së buxhetit të shtetit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore.

- Aktualisht deficiti i krijuar në mënyrë periodike është mbuluar me subvencionet e buxhetit, kur duhet të propozohen masa konkrete për rritjen e numrit të kontribuesve urban dhe pagës me të cilën llogarisin ato, në bashkëpunim me DPT, ISSH dhe Inspektoriatin Shtetëror të Punës

Rekomandimi nr. 5

Të shtohen kontrolllet e befasishme, si më efektive në konstatimin e shkeljeve dhe mangësive, me synim kryesisht

Nga ISKSH është përgatitur draft-statuti i ri për institucionin, i cili do t’u dërgohet për mendim ministrive përkatëse dhe do të paraqitet nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë për miratim në KM-ve. Në draft-statut janë përcaktuar kompetencat e organeve drejtuese dhe nuk janë mënjeluar dublimet e kompetencave.

Ky rekomandim vlerësohet në proces zbatimi.

Për rekomandimin nr. 3

Në lidhje ndjekjen e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 671,580 lekë deri në përfundim të gjykimit, rezulton e realizuar, pasi Gjykata e Apelit Durrës është shprehur me vendim.

Për shpërblimin e dëmit ekonomik prej 88,200 lekë rezulton i arkëtuar me urdhër xhirimi nr. 0311841, datë 9/9/2011.

Për rekomandimin nr. 4

Nga ISKSH (Drejtoria Ekonomike) është përgatitur materiali përkatës, ku analizohet situata aktuale dhe ecuria e të ardhurave nga kontributet dhe është analizuar në mbledhjen e Këshillit Administrativ të datës 27.12.2011.

Pra ky rekomandim është realizuar.

Për rekomandimin nr. 5

Për periudhën shtator-dhjetor 2011 janë kryer 14 kontrole lidhur me monitorimin e ecurisë së programit on-

monitorimin e ecurisë së programit on-line dhe zbatimin e tij nga të gjitha subjektet farmaceutike që kanë kontratë me ISKSH-në.

Rekomandimi nr. 6

Të bashkëpunohet me MF për buxhetin e shërbimit spitalor, që është buxhet vetëm në letër për llogari të ISKSH, i cili zë rreth 50% të totalit të buxhetit të këtij institucioni në vlerën e planifikuar 12.4 miliardë lekë dhe shpenzuar në fakt 12.2 miliardë lekë, me qëllim financimin e spitaleve nga llogaritë e ISKSH, duke qenë njëkohësisht dhe pjesë e raportimit të fondeve të akorduara.

Deri më 31/12/2011.

Rekomandimi nr. 7

Të analizohen në mënyrë periodike shpenzimet e rimbursimit, si dhe të studiohet pritshmëria e tyre për periudhat pasardhëse në total dhe për çdo Drejtori Rajonale, mbështetur në nivelin e sëmundjeve, shtrirjen dhe zgjerimin e skemës së sigurimeve, me qëllim mbulimin e nevojave me fondet e domosdoshme

II.1 Rekomandimet e përgatitura dhe të adresuara ISKSH-së nga KLSH në përfundim të auditimit të ushtruar në vitin 2012 në ISKSH, për zbatimin e buxhetit të vitit 2011.

Nga KLSH janë dërguar përfundimet e auditimit të ushtruar në vitin 2012 me shkresën nr. 448/5, datë 30/7/2012.

Nga KLSH, ISSH-së i janë dërguar për ndjekje dhe zbatim 12 rekomandime, të cilat janë konfirmuar të gjitha nga ISSH.

line të instaluar në rrjetin farmaceutik. Lidhur me kontrollet tematike është shtuar numri i tyre në 86 subjekte farmaceutike, ose rreth 30% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, përkatësisht në Tiranë, Korçë, Vlorë dhe Dibër.

Ky rekomandim rezultoi i realizuar.

Për rekomandimin nr. 6

Për vitin 2012, në zbatim të ligjit nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, neni 5, buxheti për shërbimin spitalor jepet me hollësi dhe përdoret me VKM. Për vitin 2012, numri i punonjësve dhe buxheti për çdo spital, i detajuar në paga, sigurime shoqërore e shëndetësore dhe mallra e shërbime, është miratuar me VKM nr. 15 datë 11/1/2012. Financimi i spitaleve vazhdon të bëhet nga degët e thesarit, në emër të ISKSH, pra raportimi i realizimit të këtij buxheti nuk është pjesë e evidencave të raportimit që ISKSH bën në MF.

Ky rekomandim nuk është zbatuar.

Për rekomandimin nr. 7

Për periudhat pasardhëse, rezultoi se ISKSH ka kryer analiza çdo muaj mbi ecurinë e shpenzimeve të rimbursimit në takimet mujore që organizon me drejtuesit e njesive vartëse ku përcaktohen edhe detyrat e masat për të ardhmen.

Pra ky rekomandim është realizuar.

II.1 Përgjigjet e ISKSH lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

Drejtoresha e ISKSH me shkresën nr. 774/17, datë 20/8/2012 ka informuar KLSH për zbatimin e rekomandimeve të dërguar prej tij, dhe bashkëlidhur urdhërin nr. 31, datë 20/8/2012, në të cilin përcaktohen drejtoritë përkatëse dhe afatet për zbatimin e rekomandimeve. Referuar këtij urdhëri paraqesim pa koment përgjigjet e

Rekomandimi nr. 1

Në zbatim të ligjit nr.10296, datë 8/7/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, hyrë në fuqi më 1/1/2011, ISKSH duhet:

a) Të marrë masa që të krijojë dhe verë në funksionim Grupin e Menaxhimit Strategjik, për të përmbushur të gjitha detyrimet që i ngarkohen në zbatim të këtij ligji.

b) Të përfundojë punën për “Hartimin e strategjisë së menaxhimit të riskut në ISKSH”, me qëllim vlerësimin dhe identifikimin e risqeve, si përparësi në lidhje me objektivat e përcaktuara në buxhetimin afatmesëm dhe mbrojtjen e institucionit nga risqet që mund të krijohen dhe që pengojnë realizimin e objektiveve të ISKSH.

Brenda muajit shtator 2012.

Rekomandimi nr. 2

ISKSH, të marrë masat që në bashkëpunim me spitalet dhe me Ministrinë e Shëndetësisë, të përmbushë detyrimin e saj për monitorimin e llogaritjeve dhe përcaktimin e kostove faktike të çdo shërbimi në spitale, duke rritur ekonomikitetin, efektivitetin dhe eficientësinë e fondeve të dhëna për spitalet, brenda vitit ushtrimor dhe përafrimin e treguesve buxhetor për plotësimin e standardeve të shërbimit spitalor.

Vazhdimisht në vitet 2012-2013

Rekomandimi nr. 3

Nga auditimi i aktiviteteve për pritje përcjellje të organizuara për vitin 2011, u konstatua se ato janë kryer pa miratimin e titullarit të institucionit dhe jo siç e kërkon VKM nr. 243, datë 15/6/1995 “Për pritje e përcjellje”, i ndryshuar, ndaj të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për organizimin e tyre, gjithashtu miratimi i numrit të pjesëmarrësve të bëhet nga titullari i institucionit, kjo të bëhet për çdo organizim. Vazhdimisht

Rekomandimi nr. 4

cilësuar për secilin rekomandim:

Për rekomandimin nr. 1

Të krijohet dhe vihet në funksionim Grupi i Menaxhimit Strategjik. Grupi të hartojë strategjinë e menaxhimit të riskut për ISKSH.

Afati: Brenda muajit shtator 2012.

Për zbatim: Zv/Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike.

Për rekomandimin nr. 2

Për përmbushjen e kërkesave të vendimit të KM nr. 140, datë 17/2/2010 i ndryshuar, për monitorimin e kostove faktike të shërbimit spitalor, në bashkëpunim me spitalet dhe Ministrinë e Shëndetësisë, të merren masa për përcaktimin e kostove fiktive të çdo shërbimi në spitale me qëllim përafrimin e fondeve të dhëna për spitalet me treguesit e buxhetit.

Afati: Gjatë viteve 2012-2013.

Për zbatim: Drejtoria Spitalore.

Për rekomandimin nr. 3

Për zbatimin me korrektesë të vendimit të KM nr. 243, datë 15/6/1995 i ndryshuar, të merren masa për planifikimin dhe realizimin e kuotave, duke i miratuar te titullari rastet, numrin e pjesëmarrësve, si dhe vlerën për çdo rast.

Afati: Vazhdimisht.

Për zbatim: Drejtoria e Marrëdhënive me Jashtë dhe Shërbimeve.

Për rekomandimin nr. 4



Në vlerësimin e përmbajtjes së kontratave F/2011, D/2011 dhe A/2011, është konstatuar se në disa nene të tyre kryesisht për të drejtat dhe detyrimet ekonomike të kontraktorëve, rezultojnë se ato janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, kryesisht atë tatimor dhe ligjin "Për kontabilitetin". Nga ISKSH të ngrihet grup pune në bashkëpunim me grupet e interesit (farmacistë e grosistë), ku në përbërje të ketë dhe specialistë finance dhe juristë dhe të rishikohet kontrata tip, kryesisht në drejtim të trajtimit ekonomiko financiar dhe përgjegjësisë ligjore për moszbatim të saj (vendosje penaliteti dhe masa të tjera), konformë legjislacionit në fuqi.

Brenda muajit shtator 2012

Rekomandimi nr. 5

Nga auditimi i kryer u konstatua se nuk ka gjetur zbatim të plotë vendimi i KM nr.140 datë 17.02.2010, në zbatimin e standardeve të përcaktuara për shërbimin spitalor, pasi nga Ministria e Shëndetësisë nuk janë nxjerrë akoma Standardet e përcaktuara dhe nuk janë rivlerësuar.

Për këtë, ISKSH, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë (Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Drejtorinë Spitalore), të përgatisin Standardet e përcaktuara së bashku me kostot faktike, të cilat do të shërbejnë si bazë për hartimin e kostove të paketave të shërbimeve, të cilat më pas do të miratohen nga Këshilli i Ministrave, për të hyrë në fuqi në muajin mars 2013. Brenda muajit nëntor 2012.

Rekomandimi nr. 6

Nga auditimi i ushtruar u konstatuan raste të kontrole të përsëritura në veprimtarinë audituese të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me Drejtorinë e Kontrollit Parësor e Farmaceutik në DRSKSH të ndryshme, duke kryer auditim për të njëjtin problem dy herë dhe në disa raste janë dhënë

Për përmirësimin e kontratave me subjektet farmaceutike, kryesisht parashikimin në to më mirë të të drejtave dhe detyrimeve të kontraktorëve, si dhe afateve për ruajtjen e dokumentacionit, të ngrihet një grup pune në bashkëpunim me grupet e interesit dhe me specialistë të tjerë, për të rishikuar kontratat tip me këto subjekte.

Afati: Brenda muajit shtator 2012.

Për zbatim: Drejtoria e Çmimeve dhe Rimbursimeve dhe Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmacive.

Për rekomandimin nr. 5

Në zbatim të vendimit të KM nr. 140 datë 17.02.2010 i ndryshuar, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, të përgatiten Standardet e përcaktuara së bashku me kostot faktike, me qëllim që të shërbejnë si bazë për hartimin e kostove të paketave të shërbimeve

Afati: Brenda muajit nëntor 2012.

Për zbatim: Drejtoria Spitalore.

Për rekomandimin nr. 6

Për shmangien e dublimeve në kontrole, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe Drejtorinë e Kontrollit Parësor e Farmaceutik, të identifikojnë rastet dhe të programojnë punën për shmangien e dublimeve.

Afati: Menjëherë.

Për zbatim: Drejtoria e Auditimit të

konkluzione të ndryshme. Për këtë, të bashkërendohet puna nga ISKSH me DAB dhe DKPF, për të shmangur kryerjen e kontrolleve në të njëjtin objekt dhe harxhuar burime njerëzore të panevojshme. Menjëherë.

Rekomandimi nr. 7

Duke patur parasysh administrimin dhe qarkullimin e vlerave të konsiderueshme financiare, si dhe specifikat e financimit të vlerave të rimbursueshme, ISKSH, të ngrejë një bërthamë me specialistë për të gjetur mënyrat dhe përsosur metodat e auditimit financiar, kontrollit farmaceutik dhe atij spitalor, duke hartuar e nxjerrë udhëzime sa më profesionale, madje të punohet për një manual kontrolli farmaceutik e spitalor. Kjo realizohet duke bashkëpunuar dhe asistuar nga institucione të specializuara të Auditimit dhe Kontrollit Financiar, brenda dhe jashtë vendit. Brenda muajit tetor 2012

Rekomandimi nr. 8

Në hartimin e programeve të auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, të studiohen dhe vlerësohen subjektet me rrisht të lartë, ndërsa për subjektet që nuk qarkullojnë vlera të mëdha financiare, të programohen dhe kryhen auditime tematike për objekte të veçanta dhe rezultatet të përgjithësohen, pasi kjo do të rrisë efikasitetin dhe performancën e DAB, si dhe do të shmang harxhimin e burimeve njerëzore të saj pa efektifitet. Vazhdimisht.

Rekomandimi nr. 9

Të merren masa dhe të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për të shmangur pagesat e listës së recetave të rimbursuara, ku shkruhet emërtimi "i panjohur" nga sistemi dhe të ndalohen pagesat e rimbursimeve pa u identifikuar personat konkretë. Kjo të jetë objekt vlerësimi e kontrolli, si nga strukturat e DRSKSH-ve në rrethe dhe nga strukturat e kontrollit dhe auditimit në ISKSH. Për këtë, të nxirret një

Brendshëm dhe Drejtoria e Kontrollit Parësor e Farmaceutik.

Për rekomandimin nr. 7

Për përsosjen e kontrolleve të organizohet puna për ngritjen e një grupi pune me specialistë, për të parë, analizuar dhe përmirësuar udhëzimet lidhur me kontrollet farmaceutike dhe spitalore. Kjo të realizohet në bashkëpunim me institucione të specializuara të kontrollit financiar.

Afati: Brenda muajit tetor 2012.

Për zbatim: Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Spitalore, Drejtoria e Kontrollit Parësor e Farmaceutik dhe Drejtoria e Kontrollit Spitalor.

Për rekomandimin nr. 8

Të studjohen dhe vlerësohen subjektet me risk të lartë, duke u dhënë përparësi në programet e auditimit. Për subjektet me risk më të ulët dhe që qarkullojnë vlera më të vogla financiare të programohen auditime tematike. Kjo për të rritur efikasitetin dhe performancën e DAB.

Afati: Vazhdimisht.

Për zbatim: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Për rekomandimin nr. 9

Të organizohet puna për shmangien e rimbursimeve për personat në listë me emërtim "I panjohur". Rastet në fjalë të identifikohendhe të jenë objekt kontrolli dhe verifikimi para rimbursimeve.

Afati: Vazhdimisht.

Për zbatim: Drejtoria e Çmimeve dhe Rimbursimeve dhe Drejtoria e Informatikës dhe Analizës Statistikore

urdhër nga titullari i institucionit për moskryerjen e pagesës, pa u bërë identifikimi i tyre. Vazhdimisht

Rekomandimi nr. 10

Nga ISKSH si institucion qendror, të merren masa për të vlerësuar mundësitë që ka në bashkëpunim me DRSKSH Tiranë dhe në QSUT, për të shmangur organizimin e prokurimit publik veçmas për blerje karburanti, por të zhvillohet në mënyrë të përqendruar në njërin institucion për (ISKSH, DRSKSH Tiranë dhe DRSKSH pranë QSUT) dhe në Drejtoritë e tjera Rajonale për organizimin në rang Qarku (Dibër, Korçë, Vlorë, Gjirokastër, Elbasan etj.). Vazhdimisht

Rekomandimi nr. 11

Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për shpërblimin e demit:

- a) Nga një Sh.p.k në vlerën 369,952 lekë, vlerë kjo llogaritur më pak për penalitetet e përcaktuara për vonesat në furnizimin e mallit (libreza shëndeti), kjo në zbatim të nenit 10 të kontratës nr. 5, datë 18/7/2011 ndërmjet ISKSH (blerësi) dhe kësaj Shoqërie. Brenda muajit tetor 2012
- b) Nga një Sh.p.k. në vlerën 4,760 lekë, për sa llogaritur e paguar më tepër për shërbim roje. Brenda muajit shtator 2012
- c) Nga një subjekt privat në vlerën 594,960 lekë, për sekuestrim kontrate, si pasojë e moszbatimit të kushteve të kontratës (pasi sigurimi i kontratës ka qenë i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të saj). Brenda muajit shtator 2012
- d) Nga 17 punonjës që kanë përfituar padrejtësisht pagesa për udhëtim e dieta brenda vendit dhe jashtë vendit 2 punonjëse, me dokumente të parregullta në vlerën 105,040 lekë. Brenda muajit tetor 2012.

Për rekomandimin nr. 10

Të merren masa për të vlerësuar mundësitë që ka në bashkëpunim në mes ISKSH dhe DRSKSH Tiranë dhe DRSKSH në QSUT, dhe të shmangët organizimi i prokurimit publik për blerje karburanti veçmas, por në mënyrë të përqendruar në njërin prej subjekteve (ISKSH, DRSKSH Tiranë ose DRSKSH pranë QSUT). E njëjta mundësi të vlerësohet për organizimin e prokurimit në rang Qarku (Dibër, Korçë, Vlorë, Gjirokastër, Elbasan etj.).

Afati: Vazhdimisht.

Për zbatim: Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Shërbimeve.

Për rekomandimin nr. 11

a) Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për shpërblimin e demit nga subjekti përfitues në vlerën 369,952 lekë, si penalitete të llogaritura më pak. Afati: Brenda muajit tetor 2012.

Për zbatim: Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

b) Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për shpërblimin e demit nga subjekti përfitues në vlerën 4,760 lekë, paguar më tepër për shërbim roje.

Afati: Brenda muajit shtator 2012.

Për zbatim: DRSKSH Tiranë.

c) Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për shpërblimin e demit nga subjekti përfitues në vlerën 594,960 lekë, për sekuestrim kontrate, si pasojë e moszbatimit të kushteve të kontratës prej tij.

Afati: Brenda muajit shtator 2012.

Për zbatim: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Shërbimeve.

d) Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për shpërblimin e

dëmit nga 17 punonjës që kanë përfituar padrejtësisht pagesa për udhëtim e dieta brenda vendit në vlerën 105,040 lekë dhe jashtë vendit 140 Euro.

Afati: Brenda muajit tetor 2012.

Për zbatim: Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Rekomandimi nr. 12

ISKSH, nëpërmjet Drejtorisë së Kontrollit Farmaceutik dhe Parësor, të marrë masa në bashkëpunim me DRSKSH Tiranë dhe të ushtrojë kontroll në farmacitë e konstatuara me shkelje ligjore nga ana e audituesve të KLSH, duke vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi për 27 kontrata me vlerë rimbursimi të kryer në shumën 44,545,657 lekë. Të vlerësohen shkeljet sipas legjislacionit dhe arkëtohen në mënyrë ligjore gjobat e llogaritura në vlerë 270,000 lekë, pasi këto farmaci kanë kryer aktivitet tregtimi ilaçesh rimbursimi pa dokumentacion të rregullt ligjor në marrëdhënie me DRSKSH Tiranë dhe pa u plotësuar kriteret e vendosura në kontratë dhe Udhëzimin përkatës të Këshillit Administrativ. Brenda muajit Tetor 2012

Për rekomandimin nr. 12

Të ushtrohet kontroll në 27 subjekte farmaceutike, të cilat kanë kryer aktivitet tregtimi ilaçesh të rimbursueshme pa dokumentacion të rregullt, për të vlerësuar dhe arkëtuar gjobat në vlerën 270,000 lekë.

Afati: Brenda muajit tetor 2012.

Për zbatim: Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik dhe DRSKSH Tiranë..

---

*Në mbyllje të pjesës së parë "Raport për zbatimin e Buxhetit të vitit 2011", paraqesim të dhënat përmbledhëse të efekteve negative në vlerë në të ardhurat e buxhetit, shkeljet me pasojë dëm ekonomik dhe disa nga detyrimet debitore në fund të vitit 2011, dhe konkretisht:*

- a. Në fushën e të ardhurave 813.6 milionë lekë.*
- b. Në fushën e shpenzimeve 174.2 milionë lekë.*
- c. Detyrime debitore 67,645 milionë lekë.*

*Vlerat e mësipërme sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar paraqiten në aneksin nr. 4 bashklidhur këtij raporti.*

## PJESA E DYTË

### **“MENDIME PËR RAPORTIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR SHPENZIMET E VITIT TË KALUAR FINANCIAR, PARA SE TË MIRATOHET NË KUVEND”**

Në përmbushje të detyrimit kushtetues paraqesim “Mendime për raportin e Këshillit të Ministrave, për shpenzimet e vitit të kaluar financiar 2011”.

Referuar të dhënave të raportuara të realizimit të treguesve të vitit 2011 në nivel makroekonomik dhe nga analizimi i tyre, konkludohet se ekonomia shqiptare ndonëse me ritme më të ngadalta mundi t’i përballojë efekteve të krizës ekonomike që ka përfshirë vendet e Eurozonës, madje arriti të sigurojë një rritje pozitive të zhvillimit ekonomik të vëndit dhe të ruaj ekuilibrat kryesorë makroekonomikë, nëpërmjet respektimit të kufirit të borxhit publik nën 60% të PBB-së dhe ruajtjes të niveleve të ulta për deficitin buxhetor vjetor.


Pasqyrojmë se normat e rritjes ekonomike të vitit 2011, rezultojnë për afërsisht në nivelin e realizimit të një viti më parë. Për sigurimin e një niveli të tillë, krahas masave për zhvillimin dhe transformimin ekonomik, si dhe politikat makroekonomike të ndjekura, duhen vlerësuar përpjekjet dhe politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë për kontrollin e inflacionit dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Niveli i treguesve fiskalë të realizuar gjatë vitit 2011, u bë i mundur me miratimin e rishikimit të buxhetit gjatë këtij viti, duke kombinuar ruajtjen e ritmit të realizimit të të ardhurave buxhetore të programuara me pakësimin e shpenzimeve. Në shifra konkrete, sipas të dhënave të siguruara gjatë kontrolleve të ushtruar në MF dhe BSH-së, treguesit kryesorë makroekonomikë dhe ata fiskalë të buxhetit të shtetit të vitit 2011, paraqiten:

- Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) si një nga treguesit kryesorë (me çmimet korrente) ka arritur në kuotën e 1,314,700 milionë lekë.

Politika monetare e ndjekur nga BSH ka bërë të mundur përmbushjen e objektivit kryesor të saj, mbajtjen nën kontroll të inflacionit, brenda kufirit për një inflacion vjetor 2-4%. Në vitin 2011, niveli mesatar vjetor i inflacionit ka rezultuar 3.5%, pothuajse i përafërt me atë të një viti më parë, duke ndihmuar favorshëm mjedisin ekonomik të vëndit tonë.

Në mënyrë grafike, rritja reale e PBB-së në vitin 2011 dhe dinamika e saj për disa vite në terma nominal, duke filluar nga viti 2007, paraqitet:



*Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit* janë realizuar në vlerën 330,475 milionë lekë dhe përfaqësojnë 25.14 të PBB-së të vitit 2011, nga 26.22% të PBB-së që rezultoi në vitin 2010. Në krahasim me të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës, ato rezultojnë me rritje në shumën 5,754 milionë lekë.

- *Shpenzimet e përgjithshme buxhetore* janë realizuar në vlerën 376,652 milionë lekë dhe përfaqësojnë 28.63% të PBB-së të vitit 2011. Në krahasim me shpenzimet e realizuara në vitin 2010, ato paraqiten me rritje në shumën 13,600 milionë lekë. Ndërkohë që, *shpenzimet për investime kapitale* janë realizuar në vlerën 70,679 milionë lekë duke zënë 5.38% të PBB-së të vitit 2011, nga 67,492 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2010 ose në nivelin 5.45% të PBB-së të rezultuar në vitin 2010.

- *Deficiti i përgjithshëm i buxhetit* në fund të vitit 2011 rezultoi në vlerën 45,877 milionë lekë nga 46,812 milionë lekë të programuara ose në masën 98%, kundrejt përcaktimit vjetor. Kundrejt PBB-së të vitit 2011, niveli i deficitit këtë vit arriti në 3.49%, nga 3.07% të rezultuar në vitin 2010, me një rritje prej 0.42 pikë përqindje.

- *Borxhi publik në total*, në fund të vitit 2011 rezultoi në vlerën 772,581.5 milionë lekë ose në masën 58.76% kundrejt PBB-së të këtij viti, nga 715,518.5 milionë lekë që rezultoi në vitin 2010 dhe që përfaqësonte 57.79% të PBB-së të vitit 2010.

Nga ky borxh, *borxhi publik i qeverisjes qendrore* rezultoi 772,364 milionë lekë dhe *borxhi i qeverisjes vendore* 217.8 milionë lekë.

- *Stoku i borxhit të brendshëm* në fund të vitit 2011 rezultoi me rritje kundrejt vitit 2011 në shumën 31,210 milionë lekë, nga 407,372 milionë lekë në vitin 2010 në 438,582 milionë lekë në vitin 2011, ose në masën 7.66% më shumë. Në raport me PBB-në e vitit 2011, ai rezultoi në masën 33.36%, nga 32.90% të PBB-së që zinte një vit më parë, me një rritje prej 0.46%.

Ndërsa, *stoku i borxhit të jashtëm shtetëror* në fund të vitit 2011 arriti në 333,782 milionë lekë ose në masën 25.39% të PBB-së të këtij viti, kundrejt 307,999 milionë lekë rezultuar në fund të vitit 2010, ose në masën 24.88% të PBB-së të vitit 2010, me një rritje në vitin 2011 kundrejt vitit 2010 në shumën 25,783 milionë lekë ose në masën 8.38% më tepër.

- *Borxhi i qeverisjes vendore* në fund të vitit 2011 rezultoi 217.8 milionë lekë ose 0.016% të PBB-së, nga 147.5 milionë lekë ose 0.012% të PBB-së që rezultoi në vitin 2010.

## I. MENDIME PËR SHPENZIMET BUXHETORE

Për vitin 2011, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit janë realizuar në masën 96.3%, me një mosshpenzim në vlerë prej 14,507 milionë lekë ndaj planifikimit, kurse kundrejt realizimit të një viti më parë, paraqiten me rritje në masën rreth 3.75% dhe në vlerë 13,600 milionë lekë më shumë. Më konkretisht, nga 362,752 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2010, gjatë vitit analizues 2011 janë shpenzuar 376,352 milionë lekë.

Në vitin 2011, në strukturë, *shpenzimet korrente dhe kapitale*, janë realizuar në masën 97.1% dhe 93.2% dhe ato zenë përkatësisht: 81.2% dhe 18.8% të totalit të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit të shtetit të këtij viti.

Konstatohet se, *shpenzimet korrente janë realizuar në një përqindje më të madhe se sa niveli i realizimit të shpenzimeve kapitale*. Këto shpenzime, krahasuar me nivelin e realizimit të një viti më parë, rezultojnë me rritje, dhe konkretisht:

- Shpenzimet korrente janë rritur në masën 1.6% ose në shumën 4,795 milionë lekë më tepër, po kështu dhe shpenzimet kapitale me rritje në masën 4.7% dhe në vlerë 3,187 milionë lekë më shumë. Pra, rezulton se, *fondet e shpenzuara në zërin "Shpenzime korrente" në vitin 2011 krahasuar me një vit më parë, paraqiten me ritëm rritjeje më të ulët se sa fondet e përdorura për shpenzimet kapitale në vitin 2011 kundrejt vitit 2010.*

Vlen të pasqyrohet fakti që, *në vitin 2011, përqindja që zënë shpenzimet korrente kundrejt totalit të shpenzimeve të përgjithshme ka rezultuar më e ulët krahasuar me përqindjen e rezultuar nga ky raport në vitin 2010, më konkretisht nga 82.9% që zinin në vitin 2010, në vitin 2011 kjo përqindje ka rezultuar në nivelin 81.2%.*

Analizuar sipas zërave të shpenzimeve korrente rezulton se:

**1. Shpenzimet për personelin** zënë rreth 22.06% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011 dhe përbëhen nga pagat, kontributi për sigurime shoqërore dhe fondi i rritjes së pagave. Shpenzimet personelin, janë realizuar në masën rreth 98.4%, me një mosshpenzim në vlerë prej 1,126 milionë lekë, kurse sipas nënzërave përbërës rezulton se pagat janë realizuar në masën 98.8% me një mosshpenzim në vlerë prej 687 milionë lekë; shpenzimet për kontributin e sigurimeve shoqërore në masën 97.7% dhe në vlerë 210 milionë lekë mosshpenzim dhe fondi i rritjes së pagave përkatësisht 229 milionë lekë rezultojnë të papërdorura.

Kundrejt PBB-së të vitit 2011, shpenzimet e personelit zënë 5.13%, nga 5.31% të PBB-së të rezultuar në vitin 2010.

Sipas nënzërave të shpenzimeve të personelit, rreth *87% e zenë shpenzimet për pagat*, të cilat në vitin 2011 janë realizuar në masën 98.8%, nga 59,085 milionë lekë të planifikuara, janë shpenzuar 58,398 milionë lekë, me një mosshpenzim kundrejt kuotave të planit *prej 687 milionë lekë.*

Shpenzimet për paga të realizuara në vitin 2011, kundrejt atyre të realizuara një vit më parë, rezultojnë me rritje *në masën 2.54%*, nga 56,951 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2010, në 58,398 milionë lekë në vitin 2011, me një *rritje në vlerë prej 1,447 milionë lekë.*

**2. Shpenzimet operative mirëmbajtje**, zenë rreth 10.4% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 11.4% që përfaqësonin në vitin 2010. Kundrejt kuotës së planifikuar për këtë vit, ato janë realizuar në masën 108.4%, me një tejkallim në vlerë prej 2,543 milionë lekë. Në vitin 2011, këto shpenzime zenë 2,51% të PBB-së të këtij viti nga 2.77% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Pra, ndonëse, në vitin analizues 2011, shpenzimet operative të mirëmbajtjes *rezultojnë me tejkallim të ndjeshëm me 8.4% pikë më tepër se sa niveli i planifikuar*, në krahasim me ato të realizuara në vitin 2010, ato *rezultojnë me ulje në masën 3.85% dhe në vlerë 1,323 milionë lekë më pak.*

**3. Shpenzimet për interesat** zënë rreth 13.45% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 13.82% që zinin një vit më parë. Kundrejt kuotës së planifikuar, ato janë realizuar në masën 87.8%, me një mosrealizim në vlerë prej 5,717 milionë lekë. Në vitin 2011, këto shpenzime zënë 3.13% të PBB-së të këtij viti nga 3.36% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Shpenzimet për interesat të realizuara në vitin 2011, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, paraqiten me ulje në masën rreth 1.17% ose në shumën 483 milionë lekë më pak. Në strukturë, shpenzimet për interesa të brendshme janë realizuar në masën 88.5%, me një mosrealizim në shumën 4,447 milionë lekë;

ndërsa shpenzimet për interesa të huaja janë realizuar 84.4% me një mosrealizim në vlerë prej 1,270 milionë lekë. Kundrejt vitit 2010, shpenzimet për interesa të brendshme rezultojnë me rritje në masën rreth 3.8% dhe në vlerë 1,330 milionë lekë më pak; kurse, shpenzimet për interesa të huaja rezultojnë me rritje në masën 14% dhe në vlerë 847 milionë lekë më tepër.

**4. Shpenzimet për subvencione**, zënë rreth 1.07% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 1.2% që zinin një vit më parë. Kundrejt kuotës së planifikuar, ato janë realizuar në masën 100.3%, me një tejkalim në vlerë prej 9 milionë lekë. Shpenzimet për subvencione të realizuara në vitin 2011, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, rezultojnë me ulje në masën rreth 6.6% ose në shumën 234 milionë lekë më tepër.

Referuar raporteve të konsoliduara rezulton se fondet e subvencioneve kanë ndryshuar nga buxheti fillestar në sasi të konsiderueshme nga 1,830.6 milionë lekë lekë në fillim viti në 3,372 milionë lekë, pra me një rritje prej 1,541 milionë lekë ose 84%. Kjo rritje konstatohet kryesisht në Ministrinë e Financave ku nuk ka pasur të pasqyruar subvencion në planin e fillimit të vitit. Nga auditim rezultoi se, me vendime të KM, MF i është çelur fond subvencion (artikull 603) për “Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetra tek njësitë e qeverisjes vendore” në shumën 1,524,395,812 lekë (sipas situacionit të shpenzimeve) të konfirmuar nga thesari.

**5. Shpenzimet për fonde speciale (sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe fondi i kompensimit në vlerë të pronarëve)**, zënë rreth 37.28% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 35.30% që zinin në vitin 2010. Kundrejt kuotës së planifikuar, ato janë realizuar në masën 97.5%, me një mosrealizim në vlerë prej 2,995 milionë lekë. Në vitin 2011, këto shpenzime zënë 8.67% të PBB-së të këtij viti nga 8.58% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Në strukturë, shpenzimet për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe fondi i kompensimit janë realizuar respektivisht 97.6%, 97.1% dhe 97.4%, me një mosshpenzim në vlerë respektivisht në sigurimet shoqërore 2,117 milionë lekë, sigurimet shëndetësore 793 milionë lekë dhe kompensimin në vlerë të pronarëve 45 milionë lekë.

Shpenzimet për sigurimet shoqërore, shëndetësore të realizuara në vitin 2011, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, rezultojnë me rritje në masën rreth 7.56% ose në shumën 6,001 milionë lekë më tepër dhe 7.29% ose në shumën 1,833 milionë lekë më shumë; ndërsa shpenzimet për kompensimin e pronarëve rezultojnë me ulje në masën 5.4% ose në shumën 95 milionë lekë më pak.

**6. Shpenzimet për buxhetin vendor** zënë rreth 9.2% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 10.2% që zinin në vitin 2010, pra me një ulje prej 1%. Kundrejt planifikimit ato janë realizuar në masën 95.9%, me një mosrealizim në vlerë prej 1,195 milionë lekë. Në vitin 2011, këto shpenzime zënë 2.14% të PBB-së të këtij viti, nga 2.48% të PBB-së që zinin në vitin 2010, pra konstatohet një ulje prej 0.34%. Shpenzimet për buxhetin vendor të realizuara në vitin 2011, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, rezultojnë me ulje në masën rreth 8.6% dhe në vlerë 2,645 milionë lekë më pak.

**7. Shpenzime të tjera sociale (pagesa e papunësisë, ndihma ekonomike dhe fondi i kompensimit për ish të përndjekurit politikë)** zënë rreth 6.13% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011. Kundrejt kuotës së planifikuar, ato janë realizuar në masën 96.4%, me një mosrealizim në vlerë prej 700 milionë



lekë. Në vitin 2011, këto shpenzime zënë 1.43% të PBB-së të këtij viti, nga 1.51% të PBB-së që zinin në vitin 2010.

Në strukturë, shpenzimet për pagesën e papunësisë, ndihmën ekonomike dhe fondin e kompensimit për ish të përndjekurit politikë, janë realizuar respektivisht 93.2%, 98% dhe 83.3%, dhe në vlerë 64 milionë lekë, 336 milionë lekë dhe 400 milionë lekë, më pak se sa kuotat e planifikuara.


Këto shpenzime në strukturë të realizuara në vitin 2011, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, paraqiten si vijon:

a) Shpenzimet për pagesën e papunësisë rezultojnë me rritje në masën rreth 10.8% dhe në vlerë 106 milionë lekë më pak.

b) Shpenzimet për ndihmën e ekonomike rezultojnë me ulje në masën rreth 2% dhe në vlerë 337 milionë lekë më pak.

c) Shpenzimet për kompensimin e ish të përndjekurve politikë rezultojnë me rritje të ndjeshme nga 1,000 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2010, në vitin 2011 janë shpenzuar 1,500 milionë lekë, me një rritje në masën 50% dhe në vlerë 500 milionë lekë më tepër.

Në mënyrë grafike, ecuria e shpenzimeve korrente buxhetore sipas klasifikimit në zërat kryesore, për periudhën 2007-2011, paraqitet:



▪ *Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm dhe të jashtëm)*, zenë rreth 18.8% të totalit të përgjithshëm të shpenzimeve të realizuara në vitin 2011, nga 18.6% që zinin në vitin 2010. Kundrejt kuotës së planifikuar, ato janë realizuar në masën 93.2%, me një mosrealizim në vlerë prej 5,179 milionë lekë.

Në strukturë, shpenzimet për investimet me financim të brendshëm në vitin 2011 janë realizuar në masën 94.7% me një mosshpenzim në vlerë prej 2,285 milionë lekë. Kundrejt realizimit faktik të vitit 2010, ato paraqiten me ulje të ndjeshme në masën 11.9% dhe në vlerë 5,545 milionë lekë më pak, ndërsa shpenzimet kapitale me financim të huaj në vitin 2011 janë realizuar në masën 90.6% me një mosshpenzim në vlerë prej 2,894 milionë lekë dhe kundrejt realizimit faktik të vitit 2010, ato rezultojnë me rritje të konsiderueshme përkatësisht në masën 34.2% dhe në vlerë 7,132 milionë lekë më tepër.

Kundrejt totalit të shpenzimeve kapitale, shpenzimet me financim të brendshëm kanë rënie, nga 69.1% që zinin këto shpenzime në vitin 2010, në vitin 2011 kanë zbritur në 58.1%; ndërkohë që shpenzimet kapitale me financim të huaj kundrejt totalit të shpenzimeve kapitale të vitit 2011 kanë rritje të dukshme duke arritur në 39.6%, nga 30.9% që zinin në vitin 2010. Pra në vitin 2011, krahasuar me vitin 2010, ka një ulje të peshës specifike të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm me 11%.

Kundrejt PBB-së të vitit 2011, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj zënë përkatësisht 3.13% dhe 2.13%, nga 3.77% dhe 1.68% të PBB-së të rezultuar në vitin 2010.

Krahas mendimeve dhe rekomandimeve të parashtruara në pjesën e parë të raportit për zbatimin e buxhetit të vitit 2011, për miradministrimin dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike për shpenzime, gjatë vitit të ardhshëm buxhetor vëmendja duhet përqendruar në:

- Konsolidimin dhe mirëfunksionimin e strukturave të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përgjithësi, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të miratuar për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe në përputhje me kërkesat e parashtruara nga BE për vendin tonë në kuadër të Kontrollit të Brendshëm Financiar të Sektorit Publik (KBFSP).

Në këtë kontekst, për miradministrimin e shpenzimeve publike, krahas kuadrit ligjor rregullator i cili tashmë është konfiguruar dhe plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen e stabilizim asociimit të vendit tonë në BE, kërkohet thellimi dhe përmirësimi cilësor i veprimtarisë së kontrollit brendshëm, auditimit të brendshëm, madje dhe auditimit të jashtëm.

- Referuar strukturës së shpenzimeve dhe gjetjeve të KLSH të pasqyruara në këtë raport, ka vend për të riparë kuotimin dhe përdorimin e fondeve të shpenzimeve brenda zërave të shpenzimeve korrente. Madje, ka vend për rishikim dhe brendapërbrenda zërave kryesorë të shpenzimeve, si të disa nënzërave të llogarisë 602, siç u veprua me shpenzimet për mirëmbajtjen dhe përdorimin e autoveturave me daljen e ligjit nr. 10160, datë 15/10/2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”.

- Në lidhje me shpenzimet për interesa, ato priren drejt rritjes, sidomos në kushtet e bërjes efektive të kredive apo huave të marra, ndaj kërkohet përcaktimi i masave më të efektshme në pagesën e tyre, sidomos në reduktimin e deficitit buxhetor dhe zgjatjen e afateve të maturimit.

- Përdorimin më me efektivitet të fondeve për investime publike, nëpërmjet rritjes së përgjegjshmërisë të nëpunësve të administratës publike, të nivelit teknik dhe profesional të tyre, si dhe të kërkesës të institucioneve të ngritur me ligj për monitorimin dhe respektimin e dispozitave ligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik të fondeve publike për investime.

- Në programin buxhetor të vitit 2013, krahas dhënies përparësi me fonde buxhetore sektorëve prioritarë të ekonomisë, si shëndetësisë, arsimit, investimet në infrastrukturë dhe shërbimet sociale; kujdes duhet t'i kushtohet mbështetjes së sektorëve që punojnë për eksport si bujqësia, industria minerale, prodhimi agroindustrial, industria që punon me material porositësi etj.

Po t'i referohemi strukturës së PBB-së sipas sektorëve për periudhën 2006-2011, të raportuar nga MF, sektorët e bujqësisë dhe industrisë me përjashtim të vitit 2009, në 5

vitet e tjerë kanë kontribuar mesatarisht çdo vit bujqësia 17.46% të PBB-së dhe industria 9.68% të PBB-së.

Per hartimin e buxhetit te vitit 2013 rekomandojmë që nga ana e

strukturave përgjegjëse të kryhet një analizë dhe vlerësim real i ndikimeve të krizës në Eurozone dhe me tej (asaj globale) si dhe i situates ne vend si dhe reflektimin ne këtë buxhet të parashikimeve realiste të treguesve në nivele agregate me synim shmangjen e praktikave të rishikimit të buxhetit gjate ekzekutimit te tij

## PJESA E TRETË

### MBI MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN, SI DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM.

Në vendimin e KM nr. 640, datë 11/6/2009 “Për miratimin e Letërpolitikave për kontrollin e brendshëm financiar dhe të planit të veprimit 2011-2014”, MF ngarkohet me detyrën për udhëheqjen e procesit për zbatimin e letërpolitikave. Në zbatim të këtij vendimi, NJQH/AB në MF, ka hartuar dhe miratuar drejtimet dhe çështjet që duhet të realizojë, performanca e të cilave, paraqitet përsa vijon:

MATJA E PERFORMANCËS	Njësitë përgjegjëse	NIVELI I REALIZIMIT
Miratimi i ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), i cili do të trajtojë çështje me rëndësi themelore për KBFP dhe do të përcaktojë përgjegjshmërinë menaxheriale, kërkesat minimale për mirëqeverisjen, kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e riskut, statusin e njësisë qendrore të harmonizimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.	NJQH/MFK,	<b>Realizuar.</b> Ligji për MFK-në nr. 10296, u miratua në datë 8/7/2010 nga Kuvendi dhe ka hyrë në fuqi në datën 1/1/2011.
Miratimi i ligjit për Inspektimin Financiar Publik, i cili do të rregullojë procedurën dhe mënyrën për të kërkuar dhënien e dënimeve administrative dhe të dënimeve pasurore, në rast kur vërehen shkelje të buxhetit, ekonomiko-financiare, apo të legjislacionit të kontabilitetit. Ky ligj do të përmbajë edhe trajtimin e parregullsive.	NJQH/MFK	<b>Realizuar.</b> Ligji për Inspektimin Financiar Publik, nr. 10294 u miratua në datë 1/7/2011 nga Kuvendi dhe ka hyrë në fuqi një muaj më pas.
Ngritja e funksionit të inspektimit në Ministrinë e Financave, në zbatim të ligjit të Inspektimit Financiar	Ministri i Financave	<b>Realizuar.</b> Është ngritur Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në MF, me VKM nr. 9, datë 2/2/2011 “Për miratimin e strukturave dhe organikave të MF”.
Përpunimi i “gjurmëve të auditimit” për sistemet bazë (psh. buxhetimin, zbatimin e buxhetit dhe mbledhjen e të ardhurave, monitorimin, prokurimin, menaxhimin e aktiveve). Rezultatet duhet të shtjellohen tek Manuali për MFK-në.	- NJQH/MFK - Projekti për KBFP-në - Drejtoritë përgjegjëse në MF.	<b>Realizuar.</b> Janë hartuar dhe përfshirë në Manualin e MFK-së. Është hartuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe urdhëri nr. 92, datë 29/12/2011 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” etj.
Përgatitja e Manualit për MFK-në në përputhje me praktikën më të mira, që do të reflektojë ligjin për MFK. Mbështetur në ligjin e	NJQH/MFK korrik 2011, për Manualin	<b>Realizuar.</b> Manuali është miratuar nga Ministri i Financave në datë 15 korrik 2011, me urdhërin nr.54.

<p>MFK, Manuali për MFK do të shtjellojë kërkesat bazë për futjen e një mjedisi të shëndetshëm të qeverisjes korporative. Manuali për MFK do të përshkruajë metodologjinë për vlerësimin e menaxhimit e riskut.</p>	<p>për MFK 2011-2014 e në vazhdim për përditësim</p>	
<p>Rishikimi i strukturave menaxheriale dhe financiare, përshkrime të punës dhe të kriterëve të punësimit në njësitë publike, në përfaqje me kërkesat e ligjit të MFK-së dhe të Manualit përkatës.</p>	<p>- NJQH/MFK - Njësitë e Sektorit publik  - Vazhdon për dy vjet, duke nisur nga 2011.</p>	<p><b><u>Në proces</u></b> a) Është dërguar në NJesite Publike shkresa nr. 6082, datë 16/03/2011 “Hapat që duhen ndjekur nga njësitë publike për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. b) Dërgimi i shkresës nr. 20606 datë 31/10/2011 mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues në NJesite Publike, që specifikon dhe përgjegjësitë e Titullarëve dhe NA-ve.</p>
<p>Ministria e Financave (NJQH/MFK) do të përgatitë një dokument strategjik trajnimi lidhur me zbatimin e ligjit të ri për MFK dhe manualit përkatës, ku të përfshihet identifikimi i nevojave për trajnim i të gjithë punonjësve të sektorit publik.</p>	<p>- NJQH/MFK dhjetor 2011 dhe zhvillimi i trajnimeve intensive nga janari 2011 e në vazhdimësi</p>	<p><b><u>Realizuar.</u></b> Eshte miratuar "Plani 5 vjeçar për zbatimin e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit (2011-2016)" me urdhër të Ministrit të Financave nr. 11841, datë 10.06. 2011. Ky dokument u hartua nga NJQH/MFK me asistencën ndërkombëtare të ekspertëve të SIGMA/OECD</p>
<p>Ngritja e kapaciteteve të administratës publike për zbatimin e një kuadri të ri për MFK, nëpërmjet realizimit të trajnimeve për titullarët dhe drejtuesit e niveleve operacionale në sektorin publik në fushën e përgjegjshmërisë menaxheriale, kontroll dhe menaxhim financiar, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut dhe gjurmët e auditimit:</p>	<p>- NjQH/MFK nga qershori 2011 dhe në vazhdim për strategjinë e trajnimeve - Seminarët e trajnimit prej janarit 2011 dhe në vijim.</p>	<p><b><u>Proces në vazhdim.</u></b> 1.Gjatë muajve nëntor-dhjetor 2011 u zhvilluan disa seminare dhe konsultime për menaxhimin e riskut/regjistrin e riskut për disa institucione të zgjedhura si Prokuroria e Përgjithshme, MPPT, Ministria e Drejtësisë, ZABGJ, Ministria e Brendshme. Gjatë vitit 2011, NJQH/MFK ka organizuar seminare ndërgjegjësuese dhe informuese mbi risitë e kuadrit ligjor të MFK-së dhe mbi forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale, për institucionet qëndrore dhe njësitë e tyre shpenzuese. Këto aktivitete janë organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme, Gjykatën e Lartë, Ministrinë e Drejtësisë, KLSH dhe ZABGJ.</p>
<p>Raportimi vjetor në KM, Kuvend dhe në KLSH mbi proceset që lidhen me ndryshimet në KBFP</p>	<p>NJQH/MFK dhe NJQH/AB</p>	<p><b><u>Realizuar.</u></b> Në vitin 2011 është përgatitur raporti për vitin 2011.</p>
<p>10. Zgjerimi gradual i Sistemit të Thesarit tek ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore. Decentralizimi i kontabilitetit dhe kontroleve financiare nga Sistemi i Thesarit tek Njësitë që janë të lidhura on-line me Thesarin.</p>	<p>MF-Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, duke filluar në vitin 2011, shtrihet për një periudhë dhjetëvjeçare</p>	<p><b><u>Në proces zbatimi</u></b> MF ka filluar implementimin e projektit për zgjerimin e sistemit të thesarit (SETS), i cili ka filluar në prill 2011 dhe përfundon në prill 2014.</p>
<p>Kalimi tek IPSAS. Faza e parë do të konsistojë në implementimin e</p>	<p>MF, fillon në 2011 dhe</p>	<p>Ne kuadrin e tranzitimit nga baza e modifikuar e kontabilitetit në bazën e të drejtave të</p>

<p>IPSAS me bazë cash-in si standard tranzitor, IPSAS 6 dhe 24. Këtij procesi do t'i duhen gjashtë vjet për t'u vënë në zbatim në një numër të kufizuar ministrish dhe njësisish të qeverisjes vendore.</p>	<p>zgjat për një periudhë gjashtëvjeçar e tek Njësitë e testuara.</p>	<p>konstatuara (IPSAS). Është kërkuar asistencë teknike ndërkombëtare në kuadër të implementimit të Trust Fund 2, i cili nuk është bërë i vlefshëm. MF ka aplikuar përsëri në kuadrin e IPA 2013. Në maj 2011 u zhvillua një ëorkshop në MF me pjesëmarrjen e ekspertëve të Thesarit për trajtimin e IPSAS 6 dhe 24.</p>
<p>Zhvillimi i rishikimit të kostos dhe përfitimeve nga Komitetet/Bordet e menaxhimit dhe marrja e vendimit për strukturën më të përshtatshme për Shqipërinë.</p>	<p>NjQH/MFK</p>	<p><b>Realizuar.</b> Me ligjin për MFK për ngritjen e GMS-ve në njësitë publike dhe bordin e KBFP vetëm në MF, në datë 29/4/2011 ka dalë urdhëri nr. 54 për një ndryshim në urdhërin e Kryeministrit nr. 78, datë 8/5/2006 "Për krijimin e grupeve ministrore të punës për strategji, buxhet dhe integrim".</p>

□ Në nenin 66, të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", përcaktohet:

*"Ministri i Financave i dërgon një raport, çdo vit, Këshillit të Ministrave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbatimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe të funksionimit të auditimit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përfshirë dhe gjetjet e rëndësishme dhe rekomandimet për auditimin e brendshëm".*

□ Ndërsa, në nenin 18, të ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" përcaktohet:

*"Ministri i Financave i paraqet Këshillit të Ministrave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda muajit maj të çdo viti, deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin paraardhës, përfshirë dhe gjetjet e rëndësishme dhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit".*

□ Përsa më sipër, dhe në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në Ligjin Organik të KLSH nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, neni 7, germa "e", ku përcaktohet:

*"Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me kompetencat e tij kontrollon:*

*- Mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të kontroll revizionit të brendshëm shtetëror".*

KLSH, për vitin 2011, ka ushtruar auditim për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në 19 subjekte gjithsej, nga të cilat: në 15 institucione qendrore dhe 4 njësi të pushtetit vendor.

; ndërsa për vlerësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në 40 subjekte publike gjithsej, nga të cilat 19 insitucione qendrore dhe 21 njësi të pushtetit vendor, sipas anenksit nr. 5 bashkëlidhur këtij raporti.

## **I. PËR VLERËSIMIN E SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIT FINANCIAR.**

Për të përmbushur këtë detyrim ligjor, KLSH ka ushtruar auditime vlerësuese:

**A.** Në nivel qendror në 15 institucione përkatësisht në: Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë, MMPAU, Administratën e Presidencës, Aparatin e Kryeministrit, Bankën e Shqipërisë, SHISH, ISSH, ISKSH, DPT, QKR, QPZ,

ATSH, QKKF Tiranë dhe DRA Shkodër; ndërsa në nivel vendor në bashkitë Elbasan, Delvinë, Laç dhe Poliçan.

Në lidhje me implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, janë audituar hapat që duhen ndjekur në këtë proces, në bazë të shkresës nr. 6082 datë 16/3/2011 të Njesisë Qëndrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (NJQHMFK).

Në subjektet e audituara të lartpërmendura, Grupet e auditimit të KLSH, kanë kryer verifikimet e programuara për plotësimin e kërkesave, përsa i përket ngritjes së Grupeve për Menaxhimin Strategjik dhe Kontrollin, kordinatorëve të riskut, nëpunësve autorizues dhe zbatues, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” dhe “Monitorimi”. Madje, grupet e auditimit kanë kryer teste kontrolli në procedura pune, për të vlerësuar funksionimin e sistemeve të MFK-së.

Theksojmë se, nga verifikimet e kryera në subjektet e audituar, me perjashtime të pakta, ka rezultuar se ka nisur puna për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të pesë komponentët e tij, dhe më konkretisht:

- Në MF është krijuar Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Kontrollin, kryetar i të cilit është Ministri i Financave, nënkryetarë janë dy Zv/ministrat, kordinator është Sekretari i Përgjithshëm, sekretar teknik Nëpunësi Zbatues dhe anëtarë janë të gjithë Drejtorët e Drejtorive në MF dhe Drejtorët e Institucioneve vartëse të saj. Në zbatim të nenit 18, të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Sekretari i Përgjithshëm i MF është *Nëpunësi i parë Autorizues* për buxhetin e njësive të qeverisjes qendrore, për fondet speciale të qeverisjes qendrore dhe transfertat e njësive të qeverisjes vendore.

### **1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm.**

Mjedisi i kontrollit i jep tonin të gjithë institucionit. Ai përbën themelet ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të MFK-së, pasi vendos objektivat që sigurojnë përmbushjen e misionit të çdo njësie, etikën personale dhe profesionale, strukturën organizative dhe filozofinë e menaxhimit.

Strukturat përgjegjëse të institucioneve të audituara kanë dijeni për ligjin nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe për aktet e tjera nënligjore dalë në zbatim të tij.

Ndër institucionet e audituara paraqesim përfundimet e auditimit në MF, si institucioni kryesor i menaxhimit financiar dhe vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe konstatimet më kryesore në institucionet dhe njësitë e sipërcituar.

**1.1** Nga auditimi në *Ministrinë e Financave* rezultoi se, ka objektiva, si ligjorë të përcaktuar në ligjin organik të saj dhe strategjikë të zhvillimit të institucionit të përcaktuara në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) për periudhën 2012-2014.

“Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” është hartuar në përputhje me “Manualin për MFK-në” dhe është dorëzuar tek titullari i institucioni brenda afatit të përcaktuar në nenin 18, të ligjit për MFK-në, gjithashtu ajo përmban të gjithë komponentët e përcaktuar në Manualin e sipërcituar.

Në këtë ministri, në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues mbi *etikën, konfliktin e interesit, marrëdhëniet midis menaxhereve dhe punonjësve të çdo niveli hierarkie, apo marrëdhëniet me të tretët*, është në përdorim Rregullorja e Brendshme e saj, rregulloret për secilin institucion varësie, si dhe manualet operacionale për implementimin e programeve IPA të financuar nga BE, të cilat përmbajnë seksione të veçanta për kodin e etikës, konfliktin e interesit dhe deklaratën e paanësisë.

Raportimi i shkeljeve të legjislacionit mbi etikën dhe marrja e masave për to, kryhen në bazë të procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11/11/1999 “Statusi i nënpunësit civil”, ligjit nr. 8485, datë 12/5/1999 “Kodi i procedurave administrative” dhe ligjit nr. 9131, datë 8/9/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Në drejtim të *përcaktimit të strukturës organizative në funksion të objektivave të institucionit*, rezultoi se struktura e re e MF është përcaktuar me urdhërin e Kryeministrit nr. 9, datë 2/2/2011 dhe ndryshimet e saj janë reflektuar në hartimin e një Rregulloreje të Brendshme të re, me urdhër të Ministrit të Financave.

*Në lidhje me caktimin e nëpunësit autorizues dhe zbatues të njësisë rezultoi se ato nuk janë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit për MFK-në, gjë për të cilën KLSH ka rekomanduar që kjo strukturë ka nevojë për përmirësim.* Çdo Drejtori në MF funksionon mbi bazën e rregullores së brendshme, në të cilën trajtohet delegimi i detyrave dhe janë të përcaktuara qëllimi i ekzistencës së çdo drejtorie; funksionet e drejtorive dhe detyrat funksionale të tyre dhe të çdo sektori përbërës në veçanti; detyrat e drejtorëve, përgjegjësve të sektorëve, të punonjësve etj.

Mbështetur në informacionin e vënë në dispozicion dhe në përgjigjet e pyetësorit, paraqesim:

a) Për çdo pozicion pune në të gjitha drejtoritë, përfshirë dhe drejtuesit e nivelit të lartë, ka përskrime të vendit të punës, të cilat janë përcaktuar në rregulloren e brendshme; gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme, bëhet rishikimi i përskrimeve të vendeve të punës për çdo ndryshim të strukturës së MF.

b) Vlerësimi i punonjësve është detyrë e eprorit të drejtpërdrejtë dhe bëhet periodikisht çdo vit, sipas përcaktimeve në ligjin për statusin e nënpunësit civil.

c) Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nxit ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, nëpërmjet trajnimeve të kryera nga ITAP, institucionet ndërkombëtare dhe drejtori të veçanta në Ministri.

Kontrolli i brendshëm nga lart poshtë përgjithësisht funksionon mirë. Ky kontroll i kushton një vëmendje të veçantë, vlerësimin të risqeve për subjektin dhe mbështetet në aplikimin e testeve substanciale dhe në procedura analitike të rishikimit.

## 1.2 Në ISSH:

- nuk disponohet një dokument zyrtar i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm për caktimin e nëpunësit autorizues dhe zbatues të nivelit të dytë, në kundërshtim me nenin 74 të ligjit për MFK-në; ku specifikohet se “Titullarët e njësive...të caktojnë Nëpunësin Autorizues të njësisë publike, Nëpunësit Autorizues të Nivelit të Dytë dhe të njoftojnë Nëpunësin e Parë Autorizues në Ministrinë e Financave brenda muajit nëntor të këtij viti”, njëkohësisht duke moszbatuar dhe kërkesën e dërguar nga NJQH/MFK me shkresën nr. 20606, datë 31/10/2011 “Për caktimin e nëpunësve autorizues në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;

- nuk janë bërë vlerësimet e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, sipas kriterëve të Kapitullit iii “Procesi i implementimit të MFK” të urdhrit të Ministrit të Financave nr. 54, datë 15/7/2010 “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.



- nuk është dërguar brenda afateve ligjore “deklarata vjetore mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm për vitin 2011”.

### **1.3 Në ISKSH**

- me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji, gjatë vitit 2011 nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Strategjia e Menaxhimit të Risqeve, pasi sipas pohimeve të drejtuesve të institucionit ISKSH vepron në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

### **1.4 Drejtorinë Rajonale Arsimore Shkodër:**

- rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e saj, nuk pasqyron kërkesat e ligjit për MFK-në, përsa i përket detyrave të nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues, si dhe të secilit sektor apo punonjës në veçanti.

-Nga auditimet është konstatuar se në disa njësi shpenzuese, nëpunësit zbatues nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në kuadrin rregullator ligjor të MFK-së, *si arsimimi dhe linjat e raportimit;* (disa njësi shpenzuese të rrethit të Shkodrës dhe Korçës, ku nëpunësit zbatues rezultojnë me profesionin “mjek veteriner”, “mësues cikli i ulët” apo “punonjës me arsim të mesëm”), kemi rekomanduar që nëpunësi i Parë Autorizues në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të kërkojë nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme informacion për nëpunësin zbatues të njërive shpenzuese, në lidhje me arsimimin e tyre, specialitetin, si dhe linjat e raportimit në raport me nëpunësin autorizues të njësisë shpenzuese. Po ashtu, kemi kërkuar që për të gjitha rastet e konstatimit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara, të njoftohen titullarët e njërive shpenzuese që të marrin masa për zbatimin e procedurave për emërimin e nëpunësve zbatues sipas kriterëve ligjorë brenda një periudhe tranzitore 3/mujore të diferencuar sipas rastit, por limiti përfundimtar kohor të jetë 31/12/2012, në rast të kundërt të bllokohen veprimet në thesar nga ana e këtyre punonjësve.

Në shkresën e Ministrisë të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: “shprehemi dakord dhe do të procedojmë me qëllim përmbushjen e kërkesave të ligjit”.

## **2. Menxhimi i riskut.**

Përfshin identifikimin dhe analizën e risqeve, që mund të kenë rëndësi për arritjen e objektivave dhe përcaktimin e një përgjigje të përshtatshme ndaj këtyre risqeve. Bazuar në ligjin për MFK-në, *nëpunësi autorizues i njësisë publike kryen dhe funksionin e koordinatorit të riskut për njësinë që mbulon dhe mund të delegojë disa nga detyrat për koordinimin e riskut tek një menaxher tjetër në varësi të drejtëpërdrejtë prej tij.*

**2.1** Në këtë kuadër, në *Ministrinë e Financave*, bazuar në nenin 9, pika 4.ç, të ligjit për MFK-në, Nëpunësi i Parë Autorizues ka caktuar si Nëpunës Zbatues të institucionit Drejtoren e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, të cilës i ka deleguar dhe funksionin e koordinatorit të riskut, ndërkohë që kjo Drejtore (Drejtori) nuk është në varësi të drejtëpërdrejtë nga Nëpunësi Autorizues, por nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse, gjë që bie në kundërshtim me pikën 1, neni 10 të ligjit për MFK-në.

Në përputhje me nenin 21, të ligjit për MFK-në, MF me përfshirjen e të gjithë Drejtorive, ka hartuar regjistrin e risqeve, i cili përmban në mënyrë të detajuar

risqet që pengojnë arritjen e objektivave të përcaktuara për çdo Drejtori të Ministrisë dhe për të gjitha institucionet e vartësisë, si dhe veprimet për minimizimin e risqeve të identifikuar. Regjistri i risqeve është përgatitur mbështetur në objektivat e identifikuar në PBA 2012-2014 nga çdo program buxhetor, si dhe objektivat e punës së çdo sektori/drejtorie për vitin 2012.

Risku administrohet për funksione dhe njësi të ndryshme, sipas fushave të veprimtarisë.

Në lidhje me punën e bërë për menaxhimin e riskut për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarjet apo situatat e mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të tyre, në disa nga subjektet e audituar janë konstatuar mangësi si në:

### **2.2 DPT**

- për vitin 2011 dhe deri në fund të muajit qershor 2012 kohë kur përfundoi auditimi në DPT nga audituesit e KLSH, nga DPT nuk janë ndërmarrë veprime konkrete organizative për zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 për MFK-në.

- në zbatim të nenit 22, të ligjit të lartpërmendur pika 1.2, DPT ende nuk kishte hartuar dhe miratuar strategjinë e menaxhimit të riskut.

### **2.3 ISSH:**

- nuk është hartuar një strategji për menaxhimin e risqeve, në kundërshtim me kreun iii, të manualit për MFK-në, faqe 64, paragrafi i ii, ku përcaktohet: “Titullarët e njësive të qeverisjes qendrore janë përgjegjës për miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve për sistemin efektiv të menaxhimit të risqeve brenda njësisë së tyre”, duke mos përmbushur detyrimin ligjor për dërgimin e regjistrit të risqeve, sipas kërkesave të neneve 10 e 21 të ligjit për MFK-në.

- nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik, i cili duhet të evidentojë të metat, mangësitë dhe menaxhimin e risqeve, në kundërshtim me ligjin dhe manualin për MFK-në.

### **2.4 ISKSH:**

- në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 për MFK-në, nuk ka të formalizuar dhe dokumentuar ndonjë procedurë për menaxhimin e riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit, të përcaktuara gjatë planifikimit afatmesëm dhe vjetor.

**2.5 MMPAU**, nuk ka caktuar koordinatoren e riskut sipas kërkesave të nenit 10, të ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010.

**2.6 SHISH**, nuk ka hartuar një strategji për menaxhimin e risqeve, në kundërshtim me kreun iii, të manualit për MFK-në.

### **2.7 Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Tiranë:**

- nuk është hartuar një strategji për menaxhimin e risqeve, në kundërshtim me kreun iii, të manualit për MFK-në;

- nuk disponohet ndonjë dokument që të vërtetojë se, punonjësit e njësive janë njohur me përmbajtjen e deklaratës së misionit, të objektivave dhe strategjisë;

- në rregulloren e brendshme, nuk ka asnjë paragraf apo nen ku të flitet për konfliktin e interesit;

- për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale, nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve.

**2.8 DAR, Shkodër**, nuk është hartuar strategjia për menaxhimin e risqeve, në kundërshtim me ligjin dhe manualin për MFK-në, si dhe nuk disponohet ndonjë

dokument që të vërtetojë se, punonjësit e Drejtorisë janë njohur me përmbajtjen e deklaratës së misionit, të objektivave dhe strategjisë.

### **3. Aktivitetet e kontrollit.**

Aktivitetet e kontrollit janë politikat dhe procedurat e vendosura për të adresuar risqet dhe për arritur objektivat e institucionit. Ato përfshijnë një gamë veprimesh kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues.

Në lidhje me aktivitetet e kontrollit, është e rëndësishme një ndarje e përshtatshme e detyrave, në mënyrë që i njëjti person/strukturë të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy ose më shumë detyrave që lidhen me: miratimin, zbatimin dhe regjistrimin e operacioneve, vendosjen e rregullave të brendshme mbi kontrollin para faktit ose paraprak të ligjshmërisë, veprime të përshtatshme kontrolli për sistemet e IT-së etj.

**3.1 Në MF** referuar përgjigjeve të pyetësorit dhe verifikimeve të kryera nga grupi i auditimit të KLSH, ka rezultuar se përcaktimet e mësipërme janë të shprehura në rregulloren e brendshme të institucionit. Në këtë rregullore përcaktohen procedurat e punës për proceset operacionale dhe financiare, përfshirë qarkullimin e dokumentacionit dhe të informacionit, hallkat e vendim-marrjes dhe kontrollet e brendshme të vendosura.

Në MF ka rregulla të brendshme lidhur me dokumentimin e operacioneve dhe transaksioneve financiare, si dhe përsa i përket procedurave të delegimit. Në këtë institucion funksionon mirë sistemi i firmës së dyfishtë dhe angazhimet financiare nënshkruhen nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, gjithashtu, në përgjithësi strukturat aktuale i përgjigjen mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar konflikt interesi dhe pa mbivendosur detyrat. Proceset kryesore të punëve operacionale dhe financiare janë të shkruara dhe të përcaktuar në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme.

Pavarësisht sa më sipër, në disa subjekte të veçantë janë konstatuar disa mangësi dhe konkretisht:

**3.2 Në ISSH**, për procese të veçanta, si ai i regjistrimit (hedhjes) së të dhënave në projektin e “Të vetëpunësuarve në bujqësi”, ISSH nuk disponon kapacitete të mjaftueshme, pasi në këtë proces është i angazhuar vetëm një person, i cili nuk mund ta përfundojë punën e nisur për shkak të volumit shumë të madh që ka ky aktivitet.

**3.3 Në QKKF Tiranë**, ende regjistrimet në kontabilitet bëhen me dorë dhe jo me anë të programeve kompjuterike të licencuar, siç është programi “Alpha” apo “Financa 5”.

**3.4** Po kështu dhe në **DAR Shkodër**, regjistrimet në kontabilitet vazhdojnë të bëhen me dorë dhe jo me anë të programeve kompjuterike të licencuar.

### **4. Informimi dhe komunikimi.**

Informimi dhe komunikimi janë thelbësore për zbatimin e të gjithë objektivave të kontrollit të brendshëm.

**4.1 Në MF**, në kuadrin e ekzistencës së udhëzimeve dhe rregulloreve të shkruajtura, mbi mënyrën e komunikimit brenda institucionit (komunikimi me shkrim, elektronik ose verbal) dhe mundësi që u jepen punonjësve nga sistemi aktual i komunikimit, marrja e informacioneve të duhura për zbatimin e detyrave të tyre, shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit, funksionojnë si horizontaisht ashtu edhe vertikalisht, si dhe sipas nivelit të hierarkisë, në mënyrë

shkresore dhe elektronike. Sistemi i informacionit është i përshtatshëm dhe ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve e të urdhrave të qarta dhe të sakta për rolin e çdo punonjësi.

Në lidhje me pajisjen e sistemeve të IT-së, me një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) dhe për ri-përfitimin e të dhënave në rast aksidenti të sistemit dhe të testimi të këtyre procedurave në praktikë, nga auditimi rezultoi se, *ekzistojnë sisteme back-up, të cilat administrohen nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit*. Madje, Sektori i Financës dhe Buxhetit është struktura përgjegjëse që siguron informacionin për të informuar titullarin dhe drejtuesit e programeve mbi shpenzimet aktuale, krahasuar me buxhetin e planifikuar në total dhe për çdo program për të cilin ata kanë përgjegjësi.

Dhe në institucionet e tjera, në përgjithësi titullarët e njësive publike kanë vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që ofrojnë siguri, për identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e informacionit të besueshëm dhe të përshtatshëm, brenda afateve të duhura dhe që bëjnë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë. Dokumentacioni i të gjitha veprimeve, proceseve dhe transaksioneve qarkullon dhe siguron gjurmën e auditimit etj.

Ndonëse, në subjekte të veçantë janë konstatuar dhe mangësi si në:

**4.2 AQKKF, Tiranë**, ku sistemi i teknologjisë së informacionit nuk ofron informacionin e duhur për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi dhe të strukturave të veçanta të saj, si dhe nuk ka një rregullore të shkruar për mënyrën e komunikimit brenda njësisë. Sistemi i IT nuk është i pajisur me një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave rezervë (back-up) dhe për ri-përfitimin e tyre në raste aksidentale.

**4.3 DAR Shkodër**, ku sistemi i IT nuk është i pajisur me një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave rezervë (back-up) dhe për ri-përfitimin e tyre në raste aksidenti.

## **5. Monitorimi**

Si proces i rëndësishëm, sistemet e kontrollit të brendshëm duhen monitoruar për të vlerësuar cilësinë e sistemit të performancës në kohë. Monitorimi kryhet nëpërmjet një monitorimi në vazhdimësi, nëpërmjet vlerësimeve të shkëputura, ose duke i kombinuar të dyja. Monitorimi i aktiviteteve të kontrollit të brendshëm duhet të dallohet qartë nga verifikimi dhe monitorimi i operacioneve të institucionit.

**5.1 Në MF**, monitorimi kryhet nëpërmjet verifikimit dhe performancës financiare të shpenzimeve të buxhetit, analizave të zbatimit të buxhetit nga Drejtuesit e Programeve, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit çdo 3 muaj, çdo 1 vit apo sa herë lind nevoja, kur Titullari i institucionit kërkon monitorim nga menaxherët e drejtorive dhe njësive vartëse të MF.

Përveç procedurave të monitorimit nga titullari, nga Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe menaxherët e tjerë në MF, përdoret edhe inspektimi financiar që kryhet nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik (DIFP).

Në MF, DIFP dhe NJQHAB, raportojnë dhe kanë varësi të drejtëpërdrejtë nga titullari i institucionit.

Menaxherët e drejtorive dhe drejtuesit e njësive të vartësisë, monitorojnë aktivitetin e sistemeve të MFK-së brenda njësive që drejtojnë dhe dërgojnë tek titullari raporte javore, mujore, tremujore, vjetore.

Krahas MF, nga auditimi në subjektet e tjerë rezultoi se, në përgjithësi titullarët e njësive publike kanë marrë masat e duhura për ngritjen e sistemeve të monitorimit dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit që sigurojnë përditësimin sa herë që ndryshojnë kushtet. Titullarët e njësive publike informohen në vazhdimësi nga drejtorët dhe përgjegjësit e sektorëve mbi aktivitetet e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave dhe raportimeve mujore, 3/mujore e vjetore, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në rregulloret e brendshme të tyre.

**B. Në nivel vendor përkatësisht në Elbasan, Delvinë, Laç dhe Poliçan,** nga auditimet e kryera nga KLSH ka rezultuar se në këto subjekte:

□ Janë caktuar personat përgjegjës me atributet e “Nëpunësit Autorizues”, që në përgjithësi është Titullari i bashkisë, ose në ndonjë rast kjo përgjegjësi i është deleguar zëvendësit të tij. Gjithashtu, është caktuar “Nëpunësi zbatues”, që në bashkitë e audituara është Përgjegjësi i Financës.

□ Në drejtim të sistemit të kontrollit dhe raportimit, ka rezultuar se është punuar dhe janë bërë përpjekje, duke përcaktuar në çdo pozicion personat përgjegjës dhe duke shtrirë sistemin e komunikimit elektronik (IT), për çdo punonjës, zyrë, drejtori, menaxherë të fushave kryesore, grupi për menaxhimin strategjik dhe deri tek nëpunësi autorizues.

□ Për implementimin dhe monitorimin e vlerave dhe kodit të etikës, janë hartuar rregulloret e brendshme në mbështetje të legjislacionit, duke përcaktuar vlerat etike dhe rregullat lidhur me zbatimin e detyrave, marrëdhëniet midis drejtuesve dhe kolegëve. Nëpunësi Autorizues përgjithësisht ka bërë ndarjen e përgjegjësisë që lidhen me vendimmarrjen kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit. Procedurat e brendshme përgjithësisht garantojnë se punonjësit mbikëqyren në mënyrën e duhur në kryerjen e detyrave të tyre. Detyrat, mjedisi, aftësitë profesionale të punonjësve dhe linjat e raportimit janë të përshtatura, të konceptuara dhe të zbatuara në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

□ Në bashkitë e audituara është realizuar planifikimi, menaxhimi, kontabiliteti dhe raportimi financiar i veprimtarisë së njësive publike, si dhe menaxhimi efektiv i punonjësve të njësive.

□ Janë monitoruar sistemet për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësive kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar, duke aplikuar plotësimin me dokumentacion në çdo fazë të qarkullimit.

□ Janë ndarë përgjegjësitë që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë që rrjedhin nga rregullorja e miratuar.

Megjithë sa sipër, gjatë auditimit janë konstatuar dhe mangësi në drejtim të implementimit të ligjit dhe konkretisht:

1. Për vitin 2011, titullarët e bashkive, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit *nuk kanë hartuar politikat dhe objektivat e njësive publike që ata drejtojnë, po kështu planet strategjike e vjetore, si dhe plan-veprimet për arritjen e objektivave.*

2. Në lidhje me procesin e menaxhimit të riskut për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve, nuk kanë hartuar dhe miratuar programe afatgjatë dhe afatshkurtër të auditimit. Gjithashtu, *nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut*, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8/7/2011, neni 10 dhe 21, për pasojë nuk është caktuar koordinatori i riskut. Për më keq në bashkitë e audituara, *nuk janë ngritur grupet e menaxhimit strategjik të njësisë publike*, të kryesuar nga menaxheri kryesor i saj.

2. Në ndonjë rast nuk është miratuar një sistem i rregullave specifike e të procedurave *për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike*, bazuar në Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, por i referohen akteve ligjore të shfuqizuara.

3. Në disa raste nuk janë zbatuar afatet e parashikuara ligjore për të depozituar vetvlerësimin, siç përcakton neni 18, i ligjit nr. 10296, datë 8/7/2011 “*...jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual*”. Po kështu, dhe deklarata vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë, si dhe gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për vitin 2011 *nuk është hartuar dhe depozituar te Ministri i Financave*, sipas përcaktimit në nenin 18 të ligjit për MFK-në “*...jo më vonë se fundi i muajit prill*” etj.

## **II. MBIKËQYRJA (VLERËSIMI) E VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM.**

Auditimi i brendshëm është një veprimtari që ushtrohet nga drejtuesit apo bordi drejtues i një njësie publike, nga menaxherët dhe punonjësit e tjerë, i konceptuar për të dhënë garanci të arsyeshme për arritjen e objektivave në kategoritë si më poshtë:

- Pajtueshmëria me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Besueshmëria e raportimit financiar dhe menaxherial;
- Efektiviteti dhe efienca e operacioneve;
- Garantimi i aseteve;
- Shtimi i vlerës të njësisë së audituar.

Ndërsa, auditimi i jashtëm kryhet nga *KLSH*, e cila ka për detyrë ligjore mbikëqyrjen (vlerësimin) e sistemit të auditimit të brendshëm në vendin tonë.

Më konkretisht: në Ligjin Organik të *KLSH* nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, në nenin 7, germa “e”, përcaktohet:

*Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me kompetencat e tij kontrollon:*

*“Mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të kontroll revizionit të brendshëm shtetëror”.*

Paraprakisht vlen të pasqyrojmë se, reformat e ndërmarra nga Qeveria në fushën e financave publike, kanë krijuar bazën e plotë funksionale për fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Përmirësimi ligjor dhe konsolidimi i procesit të buxhetimit, të kontabilitetit dhe të përgjegjshmërisë për rezultatet e arritura, kërkojnë metoda të reja dhe bashkëkohore të veprimtarisë së sistemeve të kontrollit dhe të auditimit, kundrejt atyre të përdorura më parë.

Fuqizimi dhe modernizimi i sistemit të auditimit të brendshëm është vendimtar dhe i rëndësishëm thelbësor, për të mbështetur menaxherët publikë për arritjen e

objektivave, në mënyrë të veçantë për të bërë qeverisjen publike më efektive dhe efektive.

Për vitin 2011, audituesit e KLSH-së, bazuar në detyrimin ligjor dhe në programin strategjik të auditimeve kanë ushtruar auditime për veprimtarinë e kryer (punën e bërë) nga strukturat e auditimit të brendshëm në 19 Struktura të Auditimit të Brendshëm në nivel qendror dhe konkretisht në:

- o MF për veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministri dhe të NJQH/AB, METE, MPÇSSHB, MPPT, MASH, MMPAU, Ministrinë e Drejtësisë, ISSH, ISKSH, DPT, DPD, DPPSH, IMK, DPISHP, SHSSH, DPTRR, Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe DRSSH Tiranë.

Audituesit e KLSH, për realizimin e auditimit të mbikëqyrjes (vlerësimit) të auditimit të brendshëm në subjektet e sipërcituar, konformë standardeve të auditimit, kanë përcaktuar çështjet dhe nënçështjet objekt auditimi, nga auditimi i të cilave të nxjerrin përfundime sa më të sakta për efektivitetin e funksionimit të sistemit të auditimit të brendshëm, në secilin nga subjektet e audituar.

Fillimisht, puna ka nisur me vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor, që rregullon organizimin dhe funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm, ku përfshihen aktet ligjore, rregulloret dhe udhëzimet, si dhe çdo akt nënligjor i zbatueshëm, që rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

Në këtë kontekst, kusht i domosdoshëm për audituesit e KLSH, për kryerjen e mbikëqyrjes në SAB-të e programuara, është njohja dhe përvetësimi në tërësi dhe në mënyrë të detajuar, si dhe ballafaqimi i zbatimit në terren të të gjithë kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm. Më konkretisht të:

- o Ligjit nr. 9720 datë 23/4/2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16/9/2010 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9720, datë 23/4/2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
- o Vendimin e KM nr. 640, datë 11/6/2009 “Për miratimin e Letër Politikave të KBFP dhe planit të veprimit”.
- o Vendimin e KM nr. 806, datë 6/12/2006 “Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar”.
- o Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29/09/2010 “Miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.
- o Kartën e auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri Financave.
- o Kodin Etik të audituesve publik.
- o Akte të tjera nënligjore të nxjerra për këtë qëllim.

Nga audituesit e KLSH, për vitin analizues 2011, kërkesat e përcaktuara në dispozitat e mësipërme ligjore dhe nënligjore, gjatë auditimit në subjekt, janë ballafaquar me zbatimin konkret të tyre, dhe për kërkesat e pazbatuara, ato janë dokumentuar dhe raportuar konformë standardeve të auditimit të KLSH.

Nga auditimi ka rezultuar se, përgjithësisht NJAB-të, për realizimin e misionit të tyre të përcaktuar me ligj, janë mbështetur në objektivat themelore të përcaktuara prej tyre, siç janë, planifikimi dhe organizimi i auditimeve, parandalimi i shkeljeve financiare, mbrojtja e subjekteve nga humbjet dhe dëmtimet, vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrisqeve, zbulimi dhe vënia para përgjegjësisë e të gjithë personave përgjegjës për shkeljet, të metat dhe parregullsitë e tjera të konstatuara gjatë auditimit etj.

Përsa më sipër, ndërmjet detyrimeve ligjore që ende nuk kanë gjetur zbatim, paraqesim mospërmbushjen nga NJAB-të të detyrimit që rrjedh nga neni 18/1, i

ligjit nr. 9720, datë 23/4/2007, i ndryshuar dhe nga pika 3, e Manualit të AB të miratuar me urdhërin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29/09/2010 dhe hyrë në fuqi më datën 1/1/2011, *në lidhje me hartimin e manualit të auditimit me veçoritë specifike të auditimeve të brendshme respektive dhe emetimi i rregullave të veçanta metodologjike për kryerjen e auditimit.* Më konkretisht:

o *Në Ministrinë e Drejtësisë,* struktura e AB nuk ka hartuar manualin me veçoritë specifike të auditimit të brendshëm në strukturat e varësisë, sipas detyrës që rrjedh nga pika 3, e Manualit të AB dhe nga neni 18/1, i ligjit nr. 9720, datë 23/4/2007, i ndryshuar. E njëjta gjë dhe në *Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektoratit Shtetëror të Punës* etj. Gjithashtu, vlen të pasqyrohet mosplotësimi në shkallën e kërkuar të detyrimit të përcaktuar në nenin 19, të ligjit nr. 9270, datë 23.4.2007 i ndryshuar, ku shprehimisht cilësohet se: *“Audituesit, jo më vonë se 2 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të jenë të pajisur me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, pasi edhe pse ka kaluar mbi 1 vit nga përmbushja e këtij detyrimi, përsëri në fund të vitit 2011 ka rezultuar se nga 392 auditues të punësuar faktikisht, 320 prej tyre rezultojnë të certifikuar.*

SAB-të, bazuar në kërkesat e manualit për procedurat e auditimit të brendshëm, kanë hartuar planet për zhvillimin e auditimit, kanë përcaktuar numrin e subjekteve të varësisë që do të auditohen, prioritetet, analizën e risqeve etj. Gjatë planifikimit, ato kanë mbajtur parasysh fushat me risk të lartë, auditimin e subjekteve të paaudituar për një periudhë të gjatë (mbi 2 vjet), si dhe auditimin e shpenzimeve administrative, prokurimet me fonde publike, shfrytëzimin e pasurive kombëtare dhe dhënien e tyre me qira, shërbimet publike në shëndetësi, turizëm, kulturë e sport, në shërbimin e punësimit, në ujësjellës-kanalizime, në institucione të larta shtetërore etj.

Mbi bazën e këtyre planeve, janë hartuar programet e punës të miratuara nga titullarët e institucioneve, ku janë përcaktuar: - emërtimi i subjektit që do të auditohet, lloji i auditimit, afati dhe periudha e auditimit, kostoja financiare e auditimit, kuadri ligjor, çështjet që do të auditohen, metoda e punës dhe grupi i auditimit.

Pavarësisht mangësive që do të trajtohen në vijim të raportit, opinionimi i përgjithshëm për periudhën 1/1/2011 deri 31/12/2011, është që NJAB-të kanë patur rezultate dhe performancë të vlerësueshme, si në drejtim të efektivitetit të shtuar të auditimeve, ashtu dhe në arritjen e rezultateve të reformës së nisur, lidhur me zbatimin e akteve dhe kuadrit ligjor në fushën e auditimit publik, e shprehur kjo më së miri me arritjen e disa niveleve të kënaqshme të treguesve të zbulimeve dhe të numrit të rekomandimeve të dhëna për subjektet që këto struktura kanë audituar.

**I. Në zbatim të neneve 15 dhe 16 të ligjit për auditimin e brendshëm të sipërcituar, kërkesë kryesore është organizimi dhe funksionimi i strukturave të auditimit të brendshëm. Gjendja e strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik për periudhën që auditohet. Kapacitetet administrative dhe cilësia e angazhimeve në misionet e angazhimit për dhënie sigurie dhe këshillimi.**

Në ligjin nr. 9720, datë 23/4/2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe “Manualin e auditimit të brendshëm”, është përcaktuar detyrimi dhe e drejta e çdo subjekti publik për të krijuar njësinë e auditimit të brendshëm (NJAB), ose për të pasur shërbimin e tij. Në nenin 17, të ligjit për AB të ndryshuar



përcaktohet: *“Të gjitha njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme duhet ose të krijojnë njësitë e auditimit të brendshëm, ose të kenë audituesin e brendshëm, ose të kontraktojnë shërbimin e auditimit”*. Kuadri ligjor dhe rregullator ka përcaktuar parimet bazë mbi të cilat ushtrohet kjo veprimtari.

Nga auditimi i materialeve të dosjeve të vëna në dispozicion të Grupit të auditimit të KLSH nga NJQH/AB, rezultoi se për vitin 2011 numri i NJAB-ve në sektorin publik është 123 njësi, të cilat funksionojnë në njësi të qeverisjes qendrore, njësi të vartësisë, të pavarura dhe njësi të pushtetit lokal.

Krahasuar me vitin 2010, rezulton një pakësim i numrit të NJAB-ve për vitin 2011, me 10 njësi më pak, rrjedhojë kjo e ndryshimeve në ligjin nr. 9720, datë 23/4/2007 dhe hyrjes në fuqi të Manualit për AB. Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të VKM nr. 212, datë 30/3/2012 “Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet se: *“Njësia e auditimit të brendshëm, detyrimisht duhet të përbëhet nga minimumi, tre auditues, përfshirë drejtuesin e njësisë”*, pritet që në vitet në vazhdim numri i njësive audituese do të pakësohet edhe më shumë. Një fakt i tillë ka kushtëzuar nevojën e rritjes së nivelit të audituesve në përbërjen e NJAB-ve dhe funksionimit të tyre mbi bazën e standardeve të miratuara dhe praktikave më të mira të fushës.

Nga të dhënat e depozituara pranë NJQH/AB-së nga NJAB-të, rezulton se një numër i konsiderueshëm institucioneve (rreth 30, sidomos komuna, bashki dhe Këshilla Qarku), shërbimin e auditimit të brendshëm e kryejnë me vetëm 1 person. Ky fakt ka ndikuar në nivelin e objektivitetit dhe besueshmërisë së veprimtarisë së auditimit, duke shprehur dhe mangësi në zbatimin e standardeve për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Për të eliminuar këtë fenomen, ka dalë VKM-ja e sipërcituar “Për miratimin e kritereve për ngritjen e NJAB-ve në sektorin publik”, ku përcaktohen kritere të sakta për krijimin e funksionimit të NJAB-ve brenda subjekteve publike.

Në NJAB-të e institucioneve qendrore, njësive vartëse, apo të pushtetit vendor, audituesit e brendshëm, kanë një rol shumë të rëndësishëm në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e rekomandimeve, ndaj është kërkuar, që ato të zotërojnë nivel të lartë profesional dhe integritetin e duhur për të siguruar ushtrimin e drejtë dhe të saktë të funksionit. Për të siguruar këtë objektiv, rëndësi i është kushtuar plotësisht të strukturës dhe nivelit profesional të audituesve. Në fund të vitit 2011, gjendja në NJAB paraqitet: - janë të punësuar 392 auditues, nga 403 auditues të brendshëm të planifikuar sipas organikave të miratuara, nga të cilët 349 auditues janë të certifikuar dhe në proces kualifikimi “Auditues të Brendshëm në Sektorin Publik”, ndërsa 43 janë të pacertifikuar

***Shënim: Referuar Raportit të konsoliduar “Për veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik për periudhën janar-qershor 2012”, të miratuar nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm në mbledhjen e datës 21/8/2012, kjo situatë ka ndryshuar. Aktualisht në NJAB, nga 415 punonjës të planifikuar në organikë për këto njësi, 407 prej tyre janë të punësuar faktik, nga të cilët 319 janë të certifikuar, 33 janë në proces certifikimi dhe 55 janë të pa certifikuar.***

Nga analiza e përbërjes profesionale të stafit auditues ka rezultuar se numrin më të madh e zënë specialistë të fushave ekonomike, ku 335 auditues janë diplomuar si ekonomistë, 38 juristë dhe vetëm 19 i përkasin specialiteteve të tjera teknike. Në

këto specialitete teknike, kanë auditues institucione të tilla si: MPPT, MBUMK, MSH, MM dhe MB, të cilët për të përmbushur misionin e tyre në raport me veprimtarinë që zhvillojnë, kërkojnë specialistë të fushave specifike. Nga 277 auditues të certifikuar që kanë qenë në vitin 2010, ose 68.2% e totalit, në fund të vitit 2011 ka arritur në 349 auditues të certifikuar dhe në proces kualifikimi, ose rreth 90%, gjë që është një bazë e mirë për sigurimin e cilësisë dhe rritjen e përgjegjshmërisë në kryerjen e shërbimit të auditimit brendshëm në sektorin publik.

Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në nenin 16 të ligjit për auditimin e brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar, NJQH/AB ka insistuar për rritjen e cilësisë dhe kualifikimit të audituesve dhe për të rekrutuar në NJAB auditues të certifikuar. Megjithkëtë, të dhënat tregojnë se, akoma rreth 10% e audituesve janë pa certifikatën e audituesit.

o Bazuar në të dhënat e institucioneve qendrore e të vartësisë të dërguara në NJQH/AB me Formatin “Përbërja profesionale dhe niveli i kualifikimit të punonjësve”, konstatohen raste të moszbatimit të kriterëve ligjore të punësimit në NJAB, si mungesa e përvojës në punë (jo më pak se 5 vjet), apo drejtues të njësisë të AB të cilët nuk janë të pajisur me dëshminë “Auditues të brendshëm në sektorin publik” dhe me përvojë pune 5 vjeçare si auditues. Për t’u përmendur DPD, QSUT “Nënë Tereza” Tiranë, KESH sh.a., Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Ushqimit, Bashkia Tiranë etj. Eksperienca në punë e audituesve të brendshëm, është tregues i rëndësishëm për funksionimin normal dhe për rezultate të mira në fushën e auditimit të sektorit publik, gjendja e të cilit paraqitet në tabelën në vazhdim:

Numri faktik i AB	Arsimimi sipas specialiteteve			Kategorizimi i audituesve lidhur me vjetërsinë në AB			
	Ekonomist	Jurist	Të tjerë	Deri 5 vjet	Në %	Mbi 5 vjet	Në %
392	335	37	18	166	42.4	226	57.6

Numri i audituesve me vjetërsi mbi 5 vjet si AB është 57.6%, tregues i qartë i eksperiencës së mirë në fushën e auditimit. Numri i audituesve të fushave të tjera në masën 18% është relativisht i ulët, ç’ka kufizon në një farë mënyre auditimin në fusha specifike, por që menaxhimi i lartë i institucioneve duhet ta zgjidhë sipas përcaktimeve të Manualit për AB, ku parashikohet mbështetja nga burime të jashtme.

Krahas sa më sipër, referuar të dhënave të auditimit të kryer nga KLSH gjatë këtij viti në NJQH/AB dhe NJAB-të e lartpërmendura, ka rezultuar se:

a) Në MF, NJAB është organizuar si drejtori me 9 punonjës, pa sektorë. Në fakt për vitin 2011 kjo strukturë ka funksionuar me 7 punonjës ose në masën 78%, duke krijuar mungesë kapacitetesh audituese, gjë që ka bërë që në objekte të veçanta si Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Shtypshkronja e letrave me vlerë etj., auditimi i tyre të kryhet për periudha kohore mbi 2 deri në 4 vjet.

b) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, NJAB është përcaktuar në nivel sektori i përbërë nga 12 auditues, të pajisur me certifikatën “auditues i brendshëm në sektorin publik”, por nga krahasimi i numrit të objekteve të

detyrueshme për auditim dhe frekuencës së auditimit të subjekteve për të cilat detyrohet të auditojë, rezulton se ky kapacitet auditues është i pamjaftueshëm për mbulimin e objekteve me auditim të plotë.

c) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, struktura e AB është e organizuar si sektor me dy auditues, ndërkohë që janë parashikuar për t'u audituar 40 objekte. Gjykuar nga numri i objekteve të detyrueshme për auditim dhe frekuencës së auditimit të objekteve, kapaciteti auditues i këtij institucioni, është i pamjaftueshëm dhe duhet rishikuar me synim mbulimin e objekteve me auditim vjetor.

o Në nivel vendor, nga vlerësimi i bërë në 24 subjekte kryesisht bashki, rezultoi se:

- Në 3 bashki si Berat, Elbasan dhe Shkodër, njësia e auditimit të brendshëm është e organizuar në nivel drejtorie.

- Në 8 bashki si Lezhë, Mamurras, Rrëshen, Ura Vajgurore, Rubik, Delvinë, Tepelenë dhe Prrenjas, në nivel zyre me nga 1 specialist.

- Në 4 bashki si Laç, Vorë, Cërrik dhe Peqin, strukurat e auditimit të brendshëm rezultojnë të pa plotësura me personel; në 5 bashki të tjera si Bajram Curri Rrogozhinë, Maliq, Shijak dhe Poliçan, strukurat e auditimit të brendshëm nuk janë ngritur; ndërsa në Bashkinë Rubik, struktura e auditimit të brendshëm nuk ka kryer veprimtari.

- Në 17 komunat e audituara nuk janë ngritur struktura të auditimit të brendshëm.

- Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë, funksionon Sektori i Auditimit të Brendshëm me 4 punonjës, prej të cilëve 3 auditues janë në procesin e certifikimit si auditues të brendshëm, përfshi përgjegjësin e sektorit; ndërsa në Zyrën Qendrore të ALUIZNI-t në strukturë Sektori i Auditimit të Brendshëm është me 3 punonjës, por në fakt funksionon vetëm me 1 punonjës, përgjegjës sektori, i certifikuar si auditues i brendshëm.

Përsa i përket pajisjes me certifikatën "Auditues i brendshëm në sektorin publik", rezulton se mjaft prej të punësuarve si auditues nuk e kanë kaluar procesin e certifikimit ende, si Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Berat, audituesit e brendshëm në bashkitë Mamurras, Rubik, Delvinë, Tepelenë dhe Prrenjas, nga 1 auditues në Bashkitë Elbasan dhe Shkodër etj.

## 2. Mbi hartimin dhe miratimin e planeve vjetore dhe strategjike nga ana e strukturave të auditimit të brendshëm. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm të subjekteve në auditim.

Në bazë të pikës 2, të nenit 18 dhe neneve 25 e 27 të ligjit për AB në sektorin publik, i ndryshuar, DPAB sot NJQH/AB në muajin tetor 2010 u ka kërkuar SAB-ve të çdo institucioni publik, që në bazë të ligjit për auditimin e brendshëm, të përgatisin planin vjetor dhe atë strategjik 2011-2014. Plani duhet të jetë analitik dhe i konsoliduar për tërë sistemin e institucionit, duke përfshirë njësitë e vartësisë dhe organin qendror.

Bazuar në ligjin dhe manualin e auditimit të brendshëm, NJAB që funksionojnë në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, kanë hartuar planin strategjik 2011-2014, në të cilin kanë përcaktuar drejtimet kryesore mbi bazën e të cilave do të kryhet veprimtaria audituese, gjithashtu, kanë përcaktuar kohën dhe burimet e nevojshme për realizimin e objektivave, duke u bazuar në studimin dhe analizën e riskut.

Plani strategjik 2011-2014 dhe plani vjetor 2011, përbëhet nga:

a) Programi strategjik i konsoliduar i auditimit të brendshëm sipas subjekteve në sektorin publik për periudhën 2011-2014.

b) Programi vjetor i konsoliduar i auditimit të brendshëm sipas subjekteve në sektorin publik për vitin 2011, përfshirë programin e vitit 2011 të NJQH/AB.

Programi vjetor 2011 dhe ai strategjik 2011-2014, pas miratimit nga Komiteti i Auditimit me datë 20/12/2010, i është dërguar Ministrit të Financave.

a) *Plani strategjik, për veprimtarinë e auditimit të brendshëm 2011-2014*, përfshin:

- Zhvillimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik; zhvillimet aktuale dhe kuadrin organizativ dhe institucional; inisiativat ligjore; objektivin strategjik dhe qëllimi i auditimit të brendshëm; identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe vlerësimin e elementeve të kontrollit të brendshëm.

Ndërsa, në programimin e veprimtarive, frekuencat e auditimeve dhe parashikimi i tyre sipas llojit dhe periudhës së kryerjes, janë mbajtur parasysh:

- Menaxhimi i burimeve dhe kosto e auditimit.
- Burimet e auditimit.
- Matja e performancës së auditimit të brendshëm dhe treguesit.
- Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë.
- Kufizimet e auditimit etj.

o *Bazat për hartimin e planit strategjik janë risqet e identifikuara nga strukturat e auditimit të brendshëm në institucionet e sektorit publik. Në vlerësimin e riskut janë marrë në konsideratë kriteret si më poshtë:*

1. Kuadri ligjor dhe rregullator.
2. Organizimi dhe funksionet kryesore të subjekteve.
3. Kërkesat e raportimit financiar.
4. Mjedidi i kontrollit të brendshëm.
5. Shkalla e ndryshimeve organizative dhe të sistemit të drejtimit.
6. Materialiteti sipas vlerës/transaksionet me vlera monetare të mëdha dhe materialiteti sipas natyrës/çështje ndaj të cilave ka interes të lartë publik e qeveritar.
7. Paraqitja financiare e fushës, apo subjektit që auditohet.
8. Risku i brendshëm i subjektit që auditohet.
9. Mbulimi i pamjaftueshëm me auditime në të kaluarën.

o *Sistemet kryesore të identifikuar për t'u audituar për periudhën 2011-2014, për të cilën është hartuar plani strategjik, janë sistemet që paraqesin nivel të lartë rrisht. Më poshtë, paraqesim risqet e identifikuara sipas sistemeve, mundësisë së ndodhjes dhe impaktit të tyre, për vitin 2011.*

Nisur sa më sipër, sistemet kryesore të identifikuar për t'u audituar për periudhën 2011-2014, për të cilën është hartuar plani strategjik, do të jenë sistemet që paraqesin nivel të lartë rrisht siç janë:

- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore.
- Sistemi i prokurimeve.
- Sistemi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
- Sisteme specifike, sipas misionit dhe qëllimit të institucionit (investimet publike, të ardhurat, etj.).

Përveç vlerësimit të rrisht, sa më sipër, në identifikimin e sistemeve kryesore për t'u audituar janë marrë në konsideratë dhe faktorë të tjerë ku përfshihen raportet e mëparshme të auditimit, informacionet e periudhave të mëparshme, si dhe këshillimi me drejtues të subjektit.

Gjithashtu, në hartimin e planit strategjik është pasqyruar dhe vlerësimi i elementeve të kontrollit të brendshëm në subjekte të ndryshme të sektorit publik. Kështu, nga 24 njësi audituese nga të cilët 13 të qeverisjes qendrore dhe 11 të qeverisjes vendore, kanë bërë vlerësimin për çdo element të kontrollit të brendshëm, ku ka rezultuar:

- *Mjedisi i kontrollit* në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, ka një nivel mesatar të vlerësimit të riskut.
- *Menaxhimi riskut* në njësitë e qeverisjes qendrore është i ulët, ndërsa në njësitë e qeverisjes vendore është mesatar.
- Po kështu, *aktivitetet e kontrollit* janë vlerësuar në nivel të ulët për njësitë e qeverisjes qendrore dhe në nivel mesatar në njësitë e qeverisjes vendore.
- *Sistemi i komunikimit dhe informimit* nga audituesit është vlerësuar i ulët për njësitë e qeverisjes qendrore dhe i mesëm për njësitë e qeverisjes vendore.
- *Monitorimi* është vlerësuar i ulët për njësitë e qeverisjes qendrore dhe i mesëm për njësitë e qeverisjes vendore.

Për sa më sipër *mendojmë* se, bazuar në planin strategjik 2011-2014, i hartuar mbi bazën e vlerësimit të riskut dhe në analizën e faktorëve të tjerë, strukturat e auditimit të brendshëm do të ndihmojnë në të ardhmen menaxhimin në pakësimin e riskut, duke rishikuar dhe vlerësuar sistemet nëpërmjet të cilave ato janë menaxhuar me qëllim përmirësimin e tyre.

Si përfundim, referuar planit strategjik 2011-2014, të hartuar mbi bazën e vlerësimit të riskut dhe në analizën e faktorëve të cilësuar më sipër, *strukturat e auditimit të brendshëm do të ndihmojnë dhe mbështesin menaxhimin në pakësimin e riskut, duke rishikuar dhe vlerësuar sistemet nëpërmjet të cilave ato janë menaxhuar, me qëllim përmirësimin e tyre.*

**b) Hartimi i planit vjetor 2011.**

Për vitin 2011, plani vjetor është hartuar mbi bazën e planit strategjik, duke pasur si prioritet:

- Kryerjen e auditimeve në sistemet kryesore dhe me risk më të lartë në subjektet publike, rritjen e cilësisë së punës audituese për dhënien e rezultateve që shtojnë vlerë për subjektin e audituar.
- Krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm publik, i cili përfshin zhvillimin dhe përsosjen e kuadrit ligjor, procedural e rregullator, si dhe ngritjen dhe zhvillimin profesional të burimeve njerëzore, për aftësimin e tyre në ushtrimin e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara.

Plani vjetor 2011, për veprimtarinë e auditimit të brendshëm përfshin:

a) Planifikimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm publik; prioritetet e auditimit të brendshëm; objektivat kryesore të auditimit të brendshëm; dhe identifikimin e sistemeve dhe fushave prioritare.

b) Programimin e veprimtarive, frekuencat e auditimeve dhe parashikimin e tyre sipas llojit dhe periudhës së kryerjes; planifikimin e kostos së auditimit dhe alokimin e burimeve për vitin 2011; burimet e auditimit; matjen e performancës së auditimit të brendshëm dhe treguesit; kontrollin dhe sigurimin e cilësisë etj.

Më poshtë, paraqesim pasqyrën e auditimeve të planifikuara për vitin 2011, nga strukturat audituese të subjekteve publike, si vijon:

Nr.	Njësitë e Auditimit të Brendshëm	Auditime të planifikuara për vitin 2011				
		Gjithëj	Të plota	Të pjesëshme	Ndjekja e zbatimit të rekomand.	Të tjera
1.	Ministria e Financave	56	25	5	26	0
2.	METE	49	31	17	1	0
3.	MBUMK	38	24	13	1	0
4.	MPPT	35	28	7	0	0
5.	MPÇSSHB	32	0	32	0	0
6.	Ministria e Shëndetësisë	69	69	0	0	0
7.	Ministria e Drejtësisë	31	25	6	0	0
8.	Ministria e Mbrojtjes	51	36	15	0	0
9.	Ministria e Brendshme	88	38	26	2	22
10.	MPJ	13	12	1	0	0
11.	MASH	39	14	25	0	0
12.	MTKRS	37	22	6	9	0
13.	MMPAU	15	12	2	0	1
14.	DPD	12	9	3	0	0
15.	DPT	18	7	1	0	0
16.	ISSH	29	15	12	0	2
17.	ATK	10	7	2	1	0
18.	INSIG	38	18	20	0	0
19.	SHKP	28	22	4	2	0
20.	SHSSH	20	20	0	0	0
<b>Totali i Sistemit të AB:</b>		<b>2,528</b>	<b>1,523</b>	<b>772</b>	<b>182</b>	<b>51</b>

Plani vjetor identifikon veprimtarinë e auditimit të brendshëm që parashikohet të kryhet në njësitë audituese në subjektet e sektorit publik për vitin 2011, që përfshijnë 77 njësi të qeverisjes qendrore (13 ministri, institucione qendrore, të vartësisë, 12 prefektura dhe 3 nën/prefektura) dhe 56 njësi të qeverisjes vendore (këshilla qarku, bashki, komuna).

Nga pasqyra e mësipërme rezulton se, për vitin 2011, janë parashikuar të kryen gjithsej 2,528 auditime, nga të cilët 1523 auditime të plota, 772 të pjesëshme, 182 për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve dhe 51 auditime të tjera. Auditimet do të jenë të përputhshmërisë, financiare, të performancës, për ndjekjen e rekomandimeve dhe auditime të sistemeve të IT-së.

Nga auditimet e kryera nga KLSH, ka rezultuar se në përgjithësi të gjitha institucionet kanë hartuar planet vjetore dhe strategjike të auditimit sipas kërkesës të nenit 18/2 të ligjit për auditimin e brendshëm në sektorin publik. Janë respektuar kërkesat e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm publik për hartimin dhe miratimin e planeve vjetore e strategjike për hartimin dhe miratimin e planeve vjetore e strategjike të veprimit. Pavarësisht nga puna e bërë në institucione të veçanta u vërejtën mangësi dhe konkretisht në MTKRS e cila në 3/mujorin e parë të vitit 2011 nuk ka realizuar asnjë auditim; Ministrinë e Drejtësisë, ku për 9/mujorin 2011, nga 24 objekte të planifikuara për t'u audituar, janë audituar 20 objekte ose 83% e tyre; MMPAU ku për vitin 2011, nga 12 auditime të plota të planifikuara, janë kryer 3 auditime ose në masën 25%; në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër, ku për vitin 2011 nga 5 auditime të plota të planifikuara për t'u audituar, janë audituar 4 auditime të plota ose 80% e tyre etj.

o Në lidhje me programet e auditimit, pothuajse, në të gjitha institucionet e audituara, për çdo mision auditimi janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar nga titullarët e institucioneve. Sipas përcaktimeve në Manualin e AB (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit, në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve. Ato përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet e auditimit dhe grupin e punës.

Gjithashtu, institucionet e audituara kanë rritur përpjekjet për realizimin e programeve të auditimeve dhe për zbatimin e standardeve të hartimit dhe mbajtjes së dokumentacionit të auditimeve të kryera.

Por, pavarësisht punës së bërë, në institucione të veçanta janë vërejtur mosrealizime dhe parregullsi, të cilat ulin cilësinë e auditimeve dhe çënojnë standardet e auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe konkretisht në:

a) MPCSSHB u konstatua se, tematikat e programeve të auditimit të hartuara për subjekte të ndryshme në disa raste janë pothuajse të njëjta dhe trajtojnë aspekte të përgjithshme të subjekteve të audituara.

b) MPPT, në programin e auditimit të hartuar për auditimin e Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit, Autoritetin e Aviacionit Civil, Institutin e Ndërtimit etj., nuk janë përcaktuar detyrat që ka çdo auditues pjesë e grupit të auditimit, gjë që është në kundërshtim me manualin e auditimit të brendshëm në fuqi.

c) ISSH për vitin 2011 programet e auditimeve të plota janë stereotipe, të përdorura në të gjitha objektet e audituara.

o Në nivel vendor, nga auditimi rezulton se, në Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë, për 5 subjekte të cilët detyrohet t'i auditojë ky institucion, u ka kaluar afati 2 vjeçar i auditimit; në Bashkinë Laç, si rrjedhojë e mosplotësimit të strukturës me auditues të brendshëm nuk janë kryer auditimet në 5 subjektet e vartësisë; ndërsa përse i përket programeve të auditimit, në disa raste në to nuk është përcaktuar kuadri ligjor i nevojshëm dhe nuk janë përcaktuar hapat e nevojshëm për grumbullimin e evidencave të përshtatshme e të mjaftueshme për llogaritjen e materialitetit dhe vlerësimin e riskut; etj.

o Gjatë procesit të auditimit, në disa raste në hartimin e materialeve të auditimit, nuk është përcaktuar dispozita e ligjit të shkelur; memorandumet e hartuara janë shumë të detajuara dhe kopje të raportit përfundimtar, gjë që nuk i jep mundësi titullarit për të nxjerrë përfundime; në disa auditime mungon llogaritja e ditëve efektive të punës dhe kostoja e auditimit.

Në auditimet e kryera në përgjithësi nuk janë rekomanduar masa organizative dhe masa disiplinore, madje dhe kur janë rekomanduar masa disiplinore ato nuk janë shoqëruar me motivacionin përkatës, por vetëm janë përmendur disa dispozita ligjore. Ndër bashkitë e audituara gjatë vitit 2011, veçojmë auditimin e Bashkisë Prrenjas, i cili ka propozuar 2 masa disiplinore.

- Shtojmë se, ndonëse në disa auditime janë konstatuar shkelje, për to nga audituesit e brendshëm nuk janë përcaktuar personat shkaktarë përgjegjës dhe nuk janë rekomanduar masa disiplinore.

**3. Evidentimi i rezultateve të auditimeve, plotësimi në afat dhe me saktësi i evidencave periodike. Përgjithësuesit statistikorë në shkallë sistemi, mbi treguesit e realizimit të planit dhe shkallën e zbulimeve.**

NJAB-të e institucioneve qendrore, të vartësisë, të pavarura dhe të pushtetit vendor, në zbatim të detyrimit ligjor (pika 5, e nenit 18, të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, i ndryshuar), kanë përgatitur në mënyrë periodike (çdo 3/mujor dhe në fund të vitit), raportet dhe të dhënat statistikore të kërkuara nga NJQH/AB. Formati i evidencave të përgatitura e miratuara nga NJQH/AB, u është dërguar NJAB-ve, të cilat i kanë plotësuar dhe dërguar në NJQH/AB brenda afateve të parashikuara. Mbi bazën e të dhënave dhe problematikës të trajtuar nga NJAB-të dhe pasqyrave të plotësuara me treguesit e aktivitetit periodik e vjetor, NJQH/AB ka përgatitur raportet periodike dhe vjetore, së bashku me pasqyrat përmbledhëse. Evidencat e plota japin një pasqyrim të plotë të gjendjes së NJAB-ve mbi përbërjen profesionale dhe nivelin e kualifikimit të punonjësve të AB-ve; planifikimin dhe realizimin e programit të auditimeve; gjetjet e ndara sipas sistemeve; rekomandimet e dhëna dhe shkallën e zbatimit të tyre.

Për vitin 2011, angazhimet e njësisve të auditimit të brendshëm, janë rritur ndjeshëm, të shprehura si në planifikimin e subjekteve për t'u audituar dhe në numrin e angazhimeve të realizuara. Strukturat e auditimit të brendshëm nga *2,528 të programuara*, kanë realizuar në fakt *2,753 angazhime auditimi ose në masën 109% të planit vjetor*, tregues pozitiv sasior i punës audituese në sektorin publik. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna të detajuara për realizimin e angazhimeve në strukturë për vitet 2009, 2010 dhe 2011:

<i>Subjekte që i nënshtrohen auditimit</i>			<i>Auditime</i>								
<i>Viti</i>	<i>Numri subjekt.</i>	<i>Parashikuar në planin vjetor</i>	<i>Të programuara</i>				<i>Të realizuar</i>				
			<i>Gjithsej</i>	<i>Nga këto:</i>			<i>Gjithsej</i>	<i>Nga këto</i>			
				<i>Të plotë</i>	<i>Tematik</i>	<i>Investig</i>		<i>Të plotë</i>	<i>Tematik</i>	<i>Investig</i>	
2009	1,754	2,294	2,294	1,115	973	206	2,075	927	965	183	
2010	1,939	1,999	1,961	1,207	614	140	2,377	987	1,170	220	
2011	2,528	2,528	2,528	1,523	772	182	2,753	1,305	1,031	417	

Të dhënat e mësipërme shprehin realizimin e auditimeve në total për vitin 2011, kundrejt auditimeve të parashikuara për t'u kryer gjatë kësaj periudhe dhe tendencën në rritje të misioneve të auditimit krahasuar me dy vitet e fundit. Në vitin 2011, ka një tejkalim të numrit të auditimeve ndaj planifikimit dhe krahasuar me vitin 2010, *çka është një tregues pozitiv për veprimtarinë e auditimit, që dëshmon për shtimin e punës audituese, shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve dhe rezervave që kanë njësitë audituese, dhe rritjen e qëndrueshmërisë së tyre, ulje të numrit të subjekteve të paaudituar për një frekuencë kohe mbi dy vjet, duke ulur në këtë mënyrë nivelin e riskut në institucionet publike.*

Nga analiza mbi realizimin e llojeve të auditimeve, në në tre vitet konstatohet shmangie nga numri i auditimeve të planifikuara, *sidomos mosrealizim i numrit të auditimeve të plota*. Ndikim në këtë rezultat kanë pasur disa faktorë, ndër të cilët *përmendim ndryshimin e prioritetëve në veprimtaritë e subjekteve të audituara (vlerësimi i riskut rast pas rasti); ndërhyrjet e menaxherëve të lartë për kryerjen e auditimeve të rëndësisë së veçantë jashtë planeve* (si auditimet e kryera në të gjithë institucionet publike për zbatimin e VKM nr. 472, datë 2/7/2011 "Për disiplinimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2011"); mbivendosja e misioneve të auditimit të



parashikuara nga strukturat e auditimit të brendshëm me auditimet e kryera nga institucione të tjera audituese; performancë jo në nivelin e kërkesave të standardit të audituesve në kryerjen e funksionit të tyre, e theksuar kjo sidomos në stafin e punësuar rishtazi, pa eksperiencë, të patrajnuar e të pacertifikuar për njohuritë që kërkon profesioni; vlerësim jo i saktë i nivelit të riskut për fusha të veçanta, si rezultat i njohurive të pamjaftueshme të audituesve që, në pjesën më të madhe, lidhen me aplikimin e metodologjive të reja, si hyrja në fuqi e zbatimit të Manualit të AB etj. Për të përmirësuar këtë situatë, faktorët e mësipërm janë marrë në konsideratë gjatë procesit të planifikimit për vitin 2012 dhe të planit strategjik të periudhës 2012-2016.

o Në disa raste, është konstatuar tendenca që, strukturat e auditimit të funksionojnë si struktura inspektimi, duke realizuar e tejkalluar planin vjetor të auditimit, nëpërmjet kryerjes të më shumë auditimeve të pjesshme. Në tabelën e mëposhtme, paraqesim numrin e auditimeve të plota të realizuara në vitin 2011, në raport me auditimet gjithsej:

o

Nr.	Institucionet	Auditime gjithsej:			Auditime të plota		
		Plan	Fakt	Në % (Fakt/plan)	Plan	Fakt	Në % (Fakt/plan)
1.	Min. Financave	56	84	150.0	25	23	92.0
2.	METE	49	51	104.0	31	30	96.8
3.	MBUMK	38	38	100.0	24	24	100.0
4.	MPPT	35	37	105.7	28	29	103.6
5.	MPÇSSHB	32	41	128.2	0	0	0.00
6.	Ministria e Shëndetësisë	69	64	92.8	69	61	88.5
7.	Ministria e Dretësisë	31	24	77.5	25	13	52.0
8.	Ministria e Mbrojtjes	51	47	92.2	36	16	44.5
9.	Ministria e Brendshme	88	106	120.5	38	37	97.4
10.	MPJ	13	8	61.5	12	7	58.3
11.	MASH	39	45	115.4	14	20	142.8
12.	MTKRS	37	38	102.7	22	19	86.4
13.	MMPAU	15	59	393.3	12	3	25.0
14.	DPD	12	16	133.3	9	9	100.0
15.	DPT	18	47	261.1	7	4	57.2

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohen shmangie të mëdha në realizimin e planit të auditimit në dëm të kryerjes së auditimeve të plota:

Së pari: konstatohet se, në total është realizuar dhe tejkalluar plani i auditimeve, por nuk është realizuar plani i auditimeve të plota si: në MMPAU, ku rezulton tejkallim i ndjeshëm i planit të auditimeve gjithsej në masën 393.3% për vitin 2011, ndërkohë që plani i auditimeve të plota është realizuar vetëm 25%. Po kështu, në DPT plani total i auditimeve është realizuar 261%, ndërsa plani i auditimeve të plota është realizuar vetëm 57.2% etj.

Së dyti: Disa institucione qendrore nuk kanë realizuar planin në total të auditimeve dhe as auditimet e plota si: MPJ e cila ka realizuar planin e auditimeve të përgjithshme 61.5% dhe planin e auditimeve të plota 58.3%; Ministria e Drejtësisë respektivisht ka realizuar këto tregues 77.5% me 52%; Ministria e Mbrojtjes 92.2% me 44.5%, Ministria e Shëndetësisë 92.8% me 88.5% etj.

o Në ushtrimin e funksionit të tyre, strukturat e auditimit të brendshëm kanë konstatuar hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, me pasojë negative

në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike. Gjetjet kryesore të rezultuara nga kjo veprimtari lidhen kryesisht me mosfunksionim siç duhet të sistemit të MFK-së, në fushat e investimeve publike, të teknologjisë së informacionit, të prokurimeve, sistemit të pagave, në ngritjen e strukturave dhe rekrutimin e AB etj., ku më kryesoret përmendim:

a) Në fushën e menaxhimit të fondeve dhe pasurive dhe të investimeve publike, ku vlerësimi i objekteve pas investimit nuk është bërë konformë rregullave, apo veprime të tjera siç është kontabilizimi i veprimeve.

b) Në sistemet e kontabilitetit dhe raportimit financiar, janë konstatuar shkelje të cilat konsistojnë në gabime materiale në regjistrimin e transaksioneve të rëndësishme, shmangie nga standardet e miratuara, apo pasqyrim jo të saktë dhe korrekt të situatës financiare në deklaratat financiare.

c) Në fushën e zbatimit të akteve ligjore dhe procedurale, deri në moszbatim apo keqinterpretim të VKM-ve, apo ligjeve si në MPPT, ISSH, ISKSH, EKB etj.

d) Menaxhimi i lartë në institucionet publike, në shumë raste nuk ka kuptim të drejtë për rolin e auditimit të brendshëm dhe mbështetje të mirë për ushtrimin e funksionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të vendit. Veçanërisht konstatohen vështirësi për sigurimin e kapaciteteve, të burimeve të nevojshme dhe mbështetjen e punës audituese. Zbatimi me rigozitet i bazës ligjore nga menaxhimi i lartë për ngritjen dhe funksionimin e NJAB-ve, është kërkesë imediate për të kapërcyer vështirësitë dhe për të pasur arritje në këtë fushë.

Të dhënat në tabelën e mëposhtme tregojnë rastet e kostatuara të shkeljeve, si dhe ndikimi financiar që ato kanë pasur në buxhetin e subjekteve të audituara:

<i>Nr.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Numri i gjetjeve</i>	<i>Vlera në mijë/lekë</i>	<i>Përqindja ndaj totalit</i>
1.	Menaxhimi i burimeve njerëzore	364	5,149	0.34
2.	Zbatimi i buxhetit të vitit 2011	327	79,290	5.21
3.	Sistemi i pagave	932	387,715	25.45
4.	Sistemi i prokurimeve	204	109,666	7.20
5.	Sistemi i kontabilitetit	438	157,061	10.31
6.	Sisteme të tjera	912	784,270	51.49
<b>TOTALI:</b>		<b>3,177</b>	<b>1,523,151</b>	<b>100.0</b>

Për vitin 2011, sistemi i pagave dhe pagesave të personelit, sidomos për zbatimin e VKM nr. 472, datë 2.07.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore, për vitin 2011”, ka pasur rastet më të medha të shkeljeve të konstatuara. Ky fakt argumenton dhe mbështet në mënyrë të arsyetuar se, angazhimi i auditimit të kryer për pagesat e personelit për lejet vjetore, orët jashtë orarit dhe shpërblimet ishte efektiv, si dhe trajtoi drejt riskun e lartë që vlerësohej të kishte kjo fushë.

#### ***4. Hartimi i raportit Final***

Nga auditimet e kryera nga KLSH, ka rezultuar se në përgjithësi SAB-të në subjektet e audituar kanë rritur cilësinë e hartimit dhe paraqitjes të Raporteve Finale të Auditimit, duke realizuar dhe sigurimin e cilësisë në përputhje me standardet e auditimeve. Këto raporte janë të shoqëruara me masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë të argumentuara me bazën ligjore ku janë mbështetur. Megjithkëtë, në disa subjekte janë konstatuar mangësi e shkelje të standardeve të auditimit dhe konkretisht në:

a) MPCSSHB, u konstatua se, në auditimin e ushtruar në Zyrën Rajonale të SHSSH Fier, audituesit e brendshëm kanë evidentuar se fondi i pagave, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative janë realizuar respektivisht 81%, 87% dhe 88%; por për këto mosrealizime audituesit nuk kanë nxjerrë ndonjë konkluzion për shkaqet e mosrealizimit, por kanë rekomanduar “*Përdorimin e fondeve me qëllim për të mos u djegur*”, rekomandim ky që konsiderohet i gabuar, pasi nxit dëshirën e subjektit për të kryer shpenzime pa efektivitet dhe të panevojshme.

b) MPPT, në dosjet e auditimeve të shqyrtuara (AQTN, Regjistri Detar Durrës, AAC, Instituti i Ndërtimit), nga drejtuesi i NJAB nuk ishte përcaktuar se kush do të bëjë rishikimin e cilësisë, pavarësisht se formulari i cilësisë është i plotësuar. Në disa raste ky formular është pa datë, apo pa emrin dhe firmën e personit që ka bërë rishikimin e cilësisë, në kundërshtim me kapitullin IV “Cilësia e kontrollit” (4.8.1) të manualit të AB.

c) Ministrinë e Drejtësisë, në dosjet e auditimeve nuk ndodhej i gjithë dokumentacioni i nevojshëm sipas përcaktimit në seksionin VII të MAB. Në disa raste, procesverbalet e mbajtura nuk janë hartuar në përputhje me formatin nr. 6 të Manualit. Po kështu, në rastet kur observacionet e subjektit të audituar nuk janë marrë në konsideratë, nga audituesit nuk janë dhënë shpjegime se përse nuk merren në konsideratë.

##### 5. Mbi rekomandimet e dhëna nga NJAB-të dhe zbatimi i tyre.

Objektivi strategjik i auditimit të brendshëm arrihet plotësisht jo vetëm me vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, por dhe me menaxhimin e riskut, *ku dhënia e rekomandimeve të zbatueshme, për t'i shtuar vlerë subjektit të audituar, është pjesa tjetër e rëndësishme e funksionit të auditimit të brendshëm.* Arritja e këtij objektivi përcaktohet, në një masë të madhe, nga cilësia e rekomandimeve dhe zbatueshmëria e tyre. Niveli i tyre, ka treguar përgjegjësinë e auditimit për të gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e menaxhimit të subjekteve publike mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatimi i rekomandimeve. Përgjegjësia e audituesve nuk kufizohet vetëm në dhënien e rekomandimeve, por dhe në ndjekjen e zbatimit të tyre, pasi rezultatet e punës audituese shprehen në fund të fundit në këtë tregues.

Në shumë raste *auditimi i brendshëm ka luajtur rol pasiv, duke u përqëndruar thjesht në dhënien e rekomandimeve, disa herë të paqarta dhe të paaplikueshme,* duke mos përmbushur objektivat e misioneve të kontrollit dhe duke mos përmirësuar veprimtarinë menaxhuese të njësisë qeverisëse.

Në materialet e NJAB-ve për vitin 2011, konstatohet se treguesi për rekomandimet ndonëse është pozitiv për numrin, llojet e tyre sipas problematikës së gjetjeve dhe pranimit të tyre nga subjektet e audituara; mbetet problem zbatueshmëria e tyre, që në tërësi rezulton në masën 63.2% të rekomandimeve të përgjithshme, ndërsa rekomandimet me prioritet të lartë edhe më pak 55.6%.

Numri i madh i rekomandimeve të dhëna nga AB, i referohet gjetjeve të konstatuara, duke pasur si objektiv përmirësimin e sistemeve përkatëse, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjidhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen.

Ndër rekomandimet më kryesore të bëra nga auditimi i brendshëm paraqesim: - përmirësimin e proceseve të implementimit të politikave, kuadrit ligjor dhe procedural të brendshëm e të jashtëm që drejton veprimtarinë e subjekteve

publike, më qëllim vendosjen e procedurave dhe rregullave të qarta për parandalimin e fenomeneve negative dhe ndarjen e detyrave sipas funksioneve dhe roleve të çdo nëpunësi; përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, me eficiencë dhe me ekonomi i fondeve publike; zhvillimin profesional të punonjësve në subjektet publike dhe sidomos stafit që punon në strukturat e menaxhimit financiar; si dhe ngritjen dhe zhvillimin profesional të kapaciteteve audituese.

Për vitin 2011, planifikimi dhe më pas kryerja e angazhimeve për të verifikuar ndjekjen e rekomandimeve ka ndikuar ndjeshëm për të siguruar informacionin mbi vazhdueshmërinë dhe vlerën e auditimeve. Për më tepër, praktika të tilla i kanë shërbyer punës së audituesve si një matës i performancës së veprimtarisë audituese. Ndonëse, duhet përmendur se, nga auditimi i materialeve të NJAB-ve për punën e tyre rezulton se, niveli i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve mbetet problem dhe lidhet me rritjen e cilësisë së punës së vetë audituesve.

Nga auditimet e KLSH, ka rezultuar se në përgjithësi NJBA-të kanë ndjekur në vazhdimësi zbatimin e rekomandimeve të lëna, si gjatë kryerjes së auditimit duke përcaktuar pikë të veçantë në programet e auditimit, por edhe me programe të veçantë për verifikimin e tyre. Gjithashtu, në shumicën e rasteve subjektet e audituar kanë raportuar për zbatimin e rekomandimeve brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e Raportit Final të auditimit.

Por në institucione të veçanta, NJAB nuk kanë bërë verifikimin e rekomandimeve të lëna në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik e përkatësisht në:

- *MPPT*, për gjashtëmujorin e I-re të vitit 2011, nuk është kryer asnjë auditim me program të veçantë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara; gjithashtu në *Ministrinë e Drejtësisë* dhe *ISSH Tiranë*, për vitin 2011, nuk është kryer asnjë auditim me program të veçantë për zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara, po kështu dhe në *ISSH Tiranë*.

Po kështu, në nivel vendor, nga pjesa dërmuese e bashkive të audituara, nuk kanë kryer auditime tematike të veçanta për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, duke e argumentuar me faktin se verifikimi i rekomandimeve është pike e veçantë në auditimet e radhës.

#### **6. Respektimi i afateve ligjore të raportimit. Shqyrtimi dhe evadimi i zbulimeve të auditimit në përputhje me standardet e auditimit.**

Përgjithësisht SAB-të kanë mbajtur dhe plotësuar evidencat e zbulimeve për të gjitha rezultatet e auditimeve të kryera duke pasqyruar drejt zbulimet me dëm ekonomik, zbulimet pa dëm ekonomik, masat organizative, disiplinore e administrative.

Këto rezultate të zbulimeve janë raportuar në NJQH/AB, sipas afateve të përcaktuara. Megjithatë, në subjekte të veçantë u konstatuan dhe parregullsi, e konkretisht në:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit*, nga shqyrtimi i evidencave të raportimit të 3/mujorit të I-rë 2011, në pasqyrën nr. 2, "Realizimi i Programit nga Njësia e Auditimit" nga mbledhja e të dhënave rezulton se janë raportuar 6 auditime të planifikuara, nga të cilat 4 auditime të plota dhe 2 auditime financiare; ndërkohë që sipas programit të miratuar plani ishte 11 auditime, nga të cilat 4 të

plota dhe 7 të pjesshme, respektivisht 3 përputhshmërie, 2 performance dhe 2 të pjesshme financiare.

b) Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektoratit Shtetëror të Punës, nga 6 misione auditimi të kryera në gjashtëmuorin e I-rë të vitit 2011, janë dërguar përfundimet e misioneve brenda afateve procedurale të përcaktuar vetëm për 2 objekte.

c) Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në 4 dosje të auditimeve të përfitimeve, ka rezultuar se kanë përfituar në mënyrë të paligjshme në kundërshtim me dispozitat ligjore pension pleqërie 75 persona, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në shumën 88,777 mijë lekë. Nga auditimi i KLSH rezultoi se, ndonëse dosjet e auditimit janë evaduar që në shtator 2011, akoma nuk ishin nxjerrë urdhërat e pezullimit të përfitimit për 41 persona që kanë përfituar padrejtësisht 52,532 mijë lekë.

o Përsa i përket, shqyrtimit dhe evadimit të zbulimeve të auditimit *në nivel vendor*, theksojmë se, parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara në auditimet e kryera nga strukturat e auditimit për vitin 2011, janë minimale dhe përmbledhen në disa masa organizative, vetëm 2 masa disiplinore dhe në një numër të vogël të gjetjeve me efekte financiare në vlera të pakta. Më konkretisht, në njësitë e audituara nga KLSH, vlera e zbulimeve i përket 4 bashkive dhe Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë, me një vlerë totale prej 1,986 mijë lekë; përkatësisht:  
- Bashkia Berat 190 mijë lekë; Elbasan 441 mijë lekë; Ura Vajgurore 180 mijë lekë; Rrëshen 272 mijë lekë; dhe Prefektura Tiranë 903 mijë lekë.

#### 7. Mbi rregullshmërinë e mbikëqyrjes për vlerësimin e strukturave të auditimit të brendshëm.

Bazuar në germën “e”, të nenit 16, të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe në planin vjetor 2011, NJQH/AB nëpërmjet Drejtorisë së Metodologjisë, Monitorimit dhe Vlerësimit të Cilësisë ka bërë vlerësimin e strukturave të auditimit të brendshëm, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin publik.

Nga verifikimi dhe analiza e dokumentacionit që dispononte DMMVC dhe e disa dosjeve të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme, rezultoi se:

o Për vitin 2011, NJQH/AB ka bërë vlerësimin e veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik, duke vlerësuar 22 njësi audituese të mbikëqyrtur dhe monitoruar 154 raporte final dhe memorandumet e dërguar nga NJAB-të. Ky vlerësim është realizuar nga DMMVC, në bazë të programeve të auditimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Nga 30 misione të planifikuara për vlerësimin e cilësisë në strukturat e AB, janë realizuar gjithsej 22, ose 8 misione me pak, rrjedhojë e pakësimit të numrit të punonjësve nga 22 punonjës që kishte, në 15 në kohën e kryerjes së auditimit vlerësues nga KLSH.

o Në mbështetje të manualit të auditimit të brendshëm, NJAB-të kanë filluar të hartojnë manualët e tyre specifike, pasi Manuali për AB, luan rolin e standardit kombëtar për zhvillimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe ka karakter rekomandues për strukturat audituese. Në këtë drejtim, NJAH/AB ka dhënë kontributin e saj dhe se, deri tani kjo Drejtori ka bërë komente dhe ka dhënë sygjerime lidhur me hartimin e metodikave specifike në 35 njësi auditimi të brendshëm.

o Nga mbikëqyrja për vlerësimin e strukturave të auditimit të brendshëm, krahas arritjeve në përmirësimin e kuadrit ligjor, të procedurave të auditimit, apo

të punës audituese në këto struktura, janë vërejtur dhe disa mangësi të sistemit të auditimit të brendshëm, ku ndër të cilat përmendim:

1. Në të gjitha njësitë e mbikëqyrura, auditimet e kryera me urdhër të menaxhimit, duke u shmangur nga planet vjetore, kanë rritur ndjeshëm riskun e prekjës së pavarësisë funksionale të njërive audituese, *që shprehet pikërisht në hartimin e pavaruar të planeve të auditimit dhe në gjykimin mbi bazë risku të subjekteve.*
2. Ka njësi audituese që, në programin e tyre të punës nuk përfshihet auditimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, siç është rasti i trajtimit në Raportin Final të NJAH/AB-së, për Institucionin e Prefektit të Qarkut të Korçës, ku NJAB e këtij institucioni në programet e punës për subjektet e audituara nga kjo njësi, nuk kishte përfshirë auditimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm.
3. Raportet Finale shpesh herë janë të njëjtë me projekraportet dhe cilësia e materialeve nuk vlerësohet kënaqshëm. Projekraportet nuk i përmbahen plotësisht programeve të auditimit dhe për pasojë nuk janë të plota dhe pothuajse nuk pasqyrojnë performancën e subjektit.
4. Nga auditimet dhe nga Raportet Finale të monitoruara nga NJAH/AB, rezulton se, në të gjitha NJAB-të, ka raste që rekomandimet e dhëna nuk përputhen me gjetjet dhe nuk marrin parasysh prioritetet. Audituesit thjesht konstatojnë dhe nuk japin rekomandime për përmirësimin e sistemeve. Trajtimi jo i drejtë i gjetjeve, apo observacioneve të dërguara nga subjekti, ka sjellë dhënien e rekomandimeve të pasakta e për pasojë të pazbatueshme, gjë e cila ka pasur ndikim negativ në cilësinë dhe produktin e auditimit.
5. Faktorë të tjerë që kanë ndikuar negativisht në funksionimin e auditimit të brendshëm ka qenë dhe rekrutimi i auditueseve të brendshëm, të cilët nuk plotësojnë kërkesat dhe kriteret e punësimit në njësitë audituese. Gjithashtu, ndikim negativ ka sjellë dhe mungesa e kapaciteteve njerëzore, eksperiencia në punë dhe lëvizjet e shpeshta të punonjësve të auditit.
6. Ndonëse, në planin strategjik 2011-2014, sistemi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit është vlerësuar me risk të lartë, auditimi i këtij sistemi është ende larg, pra i parealizuar, pasi ka mungesë të theksuar të njohurive, apo të kapaciteteve për kryerjen e auditimeve të tilla.

### III. MARRËDHËNIET E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KLSH DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Standardi Ndërkombëtar i Institucioneve Supreme të Auditimit, **ISSAI 9150 – “Bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet audituesve të SAI-ve dhe audituesve të brendshëm në sektorin publik”**, udhëzon se si të arrihet bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet SAI-ve dhe Audituesve të Brendshëm në sektorin publik, duke respektuar funksionet dalluese dhe kërkesat profesionale të të dy palëve.

Megjithëse, Audituesit e SAI-ve dhe Audituesit e Brendshëm kanë role të diferencuara dhe qartësisht të përcaktuara, qëllimi i përbashkët i tyre është për të nxitur qeverisjen e mirë, nëpërmjet kontributeve për transparencë në përgjegjshmërinë për përdorimin e burimeve publike, gjithashtu për të nxitur administrimin publik eficient, efektiv dhe me ekonomikitet.

Nëpërmjet bashkërendimit dhe bashkëpunimit, SAI dhe Audituesi i Brendshëm, përmirësojnë eficiencën dhe efektivitetin e punës të të dy palëve.

*SAI-t kanë përgjegjësinë shtesë të vlerësimit të efektivitetit të funksionit të auditimit të brendshëm.* Nëse funksioni i auditimit të brendshëm gjykohet se është efektiv, pikërisht nga bashkëpunimi ndërmjet SAI dhe Audituesit të Brendshëm do të përfitojnë të dyja palët (ISSAI 1/3 dhe 16).

Në sektorin publik, SAI-t dhe Audituesit e Brendshëm mund të bashkëpunojnë në *mënyra të shumëllojshme*. Një bashkëpunim i tillë mund të maksimizojë përfitimet e siguruara prej punës së përbashkët në fushat ku ka një mbulim pjesërisht të njëra tjetrës (përputhje pjesërisht) në objektin e punës që kryhet nga SAI-t dhe Audituesit e Brendshëm.

Përsa konstatohet auditimi i brendshëm dhe jashtëm kanë role të ndryshme, por kjo nuk pengon që KLSH dhe auditimi i brendshëm të bashkëpunojnë dhe të bashkërendojnë punët për të siguruar arritjen e objektivave të programuara nga secila palë në interes të miradminstrimit të fondeve publike dhe mbrojtjes së pronës publike dhe shtetërore.

Drejtimit dhe fushat e bashkëpunimit ndërmjet KLSH dhe auditimit të brendshëm, janë:

- Fuqizimi i mundësisë (aftësive) të ndërsjellta për të nxitur qeverisjen e mirë dhe praktikën e përgjegjësisë, si dhe rritjen e menaxhimit, duke *mirëkuptuar rëndësinë e kontrollit të brendshëm, auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm.*
- Shtrirja e bashkërendimit dhe bashkëpunimit *gjatë gjithë fazave të procesit të auditimit*, përfshirë ndjekjen e zbatimit të gjetjeve të auditimit dhe rekomandimeve.

KLSH dhe audituesit e brendshëm mund të ndjekin *zbatimin dhe plotësimin e rekomandimeve të auditimit të njëri tjetrit*, si një mjet i bashkëpunimit me proceset e auditimit që mund të rrisë efektivitetin e shërbimeve të auditimit.

- *Mënyrimi i mbivendosjeve apo dublimet* e veprimtarisë audituese ndërmjet KLSH dhe auditimit të brendshëm.

- Përdorimi i të *njëjtës terminologji për auditimin*, duke respektuar specifikat e njëri tjetrit.

- Hartimi dhe *përdorimi i metodologjisë, teknikave dhe metodave të përbashkëta të auditimit*, për të lehtësuar mbështetjen në punën e njëri tjetrit.

- *Komunikimi i rregullt dhe i hapur* ndërmjet KLSH-së me NJQHAB dhe DIFP, thelbësore për suksesin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit. Audituesit duhet të krijojnë mirëkuptim të përbashkët mbi kohën dhe natyrën e komunikimeve të tilla.

- *Kryerja sistematikisht dhe në kohë e shkëmbimit të informacioneve* lidhur me veprimtarinë e planifikimit e të raportimit të dy palëve, duke bërë të mundur rakordimin dhe koordinimin e auditimeve që në fazën e programimit.

Krahas shkëmbimit të programeve të planifikimit të auditimeve dhe strategjisë së zhvillimit, komunikimi duhet të përfshijë *shkëmbimin e raporteve të auditimit dhe materiale të ndryshme të auditimit.*

- Në disa rrethana, mundësi hyrjeje (akses) te programet e auditimit të njëri tjetrit dhe në dokumentacionin e auditimit, duke siguruar ndërkohë maturinë e mjaftueshme dhe klauzolat e besimit.

- *Takime të rregullta* ndërmjet audituesve dhe stafit drejtues të auditimit të KLSH dhe audituesve bashkë me stafin drejtues të NJQHAB dhe DIFP, *për shkëmbimin e ideve, njohurive dhe përvojave të ndërsjellta.*

○ *Kryerja e misioneve të përbashkëta* me pjesëmarrjen e audituesve të jashtëm dhe të brendshëm, duke bashkëpunuar në të njëjtat angazhime dhe duke përfituar nga aspektet pozitive të njëri tjetrit.

○ *Kryerja e trajnimeve të përbashkëta mbi tema të interesit të përbashkët*, të cilat t'i shërbejnë punës së audituesve të jashtëm e të brendshëm, gjithashtu, rritjes dhe zhvillimit të profesionalizmit të tyre.

➤ Vlerësimi i punës së auditimit të brendshëm nga KLSH me synim *që KLSH të krijojë nivelin e besueshmërisë mbi punën e auditimit të brendshëm dhe mbi këtë bazë të përcaktojë se deri në çfarë mase duhet të mbështeten në punën e auditimit brendshëm.*

Pra, mbështetja realisht në punën e auditimit të brendshëm, për fusha apo subjekte të cilët janë audituar më parë prej auditimit të brendshëm, duke bërë të mundur që audituesit e KLSH të kenë më shumë kohë dhe kapacitete audituese në dispozicion, për t'i përdorur apo përqëndruar në fusha të cilat nuk janë mbuluar më parë nga auditimi i brendshëm, në mënyrë të veçantë për kryerjen e auditimeve të performancës.

Vlen të cilësohet se, pavarësia dhe objektiviteti i audituesit të brendshëm janë faktorë të rëndësishëm për KLSH-në, pasi dihet se shërbimet e auditimit të brendshëm janë të varura nga drejtuesi i njësisë brenda të cilit ato janë krijuar.

Audituesit e KLSH, duhet të jenë të kujdesshëm dhe objektiv kur vlerësojmë dhe vendosim se cilësia e punës së auditimit të brendshëm në subjektin ku janë për auditim, duhet marrë në konsideratë. Në këto raste, audituesit e KLSH duhet të vlerësojnë:

a) Pavarësinë e veprimtarisë së audituesve të brendshëm;

b) Objektivitetin, kompetencën profesionale dhe teknike të tyre;

c) Kujdesin e duhur profesional të duhur, përfundimet e auditimit janë bazuar në objektivat e auditimit, qëllimin e tij, metodologjinë e pranuar të auditimit dhe në të dhënat e mjaftueshme të auditimit; dhe

d) Ndikimin e ndonjë detyrimi apo kufizimi të vendosur mbi ta nga ndonjë drejtues, subjekt auditimi apo individ.

Përsa më sipër, *audituesit e KLSH, dokumentojnë shkresërisht vlerësimin për përdorimin e punës së audituesve të brendshëm, si dokument provë që mbështet procedurat e auditimit të tyre.*

□ Bashkëpunimi dhe bashkërendimi zyrtar ndërmjet KLSH-së dhe MF është organizuar *nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit*. Më konkretisht, në 8 maj 2012, ndërmjet KLSH dhe MF, është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi e nënshkruar nga Kryetari i KLSH Bujar Leskaj dhe Ministri Financave z. Ridvan Bode. Marrëveshja me nr. 191/5 Prot. të KLSH dhe nr. 7307 Prot. të Ministrisë së Financave, datë 08.05.2012. Nëpërmjet kësaj marrëveshje synohet arritja e një bashkëpunimi të frutshëm ndërmjet KLSH dhe MF, respektivisht me strukturat e Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik.

Kjo marrëveshje është dëshmi e vendosjes në mënyrë institucionale, për herë të parë të marrëdhënieve të ndërsjellta të bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet auditimit të jashtëm dhe auditimit të brendshëm.

□ Në zbatim të nenit 5 të kësaj marrëveshjeje “Kordinimi ndërmjet palëve”, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet ka filluar nga funksionimi Sekretariati i përbërë një Drejtor i Përgjithshëm në KLSH dhe drejtuesit e



NJQH/AB dhe DIFP, Sekretariat i cili ka prodhuar raportin e parë për pasqyrimin dhe analizimin e nivelit të deritanishëm të marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet të dy institucioneve dhe përcaktimin e drejtimeve të punës për intensifikimin e tyre në të ardhmen. Ndër to veçojmë:

1. Për planifikimin e auditimit dhe të strategjisë së auditimit për vitin 2013, organizimi gjatë muajve nëntor-dhjetor 2012 i takimeve të përbashkëta konsultimi me pjesmarrjen e specialistëve të ngarkuar me këtë detyrë dhe atyre më të mirë të KLSH dhe MF, kryesisht të MJQH/AB dhe IFP.
2. Organizimi i kurseve të trajnimit të përbashkëta, gjë e cila tashmë ka filluar nga implementimi që në muajin muajin qershor 2012, madje dhe nën monitorimin e SIGMA.
3. Organizimi i një veprimtarie të përbashkët; lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e njëri tjetrit konformë standardeve të auditimit, për shkëmbimin e njohurive e të eksperiencave, si dhe investigimin e mashtrimit dhe korrupsionit, brënda 3/mujorit të katërt 2012.
4. Shqyrtimi i mundësive që gjatë vitit 2013, të kryhen auditime pilot me pjesmarrjen e audituesve nga KLSH dhe strukturat e auditimit të brendshëm, sipas tematikave të rëna dakord paraprakisht.

*Për zbatimin e këtyre detyrave dhe të tjera, Kryetari i KLSH ka nxjerrë urdhërin e brendshëm nr. 74, datë 9/7/2012, në të cilin për ndjekjen e zbatimit të çdo detyre, ka përcaktuar departamentin dhe drejtorinë përkatëse përgjegjëse, si dhe afatin e zbatimit të tyre.*

#### **IV. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DËRGUARA NGA KLSH.**

Rekomandimet për auditimin e mbikëqyrjes të ushtruar gjatë vitit të kaluar i janë dërguar NJQH/AB-së nga KLSH me shkresën nr. 249/6, datë 9/9/2011. Në zbatim të programit të kontrollit të Kryetarit të KLSH me nr. 285/31, datë 26/10/2011, audituesit e KLSH kanë kryer verifikimin të terren të zbatimit të tyre.

Për këtë qëllim, është mbajtur akt-verifikimi i datës 14/12/2011, sipas të cilit: *nga 12 masa organizative rekomanduara gjithsej nga KLSH, 4 janë zbatuar, 7 janë në proces zbatimi dhe 1 nuk ka gjetur zbatim.*

Disa nga masat e rekomanduara, përgjigjet e subjektit të audituar dhe problematika e konstatuar dhe evidentuar në Akt-verifikim, si dhe rekomandimet e dërguara për auditimin e buxhetit të vitit 2011 me shkresën nr. 389/6, datë 6/9/2012, paraqiten si më poshtë vijon:

<i><b>Teksti i Rekomandimit</b></i>	<i><b>Veprimet e ndërmara nga strukturat respektive</b></i>
<i><u><b>I. Rekomandimet e përgatitura dhe të adresuara NJQH/AB nga KLSH në përfundim të auditimit të ushtruar në vitin 2011 në të, për vlerësimin e veprimtarisë tij në kuadër të raportimit për zbatimin e buxhetit të vitit 2010.</b></u> <u><b>Rekomandimi nr. 1</b></u></i>	<i><u><b>I. Përgjigjet lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH dhe aktverifikimi datë 14/12/2011 për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të bëra NJQH/AB në kuadër të zbatimit të buxhetit të vitit 2010.</b></u> <u><b>Për rekomandimin nr. 1</b></u></i>

<p>Të ndiqet ecuria e rekomandimeve që janë në proces zbatimi, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 250 /5, datë 06/9/2010, deri në zbatimin e plotë të tyre. Vazhdimisht</p>	<p>NJQH/AB ka ndërmarrë hapa konkretë në zbatim të të gjitha rekomandimeve të dhëna, duke kërkuar pranë subjekteve të audituar ndjekjen e zbatimit të tyre për të raportuar. Ndaj rekomandimi konsiderohet <u>i zbatuar</u>.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 2</u> Të ndërhyhet nga NJQH/AB për të shndërruar në struktura të auditimit të brendshëm ato njësi që nuk janë organizuar në pajtueshmëri të plotë më kuadrin ligjor e procedural të auditimit të brendshëm publik, pasi ruajnë ende emërtimin dhe vepronë si struktura të kontroll-revizionit dhe ushtrojnë funksionin e inspektimit financiar, si në Bashkitë Sukth, Ersekë, Kuçovë e Bilisht. Brenda datës 04.07.2012</p>	<p><u>Për rekomandimin nr. 2</u> Është miratuar dhe shpallur në fletoren zyrtare Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 211, datë 30/3/2012 “Për kriteret e ngritjes së njërive të auditimit të brendshëm në subjektet publike”. Hyrja në fuqi dhe zbatimi i këtij Vendimi do të disiplinojë krijimin e NJAB-ve në subjektet publike të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM. Ky rekomandim konsiderohet <u>i zbatuar</u>.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 3</u> Të miratohet rregullorja e funksionimit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm nga Ministri i Financave, rekomandim i përsëritur nga KLSH i cili duhet të realizohet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, krahas miratimit të kalendarit vjetor të veprimtarive të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të punohet për realizimin e tij. Brenda muajit nëntor 2011.</p>	<p><u>Për rekomandimin nr. 3</u> Ministri i Financave ka miratuar Rregulloren e funksionimit të Komitetit të AB me nr. 24270, datë 29.12.2011 “Për veprimtarinë e Komitetit të Auditimit të Brendshëm” Ky rekomandimi vlerësohet <u>i zbatuar</u>.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 4</u> Të shqyrtohen të gjithë rastet e punësimit në njësitë e auditimit të personave që kanë më pak se 5 vjet përvojë pune në fushën e auditimit ose në fusha, si financa, kontabiliteti apo fusha të tjera të lidhura, ashtu siç përcaktohet në pikën 2/“a” të nenit 19 të ligjit nr. 9720 i ndryshuar, dhe të koordinohen përpjekjet nga Ministria e Financave për largimin e tyre nga strukturat e auditimit. Brenda muajit dhjetor 2011.</p>	<p><u>Për rekomandimin nr. 4</u> Drejtoria e Metodologjisë, Monitorimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, në auditimet e kryera në NJAB ka identifikuar rastet e rekrutimit të audituesve të brendshëm të cilët nuk plotësojnë kriteret e përcaktuar në LAB. Në çdo rast janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat duhet të zbatohen nga Titullarët e subjekteve publike. Në Raportin Vjetor të veprimtarisë audituese për vitin 2011, NJQH/AB ka konstatuar se një nga dobësitë e sistemit është rekrutimi i stafit pa përmbushur kriteret e LAB. Rekomandimi konsiderohet në <u>process zbatimi</u>.</p>

<p><u>Rekomandimi nr. 5</u> Të intensifikohen përpjekjet nga Ministria e Financave për largimin nga strukturat e auditimit dhe për të mos lejuar rekrutimin në këtë funksion të gjithë atyre personave që nuk janë certifikuar e titulluar “auditues të brendshëm” nga Komisioni Shtetëror i Kualifikimit dhe Ministri i Financave, sipas detyrimeve të nenit 19 /3 të ligjit nr. 9270, datë 23/4/2007. Brenda muajit dhjetor 2011.</p>	<p><u>Për rekomandimin nr. 5</u> NQH/AB me shkresën nr. 15209, date 28/7/2011 me subjekt “Mbi zbatimin e ligjit nr. 9720, datë 23/4/2007, i ndryshuar“, u ka kërkuar gjithë ministrive dhe institucioneve qëndrore respektimin i kritereve të punësimit për përzgjedhjen dhe rekrutimin e audituesve të brendshëm publikë. Ndjekja e rekonadimit po realizohet nëpërmjet auditimeve të vlerësimit të cilësisë në NJAB dhe Raporteve të Konsoliduara periodike dhe vjetore. Ky rekomandimi ka <u>filluar nga zbatimi dhe vijon të zbatohet.</u></p>
<p><u>Rekomandimi nr. 6</u> Të ndërtohet një kalendar veprimi me afate konkrete për sistemin e edukimit të përditësuar, trajnimin e vijueshëm e të detyrueshëm dhe procedurat e punësimit të audituesve, veçanërisht azhornimin me manualin e ri të punës të audituesve publik, veçoritë e ndryshimeve të ligjit bazë, standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale etj.</p>	<p><u>Për rekomandimin nr. 6</u> Në periudhën nëntor-dhjetor 2011 është realizuar “Programi i trajnimit të vijueshëm të detyrueshëm për audituesit publikë”. Trajnimi u organizua në 6 tema për 5 grupe, në përfundim të të cilit u trajnuan 146 persona. Programi i trajnimit është parashikuar të kryhet përsëri gjatë vitit 2012, me qëllim që të gjithë audituesit në funksion të kenë marrë orët e mjaftueshme për trajnimin e vijueshëm të tyre me njohuri bashkëkohore dhe të përditësuar. Ky rekomandimi rezultoi <u>i zbatuar.</u></p>
<p><u>II. Disa nga rekomandimet e përgatitura dhe të adresuara NJQH/AB-së nga KLSH në përfundim të auditimit të ushtruar në vitin 2012 në këtë subjekt, për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tij në vitin buxhetor 2011.</u></p>	<p><u>II. Përgjigjet e dhëna nga Ministria e Financave me shkresën nr. 4637/17, datë 14/9/2012, lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH për mbikëqyrjen e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në NJQH/AB. Jepen pa koment.</u></p>
<p><u>Rekomandimi nr. 1</u> Bazuar në germen “e” të nenit 16, të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e strukturave audituese në përputhje me standartet dhe kërkesat e manualit, KLSH ka rekomanduar që, NJQH/AB, si</p>	<p><u>Për rekomandimin nr. 1</u> Në lidhje me hartimin e metodikës për kontrollin e jashtëm të cilësisë dhe vlerësimin e njësive të auditimit të brendshëm shprehemi se duke vlerësuar rëndësinë dhe dobinë e këtij rekomandimi, Ju bëjmë me dije se që nga muaji shkurt 2012, NJQH/AB ka filluar të punojë për hartimin e “Metodologjisë</p>

<p>strukturë që mbikëqyr dhe monitoron veprimtarinë e strukturave audituese, për të siguruar zbatimin e standarteve dhe cilësinë e punës audituese, të hartojë një metodikë për kontrollin e jashtëm të cilësisë dhe vlerësimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik.</p> <p>Për vitin në vijim nëse MF e gjykon të nevojshme, KLSH është gati të bashkëpunojë në këtë fushë me ekipe të përbashkëta, në zbatim të marrëveshjes së përbashkët.</p> <p>Deri më 31/12/2012.</p>	<p>së Sigurimit të Cilësisë”, veprimtari kjo që mbështetet nga ekspertë të Projektit që SIGMA po zbaton në NJQH/AB. Në vijim të kësaj veprimtarie, me urdhër të Ministrit të Financave është ngritur një Grup Pune me specialistë të fushës së auditimit të brendshëm nga MF dhe ministri të linjës, i cili do të funksionojë deri në <u>hartimin dhe miratimin e metodologjisë nga Ministri i Financave.</u></p>
<p><u>Rekomandimi nr. 2</u></p> <p>Nisur nga fakti se, sistemi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit vlerësohet si sestetem me risk të lartë dhe se, auditimi i këtij sistemi është ende larg zbatimit të tij, pasi ka mungesë të theksuar të njohurive, apo të kapaciteve për kryerjen e auditimeve të IT, KLSH ka rekomanduar që, në të ardhmen Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me njësitet audituese të subjekteve publike, të plotësojnë nevojat për trajnime në këtë fushë. Vazhdimisht.</p>	<p><u>Për rekomandimin nr. 2 dhe 3</u></p> <p>Në lidhje me rekomandimin mbi auditimet e sistemit të teknologjisë së informacionit, si dhe përfshirjen në programet e audituesve, të auditimit të funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm (rekomandimi 2&amp;3) shpjegojmë se Drejtoria e Zhvillimit Profesional dhe Analizës është duke përgatitur Strategjinë e Trajnimit për Audituesit e Brendshëm, e cila përfshin propozime për ndryshime thelbësore jo vetëm në formën por dhe në përmbajtjen e Programit të Trajnimit. Zbatimi i Programit të ri të Trajnimit parashikon përfshirjen ndërmjet të tjerave dhe tenmatike të veçanta që lidhen me auditimet e teknologjisë së informacionit.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 3</u></p> <p>Ka njësi audituese që, në programin e tyre të punës nuk përfshihet auditimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, siç është rasti i trajtimit në Raportin Final të NJQH/AB, për Institucionin e Prefektit të Qarkut të Korçës, ku njësia audituese e këtij institucioni në programet e punës për subjektet e audituara nga kjo njësi, nuk ka përfshirë auditimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm. Për këtë KLSH ka rekomanduar që, NJQH/AB të marrë masa dhe t’u tërheqë vëmendjen, njësive audituese që në programin e tyre të auditimit, të përfshijnë dhe</p>	<p>Në vijim, tema që kanë të bëjnë me konceptin dhe komponentin e Kontrollit të Brendshëm kanë qenë dhe do të jenë në fokus të trajnimeve jo vetëm për certifikimin, por edhe në trajnimin e vijueshëm të detyrueshëm. Duke konsideruar rëndësinë e kontrollit të brendshëm për veprimtarinë dhe arritjen e objektivave të subjekteve publike, temave që kanë lidhje me këtë subject do t’i kushtohet më shumë vëmendje, kohë dhe ekspertizë e duhur.</p> <p><i>Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të jetë në fokus të veprimtarisë vlerësuese</i></p>

<p>auditimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm Vazhdimisht.</p>	<p><i>që NJQH/AB kryen në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, duke e përfshirë këtë element si një nga pikat kryesore të programit të auditimit.</i></p>
<p><u><i>Rekomandimi nr. 4</i></u>          Nga auditimi i materialeve, mbi raportimet e subjekteve për auditimet e vitit 2011, rezulton se, megjithë përmirësimet në zbatimin e rekomandimeve të lëna, akoma niveli i tyre është 63.2%, një pjesë e të cilave nuk zbatohen pasi, nuk janë bindëse për menaxherin.          Për këtë, KLSH ka rekomanduar që: NJQH/AB të intensifikojë punën nëpërmjet edukimit profesional të përditësuar me audituesit, duke u fokusuar dhe organizuar trajnime në praktikë për zbatimin e praktikave më të mira të standardeve ndërkombëtare të auditimit, për një vlerësim më të saktë të gjetjeve, me synim ndërgjegjësimin e strukturave menaxheriale përgjegjëse. Vazhdimisht.</p>	<p><u><i>Për rekomandimin nr. 4</i></u>          Programi i Trajnimit të Vijueshëm të Detyrueshëm për audituesit e brendshëm i propozuar, përfshin tema të zbatimit praktik të veprimtarisë audituese në çdo fazë. Në mënyrë specifike trajnimet që do të zhvillohen në kuadër të trajnimit të vijueshëm të detyrueshëm do të jenë të fokusuar në pjesën më të madhe në raste të zbatueshmërisë praktike të standardeve apo metodave të ofruara në Manual dhe kuadrin e përgjithshëm ligjor dhe rregullator të auditimit të brendshëm. Nga ana tjetër, <i>sjellim në vemendjen tuaj se, pjesa tjetër e rekomandimeve jashtë nivelit 63.2% të zbatueshmërisë së rekomandimeve të pranuar nga ana e subjekteve të audituar i përket rekomandimeve të pranuar, por janë ende në zbatim. Në vijim trajnime të veçanta do të intensifikohen në drejtim të trajnimit të menaxherëve publik lidhur me ndërgjegjësimin e tyre për rolin dhe funksionin e auditimit të brendshëm, si dhe rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe arritjen e objektivave.</i></p>



**LISTA E SUBJEKTEVE TË AUDITUAR PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2011**

1. Administrata e Presidencës.
2. Aparati i Këshillit të Ministrave.
3. Ministria e Financave
4. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës
5. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës (për koncensionet).
6. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
7. Ministria e Drejtësisë.
8. Ministria e Arsimit dhe Shkencës
9. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
10. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
11. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
12. Banka e Shqipërisë.
13. Shërbimi Informativ Shtetëror.
14. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
15. Instituti i Sigurimeve Shoqërore
16. Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor
17. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
18. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
19. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
20. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
21. Instituti i Monumenteve të Kulturës
22. Autoriteti Rrugor Shqiptar
23. Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës.
24. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.
25. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës – Kanalizimeve.
26. Drejtoria e Përgjithshme e Shfrytëzimit të Transportit Rrugor.
27. Qendra e Publikimeve Zyrtare.
28. Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
29. Agjencia Telegrafike Shqipëtare
30. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.
31. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Tiranë.
32. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë.
33. Drejtoria Rajonale Arsimore, Shkodër
34. Dega e Doganës Tiranë
35. Dega e Doganës Berat
36. Dega e Doganës Fier
37. Dega e Doganës Bllatë
38. Dega e Doganës Rinas
39. Projekti “Rehabilitimi i rrugës Shkodër-Hani i Hotit”
40. Projekti “Spitali Universitar Nënë Tereza Tiranë”
41. Projekti “Ndërtimi i Banesave Sociale”
42. Projekti “Ndërtimi i linjës 400 kv Tiranë-Podgoricë”

43. Projekti “Furnizimi me ujë dhe sanitetet në qytetin e Korçës”
44. Projekti “Ndërtimi i rrugës Levan-Tepelenë”
45. Bashkia Berat
46. Bashkia Elbasan
47. Bashkia Shkodër
48. Bashkia Lezhë
49. Bashkia Peshkopi
50. Bashkia Ura Vajgurore
51. Bashkia Rrëshen
52. Bashkia Delvinë
53. Bashkia Tepelenë
54. Bashkia Përrenjas
55. Bashkia Laç
56. Bashkia Vorë
57. Bashkia Cërrik
58. Bashkia Peqin
59. Bashkia Bajram Curri
60. Bashkia Rubik
61. Bashkia Maliq
62. Bashkia Shijak
63. Bashkia Poliçan
64. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë
65. Komuna Farkë Tiranë
66. Komuna Petrelë Tiranë
67. Komuna Gjepalaj Durrës
68. Komuna Kryevidh Kavajë
69. Komuna Golem Kavajë
70. Komuna Bradashesh Elbasan
71. Komuna Dajç Shkodër
72. Komuna Bushat Shkodër
73. Komuna Milot
74. Komuna Kuman Fier
75. Komuna Markat Sarandë
76. Komuna Xarrë Sarandë
77. Komuna Karinë Peqin
78. Komuna Qukës Librazhd
79. Komuna Lenie Gramsh
80. Komuna Kukur Gramsh
81. ALUIZNI Qendër Tiranë
82. ALUIZNI Rajonal Tiranë
83. ALUIZNI Rajonal Durrës
84. ALUIZNI Rajonal Fier
85. ALUIZNI Rajonal Vlorë
86. ZVRPP Durrës
87. ZVRPP Shkodër



**Aneksi nr. 2**

**INVESTIMET ME FINANCIM TË BRENDSHËM**

*Në lekë*

<i>EMERTIMI I INSTITUCIONIT</i>	<i>PLAN</i>	<i>FAKT</i>	<i>DIFERENCA</i>	<i>Në %</i>
1. Presidenca	15,000,000.00	14,988,023.00	11,977.00	99.92
2. Kuvendi Popullor	423,400,000.00	19,659,546.00	403,740,454.00	4.64
3. Këshilli i Ministrave	25,000,000.00	24,582,807.00	417,193.00	98.33
4. METE	408,400,000.00	372,560,843.00	35,839,157.00	91.22
5. MBUMK	2,199,500,000.00	1,902,883,687.00	296,616,313.00	86.51
6. MPPT	24,128,213,000.00	23,539,292,242.88	588,920,757.12	97.56
7. Ministria e Financave	580,016,000.00	292,160,123.00	287,855,877.00	50.37
8. MASH	3,785,770,000.00	3,839,776,984.77	-54,006,984.77	101.43
9. MTKRS	1,172,739,000.00	837,898,798.00	334,840,202.00	71.45
10. Ministria e Shëndetësisë	2,383,565,000.00	2,319,613,436.00	63,951,564.00	97.32
11. Ministria e Drejtësisë	414,000,000.00	333,765,606.00	80,234,394.00	80.62
12. MPJ	106,000,000.00	102,285,109.00	3,714,891.00	96.5
13. Ministria e Brendshme	1,287,555,700.00	1,316,190,755.00	-28,635,055.00	102.22
14. Ministria e Mbrojtjes	2,848,500,000.00	2,810,334,495.30	38,165,504.70	98.66
15. SHIK	97,500,000.00	98,612,838.00	-1,112,838.00	101.14
16. Drejt. Përg. Radio-Televizionit.	35,000,000.00	35,000,000.00	0	100.0
17. Drejtoria e Arkivit të Shtetit	7,000,000.00	6,705,500.00	294,500.00	95.79
18. Akademia e Shkencave	1,000,000.00	1,398,613.00	-398,613.00	139.86
19. KLSH	3,000,000.00	2,032,400.00	967,600.00	67.75
20. MPÇSSHB	145,000,000.00	131,214,845.00	13,785,155.00	90.49
21. MMPAU	332,000,000.00	197,626,355.37	134,373,644.63	59.53
22. Prokuroria e Përgjithshme	94,000,000.00	89,209,218.00	4,790,782.00	94.9
23. ZABGJ	165,000,000.00	159,654,976.00	5,345,024.00	96.76
25. Gjykata Kushtetuese	7,000,000.00	5,176,400.00	1,823,600.00	73.95
26. ATSH	2,500,000.00	3,146,097.00	-646,097.00	125.84
27. INSTAT	333,100,000.00	333,067,518.00	32,482.00	99.99
28. Shkolla e Magjistraturës	2,000,000.00	1,991,337.00	8,663.00	99.57
29. FZHS	1,802,000,000.00	1,801,939,063.00	60,937.00	100.0
30. QK e Kinematografisë	2,000,000.00	1,710,659.00	289,341.00	85.53
31. KLD	3,000,000.00	2,341,112.00	658,888.00	78.04
32. Avokati i Popullit	2,000,000.00	1,951,284.00	48,716.00	97.56
33. KSHC	1,500,000.00	1,227,523.00	272,477.00	81.83
34. KQZ	14,000,000.00	13,338,094.00	661,906.00	95.27
35. ILDKP	7,000,000.00	6,356,342.00	643,658.00	90.8
36. Autoriteti i Konkurrencës	4,000,000.00	2,735,060.00	1,264,940.00	68.38
37. Ministria e Integritit	33,600,000.00	26,724,820.56	6,875,179.44	79.54
38. Këshilli Kombëtar Kontabilitetit	1,000,000.00	110,000.00	890,000.00	11.0
39. Avokati i Prokurimeve	1,000,000.00	997,970.00	2,030.00	99.8
40. Institucione të tjera Qeveritare	491,177,000.00	429,705,179.00	61,471,821.00	87.48
41. Mbështetje për Shoqërinë Civile	2,000,000.00	1,595,516.00	404,484.00	79.78
42. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	4,000,000.00	3,950,096.00	49,904.00	98.75
43. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	4,500,000.00	4,468,960.00	31,040.00	99.31
44. Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	7,000,000.00	6,939,830.00	60,170.00	99.14
<b>TOTALI:</b>	<b>43,381,535,700.00</b>	<b>41,096,920,061.88</b>	<b>2,284,615,638.12</b>	<b>94.73</b>

Burimi : Ministria e Finances

**Aneksi nr. 3**

**INVESTIMET ME FINANCIM TË HUAJ**

*Në lekë*

<i>EMERTIMI I INSTITUCIONIT</i>	<i>PLAN</i>	<i>FAKT</i>	<i>DIFERENCA</i>	<i>Në %</i>
1. METE	800,000,000.00	976,483,248.80	-176,483,248.80	122.06
2. MBUMK	600,000,000.00	325,777,750.00	274,222,250.00	54.3
3. MPPT	17,617,056,000.00	16,400,754,636.58	1,216,301,363.42	93.1
4. Ministria e Financave	651,350,000.00	176,153,190.00	475,196,810.00	27.04
5. MASH	377,600,000.00	16,495,230.00	361,104,770.00	4.37
6. MTKRS	448,264,000.00	0	448,264,000.00	0.00
7. Ministria e Shëndetësisë	1,354,379,000.00	1,506,963,480.00	-152,584,480.00	111.27
8. Ministria e Drejtësisë	300,000,000.00	60,274,526.41	239,725,473.59	20.09
9. Ministria e Brendshme	549,471,000.00	846,901,187.00	-297,430,187.00	154.13
10. Ministria e Mbrojtjes	50,000,000.00	0	50,000,000.00	0.00
11. MPÇSSHB	0	75,450,910.00	-75,450,910.00	
12. MMPAU	320,000,000.00	578,027,449.00	-258,027,449.00	180.63
13. Prokuroria e Pergjithshme	400,000,000.00	0	400,000,000.00	0.00
14. INSTA	761,000,000.00	699,502,730.00	61,497,270.00	91.92
15. FZHSH	6,260,000,000.00	6,297,028,010.00	-37,028,010.00	100.59
16. Autoriteti Konkurrencës	100,000,000.00	0	100,000,000.00	0.00
17. Ministria e Integritit	167,000,000.00	21,719,010.00	145,280,990.00	13.01
18. Institucione të tjera	120,000,000.00	0	120,000,000.00	0.00
<b>TOTALI:</b>	<b>30,876,120,000.00</b>	<b>27,981,531,357.79</b>	<b>2,894,588,642.21</b>	<b>90.63</b>

*Shënim:* Për MASH si në kolonën plan dhe fakt, fondet për projektin “Cilësi dhe barazi në arsim” janë përfshirë në investimet e brendshme, transferim ky i cili bëhet në zbatim të marrëveshjes me donatorët.

**Burimi: Ministria e Finances**

Aneksi nr. 4**TË DHËNA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËN E EFEKTIT NEGATIV FINANCIAR NË TË ARDHURAT DHE TË DËMEVE NË SHPENZIMET SHKAKTUAR BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2011.***Në milionë/lekë*

<b>I. Vlera e efektit negativ me pasojë në të ardhurat e buxhetit:</b>		<b>813.6</b>
1.	Në sistemin e tatimeve dhe doganave	50.6
2.	Në koncensionet	606,9
3.	Në pushtetin vendor përfshi ALUIZNI	155.8
4.	Në sigurimet shoqërore	0.3
<b>II. Vlera e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në shpenzimet:</b>		<b>174.2</b>
1.	Në shpenzimet e personelit	15.0
2.	Në shpenzimet operative	10.3
3.	Në zbatimin e procedurave të prokurimit;	2.9
4.	Në projektet me financim të huaj (pa shpenzimet operative)	49.0
5.	Në pushtetin vendor	24.7
6.	Në sigurimet shoqërore	69.0
7.	Të tjera kryesisht shkaktuar në MTKRS për reklama televizive	3.3

***TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MBI DETYRIMET DEBITORE DERI MË DATËN  
31.12.2011****Në milionë/lekë*

1.	Vlera e detyrimeve debitoare në sektorin e tatimeve (DPT)	64,510
2.	Vlera e borxhit doganor në sektorin e doganave (DPD)	2,959
3.	Vlera e detyrimeve të prapambetura debitoare në ISSH	536.4
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>67,645.4</b>

Aneksi nr. 5

**LISTA E SUBJEKTEVE TË AUDITUAR PËR VLERËSIMIN E SISTEMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT**

1. Ministria e Financave
2. Administrata e Presidencës.
3. Aparati i Këshillit të Ministrave.
4. Ministria e Drejtësisë.
5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
6. Banka e Shqipërisë.
7. Shërbimi Informativ Shtetëror.
8. Instituti i Sigurimeve Shoqërore
9. Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor
10. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
11. Qendra e Publikimeve Zyrtare.
12. Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
13. Agjencia Telegrafike Shqipëtare
14. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë.
15. Drejtoria Rajonale Arsimore Shkodër.
16. Bashkia Elbasan.
17. Bashkia Delvinë.
18. Bashkia Laç.
19. Bashkia Poliçan.

**LISTA E SUBJEKTEVE TË AUDITUAR PËR MBIKËQYRJEN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

1. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave
2. Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës.
4. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
5. Ministria e Drejtësisë.
6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës
7. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
8. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
9. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
10. Instituti i Sigurimeve Shoqërore
11. Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor
12. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
13. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
14. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
15. Instituti i Monumenteve të Kulturës
16. Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës.
17. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.
18. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër.
19. Drejtoria Rajonale Arsimore, Shkodër
20. Bashkia Berat
21. Bashkia Elbasan
22. Bashkia Shkodër

23. Bashkia Lezhë
24. Bashkia Peshkopi
25. Bashkia Ura Vajgurore
26. Bashkia Rrëshen
27. Bashkia Delvinë
28. Bashkia Tepelenë
29. Bashkia Përrenjas
30. Bashkia Laç
31. Bashkia Vorë
32. Bashkia Cërrik
33. Bashkia Peqin
34. Bashkia Bajram Curri
35. Bashkia Rubik
36. Bashkia Maliq
37. Bashkia Shijak
38. Bashkia Poliçan
39. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë
40. ALUIZNI Qendër Tiranë



**FJALORI I SHKURTIMEVE**

<b>AB</b>	Auditi i Brendshëm
<b>ALUIZNI</b>	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale
<b>APP</b>	Agjencia Prokurimit Publik
<b>ARRSH</b>	Autoriteti Rrugor Shqiptar
<b>ATSH</b>	Agjencia Telegrafike Shqiptare
<b>BB</b>	Banka Botërore
<b>BSH</b>	Banka e Shqipërisë
<b>DAB</b>	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm
<b>DAR</b>	Drejtoria Arsimore Rajonale
<b>DAPPB</b>	Drejtoria e Analizave, Politikave dhe Programimit Buxhetor
<b>DIFP</b>	Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik
<b>DKPF</b>	Drejtoria e Kontrollit Parësor e Farmaceutik
<b>DRP</b>	Drejtoria Rajonale e Policisë
<b>DRSSH</b>	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore
<b>DRSKSH</b>	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
<b>DRT</b>	Drejtoria Rajonale Tatimore
<b>DOM</b>	Drejtoria e Operacioneve Monetare
<b>DPPSH</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
<b>DPA</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit
<b>DPAB</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm
<b>DP</b>	Drejtoria e Përgjithshme
<b>DPB</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit
<b>DPMB</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Borxhit Publik
<b>DPD</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
<b>DPT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>DPMA</b>	Drejtoria e Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave
<b>DPSH</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve
<b>DPTH</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
<b>DPUK</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime
<b>DRSSH</b>	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shëndetësore
<b>DSHQ</b>	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
<b>DPISHP</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës
<b>DPSHTRR</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor
<b>DMMB</b>	Drejtoria e Menxhimit dhe Monitorimit të Buxhetit
<b>FSHZH</b>	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
<b>IDA</b>	Organizata Ndërkombëtare për Zhvillim
<b>IT</b>	Teknologji e Informacionit
<b>IMK</b>	Instituti i Monumenteve të Kulturës
<b>ISKSH</b>	Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
<b>ISSH</b>	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikës
<b>ILKDP</b>	Inspektoriati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive
<b>KAB</b>	Komiteti i Auditimit të Brendshëm
<b>KBFP</b>	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
<b>KfË</b>	(Bankë gjermane zhvillimi me kapital shtetëror)
<b>KESH</b>	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
<b>KLD</b>	Këshilli i Lartë i Drejtësisë

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>KMR</b>	Komisioni i Menaxhimit të Riskut
<b>KML</b>	Komisioni Mjeko Ligjor
<b>KM</b>	Këshilli i Ministrave
<b>KSHC</b>	Komisioni i Shërbimit Civil
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
<b>LPP</b>	Ligji i Prokurimit Publik
<b>MASH</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
<b>MB</b>	Ministria e Brendshme
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MI</b>	Ministria e Integritimit
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>MBUMK</b>	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
<b>METE</b>	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar i Kontrollit
<b>MM</b>	Ministria e Mbrojtjes
<b>MMPAU</b>	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
<b>MPJ</b>	Ministria e Punëve të Jashtme
<b>MPÇSSHB</b>	Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta
<b>MPPTT</b>	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
<b>MTKRS</b>	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditit të Brendshëm
<b>NjTPM</b>	Njësia e Tatim Paguesve të Mëdhenj
<b>NJQH</b>	Njësia Qendrore e Harmonizimit
<b>NJQHAB</b>	Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm
<b>NJZP</b>	Njësia të Zbatimit të Projekteve
<b>OJF</b>	Organizata Jo fitimprurëse
<b>OST</b>	Operatori i Sistemit të Transmetimit
<b>OSSH</b>	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
<b>PBA</b>	Programi Buxhetor Afatmesëm
<b>PBB</b>	Produkti i Brendshëm Bruto
<b>QKKF</b>	Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë
<b>QPZ</b>	Qendra e Publikimeve Zyrtare
<b>QKR</b>	Qendra Kombëtare e Regjistrimeve
<b>QSH</b>	Qendra Shëndetësore
<b>QSUT</b>	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>Sh.a.</b>	Shoqëri anonime
<b>SHISH</b>	Shërbimin Informativ Shtetëror
<b>SHSSH</b>	Shërbimi Social Shtetëror
<b>T.v.sh.</b>	Tatimi mbi vlerën e shtuar
<b>UK</b>	Ujësjellës Kanalizime
<b>VKA</b>	Vendimi i Këshillit Administrativ
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>ZABGJ</b>	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor
<b>ZRPP</b>	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme



